

BIBLIOTEKA

8144-31
26523

SPIRO
XHAI

QYTETI
I RI ROMAN



814-31
2623

SPIRO XHAI

X

Q Y T E T I I R I

(Roman)

56686
36042



SHTËPIA BOTUËSE «NAIM FRASHËRI»

I. «NOMADËT» E DITËVE TONA

«Sonte, o i zoti i shtëpisë, të kanë ardhur si mysafirë disa njerëz që merren përjetë me tulla, gurë e qereste dhe kanë ndërtuar kushedi sa pallate secili, po për vete nuk kanë ku të fusin kokën».

(Një personazh i romanit)

Inxhinier Andrea zbriti me nxitim shkallët e Ministrisë së Ndërtimit me një valixhe të vogël e një vandak letrash e projekteve në dorë. Pranë trotuarit e priste një gaz i vjetër, që kishte qëndruar aty që në mëngjes. Motori i maqinës u ndez menjëherë, inxhinieri zuri vend pranë shoferit dhe gazi rrëshqiti lehtë në rrugët e lagura të qytetit. Shiu, që vazhdonte prej dy ditësh, shtrëngoi më shumë. Inxhinieri shikonte i heshtur pikat e shiut, që binin gjithnjë më dendur mbi xhamin e maqinës. Shoferi, të cilët i pëlgente të fliste gjatë udhëtimit, i hodhi disa herë një shikim të shpejtë, po kur pa se ai ishte i menduar dhe serioz, mori me zë të ulët një këngë të vjetër, ndërsa me vete thoshte: «Nuk duket njeri i muhabitet ky. Unë i kam zët këta njerëz. Kushedi sa kohë do të bredh poshtë e lart me të dhe do të bëhem derr. Apo nuk shkojmë në një vend të largët e të panjohur...»

Te kryqëzimi i rrugëve maqina ngadalësoi shpejtësinë dhe mori rrugën e veriut.

— A do të kthehem sonte? — tha më në fund shoferi, sa për të hyrë në bisedë.

— Jo! — ju përgjegj prarazi inxhinieri.

— E di pse tē pyes, inxhinier? Mua më lajmëruan që tē isha gati që në mëngjez dhe tē kam pritur aty jashtë ministrisë pér më shumë se tri orë.

— E kishim pér t'u nisur që në mëngjez, por më lajmëruan pér një takim me ministrin dhe u vonova

— Këto janë gjëra që ndodhin, xhanëm, por unë u gozhdova atje, duke pritur, dhe nuk vajta pér t'u furnizuar me benzinë.

— Pse, s'ke benzinë?

— Kam, pér tē patur por, po tē vonohemi shumë dhe tē bredhim poshtë e lart, mund tē na mbarohet.

— S'mund tē tē them gjë pér këtë.

— Ndoshta gjejmë pak benzinë edhe atje ku do tē shkojmë.

— Atje?! — buzëqeshi inxhinieri.

Shoferi e shikoi si i habitur.

— Po ç'dreq vendi është ky Gurraj! Unë shofer jam, por s'ma ka zënë ndonjëherë veshi.

— Tani e tutje ke pér ta dëgjuar gjithnjë me shpesh.

— Kështu thonë. Edhe unë kam dëgjuar se atje do tē bëhen gjëra tē mëdha. Është e vërtetë, inxhinier?

Inxhinieri tundi kokën në shenjë pohimi, po nuk tha gjë. Shoferi e vështroi një herë me inat, sikur donte t'i thoshte: «Hape zemrën, bre burrë. Fjalosu me shoferin. Si do tē kalohet ndryshe rruga?»

Gazi fluturonte në asfaltin e lagur. Inxhinieri hapi një herë vandakun e projekteve, shikoi diçka shpejt e shpejt dhe u zhyt përsëri në mendime. Nuk i shqitez shin nga mendja fjalët e ministrit: «Do tē mërziteni në fillim atje në Gurraj. Do ta keni shumë vështirë tani në ditët e para, — i tha në çastin e fundit. — Por njerëzit e ndërtimit mësohen shpejt në çdo situatë dhe përballojnë çdo vështirësi. Të thashë edhe më parë se, kur tē aprovojen përfundimisht planet pér qytetin e ri, do tē habiteni edhe ju inxhinierët».

Inxhinier Andrea u mat një herë t'i thoshte ministrit: «Pse nuk presim më mirë gjersa tē përfundojnë e tē aprovojen projektet dhe pastaj t'i përvishemi punës?»

Por ministri, sikur ta kishte nuhatur këtë mendim të inxhinierit, plotësoi: «Ne duam të fitojmë kohë. Ndaj e fillojmë punën në prak të dimrit. Derisa të marrin fund projektet, ju do të keni hedhur bazën e kantierit. Ndaj kemi dhënë urdhër që të nisen për në Gurraj disa specialistë të mirë dhe me përvojë të madhe në ndërtim. Bile ata do të kenë shkuar atje tani...»

Kështu i tha ministri dhe i zgjati dorën me përzemërsi. Në atë çast i erdhi një herë që t'i thoshte: «Mua më ra shorti që të marr përsipër këtë punë të koklavitur? Sikur s'ka inxhinierë të tjerë më të vjetër e më të zot se unë!» Por ministri i buzëqeshi me dashamirësi, dhe ai doli nga zyra pa i thënë gjë...»

Ndërkohë maqina kishte lënë në të djathtë xhadënë e asfaltuar dhe ishte futur në një rrugë të porsahapur e të pashtuar mirë. Gropat e xhadesë ishin mbushur me ujëra të turbullta, që nga balta e vendit kishin marrë ngjyrën e bakrit. Shoferi nuk këndonte më dhe, sa herë që gomat e maqinës zhyteshin thellë në baltë, shante me zë të ulët: «Dreqi e marrtë këtë rrugë të poshtër!..»

Anës xhadesë panë një barrakë të vogël prej dërrash, të mbuluar me letër katrama. Te dera dukej një tabelë e vjetruar, ku mezi lexohej: «Bufo — sende ushqimore». Nga barraka po dilnin dy fshatarë,

— Është shumë larg Gurraj? — i pyeti inxhinieri duke nxjerrë kokën jashtë.

— Përpara e keni, — u përgjegj njëri nga të dy burrat. Ndërkohë shiu kishte pushuar. Fusha, kodrat pëtreth dhe pllaja e malit ishin mbuluar nga një mjegull e dendur.

— E kam zët këtë mjegull, — tha shoferi duke i rënë borisë për të trembur një kope dhish, që u doli befas përpara.

Inxhinieri i hodhi një shikim të shpejtë dhe nuk i foli. Pasi kaluan një kthesë të fortë, panë një ndërtësë të re, që dukej ende e papërfunduar krejtësisht.

— Këtu duhet të jetë Gurraj, — tha si me vete shoferi.

— Nuk besoj, më duket si shkollë, — ju përgjegj inxhinieri. Maqina u ndal pak pranë një ure, ku tre muratorë ndërtonin një mur mbrojtës.

— Këtu është Gurraj? — i pyeti shoferi.

— Jo, — u përgjegj njëri nga ata. — Eeni edhe ca dhe pasi të kaloni një kthesë...

— Ohu! Sa kthesa paska këtu! — murmuriti shoferi dhe i dha gaz maqinës. Pas pak minutash takuan një grumbull njerëzish, që rrinin pranë një çesme, duke pirë duhan e duke biseduan. Më tej nëpërmjet mjegullës dalloheshin disa ndörtesa të mëdha e të vogla.

— Besoj se këtu është Gurraj, — tha inxhinieri, duke zbritur nga maqina.

Njerëzit u shikuan midis tyre si me habi.

— Gurraj? Këtu është Malluna, — foli njëri nga ata.

— Po Gurraj?

— E keni kaluar.

— Si, ore, e kemi kaluar?

Shoferi ktheu menjëherë maqinën, duke murmurit nëpër dhëmbë:

— T'ëmën! Ku erdhëm kështu! A nuk të thashë, inxhinier, se do të jetë ndonjë vend i humbur?

— Me kujdes tani, mos e humbasim përsëri, — tha, duke qeshur inxhinieri. — Kur të shikosh një lis të madh, qëndro.

Pranë xhadesë panë një lis të madh, që ende s'ishte zhveshur krejt nga gjethet.

— Më në fund e gjetëm dreqin, — tha inxhinieri duke zbritur nga maqina.

— Prit një herë të pyesim.

— Kë të pyesësh pa...

— Bobo! Ç'vend i shkretë! — tha shoferi, duke shikuar nga të gjitha anët.

Inxhinieri heshti.

— Janë të vërteta ato që thonë se këtu do të ndërtohet një qytet? — pyeti shoferi tani që bashkudhëtari i tij dukej më i çelur.

— Po. Dhe i madh bile...

— S'është pér t'u çuditur. Po pse zgjodhën këtë vend, or jahu?

Inxhinieri bëri një herë me dorë, sikur donte t'i thoshte se kjo është një histori e gjatë dhe hipi në një sop të vogël. Përpara shtrihej një fushë e madhe e përmbytur nga ujërat e turbullta të vjeshtës. Djathtas dhe majtas ngriheshin valë-valë disa kodra të buta, të veshura me shkurre të braktisura, që prisnin prej shekujsh dorën e njeriut. Prapa kodrave naltohej një mal madhështor i mbuluar me pyje të dendura, që në këtë kohë vjeshte, kishin marrë një bukuri të veçantë. Majë kodrave dalloheshin aty-këtu kulla të bardha e të larta, me dritat e vogla, që, sikur të ishin sytë e malit, vëzhgonin e përgjonin xhadënë e ngushtë dhe fushën e gjerë... Prapa sopit, ku qëndronte inxhinieri, shtrihej një moçal i cekët, ku kullosnin një tufë kuajsh. «Tërë moçale dhe pyje qenka ky vend, — tha me vete inxhinieri. — Sa vëشتirë do të jetë që të ndërtosh këtu një qytet të tërë!» Edhe shoferi u habit kur e pa. Qytetet ndërtohen zakonisht pranë lumenjve të mëdhenj, ose pranë gjireve të detit; kështu thonë librat, të paktën. Por këtu nuk ka as ndonjë lumë të madh dhe as ndonjë gji deti, të mbrojtur nga erërat... Ndoshta është pozitë kyçë, se këtej degëzohen rrugët drejt veriut... Po ç'më intereson mua kjo gjë? Unë qaj hallin tim, që kushedi sa vjet do të rroj këtu, në mes të këtyre pyjeve të egra dhe të këtyre moçaleve. Dhe kur pa... Në lulen e rinisë! Pastaj thonë se tani s'ka më fat! Si, ore, s'ka fat? Përse të vij unë këtu e jo një tjetër? Nga projektet e pallateve të reja, që vizatoja gjer dje në letër, tani e tutje do të merrem me ndërtimin e barракave të një kantieri të humbur në fund të dynjasë...»

Befas prapa tij u dëgjua një bisedë. Ktheu kokën dhe pa shoferin, që bisedonte me një djalë, i cili kulloste aty pranë një tufë të vogël lopësh.

— Ku doni me shkue? — e pyeti djali shoferin.

— Ne do të qëndrojmë këtu, në Gurraj.

— Erdhët me ble ve?

— Hë, tani i ke rënë në të! Inxhinier! — thirri

me të madhe shoferi. — A do të blesh vezë ti?

— Po si, ore, ne për këtë kemi ardhur, — ju përgjegj inxhinieri duke u vajtur pranë. — A thua se ka vezë këtu?

— Sa të duesh, — ju përgjegj djali.

— Unë dua njëmijë, — tha si me shaka shoferi.

— Edhe dymijë, po të duesh... Jep paret ti, pa t'i sjell unë në dekikë. .. Këtu vijnë nga qyteti përditë për me ble ve, pula, bagëti. Prisni edhe ca ditë hala, sa të vijnë rosat.

— Domethënë, paska edhe rosa, — tha shoferi.

— Rosa? Dynja! Sa të nisin ngriçat e para, zgresin ato këtu në fushë tufa-tufa dhe ne i vrasim.

— Si të quajnë ty? — e pyeti me interesim inxhinieri.

— Pashk.

— S'do të ishte keq sikur të kishim tanë ca vezë të ziera dhe ndonjë rosë të pjekur, — tha me gjysmë zëri shoferi.

— Të mori uria, shofer?

— Kam që në mëngjez pa ngrënë.

— Me sa duket sot do të agjerojmë.

— Pse, këtu do të rrimë?

— Ne për këtu jemi nisur.

— Po ku do të hamë? Ku do të flemë?

Inxhinieri ngriti krahët pa folur. Shoferi e shikoi një herë si me habi dhe u bë gati t'i thoshte diçka, por në atë çast filluan të binin pika të mëdha shiu dhe ata u drejtuan nga maqina.

Inxhinieri u fut pas tij në maqinë. Për një kohë të gjatë qëndruan pranë e pranë, duke dëgjuar në heshtje pikat e shiut, që binin mbi mushamanë e maqinës.

— Po ngryset, — ndërpren i pari shoferi heshtjen.

— Jo, ashtu duket nga vranësira.

— Është edhe nga vranësira, por mos mendo se është shpejt. Tani në vjeshtë ngryset shumë shpejt.

Inxhinieri nuk foli. «Do të kalojnë vitet, — thoshte me vete, — qyteti do të jetë ndërtuar dhe këtu mbi këto moçale do të ngrihen pallate e fabrika. Këtu ku rrimë

ne taní, do tē kalojnë me shpejtësi maqina. Atje matanë do tē ngrihet silueta e uzinës. Njerëzit do tē qarkullojnë pcshtë e lart trotuarëve modernë. Por a do ta dinë vallë, që tē parët kanë ardhur këtu me një maqinë tē vogël, një shofer edhe një inxhinier?»

«I çuditshëm éshtë ky njeri, — thoshte me vete shoferi. — Rri i qetë dhe nuk flet. Ndoshëta mérzitet edhe ai, por mérzitet e mbani brenda. Prapë nuk besoj tē mérzitet sa unë. Mendja i punon për diçka. Thonë se këta inxhinierët edhe kur flenë, èndërrojnë pallate dhe godina tē reja...»

— Ahaa! u mérzita shumë, — psherëtiu shoferi.

— S'ke ç'bën. Kështu e kanë këto punë: duan durim.

— Unë nuk kuptoj përsë rrimë këtu.

— Presim njerëz.

— Nga do tē vijnë ata? — pyeti me interesim shoferi.

— Nga Kurbneshi.

— Po ku janë, se?

— Vërtet, u vonuan... Si e ke emrin ti, shofer?

— Postol, — ju përgjegj ai me qejf, sikur donte t'i thoshte: «Hë de, hape gojën, folë që tē kalojë koha».

Përsëri ra heshtja. Po errej. Shiu vazhdonte tē binte pa pushim.

— Dikush po vjen! — tha me gjallëri shoferi dhe ndezi dritat e maqinës. Në mes tē shiut dalluan një burrë tē gjatë, me pantallona tē gjera doku e me një mushama tē zezë e tē gjatë. Burri po vinte me nxitim drejt maqinës.

— Nga Tirana vini ju? — pyeti i panjohuri para se t'i afrohej mirë maqinës.

— Po, — ju përgjegj Postoli.

— Ne kërkojmë inxhinier Andrenë.

— Unë jam Sefedin Badra, teknik ndërtimi — Urdhëro këtej!

— Unë jam Sefedin Badra, teknik ndërtimi, — tha përsëri burri, duke zgjatur dorën.

— Ku jeni, bre burrë, ku jeni! Ne ju prisnim.
Futu brenda!

— Keni shumë kohë këtu?

— Nja tri orë.

— Edhe ne do të vinim më shpejt, por qe prishur një urë në një përrua dhe mezi e ndreqëm, sa për të kaluar.

— Ke edhe shokë?

— Posi. Kam katër pesë veta.

— Ku janë shokët tani?

— Atje te kthesa. Kemi sjellë edhe tre kamiona me materiale.

— A nuk shkojmë edhe ne atje, Postol? — ju drejtua shoferit. — Jepi!

Mbas dy minutash gazi qëndroi përbri tre kamionave të ngarkuar me dérrasa, trarë, thasë çimento dhe materiale të tjera. Nga kabina e kamionit të parë dolën tre vetë të veshur me kominoshe të vjetëruara. Inxhineri zbriti nga maqina dhe u përshëndet me ta në mes të xhadesë, duke përsëritur:

— Mirë se erdhët, shokë, mirë se erdhët!

— Janë specialistët tanë, — tha Sefedini, pa përmendur emrat e tyre.

— Mirë se na erdhët edhe ju! — tha ai më i vjetri në moshë, të cilin të tjerët e thërrisin shkurt: usta Jorgji.

Shiu sa shkonte shtrëngonte më shumë.

— A nuk futemi në gaz, — propozoi inxhineri.

— C'të bëjmë në maqinë? — pyeti Sefedini.

— Të bëjmë kuvendin e parë për qytetin që do të ndërtojmë, — bëri shaka usta Jorgji, duke zënë vend në fund të maqinës. Shokët e tij qeshën. Edhe inxhiner Andrea vuri buzën në gaz e shikoi me dashamirësi punëtorin e kaluar nga mosha, që mbante gjithnjë një cigare anës së buzëve dhe e thithte vazhdimisht pa e hequr nga goja.

— Tani qeshim, po të shohim ku do të flemë sonte,

— tha njëri nga specialistët.

— Vërtet, kjo maqinë s'na merr as kështu ndenjur,

— shtoi Sefedini.

— Çështë ajo godinë e madhe majë kodrës? —
pyeti usta Jorgji.

— Është kishë, — ju përgjegj Postoli.

— A nuk shkojmë t'ja zëmë priftit sonte?

— Jo, usta Jorgji, nuk bën. Më mirë të shkojmë te ndonjë fshatar, — foli njëri nga specialistët.

— Gjer te kisha ju çoj unë me maqinë, — u propozoi Postoli.

U dëgjua uturima e motorit dhe gazi ju ngjit së përpjetës, gjer te sheshi i madh përpara kishës. Nga zhurma e maqinës një prift trashaluq doli te dera e kishës dhe u hodhi një shikim hetues të panjohurve, që zbritën nga maqina.

— Me siguri që na ka marrë si të dërguar të djallit,

— tha me seriozitet Sefedini.

Burri i trashë u fut në kishë, duke mbyllur derën me rrëmbim.

— Edhe sikur ta lësh hapur, nuk të vijmë. Mos ki frikë hiç, — tha si me vete Sefedini, duke shikuar nga ana e priftit.

— Dëgjo Postol, — tha inxhinieri duke qëndruar në vend. Është mirë që ti të nisesh për në Tiranë sonte.

— Me gjithë qef, inxhinier.

— Të pëlqen, ë? Po nesër në mëngjez të jesh këtu, ama.

— Që me natë. Ta ndez motorin?

— Prit të shkruaj dy fjalë.

Nën dritën e fortë të maqinës inxhinieri vuri vandakun e letrave imbi gjunjë dhe shkroi në një fije flitoreje:

«Ministrisë së Ndërtimit»
(Drejtorisë Operative)

TIRANE

Mbërritëm në vend dhe u takuam me teknikun që erdhi nga Kurbneshi. Por ai ka sjellë me vete disa

materiale dhe vetëm tre specialistë. Ç'mund të bëjmë me këto materiale dhe me tre punëtorë? Ne këtu s'kemi asgjë dhe na mungon çdo gjë.

Inxhinier
Andrea Nasho»

— Po niset lajmi i parë nga qyteti i ri, — tha usta Jorgji, ndërsa inxhinieri i dorëzonte letrën shoferit.

— Ama qytet i thënçin, — tha Postoli duke kthyer maqinën.

— Do të vijë një ditë që do tă bëhet. More vesh?

Gazi u nis me shpejtësi dhe pas pak u zhduk në errësirën e natës. Po në atë çast inxhinier Andrea, Sefedini, usta Jorgji dhe të dy specialistët e tjera lana kishën prapa dhe morën një rrugë të ngushtë, që të çonte në lagjen më të afërt të fshatit.

2

Në kullën e parë që takuan pranë rrugës, trokitën në derë dhe u futën brenda të gjithë. I zoti i shtëpisë, një mesoburrë me mustaqe të mëdha e të dredhura, i priti sipas zakonit, sikur t'i njihte prej kohe dhe sikur ta dinte që do t'i venin në shtëpi pikërisht atë natë. Në dhomën e miqve u ulën të gjithë këmbëkryq rrëth zjarrit të madh, që brambullonte në oxhak. Kandili, i vendosur mbi qemerin e oxhakut, sa herë ndizej flaka në vatër, humbiste si hëna në dritën e diellit.

— Sonte, o i zoti i shtëpisë, — ja nisi usta Jorgji shtruar, — të kanë ardhur si mysafrë disa njerëz që merren përjetë me tulla, gurë e qereste dhe kanë ndërtuar kushedi sa pallate secili, po për vete nuk kanë ku të fusin kokën.

— Mikut, që i bie rruga këndejej, e gjen gjithnjë të hapun derën te ne, — tha i zoti i shtëpisë duke u vënë përpëra nga një faqore me raki...

— Ne nuk jemi kalimtarë. Kemi ardhur këtu për të lëshuar rrënje të thella në këto dhera...

— Po çfarë do të bani këtu? — pyeti me kureshtje i zoti i shtëpisë.

— Do të ndërtojmë një qytet të ri...

— Usta Jorgji vazhdonte të fliste, kurse i zoti i shtëpisë e dëgjonte i menduar. Edhe të tjerët e dëgjonin me vëmendje ustanë. «Ama, brisk e ka gjuhën

— thoshte me vete inxhinier Andrea. — Dhe sa bukuri rrëfen, qerratai. Si shumë i rrahuar duket në këto gjëra.»

— Kështu, o i zoti i shtëpisë. Si e ke emrin? — përfundoi hyrjen e nevojshme usta Jorgji.

— Pal, — u përgjegj fshatari.

— S'të mbushet mendja, o Pal, për këto që të thashë?

— Besa, si një përrallë më ngjan. Vjet a parvjet erdhën këtu disa të huej dhe shponin tabanin e tokës. Asokohe u përhapën edhe fjalë se gjasme këtu do të bahej nji fabrikë e madhe. Por ata u zhdukën dhe nuk u ba gjia...


— Të huajtë janë si mysafirë, o Pal, kurse ne jemi të kësaj toke dhe këtu që erdhëm, do të lëshojmë rrënje të thella. More vesh? Ja, këtu kemi edhe inxhinierin, — tha usta Jorgji, duke treguar inxhinier Andrenë. — Ato letra që ka në dorë tregojnë se si do të jetë qyteti i ri dhe fabrika e madhe...

— Këto kartra këtu? — tha me mosbesim Pali.

— Këtu është vetëm plani i vendit ku do të ndërtohen barrakat, — tha si i turpëruar inxhinieri, duke treguar vandakun e letrave.

— S'ka gjajle; barrakat janë si fara, prej nga do të mbijë më vonë bima... More vesh?

— Vërtet, o inxhinier, nuk do të ishte keq t'u hidhnik sonte një sy këtyre. Kjo ka rëndësi, — tha Sefedini dhe pa pritur përgjegje mori vandakun e skicave dhe e hapi mbi gjunjë. I zoti i shtëpisë u përkul mbi ato letra të murme e të mëdha si çarçafë, pa disa via e kuti si lodra fëmijësh dhe tundi kokën pa shprehur asnje mendim, ndërsa me mendjen e tij thoshte me



siguri: Pallatet dhe fabrikat ngrihen me gur e me dërrasa e jo me kartra e me lapsa. Mos ju shkon mendja se do të ma hidhni mue që jam katundar? !»

Në oxhak zjarri bubulak brambullonte duke lëshuar tufa xixash. Një xixë u hodh lart dhe ra mbi skicat e hapura. Menjëherë një fjollë tymi u ngrit nga letra që po digjej. Sefedini nuk e vuri re, por e shkundi i zoti i shtëpisë dhe ai zgjati dorën dhe e fiku aty për aty.

— Do të na djegësh planimetrinë dhe nuk do të dimë nga ta fillojmë, — i tha inxhinieri. — Lëri më mirë, mbylli. Ku ke voli këtu për t'i shikuar? Nesër shohim një herë terrenin, pastaj u vjen radha këtyre.

— E di si është puna, inxhinier? — tha duke qeshur usta Jorgji. — Sefedini e ndërtoi fët e fët fabrikën dhe nga oxhaku i saj doli edhe tymi. E pe se si ngrihej?

Të tjerët qeshën, kurse Sefedini palosi shpejt e shpejt projektet dhe i mbledhi përsëri ashtu siç ishin.

Kur ranë për të fjetur, inxhinieri vuri vandakun e skicave nën jastëk. Kjo ishte pasuria e tyre më e çmueshme. Kur të gdhihej dita e re, me këto në dorë do të fillonin punën për ndërtimin e qytetit të ri...

3

Në mëngjez u përshëndetën me të zotin e shtëpisë dhe morën tatëpjetën drejt xhadesë, ku i priste një punë e madhe dhe e vështirë. Qielli gjatë natës ishte kthjeilluar. Toka zbardhte nga bryma e parë. Bënte ftohtë.

Kur mbërritën në xhade, pamë se shoferi i njërit prej kamionave, që kishte fjetur atje, kishte hapur kapakun dhe vajiste motorin.

— E, Prokop, si u gdhive? A preve shumë gozhdë natën? — e pyeti Kola.

— Jo, për besë! Isha shumë i lodhur dhe fjeta top. Po ju?

— Mrekulli. Zjarr në oxhak, muhabet, raki dhe gështenja të pjekura.

— Tallesh?!

— Jo, bre, e kam me gjithë mend. Të kesh usta Jorgjin me vete dhe të ngelësh ngshtë në fshat?

— Hajde, djema! — tha si duke urdhëruar Sefedini.

— O burrani, të shkarkojmë maqinat. Kjo ka rëndësi.

— Pse të harxhojmë forcat kot? — kundërshtoi inxhinieri. — Të kontrollojmë një herë terrenin, të caktojmë vendin e barrakës së parë dhe pastaj t'i shkarkojmë materialet.

— Kjo s'prish punë.

— Inxhinieri ka të drejtë, — ndërhyri specialisti tjeter, që quhej Fatmir dhe që gjer atëhere kishte folur fare pak.

Ranë në ujdi, që të caktonin vendin e barrakës së parë. Matanë xhadesë qe një lëndinë e gjerë, e mbluar me bar të njomë vjeshtë dhe e rrëthuar me ferra të mëdha.

Inxhinieri hapi vandakun e skicave të planimetrisë. Sefedini nxori menjëherë metrin.

Kjo barrakë është dymbëdhjetë me katër, — tha inxhinieri.

— Unë them që punën të mos e fillojmë me këtë barrakë të madhe, — propozoi Fatmiri. — Më mirë t'ja nisim punës me një më të vogël që ta mbarojmë të pak-tën atë sa të fusim kokën brenda.

— Afër mendjes që kështu duhet bërë, — ja përforcoi mendimin usta Jorgji. — Ne kemi nevojë për hotelin tonë. More vesh?

— Pa dale ato skica, inxhinier? — zgjati dorën Sefedini.

Tek i shfletonte me ngutje, i rrëshqiti një nga dora dhe ra në kanalin e ujit që kalonte anës xhadesë.

— Ma lage projektin, Sefedin! — i thirri inxhinier Andrea.

— Duket deshi të fikte atë zjarr që ndezi mbrëmë...

— qeshi përsëri usta Jorgji.

— Tallu ti, usta Jorgj, tallu, nuk na qan hallin që s'kemi një stol sa për të vendosur letrat!

— Stol? — tha si i menduar Fatmiri dhe u largua pa thënë gjë

— Sefedini nxori skicën nga kanali e shkundi nga gjethet e verdha që ishin ngjitur në letrën e trashë, pastaj e mbërtheu te trungu i një fiku të moçëm, që të thahej.

Inxhinier Andrea nxori metrin e vet dhe mati me shpejtësi terrenin.

— Ja, gier këtu, tha duke ngulur një kunj.

— Po kumbulla? — pyeti usta Jorgji.

— Kumbulla dënohet me vdekje.

— E shkreta! A s'mund ta fillojmë gjysmë metër më tutje, që ta shpëtojmë nga sëpata? Që ta kemi edhe si kujtim, bre dialë!

— E bëjmë, pse jo? Por unë çuditem pse të dhimbset kaq shumë kjo kumbull e zgjebosur.

— Ajo nuk është e zgjebosur, inxhinier, po ka mbirë pranë xhadesë dhe ka hequr shumë, si nga kafshët edhe nga njerëzit. Shiko si ja kanë rjepur lëkurën! Në pranverë, ama, kur do të çelë lule, do të më kujtosh.

— Mirë, pra, ja ta plotësova dëshirën, — i tha inxhinieri, duke vendosur kunjin nja një metër larg kumbullës.

Disa kunj të vegjël prej druri u ngulën në këtë tokë djerre në distanca të caktuara. Kështu filloi ndërtimi i qytetit. Matanë një pérroi të cekët, një plakë fshatare kullosë një tufë të vogël dhensh, duke tjerrë një shtëllungë të madhe leshi të bardhë. Ajo i shikonte me kureshtje, se si silleshin poshtë e lart, duke ngulur në tokë kunj të vegjël druri dhe dukej sikur thoshte: «Nga kanë ardhur këta burra të çuditshëm? Dhe ç'janë tue mbjellë kështu në këtë djerrin?»

— M'u ça hunda pér një cigare, — tha Kola.

— Nxirre ta ndezim një herë, — i tha Sefedini.

— Ç'e do. S'kam shkrepse.

— Më duket se ajo godinë atje poshtë do të jetë mulli. Ja ku janë mbledhur disa fshatarë, do të shkojnë ta ndez një herë, — tha në fund Kola dhe u nis drejt

një godine të vogël, ku hynin e dilnin disa njerëz; jashtë në lëndinë dukeshin ca kuaj të lidhur anës murit.

— Kur të kthehet Kola, ta pimë me radhë, që ta mbajmë gjithnjë të ndezur oxhakun, — propozoi Sefedini.

— Në kësi vendesh urori të shpëton, — tha usta Jorgji. — Por ç'e do? Më duket se e kam harruar atje në Kurbnesh.

— Kush të tha që të bëhesh edhe ti allafrënga? — deshi ta ngacmonte Kola.

— Cigaren e siguruat tani, po të shohim si do të bëjmë në drekë për bukë, — tha inxhinieri.

— E po çdo fillim është i vështirë, inxhinier. Ç'të bëjmë? Ja kështu e ka puna jonë. Sot këtu e nesër gjetkë. Të të them edhe diçka tjetër tani? Këtu është lule, ke xhade, ke maqinë. I hipën maqinës dhe shkon ku të duash. More vesh? Pa mendo tani sikur ky kantier të ngrihej në mes të pyllit, larg rrugëve e larg fshatrave!

Inxhinieri e shikoi një herë usta Jorgjin, sikur ta shihonte për herë të parë dhe heshti.

— Pse më shikon ashtu?

— Jo, kot.

— Ti nga shkolla vjen drejt për së drejti, or djale?

— Jo, kam nja tre vjet që kam marrë diplomën.

— Po ku ke punuar gier tani?

— Në drejtorinë e projekteve. Atje ku bëhen këto, — ju përgjegj duke i treguar disa letra planimetrie gjysmë të hapura për tokë.

— Në kantier për herë të parë vjen?

— Po.

— E po atëhere tani e fillon punën tamam. Po pa na pyet ne. Kemi gjezdisur gjysmën e Shqipërisë. Dhe kemi hequr boll, besa. Mbaj mend kur ja nisëm punës në Kurbnesh. Fjetoren e parë e ndërtuam në mes të borës. Dhe e di sa borë bie atje? Mbi tre metra. E që thua ti, inxhinier, ajo fillon në tetor dhe shkrin në qershor. Dhe buka na vinte prej së largu. Me hajvanë. Po, ore, me mushka. Dhe rrugës ngrinte e bëhei kallkan.

Natën tē ftohtit tē hynte nē kockë. Ne mblidheshim nē barrakēn e parë, që kishim ndërtuar, ndiznim një zjarr tē madh dhe rrëfenim meselera nga puna jonë nēpër kantieret e tjera. Sepse gjithë ato giéra tē mëdha që janë bërë këtu tek ne, nuk janë bërë vetvetiu, de, as që kanë mbirë nga toka. Çdo tullë e çdo gur është vendosur nga një dorë njeriu, nga një njeri i ndërtimit, e çdo mur e çdo ndërtesë kanë nē themel pika djerse. More vesh? Nejse, që tē mos e zgjatim, kur binim nē dyshek rrinim roje me radhë.

— Roje kundër tē ftohtit? — tha si me tē qeshur inxhinieri.

— Po, po, kundër tē ftohtit. Ç'kujton ti?

— E po ç'bënte roja juaj? Rrinte te dera me pushkë nē dorë që tē mos hynte tē ftohtit?

— Roja, vëllaçko, rrinte zgjuar pér tē ushqyer zjarrin me dru. Nē mes tē dhomës kishim një alamet fuçie, që merrete brenda trungje tē mëdha, si tē atij lisi atje. Por do ti që tē ftohtit i thithte menjëherë? Ai që kishte radhën e rojës, hidhte trungje tē tjëra. Se po tē shuhej zjarri, do tē shuheshim edhe ne. Dhe gjuha e usta Jorgjit, që llap ditë e natë, do tē kishte pushuar me kohë. More vesh?

Kola u kthye me cigare tē ndezur. Piketimi i parë kishte marrë fund.

Papritur Fatmiri foli me zë tē qetë:

— Ju bëra një tavolinë tē vogël, sa pér tē vendo-sur projektet.

— Oh! Sa mirë. Tē lumshin duart. Fatmir! — tha i gëzuar inxhinieri.

— Këtu mund tē hamë edhe bukë, — tha usta Jorgji.

— Mirë po s'kemi ku tē ulemi.

— Pér t'u ulur pasdite do tē bëj disa ndenjëse, — tha me thjeshtësi Fatmiri.

Të gjithë e shikonin tavolinën me radhë, sikur tē shihnin pér herë tē parë një gië tē tillë. Ishte mobilja e parë, që kishte dalë nga duart e Fatmirit këtu në Gurraj. Mbi tavolinën e vogël inxhinieri hapi skicat. Pér një cast ju duk sikur s'kishte përpara disa copa

letrash të vizatuara; para syve të tij u naltuan pallate shumëkatëshe dhe oxhaqe fabrikash.

— O burrani, shokë, të shkarkojmë kamionat! — thirri Sefedini. Dy vetë hovën në karroceri; të tjerët u ngarkuan me trarë, dërrasa e materiale të tjera për t'i çuar atje ku ishin vendosur piketat. Inxhinieri ndjeu një dhëmbje në shpatull nga një tra i madh që po mbarte; por e rregulloi ca më mirë në sup dhe e çoi në stivën e qerestesë, që rritej gjithnjë më shumë. Sefedini fshihte me dorë ballin e djersitur. Disa pika djerse ranë në tokën e lagur. Inxhinieri e shikoi një herë si i menduar dhe tha me vete: «Kjo është boja me të cilën do të shkruehet historia e këtij qyteti.»

4

Usta Jorgji preu bukën bajate në pjesë të barabarta, i vuri secilës sipër nga një copë sallam dhe ua ndau të gjithëve me radhë.

— Ky është mëngjez apo drekë? — e pyeti me shpoti Kola.

— Ha tani, Kolë, dhe léri llafet; punëtorët e ndërtimit nuk hanë me vakte. Kur u bie në dorë bukë, hanë, kur u del përpara një dërrasë, e zdrukthojnë, dhe kur gjejnë gurë, ngrenë një mur. More vesh?

Pas buke ju përveshën menjëherë punës për hapjen e gropave, ku ku do të nguleshin shtyllat e barrakës së parë. Para se të errej, kishin ngritur dy rreshta me trarë.

— Po tani? — tha inxhinieri duke shikuar nga ana e Sefedinit.

— Tani do ta lëmë për nesër, — ju përgjegj në vend të tij usta Jorgji.

— S'na erdhi edhe Postoli me gazin.

— Postolin pret ti? S'të vjen sonte ai, mblidhe menjen.

— Si cre s'vjen? Unë pres përgjegje nga ministria.

— Mirë, mirë, prit ti. Sikur ka vetëm hallin tonë ministria.

— Hipën në kamion dhe u nisën për në Mallunë, që të hanin darkë. Kur u kthyen, errësira e natës kishte mbuluar çdo gjë. Trarët e barrakës së papërfunduar, të ngulura në tokën djerre. dukeshin si skeleti i një përbindshi.

— Unë do të fle këtu, — tha Fatmiri.

— Si, si? — u habit usta Jorgji. — Këtu do të presësh tre karroqe gozhdë, or djalë, more vesh?

Të tjerët u nisën pér në fshat, pér te shtëpia e Palit, i cili i kishte ftuar të shkonin përsëri. Usta Jorgji kishte blerë në Mallunë një qeskë karamele pér fëmijët e Palit.

Në shtëpinë e Palit i pritën shumë ngrohtë. Bashkë me të jatin hynë në dhomë edhe të dy çunat e rritur.

— Ju e paskeni tundë, bre burra! — u tha me buzë në gaz i zoti i shtëpisë, sapo zunë vend rrëth vatrës.

Ata u shikuan midis tyre si me habi.

— E kam fjalën pér ata trarët që keni ngritun atje te Stanet, — shtoi ai.

— Ou, sa gjëra keni pér të parë tani e tutje, o Pal! — e mori fjalën usta Jorgji. — Kjo që pe ti sot, e ato gjëra që do të bëjmë në këto ditët e para, do të jenë si ai tharmi, si i thoni ju këndej; pastaj vjen puna e brumit që bëhet bukë. More vesh?

— Demek keni me qëndrue shumë kohë këtu tek ne.

— Ne, vëlla, do të ngulemi këtu më thellë se ata trarët që ke parë ti atje te vendi i Staneve. Qytet ma!...

— Pse ju katër-pesë vetë keni me e ndërtue qytetin?

— Ohu! Sa do të vijnë këtu! Prit edhe ca ti e do të shohësh... Pastaj do të marrim punëtorë edhe nga fshatrat...

— Tatë! — klithi papandehur çuni më i madh i Palit, që nga shtati dukej burrë.

Të gjithë kthyen sytë nga ai.

Pali i hodhi një vështrim të rrëptë të birit e pastaj u kthyte nga miatë.

— Kam pesë çuna, or miq. Këta të dy janë ma të

rritunit. Ky ma i madhi, Gjeta, kërkoi me ikë prej shtëpie për me gjetë punë andej nga Ulza. Po a di ç'na ndodhi? Na plasi grindja në shtëpi. Nuk deshën as nana ime as grueia.

— Gjyshja nuk deshi, — u hodh e tha Gjeta.

— Mbylle gojën ti, Gjetë! E që thoni ju, plaka nguli kambë: «Puna e tokës, puna e parmandës asht e bekume nga perëndia.»

— Unë i thashë: «Dëgjo moj nanë, kena dy djemtë rrithun, njeni të rrijë me parmandë, tjetri të mësojë një zanat». Mirë por plaka na e preu shkurt dhe puna e Gjetës ngeli...

— Gjyshja shkon me kandarin e vjetër, — tha me një frymë Gjeta. — Ajo, kur dëgjon ato që fliten për qytetin, që ka me u ndërtue këtu, thotë: «Këto janë punë të djallit».

— Pusho ti, Gjetë, — i tha me ashpërsi i ati.

— Kështu thotë edhe prifti, — tha djali i vogël, që gjer në atë çast s'kishte hapur gojë fare.

— Kush ta tha ty këtë, or trim? — e pyeti me interesim Kola.

— Unë e dëgjova me veshët e mi. Prifti ka pasë ardhë këtu.

— Na ka gjetë belaja me këta kalamaj, — tha si i menduar Pali. — Çdo gja që ndodh në shtëpi, e nxjerrin sheshit.

— Hiç mos u mërzit, ti, Pal! Këto janë gjëra që, ku më shumë e ku më pak ndodhin kudo. More vesh? Ohu! Sa myk ka ende në mendjen e njerëzve! Kemi ne myk në kokë, që shohim përditë gjëra të reja, e jo një grua plakë, që s'ka dalë kurrë nga fshati...

Inxhinier Andera e shikonte usta Jorgjin duke tundur lehtë kokën, sikur donte t'i thoshte: «Mirë e ke, usta; i ke rënë në të. Shumë fantazma të së kaluarës enden akoma këtyre anëve. Ndaj do të na bjerë edhe neve barra që të luftojmë kundër tyre.».

— Po ti, si thua, Gjetë? A do të vish të punosh me ne? — ju drejtua djalit usta Jorgji.

— Qysh nesër, — ju përgjegj me gjallëri Gjeta.

— Po lejen e gjyshes e more? — i tha si me shaka

Kola.

— Tani që erdhët këtu, s'më mban dot kush.

Të nesërmen u ngritën që me natë. Kishin ardhur pesë vetë, kurse tani që po niseshin nga shtëpia ishin, bërë gjashtë.

Kur u afruan te «qendra» — kështu e quanin tani vendin ku do të ndërtohej barraka e parë — panë prej së largu Fatmirin, që sillej poshtë e lart që të ngrrohej.

— Bëra një si çadër me batanije, — u kallézoi, — dhe fjetë mirë nja dy orë. Por pastaj fryu veriu, i ngriti batanijet në hava dhe unë ngela si zogu jetim, kur i prishet foleja.

— S'është punë kjo; t'i përvishemi punës kështu siç jemi, që të ndërtojmë barrakën tonë, — tha Kola.

Dielli ende s'kishte shkrepur në majat e maleve, kur në qetësinë e mëngjezit u dëgjua sharra dhe sqepari i ndërtuesve. Inxhinieri mori edhe vetë një sharrë dhe nisi të sharrontë dërrasat e gjata në masën që nevojiteteshin, ndërsa me vete thoshte: «Çudi. Kështu fillon ndërtimi i qyteteve?! Me tre-katër vetë e me një djalë, që morëm nga fshati? Shiko me ç'gjallëri punon usta Jorgji! Sikur të jetë djalë njëzetvjeçar. Po Fatmiri? Po Kola? E kuptojnë vallë se tani janë duke ndërtuar godinën e parë të një qyteti të ri? Do të vijë një ditë që për ta do të shkruhen libra dhe do të xhirohen filma. Dhe ai sqepar që mban tani në dorë usta Jorgji, do të jetë, ndoshta, objekti që do të tërheqë më shumë vëmëndjen e vizitorëve të muzeumit të këtij qyteti industrial».

Dielli ishte ngritur lart kur mbërriti gazi nga Tirana.

— Ju lumshin krahët! — u tha Postoli duke zbritur nga maqina, — ju po ndërtoni alamet barrakë.

— Kjo është si kokrra e parë e farës, që bie në tokë, — foli i pari usta Jorgji.

— Po ti ç'u bëre, Postol? — e pyeti me inat inxhinieri.

— Dje në mëngjez vajta në ministri dhe dorëzova

letrën; pastaj u furnizova me benzinë. Kur u ktheva në ministri, më thanë: »Eja pasdite të marrësh pergjegjen». Urdhëro tani letrën.

— Në Tiranë e ke nusen, or djalë? — ndërhyri usta Jorgji.

— Po, në Tiranë.

— Hallall të qoftë!..

— Kemi lajme të mira, — tha inxhinieri, pasi lexoi shpejt e shpejt letrën.

— Të gjithë u kthyen nga ai me sqeparë në duar.

— Ata të ministrisë shkuajnë se për së afërm do të vinë këtu forca të tjera nga hidrocentrali dhe nga Kurbneshi. Kështu që punimet tek ne do të marrin hov të madh. Vetëm një gjë kërkojnë nga ne. Të përfundojmë sa më parë disa barraka. Kështu që, kur të vijnë forcat e reja, të gjejnë të paktën vend për të fjetur.

— Dhe një lokal për të ngrënë bukë, — shtoi Kola. — Që të mos bëjnë njëzet kilometra rrugë për një pjatë gjellë.

— Ne jemi si ata stanaresh, që shkojnë nga kullotat verore në vërrri, — tha duke qeshur usta Jorgji, — atje ku hanë drekën, nuk bie të hanë darkë.

5

— Postol, — mos të ndodhet ndonjë aspirinë? — thirri inxhinier Andrea, aty nga dreka.

— Të dhemb koka, o inxhinier? — e pyeti Fatmiri.

— Nuk di pse më zuri një dhembje e fortë.

— Do të jetë nga pagjumësia.

— Unë them se do të jetë nga uria, — plotësoi usta Jorgji.

Postoli u nis për në Mallunë dhe u kthye shpejt, duke sjellë, përvëç aspirinave dhe dy bukë të mëdha, sallam, djathëtë dhe hudhra, siç e kishte porositur usta Jorgji në çastin e fundit.

— Të shtroj drekën këtu mbi dërrasa? — pyeti ai duke hapur trastën.

— Jo, kemi tavolinën e Fatmirit, — i tha Sefedini.

Vunë disa copa dërrasa si stol anës tavolinës dhe u ulën të gjithë pér të ngrënë drekë. Në fillim hanin të heshtur. Pak nga pak u ndez biseda. Inxhinier Andrea hante tok me ta, dëgjonte shakatë dhe thoshte me vete: «Po filloj një jetë të re, që ndryshon fund e krye nga ajo që kam bërë gjer tani. Kjo jetë është shumë e vë-shtirë, e rendë, po bukën e ka të ëmbël ama...»

— Hajdeni, burra! Ngrihem i shpejt e shpejt që të vazhdojmë, se do të na zejë nata dhe do të mbetemi gjene pa strehë. — thirri Sefedini duke u ngritur i pari.

— Njëri nga ne të hipë lart që të vendosë kaprilitat, — tha usta Jorgji.

— Hip ti lart, usta.

— Si urdhëroon! — tha usta Jorgji dhe u kacavjerr si djalë në catinë e barrakës.

Për nja dy-tri orë punuan me ngulm, pa hapur fare gojë. Dëgjohej vetëm sqepari, sharra dhe çekiçi. Mirëpo në vjeshtë, muzgu i mbrëmjes vjen shpejt dhe pa u ndjerë fare.

— Ta marrë dreqi ta marrë! — thirri nga çatia usta Jorgji. — S'na la edhe ndonjë orë sa ta mbulonim e ta regullonim ca më mirë hotelin tonë...

— Të ndezim një zjarr të madh që të na ndriçojë, — u hodh Sefedini. Dhe, pa u vonuar, mblodhi karthi e drutë thata dhe ndezi një flakë të madhe. Por flaka herë ngrihej, herë ulej. Ajo ndriçonte nga njëra anë, kurse nga ana tjetër ishte errët. Sefedini ndezi një zjarr më të madh, nga ana tjetër e barrakës, por përsëri s'u bë gjë.

— U pa puna, s'mund të vazhdojmë më,— pranoi edhe vetë Sefedini.

— Mirë që e mbuluam gjysmën e barrakës, — tha usta Jorgji dhe zbriti nga çatia.

Postoli ndezi motorin. Inxhinieri po e shikonte bu-zéqeshur, nën dritën e maqinës së ndezur. Flokët e usta Jorgjt ishin thuajse të bardhë, kurse mustaqet dhe mjekra, që e rruante shumë rrallë, ishin ende të zeza. Vetullat i ishin zbardhur ca, e të jepnin përshtypjen e barit të vjeshtës, kur i bie bryma e parë.

— Pse më shikon kështu, o inxhinier?

— Shikon që u plake, — e ngacmoi Kola.

— Pse, për plak më merr ti mua? Pa më vështro një herë mirë...

— E vërteta është që edhe unë u habita kur të pashë për herë të parë, — tha Postoli. Kur e vështron ustanë nga pas, shikon menjëherë flokët e thinjur. E vështron mirë në fytyrë, shikon mustaqe të zeza. S'kam parë ndonjëherë kështu.

— E di si është, or çun? Pleqëria është shumë dinake. Ndaj m'u afrua edhe mua e më zuri prej zverku; kështu që nisën të më zbardhen flokët. Mirë po unë fap! i dhashë një shqelm dhe e dërgova prapa diellit. Tani ajo mori frikë dhe s'do të më qaset kurrë më. More vesh?

Maqina jehoi nga të qeshurit.

— Shpëtote të paktën mustaqet, — i tha me të qeshur Kola.

— Po, i shpëtova. Dhe tani do të mbetem gjithmonë i ri. Ndaj dhe ti, Postol, mos më thuaj më plak. More vesh? E dëgjuat edhe ju të tjerët?

— Në vend të përgjegjes shpërthyen të qeshura të forta.

— Erdhën ata! Erdhën ata! — u dëgjuan zëra në bufe të kafe restorantit të Mallunës.

Klientët e përditshëm të lokalit kthyen kokën dhe panë ndërtuesit që zbrisnin nga gazi.

— Ç'janë këta? — pyeti një burrë i gjatë, që rrinte në këmbë pranë banakut me gotën në dorë.

— Janë ata të qytetit të ri... Kanë ardhur këtu në Gurraj. Thonë se do të ndërtojnë një qytet të madh, — u përgjegj banakieri.

Kamerieri solli pjatat dhe një dopio raki për usta Jorgjin.

Në fund blenë në dyqan një pako qirinj e disa kuti shkrepse dhe hipën përsëri në maqinë.

— A nuk ja marrim një këngë tani or burra? — propozoi usta Jorgji.

— Ne mund të bëjmë çdo gjë tjetër, o usta, — i tha Kola — vetëm këngë s'mund të marrim.

— Pse?

— Sepse jemi nga tē katér anët e vendit. Ti nga Golloborda, unë nga Oroshi, Sefedini nga Lura, Fatmiri nga Mati... Po ti, o inxhinier?

— Nga Bregdeti.

— Shiko pra? S'jemi as dy vetë nga një vend.

— Veç po tē marrim ndonjë këngë moderne, — tha me shaka Postoli.

— Jo, andej s'ja themi, — tha prerazi usta Jorgji.

Arritën te barraka dhe ndezën menjëherë një qiri.

— Ama, ç'pallat! — tha me shaka Kola.

— Vetëm që nga një anë është fare i hapur. Lëre pastaj që s'ka as xhamia.

— Në dritare vëmë batanije. Edhe këtë anën e hapur do ta zëmë me mushama e batanije.

— Tani duhet tē sajomjë nga një shtrat për secilin, — tha Fatmiri dhe pa humbur kohë solli disa dërrasa tē pazdrukthuara për t'i vendosur në vend tē shtretërve. Kola solli dysheqe, batanije dhe çarçafë. Era e kambrikut tē kollarisur tē çarçafeve tē reja e tē bardha si borë, mbushi barrakën. Kthina mori shpejt e shpejt pamjen e një fjetoreje. Drita e zbetë e qiriut ndriçonte ca fytyra tē ashpra e tē parruara.

— Sa shpejt u rregullua! — tha Postoli me gëzim duke hyrë brenda.

— E ku ka si punëtori i ndërtimit, or vëlla, — ju përgjegj usta Jorgji tërë qejf. — Në fund tē dynjasë ta dërgosh, ai di tē rregullohet për bukuri. More vesh? Ma merr mendja që edhe në fund tē detit ta hedhësh, ai do tē mbledhë guacka deti e do tē ndërtojë një konak... Vetëm inxhinieri seç ka sonte që na rri serioz...

— Jo usta, s'kam gjë.

— Ke hak, or djalë, se ti je i ri, i pamartuar, i pamësuar me këtë jetën tonë...

— Pse, vetëm unë jam beqar këtu?

— Beqarë jemi tē gjithë, po i pamartuar je vetëm ti. More vesh?

— Domëthënë edhe ti, usta, beqar je?

— Afër mendsh që jam beqar. Nëpër kantiere bëhemti të gjithë beqarë. Se gratë tonë i shohim një herë në tre muaj. Apo jo, o Sefedin? — deshi ta ngacmonte usta Jorgji.

— Mjaft tani me llafe! — thirri Sefedini.

— Lermë tani, Sefedin, se jam në qejf sonte.

— Unë s'të kam parë ndonjëherë që të mos jesh në qejf — tha Kola.

— Sidomos sonte që hodhi dy dopio...

— Sonte nuk e kam nga rakia. Është nata e parë që po flemë në godinën e parë të qytetit të ri.

— Usta, duhet të flemë, kemi punë nesër. E di? Kjo ka rëndësi, — thirri përsëri Sefedini.

— Lëre, o Sefedin, se tani kemi estradën tonë, — tha Fatmiri.

— Kisha qejf sonte që t'i kallëzoja inxhinierit disa historira ngajeta ime. Po ku të le Sefedini?

— E c'farë histori do t'i kallëzosh, o usta? — e ndërpree Kola. — Ja them unë inxhinierit me pesë llafe: usta kishte qenë gjyshi yt, usta edhe yt atë, usta je bërë edhe ti. Mirë thonë andej nga fshatrat tuaja, se gollbordasi lind me çekiç në dorë...

— Ti s'e di mirë meselenë, or pëllumbi im; e di si themi ne në fshatin tim? Kur bie gollbordasi në dyshek dhe zë afshi i gruas i zgjat dorën dhe i thotë: «Qasu, moj grua, ta sajojmë një usta të mirë, që të vazhdojë të ndërtojë shtëpi të reja».

Sefedini u ngrit serioz me një palë brekë të gjata dhe fiku qiriuin.

— Sefedini ka frikë se mos na digjet dyshemeja,

— tha usta Jorgji, por nuk e pasoi njeri dhe bashkë me erësirën në barrakë sundoi heshtja.

Inxhinier Andresë kjo jetë e re i dukej si një endërr e çuditshme. Ndjente diçka që s'e kishte provuar asnjëherë në jetën e tij. U përpinq të kujtonte me radhë të gjitha ngjarjet e këtyre tri ditëve të fundit. Por ishte i lodhur dhe e kapiti gjumi shumë shpejt. Në barrakë s'pipëtinte asgjë. Jashtë era e fortë frynte mbi batanijet e

dritareve të barrakës së re, që në errësirën e natës du-keshin si vela të një anijeje e cila po niste udhëtimin në det të hapur.

6

Qysh më parë fshatarët kishin dëgjuar se pranë fsha-tit të tyre do të ndërtohej diçka; disa thoshin se do të hapej një minierë, disa se do të bëhej një fabrikë. Mirë-po ditët dhe javët kalonin, pa u bërë gjë dhe fshatarët nuk u besonin më këtyre fjalëve. Tani kishin ardhur tre ustllarë, një teknik ndërtimi, një inxhinier dhe dy-tre shoferë, që po i kthenin fjalët në vepra e u jepnin krah të fluturonin më tej lajmeve të mëparshme. Mbi të gjitha, ajo barrakë gjysmë e mbuluar, që qe ngritur atje në djer-rinë anës xhadesë, fliste me një gjuhë më bindëse se të gjitha gojët e tjera. Këtë barrakë e panë edhe shumë kalimtarë. Kështu që lajmi për fillimin e ndërtimeve në Gurraj u përhap jo vetëm në fshatrat e afërtë, por edhe në ato të largëta.

Këtë e vunë re edhe ndërtuesit apo u ngritën nga gjumi të nesërmët dhe dolën nga barraka.

Sapo doli Sefedini nga barraka, një turmë fëmijësh fuguan si harabela të trembur.

— C'kérkojnë këta vocrrakë që në mëngjez? — tha ai si me habi.

— Fëmijët janë kureshtarë dhe vijnë për të shikuar barrakën, — ju përgjegj Kola.

— Ama, alamet barrake...

— Le të mos jetë e madhe; mjafton që është e re. Ka qenë dje në mëngjez kjo barrakë këtu? Jo; kurse sot...

— E di si them unë? Fëmijët panë batanijet nëpër dritat e barrakës dhe ndoshta u shkoi mendja se ne do bëjmë ndonjë teatër.

— Ama edhe ti, usta, qejf që ke, që në mëngjez...

Usta Jorgji nuk ju përgjegj Sefedinit, po doli jash-të dhe u thirri fëmijëve, që po qëndronin mbi një ledh:

— Hajdeni këtu, or picrrakë!

Nga grupi i fëmijëve u shkëput një djalë i hollë e i gjatë.

— Si e ke emrin ti? — e pyeti usta Jorgji.

— Pashk.

«Ku e kam dëgjuar këtë emër» — tha më vete inxhinieri duke u veshur. Kur doli nga barraka dhe e pa djalin mirë, thirri:

— Oj, ky është miku ynë i pardjeshëm! Postol!

— Pse, e njeh? — u habit usta Jorgji.

— Pashkun? Po si, ore! Ne kemi rënë në ujdi me të, që të blemë edhe vezë..

— Sefedin! — thirri inxhinier Andrea. — Pa dale një minutë. Ja një rast i mirë të lajmërojmë në fshat me fëmijët, se kemi nevojë për punëtorë.

— Nevojë kemi aq sa s'thuhet, po ka disa rregulla për marrien e njerëzve në punë. Dhe ne s'kemi asnjeri që të merret me këtë punë. Si të thanë, kur u nise për këtu?

— Mua më thanë vetëm kaq: se pas disa ditësh do të na dërgojnë një llogaritar. As që pyeta më shumë.

— Shiko pra, është pak me spec.

— Merrni, ore punëtorë dhe po t'ju thonë gjë, kemi marrë lejë nga usta Jorgji, u thoni.

— Ai që guxon, ai gjithnjë fiton, — tha me vendosmëri inxhinieri dhe ju drejtua menjëherë djalit:

— Pashk! A ka në fshat njerëz që duan të punojnë këtu tek ne?

— I pari jam unë!

Inxhinieri qeshi me të madhe.

— Ne duam burra, bre, burra, që të punojnë me kazmë, — i tha me të prerë Sefedini.

— Pse s'di me punue me kazmë unë? Më merrni nji herë për me më provue.

— Po burra s'ka?

— Tash që nisën shinat e dimnit dhe toka nuk punohet ma, ka edhe burra.

— E po mirë, Pashkë, merr shokët e tu dhe lajmëro në fshat shtëpi më shtëpi.

— Të më merrni edhe mue; kështu?

Asnjë tjetër përveç Pashkut me shokë nuk do ta përhapte më shpejt lajmin në fshat, se ata që kishin ndërtuar barrakën poshtë në xhade, kërkonin tanë edhe punëtorë të tjerë. Pashku njihet në fshat si një djalë i zgjuar, por edhe i mbërapshtë, që nuk linte gur mbi gur. Po këtë radhë fshatarët e ndjenin se fjala e tij kishte një bazë. Ata e shikonin edhe vetë se me tre-katër karpentierë e muratorë s'mund të ndërtohej ndonjë gjë e madhe. Sado që ata mund të mos u besonini plotësisht fjalëve, që thoshin se pranë fshatit të tyre do të ndërtohej një qytet i tërë, prapëseprapë diçka do të bëhej. Po atë ditë u paraqiten te Sefedini një dhjetë vetë për të filluar nga puna. I pari, sigurisht, që Pashku.

— Çfarë pune mund të të jap? — i tha me të butë këtë radhë Sefedini.

— Ç'të kesh qejf ti.

— Dërgoje këtu tek unë, të më furnizojojë me materiale — i propozoi usta Jorgji, që në atë çast mbulonte me letër katrama pjesën tjetër të barrakës.

Ndërkohë inxhinieri kishte piketuar vendin ku do të ndërtohej barraka e dytë.

Sefedini shkonte e vinte pa pushim. Një herë u fliste atyre që hapnin themelet, pas pak u bërtiste të tjerëve që shkarkonin kamionat ose u jepte porosi shoferëve, që transportonin gurë e rërë për themelet e barrakave.

Në drekë u mblodhën përsëri rrëth tavolinës së Fatmirit. Por ajo nuk i nxinte më. Prandaj ato pak ushqime, që u kishte sjellë Postoli nga Malluna, i shtruan mbi stivën e dërrasave.

— Me këtë sallam do të ngopemi kaq burra? — thirri i pakënaqur Kola.

— A nuk më thatë merr ushqime për gjashtë vetë?

— Kantieri ashtu e ka, shtohet në minutë, — tha Fatmiri.

— Jemi bërë një duzinë gojësh, — shtoi i menduar Sefedini.

— Po Pashkun e zure në hesap? — pyeti usta Jorgji.

— Pashku le të shkojë të hajë në fshat në shtëpi të vet.

— Jo, Pashkun do ta mbajmë këtu dhe do ta bëjmë djalë të kantierit. More vesh?

— Mos u zini, bre burra, — u tha me butësi Fatmiri.

— Puna është se po bëhemë kallaballék dhe duhet të mendohemi se si do t'ja dalim kësaj pune.

— Nesër pasnesër nuk do të kemi kohë as të kruajmë mjekrën e jo të bredhim poshtë e lart për një sahan corbë, siç kemi bërë gjer më sot, — tha edhe serioz edhe si me shpoti usta Jorgji.

— Të fillojmö të gatuajmë vetë, — propozoi Fatmiri.

— Kështu edhe do të kursejmë, edhe leverdi do të kemi.

— Mirë po me se pa.

— Një tenxhere dhe dy-tri pjata i kemi sjellë ne nga Kurbneshi. Të tjerat do t'i gjejmë pak nga pak.

— Mirë, o Fatmir, tenxheren e ke, por me se do ta mbushësh? — pyeti Kola.

— Me se do ta mbush? Me fasule. Ja, do të dërgojmö Pashkun në fshat të na gjejë pak fasule dhe ndonjë spec nga ata që djegin.

— Ishte aty nga mbarimi i ditës së punës kur in-
xhinier Andrea erdhë te Sefedini dhe i tha:

— Mbarova piketimin e barrakës së tretë. E bëra sipas një projekti tip, që mund të përdoret kryesisht si fjetore; por edhe mund të modifikohet menjëherë për mensë.

— Kot e bëre atë punë sot. Ne na duhet të ngremë një hangar për materialet; kjo ka rëndësi, — ju përgjegj Sefedini.

— Për ç'materiale?

— Gjithë këto materiale që na sollën sot maqinat: cimento, vegla pune, karro dore e të tjera, nuk i pe?

— I pashë, por ato mund t'i lëmë për pak ditë edhe jashtë.

— Jashtë?

— Gjersa mban koha...

— Materialet nuk duhen ruajtur vetäm nga koha, por edhe nga njerëzit e këqinj.

— Po ne këtu jemi.

— Ne këtu jemi, po natën mbulojmë edhe kokën me batanije dhe nuk shohim hiç se ç'bëhet jashtë fjetores, — i hënë një thumb Sefedini.

Inxhinieri u skuq në fytyrë, por nuk e bëri veten dhe tha me një gjakftohtësi të shtirur:

— Po ne presim forca të tjera, bre burrë, pastaj mund të vijnë edhe ata të tregëtisë me bagazhet e tyre...

— Ata të tregëtisë mund të vonohen edhe një muaj.

— Ti e dëgjove vetë atë shokun që erdhi nga komiteti ekzekutiv i rrethit dhe tha se do të na dërgojnë sa më parë ushqime e njerëz, për në kuzhinë. Gjithë këta njerëz, që po grumbullohen këtu, nuk do të ushqehen përditë me djathë e sallam.

— Ç'i duam fjalët tanë! — tha me të ashpër Sefedini.

— Nesër do të bëhet hangari dhe pikë...

— Aty mbahu, — ngriti zërin edhe inxhinieri, duke përdorur atë frazë, që e thoshte, kur s'mund të përmbar hej më.

— Si the? Si the?

— Thashë se nuk e ke nisur mirë...

— Unë s'e kam nisur mirë? Unë s'ditkam se si fillohet puna dhe erdhe të më mësosh ti! E ku ke haber ti nga puna e kantierit? Ti di vetëm të bësh skica me laps, — thirri ashpër Sefedini.

— S'kam haber? Atëhere bëje vetë! — tha i zemëruar inxhinieri dhe bëri që të largohej drejt xhadesë.

Të tjerët, që në atë çast ishin duke i dhënë fund punës së ditës, në fillim nuk i dhanë rëndësi kësaj gri ndjeje midis Sefedinit dhe inxhinierit. Po, kur panë se puna u trash, u mblohdhën rreth tyre.

— Daleni, bre burra, — u tha Fatmiri duke u bashkuar me të tjerët, — se jemi edhe ne këtu. C'keni që rrëmbheni kështu si gjela?

— Ma solli këtu, ore! — tha Sefedini duke vënë gishtin në majë të hundës.

— Ehe! Ç'fasule të shijshme që janë bërë! — thirri

usta Jorgji duke trazuar tenxheren me një lugë të drunjtë.

Të gjithë u kthyen nga ai, por nuk qeshën siç priste ustai.

— Kujt i bie radha e gatimit nesër? — pyeti pas pak usta Jorgji, kur e pa se s'ja vari njeri.

— Po të fillojmë me radhë, i bie Sefedinit, — ju përgjegj Kola.

— Jo, bre! Sefedini do t'i hedhë shumë piper nga ai që djeg e do të plasë pastaj ndonjë sherr më i madh.

Qeshën të gjithë nga fjalët e Kolës, qeshi edhe Sefedini me inxhinierin.

S'kishin arritur të mbaronin barrakën e tretë, kur filloi shiu. Ishte një shi i ftohtë dhe me erë, që të hynte në palcë. Ndërtuesit punuan gjer në drekë në shi e në llohë dhe pastaj u kthyen në barrakë.

— S'punohet më, — tha usta Jorgji, duke hequr kominoshet e lagura.

— Edhe kjo na lypset tani, — tha si me vete inxhinier Andrea, i mërzitur në kulm.

— Tani që filloi shiu do të kemi kohë të bëjmë ca stola dhe dritaret e barrakave, — tha me gjakftohtesi Fatmiri.

— Na duhen edhe dy tavolina, — i tha Kola.

— Sa gjëra na mungojnë neve këtu!

— Të gjitha do të bëhen, or pëllumbi im. Mos ki frikë ti. Vetëm mjekra e qoses s'ka si bëhet. More vesh?

Inxhinieri rrinte pranë dritares pa xhamë të barakës së parë dhe shikonte me mërzi shiun monoton të vjeshtës. Fialët e Fatmirit e të Kolës nuk e tërhiqnin aq shumë. Ai tanë mendjen e kishte gjetkë. Ishte nisur nga Tirana të hënën, para pesë ditësh. Java po merrte fund. Të nesërmen ai do të gjente rastin më të mirë dhe do të fluturonte nga kantieri. Eh, me ç'padurim po e priste ditën e shtunë!

— Në atë çast hyri në barrakë Sefedini. Nga flokët e nga mustaqet i kullonte ujë. Rrobat i kishte qull.

— Na zuri në befasi, dreqi, — tha ai duke shtrydhur flokët, — kemi dalë në punë pa mushama e pa gjë... .

— Eja këtu pranë zjarrit që të thahesh, — ju drejtua Kola, që qëronte patate.

— Mirë thua ti, o Kolë. Por, po të fillojmë qysh tani, kur do të vijë dimri i vërtetë, do të na duhet të futemi brenda në furre që të ngrohem.

Ditën tjetër inxhinieri punoi deri në drekë mbi disa projekte në tavolinën e re dhe të madhe që kishte bërë Fatmiri me usta Jorgjin. Pasi hëngrën drekë, ai nxori nga valixha një palë rroba të mira, u vesh me ngut dhe u tha të tierëve:

— Mirë u pafshim, shokë, të hënën në mëngjez!

— Po ikën, inxhinier — e pyeti Fatmiri.

— Akoma të rri? Qëndrova këtu një javë të tërë. Tani do të shkoj në shtëpi, të lahem e të ndërrohem... .

— Po ti sikur na the se je beqar, — hyri në bisedë Kola.

— Pse, beqarët nuk lahen?

— Unë them se beqarët kanë më shumë nevojë të lahen, të ndërrohen e të pispillozen, — doli në mbrojtje të inxhinierit usta Jorgji.

— Të lumtë, usta! Tani fole të vërtetën.

— Unë gjithnjë të vërtetën flas. Hajde, pra, nisu! Vetëm pér një gjë më vjen keq. Këtu tek ne plasi mishi i derrit me fasule pér sonte, kurse ti nuk do ta shijosh... .

— Ai do të shijojë gjëra të tjera atje ku shkon, — donte ta ngacmonte Kola, por ndërkokë inxhinier Andrea me Postolin kishin dalë jashtë.

— Hallall e ka, — tha usta Jorgji.

— Fshati digjet, plaka krihet. Mirë e kanë thënë të vjetrit, — tha Sefedini.

— Pér inxhinierin e ke fjalen? — pyeti usta Jorgji.

— Jo, pér ty! — tha me inat Sefedini.

— Dëgjo, Sefedin: pér këtë që thua, s'të jap hiç të drejtë. Inxhinieri është i ri nga mosha, i parrahur

në jetë dhe i pamësuar në vështirësitë e kantierit.
More vesh?

— Ç'pret pastaj nga ai? Punën e kantierit do të shikojë ai, apo ato thëllëzat që e presin atje në Tiranë?

— Mos u ngut, Sefedin, që të nxjerrësh përfundime, — i tha me ton pajtues Fatmiri.

— Dita e mirë duket që në mëngjez.

— Edhe duket edhe s'duket; ne do të hamë shumë bukë në këtë kantier dhe do të provojmë shumë njerëz.

Ndërkohë gazi fluturonte në mes të shiut për në Tiranë. Inxhinier Andrea bënte shaka me shoferin e këndonte bashkë me të.

— Unë atë ditë që vinim për herë të parë në Gurraj, të mora për njeri të zymtë e mendjemadh, por tani e shikoj mirë se ti shpirtin e ke pranverë, — i tha Postoli duke shikuar me vëmendje përrpara, ndërsa pikat e shiut përplaseshin me forcë te xhami i gazit.

— Kështu është njeriu, or vëlla. Ka raste në jetë që zemra të shpërthen nga gjëzimi, por ka edhe raste që të kapillon mërzia.

— E marr vesh, e marr vesh. Një djalë i ri si ti të shkojë të kalojë rininë atje në Gurraj...

— Ti i martuar je, Postol? — e pyeti inxhinieri duke dashur që t'i jepte një drejtëm tjetër bisedës.

— Po si, ore, kam edhe dy fëmijë.

— Pa ma jep pak mua motorin.

— Pse, di ta ngasësh?

— Kam mësuar ca.

— Patentën e ke?

— Jo, po do ta marr sa më parë.

— Mos na mbërthejnë ata të kontrollit, — i tha Postoli duke ngadalësuar shpejtësinë e maqinës.

— Mos ki frikë.

— Ah ç'është një grep që vërtitet këtyre anëve!

Ndërkohë inxhinier Andrea e kishte marrë vetë në dorë timonin e gazit dhe u përgjigjej shumë shkurt fjalëve të Postolit.

— Vetëm një gjë ka të mirë atje në kantier, — tha Postoli pas një heshtjeje të shkurtër.

— Çfarë?

— Shoqërinë. Shumë njerëz të mirë janë ata të ndërtimit, sidomos ai Fatmiri... lëre pastaj usta Jorgji. Unë atje kam qeshur më shumë nga sa kam qeshur në estradën e Tiranës.

— Kështu?

— E që thua ti, shoku inxhinier, njerëz të mirë, me të vërtetë. Dhe duarartë. E vure re? Nga tre-katër zanate dinë secili. Vetëm ai Sefedini s'para më pëlqen...

— Pse, ore? — e pyeti inxhinieri duke frenuar maqinën për t'i hapur vendin një kolone qerresh, që i ngjiteshin xhadesë, duke ardhur nga fusha.

— Ku di unë si më duket, si ca i rrëmbyer. Për të punuar, ai punon si kalë, por se si të shikon ngandonjëherë, sikur ha nga buka e tij.

Inxhinieri yuri buzën në gaz.

— E di si e quan usta Jorgji? — vazhdoi Postoli — «mushka e kantiereve».

— Vërtet? Po pse?

«Mos ja vërë re ato huqe, ti, — më tha ustai atë ditë që bëri fjalë me ty, — Ai është «mushka e kantiereve». Ne e quajmë mushkë, sepse është i fortë dhe i palodhur në punë, por edhe sepse ngul këmbë në të tijën, ashtu si bën mushka.»

— Inxhinieri qeshi me të madhe dhe e ndali maqinën.

— Na, merre ti tanë, — i tha, — se i jemi afruar Tiranës.

Gazi u nis përsëri. Inxhinieri mbështeti ballin te xhami i maqinës dhe shikonte njerëzit e paktë, që ecnin me nxitim në trotuaret e qytetit. Pas pak maqina qëndroi prapa Shtëpisë së oficerave. Ai mori valixhen në dorë dhe mori një rrugë të ngushtë dhe të errët. Por para se të merrte kthesën e rrugicës, ktheu një herë kokën dhe thirri:

— Postol! Mos harro, të hënën në ora gjashtë! Këtu!

Por të hënën në mëngjez inxhinier Andrea nuk vajti në orën e caktuar. Nuk ishte hera e parë, që nuk e respektonte orën e takimit. Shokët e tij më të ngushtë thoshin për të: «Andrea vetëm në takimet me vajzat është i përpiktë». Postoli, kur e pa që vinte me vali-xhe në dorë, i tha si me shaka:

— Të zuri gjumi, shoku inxhinier.

— Jo, bre, kam pasur disa ngatërresa, dreqi ta marrë!

E vërteta është se ai ishte kthyer në shtëpi në orët e vona, pas mesnatës. Pasi kishte munguar për një javë rresht nga Tirana, kishte dashur të bënte të gjitha takimet e javës për një ditë. Në fund, pas shumë mendimesh e ngurrimesh kishte vendosur t'i shkruante së dëshurës një letër:

«Do t'i shkruaj shkurt, — tha me vete, — ashtu si duhet të jenë përgjegjet që u iepen ultimatumeve». Po kur mori penën dhe bëri të fillonte letrën, dora ju drodh. «Më vjen keq, në qoftë se kjo letër do të jetë lamtumira e fundit».

Ishte lidhur aq shumë me Lilin gjatë tre vjetëve të fundit! Është e vërtetë se ajo, kur mori vesh transferimin e tij i kishte thënë prerasi: «Do t'i bindesh zemrës, dashurisë, apo do të kërkosh të bësh karrierë?» Këtë Andrea e quante «ultimatum». Ajo edhe në takimin e së dielës nuk i kishte ardhur. Dhe kjo e kishte zemëruar shumë Andrenë, aq sa një çast donte të merrte vendimin e fundit. Por një gjë e tillë nuk mund të bëhej lehtë. Ku ta dish, ajo mund të ishte e sëmurë. Ose mund t'i kishte ndodhur ndonjë gjë tjeter. Vendosi, pra, që t'i shkruante edhe një herë, që t'i propozonte një takim për të dielën e ardhshme, pas një jave atje, në vendin e zakonshëm.

Pena rrëshqiti në letrën e bardhë, ndjenjat e ngurrosura u nxehën, dhe u shkrinë dhe letra doli shumë e gjatë. Do të vazhdonte edhe më gjatë, po të mos shikonte orën, që kishte vajtur tre.

Ja pse nuk u tngrit herët të hënën në mëngjes e s'vajti dot në orën e caktuar atje ku e priste Postoli. Edhe gjatë udhëtimit nuk pati dëshirë të bisedonte me shoferin. «Kushedi ku ka bredhur gjithë natën mbrëmë dhe është bërë telef» — mendonte Postoli, duke kthyer herë pas here kokën nga ana e inxhinierit, që orë e çast gogësinte.

Kur po i afroheshin kantierit, panë një djali me një trastë të rëndë në krah, që ecte me nxitim anës xhadesë.

— Si ai Pashku i vogël më duket. — i tha Postoli.

— Ai shejtan është, — u përgjegj inxhinier Andrea. — Qëndro ta marrim në maqinë.

— C'ke në trastë, o Pashk? — e pyeti Postoli, kur ai hipi në maqinë.

— Gështenia.

— Tallesh!

— Po, gështenja kam, shikoi. — i tha duke hapur trastën e mbushur. I bleva në katund. Më dërgoi usta Jorgji.

Postoli dhe inxhinieri shikuan njëri-tjetrin, duke buzëqeshur.

— Fatmiri sajoi dje nji sobë të madhe dhe mbramë e ndezëm për bukuri. Edhe unë atje në barrakën tuej kam fjetë. Më dha usta Jorgji nji shtrat, nji dyshek dhe katër batanije. Pastaj mblodhëm dru bashkë me Kolën dhe unë ndeza zjarrin. Mirëpo s'kishim gështenja. Prandaj më dërguen mue në katund e mora këto gështenja, që t'i pjekim sonte në sobë.

Ndërkohë gazi kishte mbërritur te sheshi i kantierit. Pa zbritur mirë nga maquina inxhinieri pa menjëherë se nuk ishte vetëm soba, që i qe shtuar kantierit. Barraka e tretë ishte mbuluar e tëra. Në dritaret e barrakës së parë, që përdorej si fjetore, qenë vendosur xhamat.

«Ata paskan punuar me gjithë mend», tha me vete inxhinieri dhe ndieu si një farë boshllëku në kraharor.

Duke munguar për dy ditë, sikur kishte humbur ritmin dhe tensionin e punës. Ashtu si qe, me vali-

xhen në dorë, qëndroi në vend dhe u hodhi një shikim shokëve, që punonin për të ngritur një hangar prapa sheshit të kantierit. Për një cast ju duk sikur ata qeshën nën hundë, sikur donin t'i thoshin: «E, or pëllumb! Si e kalove asai Tirane? Sikur të shohim shumë të mërzitur e të rraskapitur! Ç'ke?»

Gjatë rrugës mendonte që apo tu hidhte një sy punëve në kantier, do të kthehei në barrakë e do të flinte nga dy orë, që të merrte pak veten. Por tani nuk kishte më dëshirë të shtrihej në dyshek e të bënte gjumë. Bile i vinte si turp nga vetja, edhe që e kishte menduar një gjë të tillë.

Mbi tavolinën e re e të madhe pa një zarf të hapur dhe një shkresë të shkruar në maqinë. E mori menjëherë në dorë dhe e lexi. Shkresa vinte nga kantieri i ndërtimit të hidrocentralit të madh dhe u bënte të ditur se gjatë ditës së hënë, domethënë atë ditë, në kantierin e ri të Gurrajt do të mbërrinin nga gjashtëdhjetë vetë të profesioneve të ndryshme. Bashkë me ta do të dërgohen edhe disa maqineri ndërtimi si dhe një grup elektrik për të furnizuar kantierin me energji elektrike. «Me pak fjalë, — tha me vete inxhinier Andrea, — duhet të presim një kolonë të tërë. Oh, ç'telashe!»

Sa ndryshe e kishin pritur lajmin e ardhjes së forcave të reja shokët e tjerë të kantierit!

— E more vesh sihariqin, inxhinier? — i tha Kola me përzemërsinë e tij të natyrshme, kur e takoi në vendin e punës.

— Jo, çfarë?

— Sot na vijnë shokë të rini. Ka ardhur lajmërimi.

— A! Për këtë e ke fialën?

— Pse e vogël është kjo? — ju përgjegj Kola, duke e shikuar si i habitur.

Në atë çast po vinte nga xhadeja Sefedini.

— E lexove letrën, inxhinier? — i tha Sefedini pa e përhëndetur fare.

— Po, i hodha një sy.

— Nga casti në cast duhet të jenë këtu.

— Ku do të flenë, or vëlla, gjithë këta nierëz! Ku

do të hanë bukë! S'kanë menduar ata të hidrocentralit se në ç'kondita jemi ne këtu?

— Të gjitha do të rregullohen. Tani në fillim do të na vijë pak festja vërdallë, por puna do të marrë hov... Kio ka rëndësi.

Ndërsa ishin duke biseduar, erdhi aty Kola dhe pyeti:

— Barraka e tretë po merr fund. Ne ku do të vazhdojmë, në hangar?

— Ju, Kolë, vazhdoni punën në hangar, ndërsa ne të dy, inxhinier, të piketojmë vendin ku do të ndërtohet mensa, — tha aty pér atv Sefedini.

— Kanë lajmëruar se do të vijnë ata të tregëtisë?

— Po, po dje na erdhi përsëri ai shoku nga komiteti ekzekutiv i rrethit, bashkë me një tjetër nga komiteti i partisë. Ata na pyetën pér nevojat e pér hallet që kemi. Dhe na dhanë fjalën se do të bëjnë ç'mos pér kantierin e ri.

Inxhinieri e shikonte si me dyshim.

— Pse më shikon kështu? Ne bëjmë punën tonë. Edhe të tjerët do të bëjnë atë që u takon.

— Po sikur të mos vijnë?

— S'është e mundur. Ka një dorë aë i drejtton të gjitha punët...

Inxhinieri nxori një projekt dhe bëri disa kalkulime me laps. Pa mbaruar punën u dëgjua diçka si një gjëmim i l'hellë, që bëhej gjithnjë më i fortë.

— Po vinë! — thirri Sefedini dhe fytyra i shkël-ueu nga gjëzimi.

Zhurma e maqinave në lëvizje po afrohej gjithnjë më shumë.

Te kthesa e rrugës u duk kolona. Në krye lëvizte një maqinë-vinç me skeletin metalik të zgjatur përpëra, si një dorë e hekurt, pér të hapur rrugën. Pastaj vinin kamiona të mbushur me punëtorë e shumë kamiona me rimorkio, të 'ngarkuar me materiale ndërtimi. Mbi karroceritë e skodave të fundit dalloheshin ekskavatorë e buldozerë. Në kovat e ekskavatorëve dhe në gjokset e celnikta të buldozerëve dukeshin ende

mbeturina balte të zezë nga vendi ku kishin punuar një ditë më parë.

Sefedini doli te kthesa e rrugës dhe i bëri me dorë shoferit të vinçit të kthehej në sheshin e madh përpara kantierit.

Maqinat e rënda u futën në shesh, duke e gjerryer nga çdo anë atë lëndinë të pashkelur më parë. Punëtorët zbritën nga kamionat me plaçkat e tyre në dorë. Shoferët nxirrin kokën nga kabinat, sikur donin të kërkonin me sy atë njeri që do t'u jepte udhëzime se si të vepronin. Sefedini shkonte sa nga një anë në tjetrën duke dhënë urdhëra me zë të lartë. Për një hop në shesh të kantierit sundoi një rrëmuje e një zallamahi që e hutuan fare inxhinierin. Përkundrazi Sefedini përpiquej me mish e me shpirt të vinte rregullin. Pasi u dha disa udhëzime shoferëve, që prisnin të shkarkonin materialet, u vu në krye të një grupi të madh punëtorësh duke u drejtua nga barraka e tretë, që qe gati në përfundim.

Kur arriti te dera, ai u tha punëtorëve të porsa-ardhur: — Hyni, shokë! Kjo është fjetorja juaj! — dhe u largua përsëri për në shesh të kantierit, ku e prisnin njerëz të tjerë dhe telashe të tjera.

Punëtorët u futën brenda me vrull e zhurmë dhe shikuan rrëth e rrotull. Barraka qe ende e pambuluar plotësisht. Dyshemeja qe e pashtuar. Ata lanë përdhe dengjet e tyre personale dhe ju përveshën menjëherë punës për të mbledhur copat e dërrasave dhe gurët e shpërndarë andej-këtej. Pastaj morën kazma e lopata për të sheshuar vendin, kurse disa të tjerë sollën dërrasa për të bërë një dysheme të përkohshme. Ata që erdhën të fundit transportuan nga maqina shtretër, dysheqe e mbulesa. Usta Jorgji i shikonte nga pjesa ende e pambuluar dhe thoshte me vete: «Secili nga këta kushedi sa oda dhe sa pallate ka ndërtuar. Po ja që tani ato i ka lënë për të tjerët dhe fillon rishtas nga hiçi. Tani secili përpiqet të zëjë një qoshe në këtë brrakë, sa për të vendosur një shtrat...»

Njëri nga ata që po mbërthente kartonin në murin e barrakës prej pupuliti hodhi shikimin lart dhe thirri:
— Pa shikoni, bre shokë, se kush është atje lart!
— Uh, Usta Jorgji! — thirrën dy-tre vetë së bashku.

— Mirë se na erdhët, or pëllumbat — ju përgjegj usta Jorgji, me sqeparin në dorë.

— Ama pritje që na keni bërë, usta?!

— Pse, s'të pëlqen, o Llesh? Të kemi bërë një pallat të ri, që kundërmon erë rrëshirë, sikur të jesh pranë një pishnaje të madhe. Dhe unë e ti që jemi nga malësia, kënaqemi nga era e pishës. Apo jo?

— Ku ja del dot ustait me fjalë! — tha një tjetër

— Ta gjeti përgjegjen menjëherë.

— Ç'të bënim më parë edhe ne? Tre-katër vetë ishim. Tani që erdhët ju, puna do të shkojë mbarë.

— Zbrit ti, usta, se je lodhur! — thirri Lleshi dhe në çast u kacavjerr në çati. Pas tij hipën edhe katër vetë të tjerë me nga një sqepar në dorë. Usta Jorgji donte të kundërshtonte:

— Ju jeni mysafirë sot, — u tha. — Ku është parë që të futen në punë mysafirët?

Por ata nuk ja vunë veshin. Sa të hapësh e të myllësh sytë, puna në pjesën e pambuluar të çatisë mori fund. Usta Jorgji duke zbritur, thoshte si me vete:

— Ej! Ç'trima që kam! Me ju, or djema, nuk më trembet syri nga asgjë...

Dhe mori rrugën drejt fjetores.

Po në atë çast kthehej nga vendi i piketimit dhe inxhinier Andrea me Kolën. Kola u takua me të por-saardhurit dhe inxhinieri shikonte me ç'përzemërsi përqafoheshin me njëri-tjetrin. «Dale, — tha me vete, — ku kam lexuar unë për kësi takimesh? A! Po. Në një roman përluftën, që midis të tjerash bënte fjalë se si talkoheshin midis tyre partizanët e reparteve të ndryshme».

Ktheu kokën, se ju duk sikur dikush e thërriste. Te drithja e fjetores pa usta Jorgjin, që i bënte shenjë me lugë që të hynte brenda.

— Hëngre, inxhinier? — e pyeti kur e pa te dera.

— Ku të haja? Nuk e shikon se q'po bëhet?

— Eja të kapërdish ndonjë kafshatë, se po të presësh të mbarohen më parë punët e kantierit, ato nuk marrin fund kurër.

Inxhinieri mori një lugë dhe nisi të hante. Nga dritarja e hapur e fjetores shikonte jashtë.

— Çfarë shikon? — e pyeti usta Jorgji, — Gurgule e madhe sot.

— Tani sikur u qetësua ca.

— Inxhinier, ke parë ndonjëherë ndonjë përrua që fryhet befas nga shirat e rrëmbyer?

— Po sa vazhdon kjo punë? Një orë, dy, më shumë jo. Ashtu ndodh edhe në kantier, kur vijnë shumë forca të reja përnjëherësh. Ja, shiko edhe këtu tani se q'materiale kanë sjellë kamionat! Vende-vende janë bërë si bregore të vogla me qereste, me trarë, hekura me çimento e më the të thashë. More vesh?

— Të shoh në qejf, sot.

— Jam në qejf, sepse sot fillon vallja e madhe.

— Po muzika ku është?

— Muzika? — tha usta Jorgji dhe mbeti pak si i menduar.

Inxhinieri mendoi se usta Jorgji do t'i fliste për melodinë e sharrave e të çekicëve, për muzikën e fortë të saldatriçeve, të betonierave, të transportierëve, të ekskavatorëve dhe të buldozerëve. Usta Jorgji, sikur e gjeti atë që kërkonte, ju përgjegj:

Në këtë vallen tonë të ndërtimit muzika nuk vjen nga jashtë, po nga brenda.

Inxhinieri i hodhi një shikim hetues, sikur ta shikonte për herë të parë dhe vuri buzën në gaz.

— S'ka gjë, që nuk e ndjen ende, mor bir. Do ta ndjesh më vonë, sefte nga pak e pastaj më shumë. Po të rrish këtu me ne, do ta ndjesh e do të të pëlqejë kjo muzikë, që ke për të parë.

Inxhinieri e shikonte në heshtje.

— Të shoh unë, të shoh, që qesh tinëz ti e kushedi thua me vete: «C'na përrallis edhe ky ustai, që është plakur duke ndërtuar mure!»

— Jo, usta Jorgji, nuk është kështu.

— E di si më dukesh ngandonjëherë, o inxhinier? Të mos e marrësh për keq ama...

— Jo, usta, nga ti, s'më vjen kurrë keq, çdo gjë që të më thuash.

— Hë, de, kështu të dua. Më dukesh si ndonjë zog pule. Si ndonjë zog pule, që është larguar nga klloçka dhe cicërin...

— Këtë s'e pranoj, usta, se unë kam më se dhjetë vjet që jam larguar nga shtëpia.

— E di cilën them klloçkë unë? Atë jetë që bëje në qytet. Me shokë, me miq, me mikesha...

— A, usta, usta! — thirri si me të qeshur inxhinieri.

— Do të më dëgjosh edhe një fjalë? S'ka klloçkë më të mirë se kantieri.

Inxhinier Andrea s'kishte çfarë t'i thoshte. Usta Jorgji ishte mjeshtër jo vetëm në ndërtim, por edhe në bisedë dhe e vërtiste fjalën si t'i donte qejfi.

Uturima e maqinave nuk dëgjohej më. Në shesh çdo zhurmë qe fashitur. Mugëtira e mbrëmjes kishte mbuluar gjithshka. Dhe ata dolën jashtë për të parë se ç'po ndodhë. Tani u qenë mësuar veshët në tollovi e në zallamahi dhe i shqetësonte qetësia.

9

Punëtorët hynin grupe-grupe në barrakën e parë, atje ku flinin ata që kishin ardhur të parët. Usta Jorgji i priste të gjithë si zot shtëpie. Pashku, me një si mashë në dorë, trazonte gështenjat mbi kapakun e gjerë të sobës, që kishte sajuar Fatmiri një ditë më parë me llamarinë dhe hekurishte të vjetra. Inxhinier Andrea me Sefedinin dhe Fatmirin ishin ulur rreth tavolinës së vogël në qoshen tjetër të barrakës dhe bisedonin me zë të ulët. Herë pas here inxhinieri shënonë disa emra në faqen e parë të një regjistri të madh me kapak të zi.

Jashtë frynte një erë e fortë, që herë-herë e shkundte nga themelet barrakën. Era frynte nga drejtime të ndryshme dhe ngandonjëherë e mbushte dhomën me tymin e sobës. Dritat e qirinjve, të vendosura në të dyja anët e barrakës, luhateshin e ndonjëherë gati sa nuk fikeshin fare.

Në gjysmëerrësirën e barrakës u dëgjua një këngë. Një grup mirditorësh këndonin me zë të ulët një këngë trimërie.

— Jepini, or djema! Jepi Llesh! — thirri usta Jorgji.

— Ç'e do, — ju përgjegj Lleshi, — nuk kemi ndonjë çifteli. Kështu s'vete.

— Lebërit e kanë mirë, — tha Lleshi. — Ata çiftelinë e kanë me vete.

Sefedini u ngrit i pari dhe vajti pranë sobës; pas tij shkuau inxhinieri dhe Fatmiri:

— Dëgjoni, or shokë, — filloj Sefedini me zë të fortë, duke i rënë me dorë tubit të ndryshkur të sobës.

— Neve na ra shorti që të fillojmë ndërtimin e qytetit të ri. Puni e madhe, e? Për ideal! Dhe e vështirë. Poo! Shumë e vështirë. Po ne duart ja ku i kemi, — tha duke përveshur mëngën e dorës së djathtë. — Edhe mendjen e kemi në vend. Top! Dhe do ta ndërtojmë! Kjo ka rëndësi... Sonte lypset të ndajmë forcat, që nesër të hidhemi në sulm...

Qëndroi një çast dhe nxori nga xhepi një letër të shkruar. Në ballë i dukeshin disa bulëza djerse. Ai që nuk lodhej e nuk djersinte as kur punonte në zhegun e gushtit, tanë ndjente siklet.

— Do të ndahemi, pra, në dy brigada, — vijoi.

— Kjo ka rëndësi... Brigadieri i brigadës së parë do të jetë Fatmiri, i së dytës Kola...

Pastaj lexoi me nxitim emrat e punëtorëve sipas brigadave.

— Me leje? — u dëgjua një zë i fortë nga mesi i barrakës.

— Urdhëro, Llesh!

— A ka mundësi të më heqësh nga brigada e Fatmirit, e të më kalosh në atë të Kolës?

- Përse e kërkon këtë gjë?
 — Kështu e kam punën...
 — Ke ndonjë arësy, a?
 — Arësy?! Çfarë arësy kërkon ti?
 — Mos je zënë me Fatmirin?
 — Me Fatmirin të zihem unë? E kush zihet me Fatmirin, or byrazer!
 — Atëhere?
 — Ohu! Edhe ti Sefedin! Më pëlqen të jem me Kolën.
 — T'jua them unë se si është puna, — u ngrit e tha Azisi, një djalë i gjatë e i hollë, që drejtonte vinçin.
 — Ti e di që Lleshit i hahet shumë muhabeti me Kolën. Ata, po s'u takuan një herë në ditë, që t'i bien çiftelisë e të këndojnë së bashku, nuk i zë gjumi natën.
 — Këtu s'kemi ardhur që të lozim me çifteli, — tha me të ashpër Sefedini.
 — Pas punës edhe çiftelisë do t'i biem, po përnder! — u hodh e tha Kola.
 — A prishet gjë puna, po ta caktojmë atë me Kolën?
 — i pëshpëriti inxhinier Andrea Sefedinit në vesh.
 — Mirë, xhanëm, mirë, le të bëhet edhe kështu. Po dua t'i them Lleshit se këtu në Gurraj nuk do të ketë shumë kohë që të merret me çifteli. Sidomos tanë në fillim, Kjo ka rëndësi. Këtë le ta dëgjojë edhe Kola...
 Lleshi ktheu kokën rrëmbimthi nga Sefedini dhe u mat t'i thoshte diçka me inat por, duke parë se të tjerët qeshnin nga fjalët e Kolës, ndërroi mendim dhe heshti. Edhe punëtorët e tjerë shikonin njëri-tjetrin, duke pritur vazhdimin e bisedës. Për një kohë asnjeri nuk kërkoi leje që të fliste. Një heshtje e rëndë u përhap në kapanon. Dëgjohej vetëm era e fortë që përplasej me furi në çatinë e barrakës dhe drutë që kërcisin në sobën e madhe.
 — Atëherë t'ju them edhe unë dy fjalë, — tha inxhinieri, duke u ngritur në këmbë. Zëri i tij dridhej, sikur të ishte hera e parë që fliste përpëra njerëzve të tjerë. Vështrimet e të gjithëve u përqëndruan tek ai. Disave u dukej si shumë i ri dhe nuk ua mbushte syrin. Disa të tjerë vështronin shtatin e tij të gjatë e të hollë

me flokë të zinj e me sy që shkrepëtinin nga një flakë e brendshme dhe thoshin me vete: «Alamet djali është!»

— Pata ndër mend t'ju thosha se jemi një kantier i ri — vazhdoi shtruar inxhinieri. — Por ne këtu jemi edhe s'jemi kantier i ri; se të gjithë ju jeni punëtorë të vjetër, punëtorë me përvojë, që keni punuar e derdhur djersë në shumë vepra të pesëvjeçarëve. Nga sa shoh unë këtu, vetëm unë, Gjeta dhe Pashku jemi të rinj dhe si të thuash axhaminj, në punët e kantierit...

Një gjallëri e madhe u përhap në gjithë sallën. Gjeta u skuq si vajzë në fytyrë, kur dëgjoi të përmendet emri i tij, kurse Pashku qeshi me të madhe.

— Po ma merr mendja se do të ndihmojmë njëri-tjetrin. Unë nga ana ime nuk do të kursehem. Me atë sa di dhe sa mundem, sigurisht. Dhe do të jem i pari që do të pres ndihmë nga ju; se ashtu siç ju tha edhe Sefedini, na pret një punë e madhe dhe e vështirë. Mendoni vetëm kaq: këtu do të ndërtohet një qytet i tërë... Nuk është shaka, ë shokë?!

Punëtorët shikonin njëri-tjetrin; çdo gjë e madhe dhe e bukur e mahnit njeriun dhe e bën për vete, qoftë edhe kur është një mendim, një plan ende i parealizuar.

Kur u ngritën për t'u shpërndarë nëpër fjetoret, era frynte me tèrbim. Lart në mal binte borë. Dritat e zbeta të qirinje, që u ndezën në të gjitha barrakat, luhateshin nga era që frynte jashtë e gati nuk ndriçonin fare. Kur ranë për të fjetur, barrakat zunë të tundeshin nga murllani. Por zemrat e tyre ngroheshin nga fjalët që kishin dëgjuar për qytetin e ri. Po ku ishte ky qyteti i ri?

Qyteti i ri flinte ende në muskujt e tyre të fortë, që kishin ngritur gjer tanë kushedi sa vepra të tjera...

II. KANTIERI, NJERÉZIT DHE MURRANI

«Punëtorin e ndërtimit edhe në fund të dynjasë ta dërgosh, ai do të bëjë çmos e do të rregullohet për bukuri. Ma merr mendja që edhe në fund të detit ta hedhësh, ai do të mbledhë guaca deti e do të ndërtojë një konak...».

Që të nesërmen u përhap në gjithë kantierin melodia e fuqishme e ndërtimit, vallja pa mbarim, për të cilën bënte fjalë usta Jorgji.

Inxhinier Andrea, sado që pa përvojë në punët praktike të ndërtimit, e ndjeu se kishte të bënte me valltarë të zot e të vendosur ta çonin gjer në fund çdo punë që u ngarkohej. Ata para se të vinin këtu, kishin kaluar nga një radhë veprash të pesëvjeçarëve, që për ta kishin qenë shkolla të vërteta.

Bashkë me të vjetrit punonin tanj edhe shumë punëtorë të rinj, që kishin ardhur në kantier nga fshatrat e afërtë.

Kur ra muzgu i ditës së parë dhe s'mund të punohej më, inxhinieri kaloi nga të gjithë sektorët e kantierit dhe ju duk sikur ndjeu një erë të veçantë. «Po, — tha me vete, — kjo është erë djerse, aroma karakteristike e kantierit». Hipi në një grumbull të madh zhavorri e rrëre, që kishin sjellë kamionat nga lumi dhe pa se qe bërë një punë e madhe. Hangari i materialeve, për

të cilin interesohej aq shumë Sefedini, qe përfunduar. Tri barraka me pupulit kishin filluar të merrnin formë; vende-vende toka nxinte nga themelet që ishin gjermuar pér të ndërtuar fjetore të tjera, atje ku zhgërrysheshin gjer dje derrat e fshatit.

«Kjo punë e këtushme, është shumë e ngatërruar. Problemet që dalin në një kantier të ri nuk i gjen në asnje libër, në asnje manual» — tha me vete inxhinieri, duke u kthyer pér në barrakat. Në fjetore njerëzit po mblidheshin një nga një. Pashku ndizte sobën. Usta Jorgji me sqepar në dorë rregullonte derën, që ishte bomyer nga shiu dhe nuk mbyllej mirë.

Sefedini u kthye i fundit në fjetore. Dukej menjëherë që ishte në qejf. Dita që kishte kaluar, kishte qenë pér të një ditë e lodhshme dhe plot ngatërresa; por atij do t'i pëlqente të ndodhë gjithnjë kështu.

Përkundrazi inxhinier Andrea dukej si shumë i shqetësuar. Kishte marrë në dorë disa projekte-tip, pon nuk dinte nga t'ja fillonte.

— Kanë ardhur ata të tregëtisë e kërkojnë një nga ju, — u tha Fatmiri duke vështruar herë Sefedinin, herë inxhinierin.

— Tani gjetën kohë ata? — ju përgjegj ftohtë Sefedini.

— Ku t'i vendosim bre burrë? — tha inxhinieri duke mbyllur me inat projektet.

— Léri ata të tregëtisë, por ka ardhur edhe një teknik nga zyra postare e Mallunës, — u hodh e tha Kola.

— Ç'do ai?

— Kërkon një dhomë pér centralin telefonik.

— Dreq! Të gjithë përnjëherësh mbërriten këtu?

— u habit inxhinieri.

— Çdo fillim është i vështirë, — tha Kola. — Të duket sikur s'ke ç'të bësh më parë, por të gjitha nevojiten. Pse, keq është të kemi telefon në kantier? Mbaj mend në Kurbnesh mbetëm kushedi sa kohë pa telefon. Dhe pér një gjë të vogël dërgonim korrierin katër orë larg më këmbë...

— Dëgjo, Kolë, — e ndërpren Sefedini. — Ne kemi nevojë pér shumë gjëra. Sot e nesër na duhet të ngremë fët e fët një barrakë të mirë, që t'ua dorëzojmë atyre të tregëtisë. Pa kemi edhe një hall tjetër shumë të madh: kantieri ka nevojë pér energji elektrike. Pa energji s'ka kantier. Kjo ka rëndësi...

Qëndroi pér një çast, i vështroi të gjithë me radhë e në fund u kthye nga inxhinier Andrea:

— Pa energji kantieri është i vdekur. Apo nuk e kam mirë, inxhinier?

Inxhinieri pohoi me kokë. S'ishte casti pér fjalë. Vështrimi i Sefedinit fliste qartë... Pas një heshtjeje të gjatë, ai u zotua të merrte përsipër punën pér elektrifikimin e kantierit...

Ditë me radhë ai kthehej shumë vonë në fjetore; bille ngandonjëherë edhe më vonë se Sefedini, i cili zakonisht dilte i pari në mëngjez dhe kthehej i fundit në mbrëmje.

Në një ditë të zymtë dhjetori gjithë kantieri kishte një gjallëri jo të zakonshme. Njerëzit diçka po prisin. Kur muzgu i mbrëmjes dimërore zgjati krahët e tij të fuqishëm pér të mbuluar çdo gjë, kantierin nuk e bëri dot zap. Barrakat prej pupullit dhe sheshi i madh i kantierit të ri llamburitën nga një shkëlqim i fortë, që s'ishte parë ndonjëherë tjetër atyre anëve. Dhe ky shkëlqim, që nuk donte t'ja dinte as nga stuhia e dimrit, as nga murllani i egër, sikur donte të matej me natën e t'i thoshte: «Jam më i fortë se ti...»

Nga dritaret e kullave të fshatit njerëzit vështronin këtë fener të madh që u ndez aty anës xhadesë. Plakat ndoshta bënин kryq nëpër skutat e dhomave të errëta, përpara konizmave ku ndriçonte **kandili me vaj...** Po atë natë **bashkë me barrakat e kantierit u ndriçuan edhe disa shtëpi fshati**. **Disa specialistë** të brigadës së Fatmirit, që **kishin** punuar së bashku me inxhinierin në instalimin e dritave në kantier, morën iniciativë dhe me **ndihmën** e fshatarëve ngritën disa shtylla dhe i zgjatën

telat nga centrali i ri drejt atyre shtëpive që ishin më pranë kantierit. Po ky qe vetëm fillimi...

Ato ditë erdhi në kantier sekretari i partisë përrethin. Ai u njoh me jetën dhe njerëzit e kantierit, pa nga afër të gjitha objektet që ishin ndërtuar, bëri një takim me gjithë punëtorët e kantierit dhe dëgjoi me vëmendje kërkuesat e propozimet e tyre. Në mbrëmje, kur u ndez centrali elektrik dhe gjithë kantieri llamburiti si një ishull drite në mes të muzgut dimëror, kullat e katundit, të përhapura shpatit të malit, u dukën edhe më të zymta edhe më të errëta. Sekretari i partisë vështroi një herë kantierin, hodhi një shikim nga fshati dhe u kthye nga ata që e shoqeronin:

— Sefedin! — tha me një ton të përzemërt, — ju bie detyra ta çoni dritën edhe në fshat.

— Tani për tanj kemi halle të tjera, — ju përgjegj prerasi Sefedini.

— Po kur mendon ti se mund t'i përvisheni kësaj pune?

— Të vëmë një herë punën tonë në vijë, pastaj shohim...

— Po të prisni të marrin fund më parë hallet e kantierit kjo punë do të shkojë shumë gjatë...

— Kështu është, — mori anën e sekretarit Fatmiri, — ne jemi regjur nëpër kantiere dhe e dimë që hallet e ndërtimit nuk mbarojnë kurrë.

Sefedini e vështroi një herë me inat Fatmirin sikur donte t'i thoshte: «Punën tonë do të shohim më parë, apo hallet e të tjerëve?».

— Po ti si thua, inxhinier? — ja ndërpree mendimet sekretari.

— Sonte s'mund t'ju them ndonjë gjë me saktësi, shoku sekretar. Se duhen bërë disa përllogaritje për vëllimin e punës dhe për materialet që nevojiten. Apo nuk i kanë edhe shumë të përhapura shtëpitë këtyre anëve...

— ~~Unë kam një mendim tjeter~~, — ndërhyri menjëherë Fatmiri. — Ne të marrim zotim ta elektrifikojmë fshatin brenda dy-tre muajve. Sa për ato hesape që tha inxhinier Andrea, ato i bëjmë me nge nesër-pas-

nesër. Po ndonjë hata e madhe nuk është. Pjesën më të madhe të punës do ta bëjnë vetë fshatarët. Unë kam biseduar me disa nga ata dhe janë gati...

— Unë s'jam mësuar të marr zotime e pastaj të ngec në baltë, — tha me inat Sefedini duke vështruar nga ana e Fatmirit.

Sekretari e pa se s'kishte ardhur ende koha për zgjidhjen e problemit dhe nuk e zgjati më shumë, por kaloi në një bisedë tjeter.

— Mirë që s'na caktoi ndonjë afat, — tha Sefedini si i lehtësuar, kur sekretari u largua nga kantieri.

Pastaj Fatmiri u kthyte dhe e vështroi me inat, sikur donte t'i thoshte: «Sefedin! në këtë çështje nuk je hiç në rregull!...»

2

Një ditë të ftohtë e me erë të fortë aty ndaj të ngrysur një maqinë e vogël, që vinte nga Tirana u ndal në qendër të kantierit. Nga maqina zbriti një në-punës i Ministrisë të Ndërtimit, i cili kishte porosi të merrte Sefedinin, inxhinier Andrenë dhe ca punëtorë të vjetër, për një konsultë, që do të organizohet të nesërmen në qendër.

Të gjithë ishin të një mendimi që në konsultë të merrnin edhe usta Jorgjin. E kërkuan në gjithë kantinerin, po nuk e gjetën.

— Ku do të jetë futur? — shfryu me inat Sefedini.

Kola, që në atë çast kthehej nga puna, dëgjoi fjalët e tyre dhe u tha:

— Usta Jorgjin kërkoni? — Nuk e keni këtu son te. Është në fshat. E ka thirrur një mik për të bërë sefte rakinë e re...

— Sa shpejt u njoh me fshatarët, bre burrë! — u çudit inxhineri.

— Usta Jorgji? Ai është antik. Për një muaj u njoh me të gjithë burrat e fshatit.

— Dhe e di cilin ka si ndërlidhës? — ndërhyri Fatmiri.

— Gjetën?

— Jo, Pashkun!

— Ndaj s'donte ta lëshonte Pashkun që ta bënim kamerier. «Unë kam marrë përsipër që ta bëj një usta të mbaruar, kurse ju doni ta futni në mensë, që të merret përditë me lëngje e me salcë» — na e preu shkurt.

— Ustai e ka këtë të mirë. Ka merak të madh që t'u mësojë të rinvje zanatin e muratorit, — tha Fatmiri duke e mbyllur këtë bisedë.

Konsulta në ministri zgjati vetëm një ditë. Në mbrëmjen e ditës tjetër u kthyen në kantier Sefedini, Fatmiri dhe Kola. Inxhinier Andrenë e mbajtën në ministri. Sefedini nguli këmbë që ta merrte me vete, po drejtori i drejtorisë së projekteve i tha:

— Dëgjo, Sefedin. Vëtëm projektet e uzinës së madhe kimike, po t'i marrësh si peshë, peshojnë me dhjetëra kilogram. Më kupton? Dhe ato duhen studjuar një nga një.

Inxhinieri e dëgjonte këtë bisedë pa folur fare. Fjalët e Sefedinit tregonin se ai, megjithëse sillej shpesh ashpër e pa takt karshi njerëzve, dinte të çmonte punën e bashkëpunëtorëve të tij më të ngushtë. Dhe i vinte snumë mirë që ishte bërë i domosdoshëm pér punët e kantierit.

— E po, atëhere mirë u pafshim, inxhinier! — i tha Sefedini në çastin e ndarjes. — U pa puna. Tani pas Vtitit të ri do të shihemi përsëri.

Inxhinier Andrea në çastin e fundit, kur i shtrëngoi dorën Fatmirit, i tha:

— Të fala shokëve. E mos më harro usta Jorgjin...

* * *

Ndryshe nga ç'besonin të tjerët, inxhinier Andrea u kthye në kantier një mbrëmje të errët e me shi,

katër-pesë ditë para Vtitit të ri. Sapo zbriti nga maqina, ai mbeti me gojë hapur duke shikuar kantierin me dritat e shumta e të forta, që të jepte përshtypjen e një lagjeje të vogël qyteti. «C'zhvillim ka marrë kantieri benda dy muajve! — tha me vete i kënaqur. — Mendo tani se si do të bëhet pas një viti. Po pas pesë vjetësh?» Zemra i gufoi nga një gëzim, që e provonte për herë të parë, dhe sikur nuk ndjente më atë frikë, që e kishte pushtuar, kur kishte shfletuar atje në ministri gjithë ato projekte, që do të vihesin në zbatim menjëherë pas Vtitit të ri...

Gjithë kantieri ishte zhytur në baltë. Nga shirat e shumta që kishin rënë gjatë dy ditëve të fundit, nga gjermimet që qenë bërë kudo rrëth e rrrotull, nga lëvizjet e shpeshta të automobilave dhe të maqinerive të tjera të ndërtimit, tërë vendi qe mbuluar me baltë. Baltë në shesh, baltë në vendin e punës, baltë në rrugicat midis fjetoreve dhe barakave. Këtë baltë të verdhë në të kuq e merrnin njerëzit në këpucë e në çizme dhe e çonin në mensë, në klub, në fjetoret; bile-bile nga maqinat që lëviznin pa pushim nga kantieri për në lumë e për në gurore edhe xhadeja nja dy-tre kilometra rrëth kantierit, qe mbuluar me një shtresë të trashë balte bojë bakri. Kudo mbi baltën e trashë dukeshin gjurmat e këmbëve të ndërtuesve, si shkronja të një alfabeti të panjohur.

«Këtu nuk mund të ecet pa çizme» — tha me vete inxhinieri duke u drejtuar për në fjetore. Por atje nuk gjeti njeri.

Hapi çantën dhe rrugulloi nëpër sirtaret projektet e rinj. «Siç e shikon, — i kishin thënë në ministri — vepra është shumë e madhe dhe ndërtohet për herë të parë në vendin tonë. Prandaj kujdes...» Jashtë u dëgjuan hapa. Po ktheheshin nga puna Sefedini, Fatmiri, Kola dhe usta Jorgji. Menjëherë ndjeu një si lehtësim në zemër. Dhe doli te dera për t'i pritur.

Kur dëgjuan fjalët e inxhinierit për përpjesëtimet e mëdha që do të merrnin ndërtimet në Gurraj gjatë vitit të ardhshëm, ata erdhën në qejf.

— Andrea! — i thirri për herë të parë në emër Kola. — Ti na solle një sihariq të madh! Sonte është festë e madhe për ne.

— Ta dinim qysh më parë, do të kishim dërguar Pashkun të na merrte pak raki. More vesh? — tha usta Jorgji.

— Tani, bre burra, lerini fjalët dhe hajdeni të bëjmë një plan për këto katër-pesë ditë që na mbeten gjer në Vitin e ri. Kjo ka rëndësi, — tha i përbajtjor Sefedini.

Kthimin e inxhinierit pak vetë e morën vesh atë natë. Po të nesërmen e ndjeu gjithë kantieri, se u muarën masa për shpejtimin e punës. Të gjitha forcat u tërroqën nga objektet e tjera dhe u grumbulluan në qendër të kantierit, për të ndërtuar fjetore dhe lokale të tjera banimi. Pas Vtit të ri do të vinin në kantier forca të mëdha. Punimet për ndërtimin e hidrocentralit të madh ishin në fazën përfundimtare. Pra, një pjesë e mirë e punëtorëve, që do të liroheshin së andejmi, do të vinin në Gurrat, që ishte hallka e re në zinxhirin e lgjatë të veprave të mëdha të pesëvjeçarëve.

Kantieri i ri, në ato ditët e fundit të vitit, jetoi në një tension të madh. Që nga mëngjezi e gjer në mbrëmje vonë punohej për ngritjen e barrakave të reja. Koha një herë u duk sikur u përmirësua. Shiu pushoi dhe balta nuk qe më aq e bezdisshme. Por, në vend të shiut e të baltës, doli një armik tjetër më i rrezikshëm, murrlani.

Ndërtuesit veteranë kishin punuar në vende malore e fushore, në vende të ngrohta e të ftohta dhe e dinin se ç'ishte era e tërbuar e dimrit. Por si ky murrlani i Gurrat nuk kishin parë në asnjë vend tjetër të Shqipërisë. Murrlani vinte nga gryka e thellë e malit, ulërinte si një bishë e egër dhe dukej sikur do të rrëzonte e do të shkatërronte çdo gjë që do të gjente përpara.

— Tëmën! — shante orë e çast Sefedini, duke kaluar nëpër sektorët e kantierit me radhë. — Sikur e bën për inatin tonë. Tani që ne kemi shumë punë të ngutshme, na shembi fare kjo qerrata erë...

Usta Jorgji, që kishte dëgjuar nga fshatarët shumë legjenda të këtyre anëve, u tha disa të rinjve, që nuk i ndaheshin kurrë plakut hokatar:

— Kur fillon të fryjë në Gurraj, harron të pushojë.

— Kot nuk e kanë quajtur, «nëna e erërave». E shikon atë mal të lartë mbi fshatin, nga fillon ajo grykë e thellë? Atje nà qenka fshehur prej kohërave të lashta një shakull i madh sa i tërë mali, i mbushur me të gjitha llojet e erërave. Në kohërat e lashta gryka e shakullit qe e lidhur me një türkuzë të trashë. Grykën e shakullit e ruante një magjistar, që herë pas here e hapte nga pak, sa frynte aq sa duhej, dhe e mbyllte përsëri. Magjistari fshihej gjithë ditën nëpër pyjet që shtriheshin kudo këtyre anëve. Më vonë pyjet u prenë, magjistari s'kishte ku të fshihej më, dhe u largua nëpër male të tjera më të largëta. Mirëpo, kur mori rrugën për të ikur, u nis me ngut dhe nuk arriti ta mbyllte grykën e shakullit. Qysh atëhere këtu nuk pushon era dimër e behar. More vesh?

— Po s'e dinin punën e erës ata që e zgjodhën këtë vend për qytetin e ri?

— Ndoshta do të habiteni, por ky vend u zgjodh si truall për qytetin e ri, pikërisht për punën e erës, — nisi t'u shpjegonte inxhinier Andrea, që gjë në këtë çast ndiqte në heshtje bisedën e të rinjve me usta Jorgjin.

— Inxhinieri sot është me qejf dhe kërkon të tallet me ne, — tha usta Jorgji.

— E them me gjithë mend. Zemra e këtij qyteti që do të ndërtohet, do të jetë uzina kimike. Kur të përfundohet kjo uzinë e madhe, oxhaqet e saj do të vjellin pa pushim gazra të dëmshme për shëndetin e njeriut, helme, ta themi më mirë shkurtimisht. Këto helme, po të grumbullohen në ajër, mund të bëhen të dëmshme për shëndetin e njerëzve. Por këtu, që fryn vazhdimisht erë, këto helme do të shpërndahen menjëherë...

— S'më shkonte kurrë në mendje, — tha i çuditur usta Jorgji. — Po të ma thoshte ndonjë tjetër 'nuk do

ta besoja. Po gjersa e thotë inxhinieri... Ore! — ju drejtua tē rinxve. — Çdo gjë që bëhet tani tek ne, peshohet mirë në kandar para se tē fillohet. More vesh?..

Një natë para Vtit tē ri murrlani u duk sikur do ta përlante krejt kantierin nga faqja e dheut. Aty ndaj tē errur nisi tē ulërinte e tē vërvshëllente riëpër dritaret si një egërsirë, që sulmonte tē hynte brenda me çdo kusht. Xhamat dridheshin pa pushim dhe shpesh barrakat lëkundeshin e kërcisnin sikur në çast do tē rrëzoheshin përdhe. Llambat elektrike luhateshin si lavjerës dhe nga kontakti i telave ndërpriteshin pér një çast e ndizeshin përsëri. Kantieri i ngjante një gjemie tē drunjtë në mes tē oqeanit, që rrighet nga dallgët e mëdha tē detit dhe nga furia e papërbajtur e shtrëngatës së dimrit.

Megjithatë nëpër barraka vlonët biseda pér forcat e reja që priteshin tē vinin së shpejti dhe pér festën e Vtit tē ri.

Edhe në barrakën e parë tē kantierit, që disa e quanin si me shaka «barraka e shtabit», Fatmiri tha se duhet tē mendonin se si do ta festonin në kantier natën e Vtit tē ri. Në bisedë morën pjesë tē gjithë, edhe Sefedini. Vetëm inxhinieri, sa zgjati ky muhabet, nuk tha asnjë fjalë.

— Ku tē kullot mendja, inxhinier! — e ngacmoi usta Jorgji.

— Po dëgjoj bisedën tuaj, — u përgjegj ai si me zor.

— Ku do ta bësh Vtin e ri sivjet?

— Të shohim një herë...

— Hala s'e ke vendosur?

— Rri këtu me ne, Andrea! — i propozoi Kola. — Të shikosh me sytë e tu se punëtorët e ndërtimit nuk dinë vetëm tē ngrenë mure, tē hedhin soleta e tē ndërtojnë uzina e pallate. Po pér nder!

Inxhinieri nuk u përgjegj.

Ditën e fundit tē vitit tē vjetër ndërtuesit e kaluan si edhe ditët e tjera me punë.

Aty ndaj tē gdhirë murrlani u duk sikur ra pak. Po qysh në orët e para tē mëngjezit ja nisi përsëri më me tërbim. Do tē thoshte njeriu se, pasi ishte çlodhur

për dy tri orë, kishte marrë forca të reja e kushedi kur do të pushonte.

Pjesa më e madhe e skuadrave po u jepte fund fjetoreve dhe po punonte nëpër çati. Kola, që zakonisht lëvizte nëpër trerët e çative lirshëm, sikur të ishte në shtëpi të tij, tani ecte i përkulur që të mos e rrëzonte era. Herë-herë, kur donte të jepte ndonjë urdhër, vinte duart në gojë si hinkë dhe bërtiste me forcë, por asnjeri s'e dëgjonte. Zëri i tij i fortë mbulohej nga murrlani i egër. Atëhere filluan të merren vesh me shenja. Po t'i shikoje së largu, do të thoshe se kishe të bëje me shurdhë-memecë, që komunikojnë midis tyre vetëm me gjeste. Kur kërkonin ndonjë material nga ai që ishte poshtë, përdornin copa pllakash eterniti, ose tulla, ku shënonin me laps atë që kërkonin.

«Si në kohërat e lashta, kur përdornin tullat përtë shkruar» — tha me vete inxhinieri duke hipur mbi çatinë e një hangari të madh, që do të përdorej si garazh përmaqinat. Kur hipit lart, e provoi më mirë forcën e erës. Një çast u detyrua të mbahej nga një tra, që të mos rrëzohej. «Teorikisht në kondita të tillë s'mund të punohet», — u mendua, duke kujtuar ato që kishte mësuar në universitet.

Pas pak rrëshqiti me kujdes nga ana tjetër e çatisë, që nuk e rrihet shumë era. I hodhi një sy kantierit. Kudo njerëzit punonin pa e përfillur murrlanin. Fytyrat e njerëzve ishin si të ashpërsuara nga era. Ja, edhe Sefedini me flokë të shprishur e me hundë të kuqe, si një gogozhare e arrirë, shpejton hapin drejt tij dhe i bën shenjë me dorë. Por ai nuk kupton se ç'kërkon të thotë dhe zbet nga çatia duke pëshpëritur: «Ende nuk e kam mësuar këtë gjuhë me shenja».

— Të gjitha objektet që janë në përfundim, duhet të mbulohen brenda ditës, — i tha Sefedini në vesh. — Se po të mbeten të mbuluar përgjysmë, natën i përlan murrlani.

Në çastin e parë, kur dëgjoi fjalët e Sefedinit, donte t'i thoshte: «Po sot jemi në prak të Vtit të ri, o Sefedin!» Por u mendua më mirë bëri shenjë me kokë se e

aprovonte dhe tha me vete: «Ka të drejtë. Si s'më vajti fare në mendje? Se si jam si i shastisur sot».

Gjatë pushimit të drekës filloj të binte borë. Era e fortë i merrte me furi flokët e borës, kështu që dukeshin sikur fluturonin horizontalisht e nuk binin fare në tokë, por përplaseshin në muret e godinave e në vende të ngritura.

— Do të dalim edhe pasdite në punë, s'kemi ç'bëjmë — u dëgjua në mensë zëri i fortë i Sefedinit, që hodhi një shikim hetues në gjithë sallën e pastaj vazhdoi: — Ata që kanë ndër mend të shkojnë në shtëpitë e tyre, për ta festuar atje Vitin e ri, të nisen që tanë. Ne të tjerët që do të qëndrojmë këtu, do të përfundojmë fjetoret, që na kanë mbetur përgjysmë. Kjo ka rëndësi...

Ndërtuesit, duke dalë nga mensa, drejtoheshin përnë objekte. Kola hipi i pari mbi çatinë e garazhit të madh për të mbërthyer fletët e fundit të eternitit. Pas tij vanë ustallarët e tjerë të brigadës. Të gjithë punonin me shpejtësi e në heshtje. Pranë kulmarit u ngrit përnjë çast shtati i gjatë i një njeriu të fortë, që nuk donte të dinte as nga të ftohtit, as nga bora, as nga murlani. Mbi xhupin e tij të vjetër e mbi kasketën prej meshini përplaseshin me furi flokët e borës bashkë me murlanin.

— Ulu, Sefedin, ulu, se të rrëzon kjo erë, nuk bën shaka! — i thirri Kola me të madhe.

— E, ore, shumë me të egër e ka marrë sot.

Inxhinieri, duke zbritur nga çatia, hodhi një shikim rrëth e rrotull. Retë e dendura ishin ulur aq sa duke-shin sikur mbështeteshin mbi majat e maleve. Hori-zonti ishte ngushtuar shumë. Kantieri dukej si i rrëthuar nga të gjitha anët prej dimrit të egër. Megjithëse që ende mjaft herët, dukej sikur po ngrysej...

— Dita e fundit e vitit po mbaron, — tha me vete inxhinieri. — Pas pak vjen nata, nata e gëzuar, nata e pa-harruar e Vitit të ri.

— Kujdes, djema, kujdes! Se rrëshqet çatia nga bora. Sidomos ju atje lart, pranë kulmarit, — u thoshte

Fatmiri njerëzve të brigadës që po përfundonin një fjetore të gjatë.

Inxhinier Andrea kontrolloi edhe një herë punën dhe dha udhëzimet e fundit që të mbaronin sa më parë. Në strehë të një kapanoni, një fletë katramaje ishte zërthyer nga një anë dhe valavitej në erë. Ai ishte mbërtheu mirë. Pastaj kontrolloi mirë gjithë çatinë e mbuluar.

Në rrugë kalonin maqina. Të gjitha për në Tiranë dhe asnje në drejtim të kundërt. «Njerëzit shpejtohen të arrijnë pranë familjes që të mos i zejë nata në rrugë, — tha me vete. — Dhe kanë hakë... Ku kam qenë unë në këtë orë vitin e kaluar? Oh! e mbaj mend fare mirë! Çaste të tilla nuk harrohen kurrë! Gjithë pasditen shëtitë rrugëve të Tiranës dorë më dorë me atë. Ndaj të ngrysur kaluam Rrugës së Barrikadave. C'lëvizje! C'gjallëri! Domim të hynim nëpër dyqane, se kishim ende për të blerë disa gjëra të fundit për natën e Vtitit të ri, por s'na bënte zemra të largoheshim nga rrugët e ndriçuara, ku lëvrinin njerëzit. Na pëlqente të shëtisnim trotuarëve, duke soditur vitrinat e zbulkuarara dhe valët e njerëzve që ecnin me ngut, sikur shkonin në një takim, që e prisnin prej kohe me padurim. Ajo më shtrëngonte dorën dhe unë i shtrëngojja asaj krahun. Dhe nuk flisnim, se merreshim vesh më mirë kështu... Ndërsa tani gjendem majë çatisë së një fjetoreje të ndërtuar me nxitim të madh. Këtu lart murrlani të than dhe po të mos mba-hesh mirë, të rrëzon poshtë. Tani pasdite acari u bë më i fortë. Po të mos kisha blerë javën e shkuar këtë xhaketë prej meshini, të ftohit do të më hynte në palcë... Ja, po ngryset. Në këtë orë rrugët e Tiranës do të jenë mbushur rishtaz me njerëz që mbajnë në duar dhurata e sende të tjera. Unë sivjet s'bleva asnje dhuratë. Por për cilën ta bleja?... Pa dale... Aty te kthesa e Rrugës së Barrikadave, sikur shoh një vajzë të njojur. Po, po, ajo është... Pse ecën e vëtmuar dhe e menduar? C'pret? Mos më pret mua? Nuk besoj. Unë ja kam bërë të quartë çdo gjë; edhe me gojë edhe me letra: «Do t'i bindesh zemrës, dashurisë, apo do të kërkosh të bësh

karrierë?» — Kështu më tha në takimin e fundit. Sikur unë erdha këtu në Gurraj për të bërë karrierë. Budallaqe!..»

— Fund! Çdo gjë mbaroi — thirri Fatmiri; punëtorët nisën të zgresin një nga një nga çatitë e fjetoreve të përfunduara.

4

Ndërtuesit menjëherë pas punës kaluan nga fjetoret, hoqën rrobat e punës dhe me ndonjë orë natë nisën të mblidheshin në sallën e mensës. Tavolinat e mensës ishin shtruar me gjithë të mirat. Gjellëbërësi trashaluq i mensës së kantierit u tregua shumë mendjehollë në të gatuarit e llojeve më të ndryshme të mezeve. Nga ana e tij usta Jorgji vuri në praktikë gjithë përvojën e tij të gjatë në të shtruarit e tavolinave. Në çastin e fundit Lleshi me Azisin sollën një goxha bredh të prerë në pyll dhe e vendosën në mes të sallës. Bora e ngrirë në degët e bredhit, nën dritat e forta të sallës, lëshonte reflekse, quditërisht të bukura dhe origjinale.

Inxhinier Andrea hyri nga të fundit në mensë. Dukej shumë i menduar dhe si i vrarë në fytyrë. Ishte e qartë se në shpirtin e tij ishte zhvilluar një luftë e ashpër, që ende nuk kishte marrë fund plotësisht. Para disa javësh ai e priste të shtunën me padurim, si një festë të madhe dhe ndjente morrnica në trup, duke kujtuar çastin që do të nisej për në Tiranë. Ndërsa tanë po qëndronte këtu në kantier për të kaluar natën e Vtit të ri! Kurse mendonte këtë gjë, habitej edhe vetë. Detyra e madhe që i ishte ngarkuar, për të ndërtuar fjetore e lokale të tjera për forcat e shumta që do të mbërrinin në kantier menjëherë pas Vtit të ri, duhej të kryhej patjetër brenda kohës së caktuar. Ai e kuptonte mirë arësyen. Hidrocentrali i madh mbaronte përpëra afatit. Pra, edhe forcat që punonin atje do të largoheshin së andejmi më shpejt nga c'ishte parashikuar. Prandaj, baza e kantierit duhej të ishte gati patjetër. Por tanë do të dilnin njëmijë probleme të reja.

C'të bënte, pra, ai? Të largohej? Për një kohë të gjatë u luhat midis detyrës, që kërkonte ta mbante këtu dhe dëshirës që kishte për t'u larguar. Po ku të shkonte në Tiranë? S'do mend që nuk do të mbetej jashtë. Ai atje kishte shumë miq. Por edhe këtu kishte zënë miq të rinj...

Në minutën e fundit, kur maqina u bë gati të nisej, Postoli nxori kokën nga xhami i hapur, dhe i hodhi një shikim plot habi, sikur donte t'i thoshte: «Vërtet nuk do të vish, inxhinier, sonte në Tiranë? Këtë s'ma merrte mendja kurrë!»

Më në fund inxhinieri mori rrugën e mensës. Usta Jorgji edhe u çudit, por më tepër u gjëzua, kur e pa te dera e mensës, të veshur me rroba të reja, si për festë.

— Nuk ike? — i tha duke i shtrënguar duart. — Sa mirë! Sa mirë! Do ta djegim sonte, Andrea! Ke për të parë!

— Pse s'fillojmë tani? — pëshpërisnin njerëzit nga tavolinat.

— Vërtet, o usta Jorgji, pse nuk fillojmë? — e pyeti inxhinieri duke zënë një vend bashkë me Kolën e me Lleshin.

Usta Jorgji i vajti fare pranë dhe i tha në vesh:

— S'na ka ardhur ai shejtani i vogël.

— Pashku?

— Po. E kam dërguar në fshat për disa çikërrima që na lypsen për sonte dhe ende s'po duket.

— Si do të vijë i shkreti, në këtë kiamet? Jashtë po prishet dynjaja!

— Jashtë po bëhet kiameti dhe unë po prishem mendsh, Andrea.

Inxhinieri ktheu kokën dhe shikoi jashtë nga dritarja. Era ulërinte. Xhamat kërcisinë sikur do të thyhej. Në dritën elektrike dukej bora, që era e vërviste me furi na çatitë e barrakave, në muret e ndërtesave, në grumbujt e tullave dhe të gurëve dhe në dritaret e ndriçuara të mensës.

Padurimi nëpër tavolina po shtohej.

— Të fillojmë! Të fillojmë! — thërrisnin disa të rinj

duke trokitur ritmikisht lugët e pirunët mbi pjatat. Inxhinieri kthehu kokën dhe pa Azisin bashkë me një grup të rinjsh, të cilët kishin bashkuar dy-tri tavolina, në fund të sallës së madhe të mensës.

— Ja ku na vjen dhe Sefedini! — thirrën në kor të rinjtë.

Dera e mensës u hap dhe bashkë me Sefedinin u sul brenda edhe murllani i egërsuar. Sefedini ishte mbuluar me borë. Hoqi qasqetën prej meshini dhe shkundi mushamanë e gjatë, që e kishte veshur mbi xhupin.

— S'e hoqe një herë atë pambukore nga kurrizi, o Sefedin! — i tha me zë të lartë Kola. — Edhe sonte që është nata e Vtitit të ri?

Nga ana tjetër e mensës u dëgjuia zëri i Fatmirit:

— Sefedin! të presim, eja!

— Bo, bo! Sa nxeh të bën këtu! — u habit Sefedini, duke fërkuar faqet dhe hundën e skuqur nga thëllimi. Pas pak vajti e zuri vend në tavolinën ku rrinte Fatmiri bashkë me disa muratorë e karpentierë.

— Epo, tani filloni! — tha si me siklet usta Jorgji.

— Nuk do të mbash ndonjë fjalim, o usta? — deshën ta ngacmonin ata të tavolinës së Azisit.

— Ç'kini, or shejtanë? Unë vetëm mure dhe çati di të bëj; fjalime mban i ju, që jeni me shkollë. More vesh?

— Hape tani mbrëmjen, de!

— Mbrëmjen e hapin këto, — tha ustai, duke ngritur një shishe të mbushur me raki.

Pastaj u drejtua nga të gjithë dhe bashkë me gotën e rakisë ngriti edhe zërin.

— E po gëzuar, or shokë! Viti i ri na pruftë gjithë të mirat: pallate, fabrika, centrale!

— Gëzuar, usta Jorgji! — u ngrit pas tij Fatmiri. — Le ta pimë këtë me fund për qytetin e ri!

— Për qytetin e ri! — thirri edhe Sefedini dhe e kthehu gotën me fund.

Inxhinier Andrea piu vetëm një gllënkë dhe u ul përsëri i menduar.

Dera u hap si me zor dhe brenda në sallë rrëshqiti diçka si një top i çuditshëm i bardhë. Të gjithë kthyen sytë nga ai.

— Pashku! Pashku! — thanë ata që rrinin pranë derës.

— Pashku? — thërriti me të madhe usta Jorgji dhe rendi drejt atij njeriu të shkurtër prej bore, që kishte qëndruar në mes të sallës. Kur i vajti pranë, i hoqi me të shpejtë thesin, me të cilin që mbuluar njeriu prej bore dhe para të gjithëve doli ajo fytyra e njohur e djaloshit të vogël.

— Ku je, more shejtan?! Ç'u bëre sonte? — bënte sikur i bërtiste usta Jorgji, duke e përqafuar e duke e shtrënguar në gji. — Ti je bërë akull, mor bir, akull fare. Futi duart këtu në gjoksin tim që të të ngrohen!

— Usta Jorgji, — u dëgjua një zë i qartë fëmije.

— Hudhra nuk ka. Nuk gjeta dot. Vajta në pesë shtëpi, por asnjë s'kishte.

Gjithë salla ushtoi nga të qeshurat, që, për një çast, mbuluan edhe gjëminin e murrlanit.

— Të tjerat ja ku i ke, — i tha djali usta Jorgjitet, duke hequr nga krahu një trastë të mbushur me gjëra të ndryshme.

— Hudhra? Në dreq të shkojnë! Mjafton që na erdhe ti. Shejtan! — i tha usta Jorgji dhe e puthi në ballë. Pastaj u kthye nga të tjerët.

— Më jepni një gotë të mbushur, or shokë. Tani do ta pi megjithë qejf. Viti i ri do të shkojë mbarë. Mbarësia na erdhi, qysh sonte: ja ku e kemi! — tha duke treguar Pashkun. More vesh?

Pa e zbruzur mirë gotën usta Jorgji, barraka u tund e téra si nga një tërmët i fortë. Xhamat kërcitën me të madhe sikur do të shkallmoheshin. Dritat u shuan për një çast.

— Merrjani një kënge! Një këngë! — u dëgjua në errësirë zëri i Fatmirit.

Dhe përnjëherësh, në mes të errërës dhe të ulërimës së murrlanit, u dëgjua një çifteli, së cilës i binte bukur një dorë mjeshtri.

Dritat u ndezën përsëri.

— Të ëmën! — çfryu Sefedini duke përgjuar murr-lanin. — Kam frikë se kjo erë e marrë do të na bëjë zarar.

Nuk arriti të mbaronte fjalët dhe diçka si një zhaurimë shurdhuese, si një dallgë e fuqishme deti, që rrëzon një shkëmb të madh, u përplas mbi barrakën, ku ndërtuesit festonin Vitin e ri. Mensa u trondit e tëra, dera u hap me rrëmbim dhe po në atë çast dritat u fikën fare. Një rrapëllimë e tmerrshme u dëgjua në mes të natës, që u pasua nga tringëllima xhamash që thyheshin, nga tjegullat që rrëzoheshin përdhe e nga fletët e llamarinës, që, pasi fluturonin në erë, binin pastaj si shpend grabitqarë të vrarë në fluturim e sipër. Çiftelia e Lleshit nuk u dëgjua më. Salla e mensës u zhyt në errësirë. Për një çast sundoi një heshtje e rëndë e plot ankth.

— O burrani, djema! Pas meje! — sokëlliu befas Sefedini dhe u vërsul jashtë. Pas tij vrapuan përnjë-herësh edhe të tjerët. Bashkë me ta rendi edhe inxhinier Andrea. Salla mbeti bosh. Në dritën e mekët, që dilte nga refleksi i zjarrit në kuzhinë, dallohej koka e madhe e gjellëbërsit, që, me thikë në dorë, shikonte i trembur dhe i habitur. Në çastin e parë, kur dolën nga dera e mensës, murrlani qe aq i fortë, sa i rrëzonte përdhe e nuk u lejonte të bënin asnjë hap përpara. Atëhere, ata që shkonin në krye, u rokën dorë për dore dhe u sulën së bashku drejt hangarit. Pak nga pak vala e murrlanit sikur u largua më tutje dhe, si një kalë i egër dhe i hazdisur, vrapoi drejtë fushës, për të shkulur e për të rrëzuar edhe atje pemë, shtylla telegrafike, çati shtë-pish të mëdha e kasolle të vogla. Në malin e largët pylli gjëmonte si një det i shkumbëzuar nga dallgët.

Sefedini, që për një çast u shkëput nga të tjerët dhe u sul përpara, u pengua në disa tela dhe u rrëzua përdhe. Por u ngrit shpejt e shpejt dhe thirri me të madhe:

— Kujdes, djema, kujdes! — dhe vazhdoi përsëri vrapin.

Gjithë kantieri qe zhytur në errësirë. Por në bardhë-

sinë e borës dallohej mirë hangari i madh i maqinave, që ishte shkatërruar i terti. Një pjesë e mbulesës ishte rrëzuar fare, kurse pjesa tjetër kishte bërë bark. Mendja u vajti menjëherë te maqinat që gjendeshin atje. Sefedini, i cili ishte marrë personalisht me ngritjen e hangarit, aty për aty, mendoi: «Gjithë ai mundim dhe gjithë ajo djersë të shkojë kot! Të zhduket në minutë puna që është bërë për disa ditë me radhë nga një brigadë e tërë!» Dhe shtrëngoi grushtin e ngrirë nga të ftohtit, sikur i hakërhohej një hijeje të padukshme, që e shihte vetëm ai.

Ata që ju afroan të parët hangarit të rrëzuar, dëgjuan si një zë njeriu, si një klithmë të largët. Nga vinte kjo klithmë? Mbase qe ulërima e murrlanit, mbase qe vërvëllima e erës...

— Do të jetë roja! Xha Idrizi! — u dëgjua zëri i fortë i Kolës.

S'dihet se kush arriti i pari në vendin nga vinte klithma. Në të njëjtën kohë me dhjetëra duar nisen të hiqnin kapriatat, trarët, dërrasat dhe fletët e eternitit të rrëzuarë e të copëtuara. Nuk vonoi shumë dhe xha-Idrizin e nxorën nga gërmadhat gjysmë të alivanosur. Dikush hoqi kapotën e vet dhe e bëri tezgë. Disa duar të forta e morën dhe e quan në mensë.

— Puna është që të shpëtujmë edhe maqinat, — tha Kola, duke hipur mbi çatinë e rrëzuar përgjysmë.

— Prit, Kolë! — i thirri inxhinieri. — Të shohim një herë a mban çatia!

— Kola është i lehtë si nusja e lalës, inxhinier, — ju përgjegj Azisi.

Ndezën një copë llastiku për të bërë pak drithë. Pasi hoqën pjesën e rrëzuar të çatisë, panë kamionat e radhitur në hangar. Disave u ishin thyer xhamat e kabinave, disa të tjerëve u ishin prishur parafangot. Të gjitha qenë të mbuluar me copa eterniti, dërrasash, kapriatash.

— Maqinat shpëtuan mirë, — tha Azisi, — vetëm duhen nxjerrë këndeje.

— Po ku t'i çojmë? — pyeti një shofer.

— Nesër do ta rregullojmë përsëri hangarin, — ju përgjegj Fatmiri.

— Po sikur të fryjë prapë murrlani dhe ta prishë rishtas? Këtu është vendi i dreqit!

— Jo, nuk do ta prishë përsëri, — ja preu me inat Sefedini. — Do ta ndërtojmë më të fortë këtë radhë, kështu që t'i bëjë ballë edhe murrlanit më të egër. Mbështetja kemi bërë gabim që kemi zgjedhur këtë vend pak si të ngritur për hangar. Këtu e rreh shumë era. Tani do të zgjedhim ndonjë vend më të përshtatshëm.

5

Si morën fund rregullimet urgjente e të domosdoshme, ata u kthyen grupe-grupe në mensë. Duart i kishin të ngrira dhe rrobat u ishin bërë si dhogë nga acari i natës e nga era e ftohtë. Tavolinat e shtruara me meze e raki i prisnin të paprekura. Mirë po tani nuk kishin drithë.

— Ku është Kola? — pyeti inxhinieri.

— Kola ngeli atje në çati, — ju përgjegj Fatmiri.

— Do të ngrijë i shkreti!

— Mos ki frikë, inxhinier. Kola është si macja me shtatë shpirtra.

— Po Sefedini?

— Sefedini vajti poshtë në central për të ndrejtur dritat — foli Azisi.

— Zor që të na vijnë dritat sonte.

— Ku ta dish? Mbështetja i rregullon. Ti e di Sefedinin...

— Po usta Jorgji çu bë?

— Usta Jorgji coi xha-Idrizin në barrakë. I bëri shpejt e shpejt një jaki, ja vuri në gjoks dhe ja lehtësoi shumë dhimbjet, — tha nga kuzhina gjellëbërësi.

Tavolinat u mbushin përsëri me njerëz. Po në mensë ishte errësirë. Vetëm tavolinat e mesit ndriçohej shumë pak nga një dritë e mekët, që dilte nga ana e kuzhinës.

— Sa éshtë ora? — u dëgjua në heshtje zëri i Lleshit.

— Po shkon dy e gjysmë, — u përgjegj gjellëbëreshi nga kuzhina.

— Domethënë ka më se dy orë që ka ardhur Viti i ri, — tha si i habitur Fatmiri.

— Me pak fjalë Viti i ri na gjeti në sulm.

— O Llesh, ku e lamë qëpari çiftelinë? — pyeti Kola, duke hyrë në mensë.

Në atë çast u ndezën dritat.

— Erdhën dritat! Erdhën! — bërtitën të rinjtë nga fundi i sallës.

— Të lumtë, Sefedin! — thirri Fatmiri.

Dritaret e fjetoreve llamburitën në mes të natës. Murrlani frynte me hope. Por ato drita që u ndezën përsëri, sikur donin t'i thoshin: «Ne jemi më të forta se ti!»

Këtë radhë të rinjtë i dolën përpara Lleshit, duke marrë një këngë dashurie. Kur mbaruan ata, u dëgjua melodia e hollë dhe elegante e çiftelisë. Festa e ndërprerë po merrte përsëri hov.

Sefedini u kthyte në sallë i fundit. Kur e panë te dera, të gjithë e përshëndetën me përzemërsi:

— Gëzuar Vitin e ri, Sefedin!

— Gëzuar shokë! Gëzuar! — u përgjegj ai me një zë që mezi i dilte nga fytë.

I dhanë një gotë me raki, por s'mund ta mbante në dorë. Gishtat i kishte të ngrirë.

— Na, piye, që të ngrohesh, — i tha Kola duke ja derdhur në gojë.

— Eja, Sefedin, të pimë një së bashku! — i tha inxhinieri, duke i vajtur pranë. E hodhën gotën, u shikuan ndër sy dhe i buzëqeshën njëri-tjetrit me mirëkuptim.

Inxhinier Andrea ra përsëri në mendime. I kujtoheshin mbrëmjet në Tiranë, kur qe student, e më vonë kur punonte në drejtorinë e projekteve. Kjo festë e parë në kantier nuk ngjante aspak me ato të tjerat, të mëparshmet. Pikësëpari në këtë mbrëmje këtu në sallën e mensës nuk kishte asnë vajzë. Por nuk mungonin vetëm vajzat. Në sallën e mensës nuk kishte as orkestër.

E megjithatë nuk mungonte as qejfi, as gjallëria. Në fund të sallës kishte filluar vallja. Ja, tani sikur e kërkonin andej nga fundi.

— Unë them të pimë një gotë për seriozitetin e inxhinierit tonë, — thirri me të madhe Azisi dhe të gjithë u gajasën së qeshuri. Inxhinieri u ngrit nga vendi me një gotë në dorë dhe u drejtua nga tavolina e të rinjve. Piu një gotë me ta dhe zuri një vend në mes të tyre.

— Tani dëgjohet! Sa mirë! — tha një i ri që qëndronte si mënjanë.

— M'i jep edhe mua, or shok!

Inxhinieri shikoi nga kjo anë dhe pa një palë kufje në veshët e atij të riut, që rrinte si mënjanë.

— A do të dëgjosh, inxhinier? — e pyeti i riu.

— E pse jo?

— Na, merre tani që dëgjohet qartë..

— Dale, or vëlla, dale! Ta dëgjoj edhe një herë!

— Këtu nuk je vetëm ti, or shok! Prit ta dëgjojnë edhe të tjerët.

Inxhinier Andrea mori në dorë kufjet dhe i vuri në vesh. Një zë gruaje, një zë sopranoje arrinte valë-valë gjer aty. Kënga herë-herë dëgjohej fare qartë, sikur vinte nga ana tjetër e sallës së mensës, herë-herë humbiste e gati shuhej fare, sikur vinte nga një planet tjetër. Edhe murrlani herë-herë egërsohej e tërbohej fare, sikur donte të luftonte kundër asaj këngë të bukur; por kënga dilte më e fortë se murrlani. Befas melodja mbaroi dhe menjëherë e pasuan duartrokitje të gjata e zëra entuziazztë.

«Po dëfrejnë njerëzit!» — tha me vete inxhinieri dhe njëmijë mendime i shkrepën përnjëherësh në kokë. Duartrokitjet vazhdonin ende. Ai parafytyroi një sallë të madhe ku me dhjetëra çifte vallëzonin rreth pemës së Vtit të ri, të stolisur për bukuri. Një dorë u zgjat dhe ja rrëmbeu kufjet nga veshi. Por kjo nuk e ndërpree melodinë e ëmbël të një valsi, që atij i pëlqente aq shumë. Ju kujtua festa e vtit të mëparshëm. Ai mbante mend edhe hollësitë më të vogla të asaj nate të paharruar. Natën e Vtit të ri e kishte kaluar në shtëpinë

e Shemshiut, shokut tē tij mē tē ngushtë tē shkollës. Atje, sigurisht, nuk kishte vajtur vetë». Shemshiu, që ishte organizator i tē gjitha mbrëmjeve tē grupit tē tyre dhe shakaxhi i madh, u kishte vënë këtë kusht: «Në mbrëmjet e Vtit tē ri pranohen vetëm çifte». Ja edhe diçka tjetër ju kujtua tani. Aty nga orët e vona tē natës ajo ju afrua atij dhe i pëshpëriti në vesh: «Andrea! Festën tjetër tē Vtit tē ri do ta festojmë në apartamentin tonë. Kështu?» Dhe ai pohoi me kokë...

Çfarë ndryshimesh solli ky vit që po mbaron! Ç'kthesë e madhe në jetën e inxhinier Andresë! Ai e festonte tani Vitin e ri në këtë barrakë tē largët, ku ulurinte murrlani.

— Andrea! — i thirri Kola në emër, duke ju afruar me gotën në dorë. — Çështë kjo punë me ty! Ç'ke që rri kështu?

— S'kam gjë, Kolë, jo.

— Dëgjo, sonte do tē bëjmë qejf, është nata e Vtit tē ri. Pas festës do tē kemi kohë edhe pér tē menduan edhe pér tē punuar. Po pér nder! Eja tē pimë një gotë pér shëndetin tënd, me fund! Dhe në dasmën tënde!

Lleshi vazhdonte ti binte çiftelisë. Azisi me shokët e tij tē tavolinës hoqi një valle vendçe. Me ta u bashkua edhe Kola, duke thirrur me tē madhe:

— Digjeni, djema! Digjeni! Po pér nder!

Dalëngadalë inxhinier Andrea erdhi në qejf. Ai piu, këndoi dhe kërceu bashkë me shokët e tjerë tē kantierit. Por mendja shpesh i fluturonte larg, shumë larg. Kishte kohë që nuk jetonte me kujtimet e vjetra. «Interesant. — thoshte me vete duke shikuar shtresën e tymit, që lundronte si mjegull në sallën e madhe. — Kjo puna e ndërtimit është me tē vërtetë si një valle, ashtu si thotë usta Jorgji; një valle e madhe që tē bën pér vete, tē thith fund e krye e nuk tē lë tē merresh hiç me tē kaluarën. Por sonte një forcë e madhe më tërheq drejt viteve tē mëparshme, drejt ngjarjeve tē jetuara e tē paharruara».

Para mendjes së tij parakolojnë me nxitim ditët, muajt, e vitet. Ngjarjet e shumta pleksen e ngatërrohen

dhe shumë ftyra mezi dallohen në mjegullën që mbulon çdja gjë të shkuar. Mbi mjegullën e dendur të kohës dalin disa majë të larta, që duken fare qartë dhe s'kane frikë se mos i fshijë dora e harresës. Përpara syve të mendjes i del një fshat jo edhe shumë i madh, po i bukur, një nga ato fshatrat, që isiq thoshte i ati, vetëm në bregdet mund t'i gjesh. Anës së fshatit një shtëpi e bardhë, si bora, majë një kodre të veshur me ullinj shekullorë. Përpara shtëpisë hapet një panoramë e mahnitshme. Qoftë nga dritaret, qoftë nga ballkoni syri nuk të sheh asgjë tjetër veç detit të pafund. Zhaurima e dallgëve të detit gjëmon netëve të stuhishme të vjeshtës e të dimrit, kurse në verë e në pranverë mezi dëgjohet murmuritja e valëve të lehta, si një psherëtimë e një pëshpëritje e fshehtë dashurie. Njerëzit e shtëpisë shikojnë detin për të përcaktuar drejtimin e erërave dhe përsëri nga deti parashikojnë motin. Gjyshi plak, kur dëgjonte detin të gjëmonte si ndonjë përbindsh, u thoshte vocrrakëve, që i mblidheshin rrötull: «E dëgjoni detin si gjëmon? Ai qan për trimat që janë vrarë në luftëra kundër dushmanit». Por gjyshja, që rrinte në kreun tjetër të vatrës, kthehej nga ai dhe i thoshte me zë të ngjirur: «Jo, zallahia e detit është nga vajtimi i nënave dhe i grave, që kanë djemtë e burrat në kurbetin e zi».

Sa herë kishte ndëgjuar Andrea në shtëpi të flitej për bukën e hidhur të kurbetit! Se edhe i ati, Prokua, e kishte lënë fshatin e kishte kaluar oqeanin për të kërkuar fat. Por, pasi bëri katër-pesë vjet në dhe të huaj, u kthye përsëri në shtëpi, u martua dhe nuk u largua më nga fshati, i lindjes.

Në atë shtëpi të vogël majë kodrës, që e rreh era e shëndetshme e detit dhe e mban në këmbë vaji i ullirit, lindën dhe u rritën tetë fëmijë: pesë djem dhe tri vajza. Fëmija i parë qe Andrea. Kur e ngacmonin moshatarët për fëmijët e shumtë, Prokua u përgjegjej aty për aty edhe me seriozitet edhe me të qeshur: «Në këtë dynjë ka njerëz e njerëz. Ka asish që janë tamahqarë për para dhe nuk i zë gjumi po s'patën mënjanë një qese me flori. Ka të tjerë që rropaten e bëhen copë që të kenë

sa më shumë tokë e bagëti. Unë për vete s'kam as flori, as tokë, as bagëti. Por kam fëmijët. Kur të më rriten kalamanët, hajdeni një herë të shohim kush do të ketë dalë i fituar».

Andrea mban mend se kur kishte qenë kalama i kishin shkuar shpesh në shtëpi disa njerëz me pushkë në krah dhe me yllin në ballë. Gjendja e familjes qe shumë e vështirë se, përvèç të tjerave, çmimi i vajit kishte rënë përtokë, kurse ai i misrit qe ngritur në qiell. Megjithatë i ati i priste ata njerëz me bukë e kripë e me zemër të hapur. Dhe Andrea i vogël rrinte gjer natën vonë për t'i dëgjuar.

Pa pushuar mirë pushka, atyre anëve filloj zhurma e çekanit të muratorëve për të ndërtuar shtëpitë e djegura. Kushedi sa herë ai bashkë me shokët e tjerë të klasës, kishte punuar për të transportuar gurë e materiale të tjera, atje ku ndërtoheshin shtëpitë e reja! Pastaj erdhën aksionet e rinisë, shkolla e përsëri aksione. Punë në aksione dhe tëndërrime; mësimë në klasë dhe tëndërrime. Mos vallë, qe mosha që i ushqente këto tëndërrime të guximshme? Qe sigurisht edhe mosha, por edhe vrulli që po merrte vendi për të fluturuar mbi shekuj...

Kur u regjistrua në Fakultetin e inxhinierisë dhe hyri në një sallë të madhe për të dëgjuar leksionin e parë, ndjeu një kënaqësi të thellë, se po i realizohej një nga dëshirat e tij më të zjarrrta. Gjatë viteve të jetës studenteske, sado që e tërhoiqnin shumë défrimet e rinisë, nuk u shkëput kurrë nga leksionet e nga studimi, kështu që edhe në mbrojtjen e diplomës doli i shkëlqyer...

Kishte ardhur koha që ai të vinte në jetë tëndërrat më të bukura të rinisë. Por ato aty në drejtorinë e projektit sikur ishin mbuluar nga një shtresë hiri e pluhuri, ashtu si mbulohet thëngjilli i ndezur nga një shtresë hiri e nuk të ngroh më. Jeta e qetë e pa telashë e në-punësit të drejtorisë së projekteve nuk i shkonte për shtat natyrës energjike të tij. Po tanë? Jeta këtu në kantier ndryshonte fare nga ajo e kryeqytetit. Telashet dhe shqetësimet që lindnin orë e çast, i kujtonin murrlanin

e egër që frynte përjashta. A do t'i bënte dot ballë këtij murrlani?..

Gjithë salla e priti me thirrje e brohoritje gjëzimi hyrjen e usta Jorgjit në mensë nga dericëka e fshehtë që të conte në kuzhinë. Inxhinier Andrea e pa veteranin që u buzëqeshte të rinxve dhe filli i kujtimeve ju këput si me sépatë. «E duan me të vërtet plakun e mirë, — tha me vete duke vështruar usta Jorgjin. — Mirë thotë Fatmiri se ai është kripa e kantierit...»

— Usta! — i thirri me të madhe Kola, — si është xha Idrizi?

— Idrizi: Qiqër!

— Çudi se si shpëtoi! Gjithë ato materiale që i ranë përsipër. Unë, kur e pashë të mbuluar nga copa eterniti, thashë me vete: «Vajti xha-Idrizi. U bë kurban i kantierit...»

— Cuditesh edhe ti, o Kolë? Ti je i vjetër nëpër kantiere dhe e di mirë se ne na njohin edhe dërrasat, edhe gurët, edhe tullat, edhe hekurat. Dhe kur na bien mbi trup, vetëm sa na gudulisin ca dhe asgjë më shumë.

— Usta Jorgji në krye të valles! Usta Jorgji në krye të valles! —nisën të thërrasin horas të rinjtë që ishin mbledhur me Azisin në fund të sallës.

— Meqë ngulni këmbë, unë do të heq një valle bashkë me Andrenë, — u tha usta Jorgji dhe u drejtua nga inxhinieri, sikur t'i jepte urdhër.

— Ngrehu, Andrea!

Vallja u hap në gjithë sallën e madhe. Usta Jorgji i hidhte këmbët me shkathtësi, sikur të ishte fare i ri. Llambat elektrike luhateshin mbi kryet e vallëtarëve, gjë që tregonte se murrlani ende nuk kishte pushuar. Por tani asnje nuk e përfillte. Vallja bëhej gjithnjë më e gjallë, më e potershme.

— E sheh si dëfrehen njerëzit nëpër kantiere? — i tha usta Jorgji inxhinierit në vesh. — Dhe kjo s'është gjë hiç, se hala jemi në nisje. Prit një herë të mblidhet këtu kallaballëku i madh e ta vëmë pak punën në vijë, pa ke pér të parë...

— Andrea, — thirri têrë qejf Kola. — Hiqe vallen ti tani!

— S'di unë ashtu vendçe...

— S'di vendçe? Të mësosh. Kështu kërcejmë ne këtu në kantier. Dhe do të të mësojmë edhe ty. Po përnder

— Merrte një valle nga ato të Bregdetit — e këshilloi usta Jorgji.

Inxhinier Andrea doli në krye të valles.

— Ta mbajë Sefedini! Sefedini! — thirri Fatmiri.

— Po, Sefedini ta mbajë. Se pas inxhinierit i vjen atij radha të heqë vallen.

— Ti e di, o Kolë, që unë s'mund të kërcej në krye të valles.

— Ama edhe ti, Sefedin, kaq vjet nëpër kantiere dhe s'di të kërcessh një valle! — i tha Kola.

— Sefedini di të kërcejë evropiançe, — nuk u përmabajtë pa hedhur një thumb usta Jorgji.

Sefedini qeshi edhe vetë, bashkë me të tjerët.

— A nuk pimë një gotë bashkë Sefedin? — i tha Andrea kur mbaroi vallja. — E vlen të pimë një gotë, se më mbajte mirë në valle.

— Ashtu të më mbash edhe ti në punë. Që të mos rrëzohem. Se po të rrëzohem unë, të tërheq edhe ty pas...

6

Pulsi i fuqishëm i forcave që do të vinin u ndje në Gurraj para se ato të mbërrinin në vend. Që ditën e parë pas festës së Vítit të ri kantieri i porsa krijuar ishte si në ethe. Sefedini bashkë me Fatmirin kishin dalë nga fjetorja në agim dhe ende nuk dukeshin, me gjithëse ishte bërë shumë vonë.. Inxhinier Andrea ishte zhytur gjithë ditën në studimin e disa projekteve, që ishin bërë stivë në tavolinën pranë shtratatit. Herë-herë ngríhej nga vendi, bënte shëtitje poshtë e lart në fjetoret e përsëri ulej në tavolinë për të vazhduar punën.

Usta Jorgji, kur u kthye nga mensa, u habit kur pa se inxhinieri s'kishte lëvizur nga vendi.

— Nuk do tē hash ti bukë sonte, or djalë? — i tha duke i shkuar pranë.

— Edhe pak, usta — ju përgjegj ai, pa ngritur kokën nga projektet.

— Do tē mbyllët mensa e do tē mbetesh me barkun bosh, pa...

Inxhinieri i bëri me dorë që tē mos e trazonte dhe vazhdoi tē hiqte viza me laps në një letër tē bardhë e tē trashë.

— Të shoh se je shumë në siklet sonte, or djalë,

— ju drejtua përséri usta Jorgji, kur e pa se ai ngriti kokën dhe e vështronë si i hutuar.

— E po njeriu ka nga ndonjëherë halle, usta...

— Hallet lëri pér nesér, se u bë vonë tani...

— Kemi aq shumë, sa do tē mbeten edhe pér nesér...

Dera u hap me vrull dhe në fjetore u futën Sefedini dhe Fatmiri. Sefedini dukej i lodhur, por dhe i këna-qur.

— S'ke mbaruar ende, inxhinier? — e pyeti Fatmiri si me habi.

— Ku ka fund kjo punë, o Fatmir?! — ju përgjegj inxhinieri duke u ngritur më këmbë.

— Ai hala s'ka ngrënë bukë! — u hodh e tha usta Jorgji.

— Kështu? Edhe ne e pësuam sonte. U vonuam shumë dhe mensën e gjetëm tē mbyllur.

— Do tē ketë ndonjë gjë ustai mënjanë. S'do tē na lëjë kështu barkthatë, — tha Sefedini duke vështruar nga ana e plakut.

— Rrini ju si lugetër gjer në mesnatë e pastaj ejani te usta Jorgji që t'ju ushqejë, — u përgjegj si me inat ustai; por megjithatë u drejtua nga shtrati ku mbante një sepet tē vogël me turli gjërash. Ndërsa ishte duke kërkuar dicka në sepet, murmuriste si me vete: «Nuk është punë kjo kështu, or joo! More vesh?»

— Do tē vijnë forca tē mëdha, usta, — i tha Fatmiri. — E di si do tē bëhet këtu nesér?

— Le të vijnë. Aq më mirë pér ne. Sa më shumë forca të vijnë, aq më shpejt do të dalë zogu...

Sefedini ktheu menjëherë kokën dhe e vështroi me inat, sikur donte t'i thoshte: «Ne flasim seriozisht sonte; c'janë këto bûdallallëqe që na nxjerr nga goja?»

— Pse më vështron kështu, o Sefedin? — ju kthyen menjëherë usta Jorgji. — Të duke t pa vend fjala ime, byrazer? E megjithatë nuk e tund as topi! Unë ua kam thënë të gjithëve: kantieri eshtë si një ve. Çdo kantier, jo vetëm ky yni. Tamam si vezza eshtë. Dëgjomë mua, ti. A nuk dalin prej vezës zogj pule a pate, a thëllënze, sipas llojit të vezës? Kështu edhe nga çdo kantier lind një hidrocentral të themi, a një fabrikë, a një qytet i ri. More vesh? Dhe kloçka që e bën vezën të ngrohet që të dalë zogu e di kush eshtë? Dora e punëtorit... Kështu...

7

Gjatës dy ditëve të para pas ardhjes së forcave të reja, në kantier pati aty-këtu çrregullime e rrëmujë. Kjo vihej re sidomos në mensë në drekë e në darkë, kur punëtorët grumbulloheshin pak a shumë në të njëjtën kohë e nuk gjenin vend pér t'u ulur. Pér të përballuar kërkesat e shumta, personeli i mensës ishte shtuar mjart. Midis tyre ishte edhe Pashku. Këtë radhë nuk u morën parasysh protestat e usta Jorgjit dhe djaloshi u caktua përkohësisht si kamerier. Pashku i shkretë, megjithëse rendte poshtë e lartë si fugë, nuk mund t'i plotësonte kurrsesi të gjitha kërkesat e klienteve. Shpeshherë nga tärrohej nga të thirrurat e njerëzve nga të katër anët, hutohej nga kërkesat e shumta e sillej poshtë e lart pa ditur q'të bënte më parë. Jorrallë të porsaardhurit, që nuk e njihnin, i bërtisin e ngandonjëherë edhe e shannin. Por ai, në vend të përgjegjes, u buzëqeshte të gjithëve me dliresi fëminore dhe gjaknxehtët ulnin kokën si të penduar e të turpëruar.

Por kantieri nuk i duron gjatë çrregullimet. Çdo

kantier, që në fazën e parë të jetës së tij i ngjan një rregulatori, që i ndan dhe i kanalizon shpejt ujërat e tepërtë e të trubullta të vërshimeve të mëdha.

Ditën e tretë forcat e reja, të shkrira me ato të vjetrat dhe të organizuara në brigada, u nisën qysh herët në mëngjez pér në sektorët e ndryshëm të punës. Moti ishte i kthjellët, por i ftohtë. Balta ishte tharë. Gropat e rrugës ishin mbuluar nga një shtresë e hollë akulli. Dielli i mëngjezit nuk kishte fuqi pér të ngrohur tokën e ngrirë, por, me shkëlqimin e tij të ëmbël mëngjezor, sikur i ftonte njerëzit pér punë e pér veprim.

Kur forcat kryesore u nisën nga qendra e kantierit pér në vendin ku do të ngrihej uzina e madhe kimike, inxhinier Andrea seç ndjeu një hutim e një si të shtërnguar në kraharor. Prej së largu pa Sefedinin që e cte në krye të kolonës dhe sikur u qetësua pak. Hapat e ndërtuesve mbi rrugën e bërë kallkan nga ngrica e natës, jehonin fort në qetësinë e mëngjezit, si një marsh i fuqishëm, që ai s'e kishte dëgjuar asnjeherë tjetër...

Kur kolona u largua nga qendra, u nis edhe ai, i ndjekur nga dy inxhinierë të rinj, që nuk i ndaheshin asnje minutë.

— Ne jemi praparoja, — tha si me shaka njëri nga ata, një djali i shkurtër me një pallto të gjatë, me jakén e së cilës kishte mbështjellë qafën dhe veshët.

— Më mirë të jesh praparojë se sa pararojë, — ju përgjegji tjetri.

Inxhinier Andrea bëri sikur buzëqeshi, por nuk tha gjë dhe biseda reshti. Ata që e shoqëronin, ishin dy inxhinierë të rinj edhe në moshë edhe në punë, që kishin ardhur bashkë me forcat e reja. Andrea ishte gëzuar shumë, kur mori vesh ardhjen e dy kolegëve. Por, kur u njoh me ta, nuk mbeti dhe shumë i kënaqur. I pari, ai djali i shkurtër me pallto të gjatë, që quhej Burhan, ishte specializuar pér arkitekturë dhe mund të ndihmonte shumë më vonë në ndërtimin e banesave; kurse tjetri, Sahiti, kishte marrë diplomën e inxhinierit vetëm para disa muajsh dhe nuk kishte

veç pak javë që ishte liruar nga radhët e ushtrisë. Sidoqoftë ata ishin inxhinierë dhe do të bëheshin bashkëpunëtorët e tij më të afërt. Dhe kjo sikur ja ngrohte pak zemrën.

Pas një marshimi, që nuk zgjati as gjysmë ore, forcat qëndruan në një vend pak si të ngritur. Aty do të ndërtohej uzina e madhe kimike, mbi një djerrinë të mbuluar me lloj-lloj shkurresh e kaçubash dhe që zinte një sipërfaqe prej afro njëqind dynamësh. Inxhinier Andrea e kishte shkelur kryq e tërthuar këtë djerrinë, ku më parë, siç thoshin fshatarët, fshiheshin egërsirat që zbrisnin nga pylli i afërt.

Në planin e javës së parë të punimeve inxhinier Andrea kishte shënuar: «Rregullim e rrëthim territori». Kur e kishte çuar këtë plan te Sefedini për ta firmosur, ky i fundit e kishte pyetur:

— I ke bërë mirë hesapet?

— Çdo gjë me kalem, — ju përgjegj Andrea me bindje të plotë. Sefedini e kishte hedhur firmën menjëherë përbri asaj të inxhinierit, por në fund, sikur të ishte penduar, tundi një herë kokën si me dyshim. Në atë çast Andrea se ku e kishte mendjen gjetkë dhe as që e kishte vënë re këtë gjë...

Ditën e katërt të punimeve në territorin e uzinës, Andrea filloi piketimin e vendit ku do të hapeshin themelët e veprës së madhe. Së bashku me të punonin të dy inxhinierët e tjerë, si dhe një topograf dhe një teknik.

Sefedini kishte dy ditë që mungonte nga kantieri. E kishin thirrur në Kurbnesh ku do të dorëzohej një objekt industrial, në ndërtimin e të cilit kishte marrë pjesë edhe ai. Aty nga dreka zhurma e sharrave dhe e sqeparëve të brigadës, që vazhdonte rrëthimin e truallit, sikur nuk dëgjohej më. Inxhinier Andrea ngriti një herë kokën dhe pa Kolën që po vinte me hap të shpejtë.

— Ç'ka ndodhur, Kolë? — u nxitua që ta pyeste

— Asgjë, inxhinier. Rrëthimi mori fund.

— Si ore, mori fund?

— Po, për nder! Ndaj erdha, që të na caktosh front pune.

Andrea kruajti një herë kokën si i menduar.

— Si thua ti, Kolë?

— Ne jemi gati pér sulm, ku të na thuash ti.

— Sikur të bashkoheshit edhe ju me brigadën që punon pér hapjen e xhadesë?

— Edhe ata nga fundi janë.

— Dreq o punë! — tha Andrea dhe i dha urdhër Kolës që ta çonte brigadën në hapjen e rrugës që do të bashkonte xhadënë me territorin e uzinës.

Ndërsa Kola ishte duke u larguar, ai vështronët brigadat që punonin rrëth e rrotull e thoshte me vete: «Gjer tani kisha të bëja me dy brigada të vogla, që ngrenin barraka dhe objekte të tjera të zakonshme. Ndërsa tani po i futem një pune jashtëzakonisht të vështirë, punës më të vështirë të jetës sime. Turp është të mbetem prapa, qysh tani në fillim...»

Në mes të truallit të madh, që sapo qe shpyllëzuar e sheshuar pér bukuri, u duk Sefedini, Përbri tij shkonte Kola. Sefedini diçka po i thoshte Kolës me nxitim, duke tundur duart me nervozizëm.

— Ç'ka ndodhur, inxhinier? — pyeti Sefedini pa e përshëndetur fare.

— Pak a shumë...

— Po brigadën e Kolës kush e ka caktuar atje në hapjen e rrugës?

— Unë.

— Pse?

— Sepse e mbaroi punën që i kemi ngarkuar më shpejt nga ç'ishte parashikuar.

— E dérgove atje që të gjendej në punë...

— Ç'të bëja?

— Mua më pyet ç'të bëje? Ti je kryeinxhinier dhe duhet ta dish këtë më mirë se çdo njeri tjetër, — ngriti zërin Sefedini dhe bëri dy tre hapa përpara ngaqë s'përmblahej dot.

Inxhinier Andrea ndërroi çehre menjëherë, por e mbajti veten e nuk foli. Që të merrej me diçka, nxori me nxitim metrin nga xhepi dhe një herë e hapte një herë e mbyllte në mënyrë mekanike.

— Për sa ditë ua kishe caktuar si detyrë që të mbaronin rregullimin e rrëthimin e oborrit? — pyeti pas pak Sefedini me një zë më të shtruar tanë, por që tregonte se përmbahej me zor.

— Për pesë ditë.

— Gabim.

— Po ne e kemi aprovuar së bashku planin.

— Kjo do të thotë se jemi gabuar që të dy. Asgjë më shumë, — e pranoi troq Sefedini.

— Gjëra që ndodhin në fillim, o Sefedin, — ndërhyri Kola me dorë në zemër.

— Nuk duhet të ndodhin, jo! Pse të ndodhin? — ja preu ashpër tjetri.

Sahiti me Burhanin, që vazhdonin matjet më tutje, e ndërprenë punën dhe vështronin si të habitur.

— Nesër duhet të fillojmë nga themellet. Kjo ka rëndësi, — tha Sefedini duke mos e zgjatur më me Kolën.

— Po, atje në sektorin e acidit mund të fillojmë.

— Pse vetëm në një sektor?

— Sepse vetëm atje ka përfunduar piketimi.

— Po në sektorët e tjera?

— Ja, vazhdojmë...

— Shumë avash keni ecur. Shumë avash!

— Kemi ecur avash se është punë me përgjegjësi.

— E di që është punë me zarar, ndaj jeni një skuadër me inxhinierë!

— Jemi vetëm tre, — tha me nxitim Sahiti.

— Pse, pak janë tre? Ne një inxhinier kishim në fillim në gjithë ndërmarrjen e hidrocentralit të parë në Dajti, që ka pasur pesë a gjashtë sektorë. Nëse jeni pak pse s'merrni edhe Baftjarin?

— Cilin Baftjar? — pyeti inxhinier Andrea.

— Baftjar Selamin. Atë të gjatin, që erdhi nga Shkopeti dhe e caktuam brigadier të brigadës komplekse.

— Mua më thanë se ai është teknik dhe jo inxhinier.

— Që s'ka shkollë do të thuash ti? Ai ka marrë

disa herë diplomën në veprat më të mëdha që janë ndërtuar tek ne.

— Sështë kollaj, — buzëqeshi hidhur inxhinier Andrea.

— E shoh unë, e shoh që ti s'ke besim tek ata që s'kanë diplomë.

— Unë shoh të kundërtën.

— Cfarë? —ngriti zërin Sefedini dhe sytë i shkrepën zjarr. — Ore leri fjalët tan! Sot të mbaroni pike-timin. Pikë. Dhe nesër të fillojmë themelet në të gjithë frontin. Kjo ka rëndësi.

— E pamundur! — ju përgjegj inxhinier Andrea prerazi.

— E sheh, pra? Më rrofshin diplomat mua...

— Aty mbahu! — ju hodh inxhinier Andrea duke shtërnguar dhëmbët, gjë që tregonte se mezi përmbahej.

— Oh, se ç'do të na lini në baltë! — thirri Sefedini dhe bëri pér tu larguar, se po të rrinte atje do të ndizej sherri më keq. Por, pas disa hapash ktheu kokën dhe thirri duke ju drejtuar të gjithëve:

— Gjer nesër në mëngjez të ketë marrë fund pike-timi!

Të tre inxhinierët ngelën pér një farë kohe si të gozhduar në vend.

— Ama ç'të mbledhur! — tha pas pak Burhani, sikur fliste me vete.

Inxhinier Andrea bëri disa hapa poshtë e lart, vë-shtroi një herë orën dhe duke ju afruar të tjerëve, u tha me vendosmëri:

— Hajdeni, djema! Vazhdojmë...

8

Nga fundi i javës çdo gjë qe gati pér të vendosur me ceremoni gurin themeltar të uzinës. Aty nga mbarimi i orarit të ditës së shtunë. Sefedini lajmëroi brigadierët dhe teknikët të mos largoheshin, se do të bënte një takim të shkurtër me ta.

Ndërsa punëtorët me veglat e punës në krahë po ktheheshin për në qendër të kantierit, brigadierët e teknikët nisën të mblidheshin në një vend të pjerrët, të mbrojtur ca nga veriu.

— Mbani mend, ore shokë, — tha si me shaka Kola, — këtu, në këtë vend të shkretë, u bë mbledhja e parë e këshillit teknik të kantierit tonë. Po për nder! Kjo nuk duhet harruar.

— Pse, këtu jashtë do ta bëjmë mbledhjen e këshillit teknik? — u habit një nga brigadierët e ardhur rishtas.

— Jo, byrazer, do të presim gjersa të bëhet salla e mbledhjeve, të përfundojë edhe uzina e pastaj të bëjmë mbledhjen e këshillit teknik, — e ngacmoi Azisi.

— Këtu jashtë është më mirë, se bën ftohtë dhe do t'i japim fund mbledhjes fët e fët. More vesh? — hodhi kripë në bisedë usta Jorgji.

— Jo, shokë, mos u mërzitni, nuk kemi mbledhjen e këshillit teknik, — tha Sefedini duke zënë një vend në mes të tjerëve. — Meqë nesër do të bëhet ceremonia e inaugurimit të punimeve për ndërtimin e uzinës, thamë të takohemi një herë që të shohim se mos kemi gjë mangut.

— Sa gjëra kemi mangut ne këtu! — hodhi shigjetën e tij të parë Baftjari.

— Pa na i thuaj ato të shkretat, o Baftjar! Pse i mban të fshehta, — e nxiti Sefedini.

— Nga t'ja fillojmë pa! Se këtu kemi çrrregullime me thes.

— Ne tani e kemi fjalën për punën e ditës së nesërme. Ju e dini se këtu nesër do të vijnë të dërguar nga partia e nga qeveria; do të vijnë edhe nga rrithi ynë gjithë ata njerëz, lere pastaj gazetarë e njerëz të tjerë nga të gjitha anët...

— Cdo gjë në vijë është. Po për nder! — tha Kola nga vendi ku ishte ulur. — Edhe gurin që do të vendoset nga i deleguari i qeverisë në themel, gati e kemi edhe llaçin edhe mistrinë...

— S'mungon asgjë, asgjë?

— Nuk jemi më axhaminj në kësi punësh, o Sefedin. Ohu, në sa inaugurime kemi marrë pjesë gjer tani!..

— Inaugurimi i një vepre nuk ka ndonjë telash të madh u dëgjua befas zëri kumbues i Baftjarit. — Pas inaugurimit të vjen festja vërdallë...

— E dimë këtë, Baftjar, — e ndërpren Sefedini.

— Me fjalë e dini, po me vepra jo.

— Ç'do të thuash ti me këtë?

— Dua të them se nuk ja nisëm hiç mbarë punës...

— Le të na thotë Baftjari ku e ka fjalën, — shprehu mendim Fatmiri. — Se ka dy-tri ditë që flet poshtë e lart.

— Si urdhëron! — tha si me ironi Baftjari dhe, pasi u ngrit më këmbë, vazhdoi: — Ne, or burra, erdhëm këtu në Gurraj me zemër të ngrohur nga mbarimi i hidrocentralit. Po këtu sikur na u ftoh pak shpirti. Pse, do të thoni ju. Sepse administrata e kantierit nuk është në krye të punëve. Ajo qëndron në bisht, ore, fare në bisht, të them...

— Hapi letrat, Baftjar! Jo kështu në erë, i thirri Sefedini.

— Do t'i hap, posi. Ti ma di mirë kokën, byrazer. Unë s'flas kurrë me doreza. Dhe që ta themi troç që në fillim, fjalën e kam pikërisht për ty e për kryeinshinierin. Po, po! Qysh ditën e parë pamë këtu një çrrëgullim të madh. Pastaj mezi na u sigurua front pune. Sot e dje, nja dy brigada specialistësh punuan në hapjen e xhadesë. Pse punë me mend e quan ti këtë? A lejohet të vihen specialistë të kategorisë së shtatë në hapjen e xhadesë?

— Me leje, shokë! — thirri me zë të lartë Kola, dhe pa marrë leje tha nga vendi:

— Po t'i shikosh punët me syrin e atij kantierit që ke qenë ti, Baftjar, duket se këtu është beter. Po ky është kantier i ri, or byrazer. Dhe frontet e punës janë shumë të pakta. Po, për nder! Ku do t'i dërgonin Sefedini me kryeinshinierin gjithë këto forca që erdhën këtu përnjëherësh? Kur erdhëm këtu sefte, edhe unë që jam specialist, edhe Sefedini që është drejtor, edhe

inxhinieri që s'kishte zënë çekiq e sqeparë në dorë dhe gjithë sa ishim, punuam me kazmë për hapjen e themeleve dhe mbërthenim dérrasa për ngritjen e barakave. Si të bënim ndryshe? Fillimi i ka këto gjynahe... Tani Baftjari kërkon që çdo gjë të shkojë si sahat. Por edhe sahati, kur e merr sefte, të bën naze, gjersa ta sjellësh në terezi. Po, për nder! Ndaj unë them se Baftjari ngutet...

— Ngutesh ti, Kolë, e jo unë, — e ndërpree Baftjari.

— Ti që nuk më le të thosha kryesoren.

— Thuaje, pra, thuaje!

— Do ta them pos! Do të kthehem edhe një herë ke puna e kryeinxinierit. E kam fjalën për piketimin e themeleve të uzinës. Kryeinxinieri ynë, së bashku me dy inxhinierë të tjera, punoi disa ditë me radhë në piketimin e themeleve. Mirë bëri, do të thoni ju, se nuk është punë e vogël të hedhësh themellet e një vepre kaq të madhe. Kështu them edhe unë. Por, duke u marrë për disa ditë me radhë me këtë punë, na la ne të tjerët pa front pune. Më kuptioni ku e kam fjalën? Këtu ndreq, atje prish, i thonë kësaj... Dhe e dini pse ndodhi kjo? Ja, po jua them unë. Kryeinxinieri ynë është axhami. Për një gjë të vogël bënte matje e stërmatje dhe, pasi i mbaronte një herë, ja niste prapë nga e para. Punë i thonë kësaj? E dini si më dukej mua kur bënte kështu? Si ndonjë shkollar i pastërvitur, që kërkon të zgjidhë një problem të vështirë, por nuk ka besim në vetëvete dhe qëndron si i hutuar me gisht në gojë...

Disa qeshën.

Inxhinier Andrea qe bërë spec në fytyrë. Ishte hera e parë që e kritikonin kështu ashpër dhe, siç i dukej atij, «pa takt». Me një kleçkë në dorë gërmonte tokën e shkriftë sikur donte të futej atje brenda, në atë gropë të vogël, e të zhdukej nga sytë e njerëzve...

— Një minutë, një minutë! — tha me zë të qetë e me buzë në gaz Fatmiri. — Ne u mblodhëm për punën e inaugurimit e na doli diçka tjetër. Kjo s'prish punë, sigurisht. Nga sa u tha këtu, doli se ne jemi plotësisht

gati për ditën e nesërme. Mirë thanë shokët se ne edhe gurin, edhe llaçin, edhe mistrinë e kemi në vend dhe ato presin çastin e lumtur. Kjo ka rëndësi, siç e ka zakon të thotë Sefedini. Poo! Se nesër në këtë truall do të bëhet një festë e madhe. Do të vijnë njerëz nga ana e anës. Ju ndoshta nuk e dini, por Kola me Lleshin kanë thurur një këngë që thotë se nesër do të vijë vetë Shqipëria e veshur me rrrobat e saj më të mira... Bukur e kanë thënë, ë? Poo!..

— Ç'i duam ato tani? Ne fjalën e kishim gjetkë, — thirri dikush nga mesi i grumbullit.

— Po, ke hakë ti, shok, — vazhdoi Fatmiri. — E kishim fjalën te kritika e Baftjarit. Ai kritikoi kryeinxhinierin, se u tregua i ngathët në piketimin e themelive. Ndërsa ishte duke folur Baftjari, m'u kujtua se ç'thoshin punëtorët në Ulëz. Mbani mend, o shokë, ju që keni qenë atje? Baftjari, — thoshin, — kritikon edhe ujin që rrjedh nga çesma, se kur fryn era, nuk bika drejt.

Dikush qeshi me të madhe aty nga fundi. Baftjari e vështroi me inat. Fatmiri bëri një shenjë me dorë për të vendosur qetësinë dhe vazhdoi:

— Vjmë tani te puna e kryeinxhinierit. Gjatë ditëve që ai piketonte themelet e uzinës, edhe unë e shikoja që ai punën e kryente shumë ngadalë; maste një herë truallin, mendohej, shikonte projektin, bënte përllogaritje në defter e përsëri e provonte punën një e dy e tri herë, gjersa i mbushej mendja se e kishte bërë mirë e saktë. Nga kjo anë, ashtu si tha Baftjari është. Por unë gjëzohesha, kur e shikoja që bënte punë me merak. Për sytë e ballit! Gëzohesha me gjithë mend dhe thosha me vete: «Kryeinxhinieri ynë ende nuk është bërë i shkathët në zbatimin e projekteve. Por bën punë të saktë, ama. Në çdo punë që del nga dora e tij, mund të kesh besim të plotë.» Poo! Themelet e uzinës tani do të jenë të sigurta, të forta... E mora këtë shembull për të treguar se Baftjari nuk qëllon gjithnjë në shenjë dhe ngandonjëherë flet në hava.

— Unë flas në hava? — u ngrit Baftjari e bërtiti me të madhe,

— Ulu, Baftjar, ulu! — u dëgjuan zëra nga të gjitha anët.

U bë një si rrëmujë. Secili shfaqte mendimin e vet pa radhë e pa rregull. Në atë çast u ngrit Sefedini, u ra një herë shuplakave të dorës dhe qetësia u vendos në çast.

— Tani ta mbyllim, shokë, ë, si thoni? — filloi ai.

— Fo, po, ta mbyllim tani, — u dëgjuan shumë zëra së bashku.

— Po të doni vazhdoni edhe ca, se ja, tani del edhe hëna... — bëri shaka usta Jorgji, duke vështruar nga qielli...

— Mirë, o usta, unë do t'i bie shkurt, — vazhdoi Sefedini. — Baftjari më kritikoi mua për mosorganizimin e mirë të punës. Mirë ma bëri. Do të thoni ju se ishin ditët e para dhe kësi gjërash edhe mund të falen. Jo, më mirë të mos falen. Dëgjove, o Kolë? — u drejtua nga Kola që rrinte këmbëkryq andej nga fundi. — Kështu, pra, shokë. Kjo ka rëndësi. Vetëm në një gjë s'ka pasë të drejtë Baftjari. Në ato që tha për kryeininxhinierin. Nuk e di si thoni ju të tjerët, po mua kështu më duket. Ne jemi të vjetër në ndërtim dhe njihemi mirë me njëri-tjetrin. Kemi ngrënë bashkë njëqind koçekë misër, si i thonë fjalës. Kemi parë të mira dhe të këqia nëpër kantiere. Kryeininxhinieri është i ri midis nesh dhe hala nuk e njohim mirë. Tani, po të dëgjojë njeri fjalët e Baftjarit, kushedi se çfarë mund të mendojë për kryeininxhinierin tonë. Më kuption? Ndoshta mund t'i shkojë mendja se ai nuk është i aftë.... Tani do t'ju them nja dy fjalë për të. Unë, ç'është e vërteta, nuk e njihja fare para se të vija këtu në Gurraj. Po më thanë ata të ministrisë që në ditën e parë: «Atje të vjen një inxhinier shumë i zotit». Ai në hartimin e projekteve ka qenë nga më të dalluarit. Por edhe në shkollë e mbanin profesorët në gojë. Më kuption? Ndaj e kanë dërguar këtu në Gurraj, në një vepër aq të madhe. Që është i pastërvitur në zbatimin e në punët praktike të kantierit,

këtë e thotë edhe vetë. Unë u zura pardje me kryeininxinierin për çështjen e piketimit të themeleve, dhe u kapërthyem keq, të them më mirë. Më kupton? Por pastaj u mendova më mirë dhe u bëra pishman. «Më mirë palk, po saktë» — thashë me vete kur e mora punën më shtruar. Kjo ka rëndësi...

Inxhinier Andrea ngriti kokën dhe shikoi një herë Sefedinin, që fliste me pasion. Një buzëqeshje e fshehtë sikur i zbuti pak fytyrën e ashpërsuar nga telashet e ditëve të fundit. Njëmijë mendime i kalonin në kokë. «Gjatë kohës që punoja në drejtorinë e projektevë, — thoshte me vete, — punën që dilte nga dora ime e kontrollonte përgjegjësi i zyrës, e kur ishte ndonjë objekt i rëndësishëm e shqyrtonte me imtësi vetë drejtori. Pünën time këtu do ta kontrollojnë këta, me paanësi. Edhe po të mos e dija këtë gjë, e mësova sot një herë e mirë. Tani e tutje do të kem besim se ata nuk do të më lënë kurrë në baltë...»

— Nuk do të flasësh, ti Andrea? — i tha në vesh Burhani kur mbaroi Sefedini.

— Jo! — ju përgjegj me vendosmëri Andrea. — Ato që kisha për të thënë, i thanë Fatmiri dhe Sefedini. Dhe i thanë më mirë se unë.

Fjalët e tij të fundit i dëgjoi dhe Sahiti, që i rrinte nga ana tjetër. Të dy inxhinierët e porsaardhur në Gurraj, vështruan njëri-tjetrin, si me habi, për ato që shikonin e dëgjonin këtu në kantier, sikur donin të thoshin: «Është një botë tjetër këtu...»

III. FESTIVALI NË KANTIER

«Kjo që ndodhi në këtë festival të çuditshëm duhet të jetë akti i një drame të tërë, të madhe e të fshehtë, fillim i së cilës gjendet larg e thellë.. Dhe me siguri kjo ske-në nuk është akti i fundit...»

1

Një ditë të kthjellët shkurti, nga ato që kanë ende të dukshme vulën e dimrit, por edhe buzëqeshjen e parë të pranverës së afërt, nga qendra e kantierit u nis një kolonë ndërtuesish, me kazma e lopata në krahë e me sharra e çekiçë në duar. Kjo kolonë e vogël, që përbëhej nga dy brigada komplekse, qëndroi në një lëndinë të madhe, anës një pérroi me ujë të paktë. Disa lanë veglat e punës përdhe dhe u ngjitën mbi një si ledh pér të vështruar rrëth e rrotull. Në lëndinën e gjërë nuk ndihej frysë njeriu. Pak më tutje kullosonte një tufë e vogël dhensch pa çoban. Në heshtjen e thellë të mëngjezit dëgjohej vetëm tringëllima ritmike e një zileje nga tufa e dhenve dhe shushurima e ëmbël e përroit të vogël aty pranë.

Inxhinier Burhani, që ishte caktuar të punonte në këtë sektor, pasi kërkoi shenjat e piketimit, qëndroi në një vend dhe, duke treguar një kunj të ngulur në tokën e butë, tha:

— Këtu fillon godina e parë.

Ndërtuesit u hapën në një rresht të gjatë, si skuadrat në luftë, kur bëhen gati pér sulm.

— Kush do të fillojë i pari, or burra? — pyeti pas pak inxhinieri i ri.

— Usta Jorgji! — thirrën disa me një zë.

— Hajde, pér hajr! — tha si me vete ustai dhe, pasi pështyu në shuplakat e dorës, ngriti kazmën lart dhe i ra tokës me forcë.

Orkestra e kazmave dhe e lopatave prishi qetësinë e mëngjezit dimëror. Dhentë vrapiuan pér t'u larguar sa më parë nga kjo zhurmë e papritur dhe pas pak tringëllima e ziles nuk arrinte më gjer këtu...

Usta Jorgji punonte në heshtje. Ndoshta i kujtohesin ditët e para në veprat e shumta, ku kishte marrë pjesë. Ndoshta mendonte pér qytetin e ri, që do të ndërtohej këtu, në këtë lëndinë të shkretë. Herë-herë ngrinte kokën dhe vështronte nga ana e rrugës, sikur priste njeri. Një ditë më parë, kur i kishin thënë, se do të shkonte me brigadat, që do të punonin në sekторin e banesave, veterani kishte shtrembëruar buzët.

— S'të pëlqen të shkosh atje, usta? — e kishte pyetur me interesim të dukshëm inxhinier Andrea.

— Unë, or djalë, kam dyzet vjet që punoj në ndërtim dhe urdhërat e përgjegjësve të mi nuk i kam thyer kurrë. More vesh?

— Në qoftë se ke ndonjë arësy, thuaje dhe ne mund ta marrim parasysh. Kjo nuk është aspak thyerje urdhëri.

Usta Jorgji kishte mbetur ca si i menduar e nuk kishte folur. Po të kishte të bente me Sefedinin këtë radhë do ta kundërshtonte e do t'i thoshte: «Pse më dërgoni atje, Sefedin? Ju specialistët më të mirë i mbajtët këtu në uzinë. Apo nuk jam edhe unë specialist nga më të vjetrit? Pastaj, shokët e mi më të ngushtë do të punojnë në ndërtimin e uzinës. Pse më ndan ti nga ata?» Por me inxhinier Andrenë nuk donte të bënte fjalë. Ai ishte i sigurtë se, po t'i lutej, inxhinieri do t'ja pranonte kërkësën, të mos ndahej nga shokët e tjerë; por nuk ishte mësuar t'u binte në qafë të tjerëve pér çështje personale...

— E di si është puna, usta Jorgji? — i kishte thënë

inxhinier Andrea me ton tē përzemërt. — Ne tē cak-tuam nē brigadat që do tē merren me ngritjen e banesave, sepse atje kemi pak specialistë me eksperiencë. Dhe ti do tē jesh më i nevojshëm nē banesa, se sa nē uzinë.

Usta Jorgji e kishte vështruar një herë si me dyshim.

— E kam me gjithë mend, — kishte përsëritur inxhinieri.

— Nejse, mirë, unë do tē shkoj atje, por me një kusht ama...

— Me ç'kusht, o usta?

— Të vijë edhe Pashku tē punojë ajte me mua.

— Pashku i vogël?

— Po, po, Pashku i vogël. Përse habitesh?

— S'më shkonte mendja kurrë! Dhe unë thashë me vete se kushedi çdo tē na kérkojë ustai!

— Dua ta marr me vete, që t'i mësoj zanatin. Atje në mensë një herë e marrin në kuzhinë, një herë e vënë si kamerier dhe ca i bërtasin andej, ca i gër-thasin këtej... More vesh?

— Mirë, usta, mirë, do ta rregullojmë. Vetëm një gjë s'kuptoj, usta, pse ngul këmbë që ta marrësh me vete Pashkun?

— Më ka hyrë në zemër ky djalë, inxhinier, më kupton? Qysh ditën e parë që e pashë, e di si m'u duk? Si ata harabelat e shkretë, që në dimër rrojnë me thërrimet e botës. I ke parë ndonjëherë? Ti ndjell pulat në mëngjez për t'i ushqyer dhe fap! Të vjen në mes të pulave edhe një zokth i trembur, që kérkon tē gjejë ndonjë kokërr drithi. More vesh?

— Pse, jetim éshtë Pashku, o usta?

— Në tē vërtetë ai ka edhe babë edhe nënë, por mund ta quash jetim fare mirë.

— Nuk e kuptoj këtë gjë.

— Që ta marrësh vesh ti, or djalë, i ati i Pashkut éshtë në burg, se ka vrarë një njeri për punë hasmërie.

Para disa vjetësh këtyre anëve s'kishte ditë që të mos dëgjohej dyfeku pér gjakmarrje.

— Po të jëmën ku e ka?

— E ëma e Pashkut është martuar pér së dyti në një fshat të largët të malësisë...

... Dielli ishte ngritur lart në qìell, kur befas usta Jorgji dëgjoi prapa tij zërin e Pashkut:

— Më dërgoi inxhinieri këtu, — i tha me një frymë.

— Nga dole? Unë mbeta duke vështruar nga rruga.

— Zbrita këtej nga burrimi, — ju përgjegj me qejf cunaku.

— Tani do të punosh këtu me mua. Po s'të bëra unë usta të mbaruar, mos më thënçin usta Jorgji, — i tha ustai duke i përkëdhelur flokët e pakrehur...

2

Çdo kantier ndërtimi shpesh mbetet pér një kohë pak a shumë të gjatë vetëm me burra. Atje të sheh syri muratorë, karpentierë, montatorë, betonistë, buldozeristë, ekskavatoristë, hekurkthyes e shofera, të gjithë burra. Të merr malli të shikosh një grua.

Edhe kantieri i Gurrajt nuk bënte përjashtim nga ky rregull. Pér pesë-gjashtë muaj rrjesht atje nuk shkeli këmbë gruaje, me përjashtim të disa fshatareve, që vinin këtu të dielave pér të shitur ndonjë kokërr ve, ndonjë pulë a ndonjë frut të thatë.

Mbas ardhjes të forcave të reja dhe shtimit të fuqisë punëtore me fshatarë, që vinin këtu nga fshatrat e malësisë, popullsia e kantierit ishte rritur mjaft. Por s'kishte ende asnjë familje. Prandaj qytetin e ri banorët e tij e quanin si me shaka: «Qyteti i njëmijë be-qarëve». Nuk dihej se kush e quajti i pari kështu, si-diqsoftë ky emer u përhap aq shpejt, saqë e morën vesh edhe ata të kantiereve të afërta. Shoferët që niseshin pér këtu, kur i pyesnin të tjerët se ku shkomin, nuk

përgjegjeshin «në kantierin e Gurrajt», por «në qytetin e njëmijë beqarëve». Nga sa kallézonin veteranët e kantierit, kur ishin në qejf, të gjithë beqarët e qytetit të ri, na ishin mbledhur një ditë dhe na kishin zgjedhur si kryetar usta Jorgjin!..

— Kur i vajti në vesh ustait kjo gjë, bëri një herë sikur u zymtua dhe u zemërua, por nuk u përbajt dot dhe tha duke buzëqeshur:

— Dobiçat! C'gjëra trillojnë!..

Dhe duke tundur kokën sikur t'i kanosej dikujt, shtoi:

— E di unë kush i sajon këto, e di; Azisi me shqëri... .

E para grua që erdhi në Gurraj, qe Terezina. Ajo para disa vjetësh kishte mbetur e ve me tre fëmijë të vegjël. Për një kohë të gjatë kishte punuar si bufetiere në klubin e hidrocentralit të Ulzës e pastaj të Shkopetit. Kështu që e kishte lidhur fatin e saj dhe të ardhmen e fëmijëve me kantieret e ndërtimit. Pasi u largua nga kantieri për ndërtimin e hidrocentralit dhe erdhi në Gurraj, zuri punë si kameriere në klubin e porsandërtuar.

Terezina s'ishte edhe aq e re por, kur dilte në mëngjez për punë, dukej sikur gjithë kantieri buzëqeshte. Duke folur për ardhjen e saj në Gurraj, dikush e quajti «dallëndyshja e parë». Dhe ashtu si ndodh në pranverë, kur, pas dallëndyshes së parë vijnë tufa dallëndyshesh të shumta, pritej që të vinin edhe në Gurraj familje të tjera me gra e fëmijë.

Meqë pallatet po vonoheshin më shumë nga c'pritej, disa i sollën familjet në Gurraj dhe i rregulluan përkohësisht, kush në ndonjë shtëpi fshati, kush në ndonjë kasolle, kush në disa barraka që ishin ndërtuar prej disa vjetësh në guoren e madhe në afërsi të kantierit.

Familjet e para, sado të shpërndara andej-këndeji, i dhanë një notë të re qytetit që po ndërtohej. Nëpër rrugët e ngatërruara të kantierit u dukën jo vetëm gra, por edhe fëmijë të vegjël që vështronin çdo gjë me kureshtje të madhe e luanin me qejf në grumbujt e zha-

vorrit e të rërës, dhe në stivat e trarëve e të dërrasave që sillnin maqinat prej së largu. Dhe ndërtuesit me duart e tyre të ashpra e plot me kallo, i përkëdhelnin me përmallim këta fëmijë, sikur të ishin fëmijët e tyre...

Tani edhe bisedat në kantier nuk kufizoheshin vetëm në çështjet e ndërtimit. Gjithnjë më shpesh dëgjoheshin lajme për familje të reja që mbërrinin në qytetin e ri nga viset më të ndryshme. Inxhinier Andrea kënaqeji nga këto lajme dhe i vinte mirë fizionomia e kantierit po ndryshonte, si një pejsazh i thatë që mbulohet pak nga pak nga një blerim i këndshëm e tërheqës. Po zakonisht nuk merrte pjesë vetë në të tilla biseda, sepse i quante si diçka që s'kishin të bënин fare me të. Po shumë shpejt u bind se nuk kishte hiç të drejtë...

Një ditë me shi të imët e të mërzitshëm ai po kthehej nga sektori i uzinës bashkë me Kolën. Kur ju afrouan qëndrës, shiu shtrëngoi më shumë.

— A nuk kalojmë pak nga klub? — i propozoi Kola.

Pa u futur mirë në klub, dëgjuan një zë të fortë:

— Kolë! Inxhinier Andrea! Hajdeni këtej, hajdeni!

U kthyen andej nga vinte zëri dhe nëpërmjet tymit të cigareve, që lundronte mbi kryet e njerëzve si një mjegull kaltëroshe, ata panë Fatmirin, usta Jorgjin dhe inxhinier Sahitin, që ishin ulur në një tavolinë andej nga fundi.

— Po ju, kur erdhët këtu? — u thirri Kola fort, sikur të ishte jashtë në ndonjë skelë ndërtimi.

— Na mërziti ky shi dhe thamë që të hedhim nga një gotë — u përgjegj usta Jorgji. — Uluni tani edhe ju, uluni!

— Jemi ca si të lagur.

— S'ka gjë, inxhinier! Pi një dopio tani, pa thahesh menjëherë. Thahesh nga brenda të them, more vesh?

— Mos keni parë Sefedinin, Fatmir?

— Sefedinin vetëm këtu në klub mos e kërko, — ju përgjegj usta Jorgji.

— Po ç'kemi tjetër?

- Gjëra të reja, inxhinier. Fatmiri ka vendosur të sjellë familjen.
- Po, të dielën, — plotësoi vetë Fatmiri.
- Po me shtëpi si u rregullove?
- Gjeta një konak sa për të futur kokën në një barrakë andej nga gurorja.
- Mua më pëlqen të vijnë sa më parë dhe sa më shumë familje në qytetin tonë.
- Që të bëhet kjo, ti e ke në dorë, — i tha duke e shkundur me bërryl usta Jorgji.
- Unë?
- Po si ore, dërgo nja dy brigada të mira në ngritjen e pallateve, që të mbarojnë sa më parë, pa do të shikosh ti se sa familje kanë pér të ardhur këtu. More vesh?
- Vërtet, ore, kemi mbetur shumë mbrapa në ndërtimin e banesave. Po ti, usta, a do ta sjellësh familjen këtu?
- Puna ime ndryshon.
- Pse ndryshon?
- Të kam thënë edhe një herë tjetër, se dua të më mbarojë djali shkollën një hërë, të vendoset në ndonjë punë e pastaj shohim e bëjmë.
- Punë vitesh, domethënë.
- Afër mendjes. Njeriu, mor djalë, kur i kalon të pesëdhjetat i bën punët avash-avash. More vesh?
- Përveç usta Jorgjit, të gjithë do t'i sjellin familjet këtu, sa të mbarohen banesat e para, — tha Fatmiri.
- Edhe Sefedini?
- Sefedini është i mësuar nëpër kantiere dhe sikur i pëlqen më shumë larg familjes.
- Çudi, hë?
- Ti, inxhinier, ende nuk e njeh mirë Sefedinin. Nuk ke venë re, që ai as një herë në tre muaj nuk shkon në shtëpi? Edhe kur merr leje, kthehet në kantier para se t'i mbarojë ditët e lejes. Apo jo, or shokë?
- Po kështu është, — miratoi Kola. «Familja jonë është kantieri» — thotë Sefedini.

— Unë s'mund të rroj kështu larg familjes, — përfundoi bisedën Fatmiri, ndërsa ishin gati për t'u ngritur. — Poo! Kështu kam bërë gjithnjë, në të gjitha kantieret. Heq pak njeriu në fillim, gjersa të mbartë plaçkat e të vendoset me fëmijë, por kjo është punë ditësh. Fundi i fundit ne nuk kërkojmë gjëra të mëdha. Një konak na mjafton.

Duke dalë nga klubi, inxhinier Andrea thoshte me vete: «Jeta në kantier po ndryshon. Edhe bisedat e një-rëzve bëhen më të larmishme. Në to po hyn gruaja, familja, fëmijët. Dalëngadalë çdo gjë vihet në rrugë..»

3

Lajmërimi për mbledhjen e organizatës bazë të partisë u bë gojarisht. Në rendin e ditës kishte vetëm një çështje: «Pranim anëtarësh të rinj». Konkretisht do të shqyrtohej kërkesa e Kolë Lesterit, për t'u pranuar anëtar partie.

Mbledhja filloi në orën e caktuar në një dhomë të zbrazët të katit të parë të një ndërtese katërkatëshe ende të papërfunduar. Anëtarët e partisë erdhën drejt për së drejti nga puna, të veshur me kominoshe të spër-katura me llaç e gëlqere. Në flokët e disave dukeshin zdrugulina dhe një shtresë e hollë tallashi nga zdruktharia.

Ata zunë vend në një stol të gjatë, në disa arka gozhdësh dhe në një kapicë thasësh çimentoje. Disa që erdhën nga fundi e s'gjetën vend ku të rrinin, morën një dërrasë të gjatë, e vendosën mbi disa tulla dhe rregulluan aty për aty një stol.

... Tani organizata bazë e kantierit kishte më se dyzet vetë. Por ata që kishin ardhur të parët e mbanin mend mirë se ditën e krijimit të saj organizata kishte pasur vetëm katër anëtarë dhe një kandidat. Kandidati ishte Kola. Tani që të pestë ata janë aty në dhomë. Ndoshta në këtë çast atyre u kujtohet ajo ditë e zymtë vjeshte, kur bënë mbledhjen e parë të partisë në Gu-

rraj. Atëhere, meqë s'kishin vend tjetër, vendosën të mbledheshin mbi një kapicë trarësh e listelash. Qielli ishte i vrenjtur dhe frynte jugu. Për t'u mbrojtur nga era, ata ngritën disa dërrasa në formë gjysmëharku, si mburojë.

Në atë mbledhje të parë të organizatës bazë merrte pjesë edhe një instruktor i komitetit të partisë përrrethin, që kishte ardhur aty që në ditët e para të fillimit të punimeve në kantier.

— Pilkësëpari duhet të njiheni me njëri-tjetrin, se vini nga kantiere të ndryshme — u tha instruktori.

— Ne njihemi prej kohe, — ju përgjegj Sefedini. — Por edhe sikur të mos njiheshim, në kantier nuk është aspak e vështirë që të njihesh me shokun.

Pa filluar mirë mbledhja, ranë disa pika të trasha shiu. Ku të shkonin? Barrakat ishin ende të papërfunduara. U ngritën që të pestë dhe bashkë me instruktorin e komitetit të partisë së rrethit ngritën disa dërrasa në formë të pjerrët si çati dhe u ulën nën to. Në këtë strehë të improvizuar vazhdoi mbledhja e parë e organizatës bazë të partisë. Kur ajo mori fund, të pestë komunistët e ndjenin mirë gjithë peshën e rëndë të detyrave që rëndonin mbi shpatullat e tyre.

... Qysh atë ditë kanë kaluar disa muaj. Në këtë kohë gjendja në kantier është ndryshuar si nata me ditën. Nga një grusht njerëzish tanë punojnë këtu disa qindra vetë. Për ditë vijnë njerëz të rinj. Midis tyre ka edhe të organizuar. Kështu organizata bazë u shtua. Por tanë organizata do të marrë forca të reja e gjak të ri nga vetë kolektivi. Po të aprovohet lutja e Kolës nga organizata, ky do të jetë i pari komunist i pranuar në parti në qytetin e ri. Do akoma disa minuta që të fillojë mbledhja dhe shokët bisedojnë me gjallëri. Vetëm Kola hesht. Nga dritarja e hapur duken në rresht pallatet karabina. Në njérën prej këtyre ndërtesave tanë po hedhin soletën. Kola duket se vështron andej, nga ana e dritarës së hapur, por ai nuk shikon asgjë, as godinat shumëkatëshe, as punëtorët që shkojnë e vijnë me nxitim. Atij i del përpëra jeta e fëmijërisë. Mali i lartë, fshati

i vogël, nulla e vettuar, varfëria. Pastaj kantieri në mal të Dajtit, tunelet në zemër të malit e përsëri kantiere, diga e lumej të furishëm, që bëhen zap nga njërit e fortë të kantiereve...

— Ora vajti pesë, shokë. Fillojmë! — tha më në fund Fatmiri.

Ai lexoi lutjen e biografinë e Kolës, i la letrat mbi tavolinë dhe ju drejtua me një vështrim të gjithëve.

— Hajdeni, shokë, kush ka pyetje tani?

Një komunist nga ata që merrnin pjesë për herë të parë në këtë organizatë, pyeti nga vendi ku rrinte:

— Para se të themi mendimin tonë, mirë është që të dimë këto dy gjëra: e para, a ka qenë në rini Kola? Kur dhe ku është pranuar si kandidat partie?

Kola u ngrit dhe u përgjegj shkurt:

— Në rini kam hyrë në kantierin e Selitës të hidrocentralit «Lenin», si kandidat partie jam pranuar para një viti e ca në kantierin e Shkopetit. Tani kam bërë kërkesë për anëtar partie këtu në Gurrat.

— Me leje? — u dëgjua si një bubullimë zëri i fortë i Azisit, që i bëri njerëzit të kthehen nga ai. Bile një punëtor i ri, që nuk e njihte Azisin qeshi me të madhe.

— Mos qesh, shok; — e qortoi Fatmiri. — Azisi kështu flet edhe kur është brenda në dhomë. Kujton se është gjithnjë në ekskavator andej nga lumi... Vazhdo Azis!

— Unë kam një propozim, — tha Azisi me një zë më të ulët, por që në këtë dhomë të vogël stononte përsëri. — Kola na ka paraqitur një biografi me shkrim shumë të shkurtër. Këtu kemi edhe shokë të rinj, që sonte e shohin për herë të parë. Prandaj, jam i mendimit që Kola vetë të na flasë pak më gjatë për jetën dhe aktivitetin e tij.

— E drejtë, — u dëgjuan zëra në dhomë.

Kola u ngrit dhe u hodhi një shikim të shpejtë shokëve.

Të gjithë e vështronin në sy, duke pritur që të liste. Por ai uli kokën dhe qëndroi pak si i menduar. Në atë

çast në sheshin përpara ndërtesës së papërfunduar qëndroi një kamion dhe zbrazi zhavorrin me rrapiellimë. Dikush u ngrit dhe mbylli dritaren. Kola rrinte ende i heshtur dhe i menduar.

— Folë, o Kolë! — i tha Fatmiri. — Thuaj ato që ke për të thënë.

Kola vështroi nga ana e Fatmirit. Vështrimet e tyre u takuan dhe që të dy sikur i buzëqeshën njëri-tjetrit.

— Ç'tju them më shumë, ore shokë? — tha Kola dhe u ndal pak. Që jam prej një familjeje fukarai, një familje të këputur, ju e dini fort mirë. Dhe sidomos Fatmiri. Ne quheshim fshatarë, or vëllezër. Po fshatarë pa shtëpi e katandi. Im atë ka pasur tre katër dynym tokë. Dhe këtë tokë në Orosh të Mirditës, të kam rixha, ku misri thahet prej hëne, siç themi ne. Po, për nder! Ka pasur edhe gjashtë a shtatë kokë dhi. Kaq... Ç'hoqi im atë që të na mbante të gjallë, s'thuhet dot me fjalë. Se ishim pesë djem dhe dy vajza, shtatë gojë që kërkonin të bluanin. Tani këto janë gjëra të vjetra, mund të thotë njeri. Po, or byrazer, janë ca të vjetra, se ne tani flasim për uzina e hidrocentrale e jo për një karrroqe kallamoqi. Po sado të vjetra që të jenë, mua më bëjnë të mendohem, dhe them me vete: po të mos kishte ardhur partia, si do të bëhej halli im, halli yt, halli i të gjithë fukarenjve? Unë marr si shembull veten time, familjen time. Po të ndanim tokën që kishim, na binte në hise tre çerekë dynymi secilit dhe nga një dhi e gjysmë; se vajzat, ta themi me të vjetrën, nuk do t'i vinim fare në hesap...

Qëndroi një çast, u gëlltit një herë duke zgjatur qafën dhe vijoi me dorë në zemër.

— Ndaj them se të gjitha këto ja kam borxh partisë. Po, për nder! — tha me një zë që mezi dëgjohej. Ishte e qartë se donte të thoshte edhe diçka tjetër, por zëri nuk i bindej më...

— Folë, o Kolë, thuaj çfarë ndjen në zemër, — i thirri Azisi. — Këtu je midis shokësh.

— E di, vëlla, e di, — tha me një zë më të kthjellët Kola, — ja se ç'doja t'ju thosha: mbrëmë natën nuk

më zuri gjumi. Edhe sot gjithë ditën vetëm duart më punonin duke vendosur plintat në themel e uzinës. Po, për nder! Pse, do të thoni ju. Unë këtë ditën e sotme e prisja prej vjetësh si një ditë të madhe për mua. Mirë po sa më shumë që po afrohej çasti vendimtar, e shikoja veten si në pasqyrë dhe thosha me vete: «Mos jam ngutur që kam kërkuar të bëhem anëtar partie?» Ne, ore shokë, punëtorë ndërtimi jemi të gjithë dhe flasim me gjuhën tonë. Dhe unë do t'ju flas hapur, ashtu si nuk u kam folur as vëllezërve të mi. Po, për nder! Tani që erdha këtu në mbledhje, e di si më duket vetja? Si një godinë karabina e pandrequr nga brenda, pa dritare e pa dyer, e pasuvatuar dhe e palyer. Po, për nder! Që sa të kalosh prakun të bien menjëherë në sy, njëmijë mungesa: në mure, në dysheme, në tavane. Tani, ç't'ju them më shumë? Unë déshiroj me gjithë shpirt të hyj në parti. Oj! Si të mos e dua një gjë të tillë? Po ju shikojeni mirë këtë punë. Peshojini mirë gjërat. Nëse do ta gjeni me vend se më duhet të pres ende që të ndreqem e të meremetohem, mos ma hapni derën. Lermëni edhe për një kohë në mesore. Më kuptioni? Unë nuk do të zemërohem hiç me ju. Për nder, ju them! — përfundoi Kola dhe u ul mbi thasët e çimentos.

Fatmiri shënoi diçka në një blok xhepi. Ai ishte i sigurtë se Kola kështu do të fliste. Ai e njihte aq mirë shpirtin e tij!

Të tjerët e vërenin Kolën sikur ta shihnin për herë të parë. Kishte midis tyre nga ata që e njihnin prej kohe dhe që tani sillnin ndër mend punën e tyre së bashku me vargun e kantiereve, vështirësitë, rreziqet, këngët e Kolës me çiftelinë, fjalët e tij të përzemërtë dhe entuziazte në çdo rast e në çdo rethanë. Ndaj vështronin ngandonjëherë nga ana e Fatmirit sikur donin t'i thoshin: «Mjaftë më, çdo gjë është e qartë...»

Pasi folën shumë shokë të tjerë, në fund u ngrit edhe Fatmiri.

— Kam dhe unë disa fjalë, shokë, — filloi ai. Ashtu siç qe i shkurtër nga shtati, edhe kur u ngrit prapa tavçlinës së madhe, dukej sikur fliste ndenjur. — Poo!

Unë Kolën e kam njohur këtu e pesëmbëdhjetë vjet të shkuara. Ne jemi nisur pér të kërkuar punë nga fshatra të ndryshme, që ndodhen shumë larg njëri-tjetrit, por mbërritëm në kantierin e Selitës në një ditë. Dhe u njohëm bashkë që ditën e parë. Ç'ishte Kola atëhere? Një çunak, që hidhej në punë duke kënduar. Edhe unë, ndonëse nja dy vjet më i madh se Kola, meqë jam ca më i shkurtër, dukeshë më i vogël nga ai. Meqë shkonim gjithnjë bashkë, edhe në punë edhe mbas punës, atje në kantier na ngjitën njënofkë «binjakët e kantierit». Dhe kjo nofkë na ka mbetur edhe sot e kësaj dite.

Ata që dëgjonin pér herë të parë këtë gjë, qeshën.

— Mos qeshni, shokë! — vijoi Fatmiri, — kështu u njohëm me njëri-tjetrin. Dhe qysh atëhere nuk jemi ndarë asnjëherë, as që jemi grindur ndonjëherë. Se u njohëm, jo në një aheng, apo në një dasmë, si i thonë fjalës, por në tunelet e malit të Dajtit. Atje njihet mirë njeriu, shoku, miku. Pooo! Atje kemi qenë bashkë me Kolën gjer në ditët që i vajti uji dhe drita Tiranes. Pastaj ndoqëm rrugën e kantiereve të tjera; jo pér një javë e pér një muaj, por pér dymbëdhjetë vjet rresht. Ndaj them me bindje se Kolën e njoh më mirë se vëllerëzit e mi. Dhe e dua fort. Poo! Tani vetë Kola na tha se i duket vetja si një bina e papërfunduar, e pandrequr, e pasuvatuar. Kështu është! Jo vetëm Kola, xhanëm, por edhe ne të tjerët. Po sonte fjalën e kemi pér Kolën. Kola do punë akoma që të bëhet tamam; të bëhet ashtu si duhet. Poo! Se kur i thamë, parvjet të shkonte në shkollë, ai nuk deshi. «Nuk mundem, — tha, — nuk më nxë rradakja». Mirëpo partia do njerëz të mësuar. Dëgjon, o Kolë?

— E di, or vëlla, e di, sikur është vetëm kjo? ! — u dëgjua mbyturazi zëri i Kolës.

— Ndryshe është ta dish dhe ndryshe është ta vësh në jetë. Ty të ka marrë mendjen çiftelia, Kolë. Poo! Çiftelia e mirë është, edhe mua më pëlqen fort, kur i bie një dorë mjeshtri si ti apo si Lleshi, po ka gjëra të tjera më të rëndësishme se çiftelia... Nejse, Kola është ende bina e papërfunduar. Po bazën e ka të fortë,

ama. Themelet i ka të shëndosha. Apo jo, shokë? Dhe gjersa themelet i ka të shëndosha, të futura thellë në tokë dhe të mbështetura mbi shkëmb të fortë, që nuk e tund as tërmeti, edhe unë jam i mendimit që ta pranojmë si anëtar partie. Ç'e do një ndërtesë të lyer e të bojatisur nga jashtë për bukuri, por që themelet i ka çyryk? Nuk është boja që e mban ndërtesën, as lulkat e bukura, por themelet. Poo! Fundi fundit një ndërtesë me themele të forta, që është ende e papër-funduar dhe e pasuvatuar, vjen ustai dhe e bën nuse. Dhe ku ka usta më të mirë se partia, për të ndrequr shpirtin e njerëzve? Kështu, ore shokë. Kështu, or Kolë, — përfundoi Fatmiri dhe u ul.

... Kola u pranua njezëri në parti. Menjëherë u ngritën të gjithë për ta përgëzuar. Edhe ata që e njihnin prej vitesh, edhe ata që e shikonin, për herë të parë. Kola i përqafonte me përzemërsi shokët dhe donte t'u thoshte të gjithëve nga një fjalë, po zëri i mbytej në grykë....

Dikush vajti për të hapur dritaren. Të tjerët bëhen shin gati që të dilnin.

— Me leje, shokë! — thirri me të madhe Azisi. — Kemi edhe një njoftim për të bërë. Ju lutem uluni dhe dëgjoni me vëmendje sekretarin e organizatës.

— Byroja, — ngriti zërin Fatmiri, — ka mënduar që nga fundi i muajit të bëjë një mbledhje të hapur të organizatës. Në këtë mbledhje do të thërriten në raport Sefedini dhe inxhinier Andrea për realizimin e planit, ose të themi më mirë për mosrealizimin e planit në sektorin e banesave. Sepse në këtë drejtim s'jemi hiç në terezi. Si thoni, shokë?

— Poo! Jemi shumë dakord! — folën njëzëri duke ngritur duart.

— T'ua mbledhim ca, se e kanë marrë shumë me avash — u dëgjuva një zë nga fundi.

— Me leje, shoku Fatmir? — thirri Sefedini, duke u ngritur më këmbë. — Me shkrim e doni raportin?

— Po, po, me shkrim.

— Kjo është me spec, — tha si me vete Sefedini.

Klubi i madh i Gurrajt hapej që me natë. Qysh herët në mëngjez rrugët e kantierit mbusheshin me njerëz që shkonin për në punë. Në atë orë nuk gjeje në klub asnjë vend bosh. Terezina, në orët e para të mëngjezit shkonte sa në një tavolinë në tjetrën dhe mezi arrinte t'ua plotësonte kërkesat klientëve. Por pak nga pak lëvizja fashitej, sheshi qendror i kantiert shkretetoj dhe klubi boshatisej. Banorët e qytetit të ri i thithët me të shpejtë labirinti i madh i uzinës dhe sektorët e tjerë të ndërtimit. Atëherë Terezina, meqë s'kishte ç'të bënte në sallën bosh të klubit, dilte te dera e lokalit për të soditur lëndinën e madhe, ku po ndërtotoj kinemaja dhe fushën e gjërë, që shtrihet matanë xhadesë. Atje shihet po ato hendeqe të hapura për themelet e kinemasë, po ata grumbuj dherash të hedhur nga të dyja anët e themeleve dhe dy tre punëtorë, që grumbullonin pranë themeleve gurë e materiale të tjera ndërtimi.

Po një ditë pejsazhi i shkretë përpëra klubit ndryshoi përnjëherësh. Terezina u habit kur pa që në mëngjez grupe punëtorësh, që ju përveshën menjëherë punës për hedhjen e themeleve. Pas pak erdhë me zhurmë të madhe një ekskavator. Terezina rrintë te dera dhe vështronët me kureshtje. Azisi e përshëndeti me dorë nga kabina e ekskavatorit dhe, pa humbur kohë, filloi të ngarkonte dy kamiona riportabël me dherat e themeleve.

Aty nga ora tetë u futën në klub Sefedini me inxhier Andrenë, hodhën shpejt e shpejt nga një fërnet dhe dolën duke biseduar me zë të ulët. Terezina donte t'i pyeste se përsë kishte ndodhur ky ndryshim i madh në ndërtimin e kinemasë, por ju dukën si shumë të mërzitur dhe nuk u tha gjë.

Ajo nuk e dinte se pas mbledhjes së organizatës së partisë, problemi i prapambetjes në sektorin e banesave ishte shtruar edhe me gjithë kolektivin e kantierit. Mbledhja ishte bërë në fushë të hapur, në sheshin e madh midis xhadesë dhe themeleve të uzinës. Punëtorët ishin

ulur nē arkat që gjendeshin aty, e mbi kapicat e materialevë, që ishin grumbulluar nē atë vend.

Në fillim mbledhja ishte e qetë. Por gjakrat u ndezën përnjëherësh, sidomos nga disa kritika të forta që ju bënë Sefedinit dhe Andresë, për vonesat e mëdha nē ndërtimin e banesave.

— Puna jonë këtu nē Gurraj çalon nga një këmbë, dhe çalon fort bile, — tha nē diskutimin e tij Fatmiri.

— Se punët shkojnë mbarë nē sektorin e uzinës, por shumë keq nē atë të banesave. Poo. E si të mos ndodhët kështu? Sefedini dhe kryeinixhineri ngelën me uzinën nē gojë. Uzinë e uzinë natë e ditë. Dale, or jahù! Edhe uzina të bëhet, edhe pallatet të mos ngelen prapa. Se njerëzit që ndërtojnë uzinën kanë nevojë edhe për banesa...

Sefedini, që kishte zënë vend mbi parafangon e një kamioni, dëgjonte me gjakftohtësi dhe herë-herë mbante ndonjë shënim nē një defter të vogël e të zhubbavitur. Inxhiner Andrea kishte ulur kokën dhe thoshte me vete: «I kam thënë kaq herë Sefedinit: «Na mbetën këto pallate si gërmadha. Të transferojmë nja dy tri brigada nga uzina, gjersa t'i vëmë përparrë këto ndërtesa...» «Në asnjë mënyrë» — ma preu shkurt ai. «Po janë edhe pranë xhadesë, bre Sefedin, — i thashë unë përsëri. — Këtej kalojnë shumë njerëz, kalojnë gazetarë, kalojnë ata të ministrisë dhe do të na heqin veshin.» «Hiç mos ki frikë, — m'u përgjegj ai. — Këtu puna kryesore është uzina. Po të jesh nē rregull me zbatimin e grafikut të uzinës, fli rehat. S'të thotë njeri gjëkafshë. Më kupton? Kjo ka rëndësi». Dhe puna mbeti me kaq. Se as mua as atij s'na shkonte mendja që do të na hiqnin veshin jo nga lart, por punëtorët, kolektivi...»

Në atë çast u ngriti i furishëm Baftjari. Inxhiner Andrea ngriti kokën dhe e vështroi prej së largu. Baftjari kishte trup të gjatë e të fortë, por tani që kishte hipur mbi një grumbull zhavorri, dukej akoma më i gjatë. «Prit tani gjylet e «katjushkës» — tha me vete Andrea dhe uli kokën përsëri.

— Fatmiri tha se puna jonë çalon nga një këmbë,

— filloi të thoshte Baftjari. — Por unë them se ajo çalon jo nga këmba, por nga koka. Se, po të pyesësh Sefedinin dhe kryeinxhinierin, të përgjigjen menjëherë: «Puniën e kemi në vijë.»

Po ç'në vijë, or të uruar, kur jemi në tremujorin e tretë dhe ende s'kemi dorëzuar as një pallat? Këtu tek ne fillohet një punë dhe, si pa gjë të keq, mbetet e pambaruar. Marrim për shembull punën e kinemasë. Kur janë hapur themelet e kinemasë? Para pesë muajsh e ca, në mos më shumë. Dhe puna ka ngecur në vend. Para disa ditësh dëgjoja disa të rinj që bisedonin për punën e kinemasë. «Nga sa tregojnë bathët, më përpara ka për të marrë fund uzina e pastaj kinemaja jonë» — thoshte njëri. Dhe tjetri ju përgjegj: «Gjene kemi shpresë, se në këtë kinema kanë për të shkuar fëmijët tanë...»

Disa të rinj s'e përbajtën dot të qeshurit.

— Mos qeshni, djema, — vijoi Baftjari. — Janë çështje serioze këto...

— Të gjitha përnjëherësh nuk mund të bëhen, — u hodh nga vendi Sefedini.

— Duart e punëtorëve mund t'i bëjnë të gjitha, Sefedin. Edhe uzinën, edhe banesat, edhe kinemanë.

— Dale, Baftjar, dale, — e ndërpreu Sefedini duke u ngritur në këmbë. — Ne në disa objekte kemi litarin në fyt. Se kemi edhe dimrin përpara, de. Kjo ka rëndësi. Kinemaja mund të presë edhe ca. Fundi i fundit këtu ka ardhur edhe kinemaja ambulante e rrëthit dhe njerëzit s'kanë mbetur fare pa filma...

— Me leje! Me leje! — thirri me të madhe Azisi dhe, duke fshirë duart në kominoshe, zbriti nga kabina e ekskavatorit e qëndroi në shkallë. — Sefedini për vete është i kënaqur se na ka ardhur dy-tri herë kinemaja ambulante. Afër mendjes se ai për vete shkon apo nuk shkon një herë në tre vjet në kinema... Kur u fol për banesat, e mori fjalën edhe inxhinier Andrea. Tani që e kemi fjalën për kinemanë, hesht. Se ai për vete shkon shpesh në Tiranë dhe i shikon atje filmat e rinj. Po ne të tjerët s'mund të bëjmë me dhjetra kilometra rrugë, për të parë një film. Apo jo, shoku inxhinier?!

Nga të gjitha anët u dëgjuan të qeshura...

— Ndaj, po ta lëmë në duart e tyre këtë punë, kinemaja jonë s'ka për t'u mbaruar as sot as mot.:.

— Po ti, si thua ta bëjmë? — e pyeti Sefedini me nervozizëm.

— Është marrë zotimi që banesat e para të dorëzohen nga fundi i vitit. Të mbahet fjala; ja ç'them unë.

— Jo, jo, e kam fjalën për kinemanë.

— Edhe kinemaja të futet në listën e objekteve që duhen përfunduar brenda vitit. Ne jemi më se njëmijë palë duar këtu. Nga dhjetë tulla të vëmë secili, u bë edhe kinemaja. Apo jo, ore shokë?!

U dëgjuan zëra aprovimi nga të gjitha anët. Sefedini s'kishte ç'të thoshte më.

Atëherë u ngrit Malia, e shoqja e Fatmirit, e cila sapo kishte ardhur në Gurraj, kishte filluar nga puna si vinçiere, ashtu siç kishte punuar edhe në kantierin për ndërtimin e hidrocentralit.

— Ne s'duam llafe e pretime, — tha ajo. — Ne duam kinemanë. Kur kthehem nga puna në shtëpi, fëmijët më thonë: «Mami, kur do të shkojmë në kinema?» Dhe unë s'kam si t'u përgjigjem. Po t'u them se në kantierin tonë nuk kemi fare kinema, për arësyse se Sefedini dhe kryeinxhinieri e kanë lënë zvarrë këtë punë, ata me siguri do të më thonë: «Mirë ata të dy, po ju të tjerët ç'bëni?» Ja, kështu do të më thonë. Dhe kanë halkë. Ndaj, mos e zgjatni shumë këtë punën e kine-masë. — ju drejtua ajo Sefedinit e kryeinxhinierit.

— Se do t'ju dalin ndonjë ditë kalamajtë rrugëve e do t'ju zenë me gurë. Mos e merrni si shaka këtë që po ju them...

— Nuk ka ardhur Andrea? — pyeti ai me habi.

— Jo, hala, — ju përgjegj usta Jorgji.

— Eh, ç'kisha punë urgjente me të!

— Kushedi nga janë ata tani, — tha si i menduar Kola. — Po marrin masa për nesër. Se i dërmuan sot me kritika.

— Më vjen keq për Andrenë, — tha usta Jorgji.

— Pa sa për Sefedinin, i mban kurrizi.

— Puna e ndërtimit është e vështirë, — foli në përgjithësi Kola. — Ngandonjëherë edhe drejtuesi më i mirë s'di ç'të bëjë më parë. Po, për nder!

— Mos i mbaj anën Sefedinit, Kolë, se këtu në Gurrat e ka shkelur fare. Ai gjithnjë kokë më vete ka qenë, por këtë radhë, në daç nga se ka shumë telashe, në daç nga ndonjë shkak tjetër, është bërë si lumi i turbulluar dhe i rrëmbyer... Nuk merr mendimin e të tjerëve. More vesh? Për punën e banesave i thashë një ditë: «Sefedino! Mua më keni lënë me kalamanët atje në banesa. Specialistët më të mirë i mblohdhët në uzinë. Do të turpërohemë kështu. «Mësoju zanatin atyre kalamanëve që ke në brigadë» — tha. — Ke parë?

— Pse s'e kritikove atje në mbledhje, o usta?

— E di si është puna, or djalë? Unë flas më mirë pas mbledhjeve. More vesh? — tha edhe si me shaka edhe me seriozitet usta Jorgji.

— Ka frikë nga Sefedini, prandaj s'foli, — e ngacmoi Kola.

— Unë të kem frikë nga Sefedini? Jo ore! Askaq!

— u përgjegj ustai duke treguar majën e thojit. — Unë kam më se pesëmbëdhjetë vjet që punoj së bashku me të në ndërtim dhe ja di mirë huqet. Kur nis të më bërtasë Sefedini, i bërtas unë më shumë. More vesh?

— E c'bën atëhere Sefedini?

— C'të bëjë? Të nxjerr koburen? Shtrëngon një herë dhëmbët nga inati dhe largohet.

— Mirë thua, usta Jorgji. Unë kur e dëgjova herën e parë që i bërtiste Andresë, thashë se do të bëhej kia-

meti. Të nesërmen Sefedini e mbrojti Andrenë në mble-dhje, e q'të mbrojtur, pa...

— Me kryeinxhinierin Sefedini aty zihet aty ndre-gjet.

Usta Jorgji, duke dredhur me nge një cigare të trashë, tundte lehtë kokën dhe sikur buzëqeshte fshehtazi me vete.

— Diçka ke pér të thënë, ti usta, — i tha Burhani duke i vajtur pranë me shkrepsen në dorë pér t'ja ndezur cigaren.

— Ej, dreq — tha si me vete usta Jorgji. — Se q'm'u kujtua tani një mesele e vjetër e Sefedinit...

— Ajo e kantierit të Selitës në mal të Dajtit? — pyeti Kola.

— Jo, jo! ajo tjetra në Kurbnesh. Të kujtohet atë-here kur u ngatërrua me atë gjermanin e gjatë? Kurre s'e kisha parë aq ngushtë Sefedinin, se sa atë ditë.

— Pér kohën e luftës e keni fjalën? — u habit Burhani.

— Jo, bre djalë, kjo mesele ka bërë vaki në Kurbnesh, katër a pesë vjet të shkuara; se atje kishim disa specialistë gjermanë që merreshin me ndërtimin e fabrikës së balkrit. More vesh? Sefedini kishte qenë përgjegjës i ndërtimeve atje. Pra, ai kishte të bënte me ta.

— Usta Jorgji mënjanoi cigaren në cep të buzëve, ashtu siç e kishte zakon dhe duke thithur me ëndje, vazhdoi:

— Tí, or djalë i mirë, e kupton se specialistët që kishin ardhur në Kurbnesh nuk ishin nga ata gjermanë që na kishin vënë flakën shtëpive tonë kohën e luftës. More vesh? Tanët bënин çmos që t'i mbanin sa më mirë, se i kishim mysafirë, de... Po, helbete, në punë ndodhin edhe pështjellime, edhe ngatërresa. Apo jo? Sidomos kur gjermanët ngulnin këmbë që të bëhej ashtu si thoshin ata. Po e hante shqipua këtë? Jo, or pëllumbi im... Tani një gjë duhet të dish: nga sa kam parë unë me sytë e mi atje në Kurbnesh, gjermani të bën punë të saktë, nuk duhet t'i hash hakun. Po punon me nge, ama, edhe kjo duhet thënë. Se, helbete, atë e pret koha, kurse ne jo. More vesh? Se na lypset të bëjmë

me yrysh atë që gjermani e ka bërë rehat-rehat për treqind vjet, që i thonë fjalës. Nejse, që të mos e zgjatim, nja dy-tri ditë pas Vtitit të ri, na u ngatërrua keq Sefedini me të madhin e gjermanëve. Pse, do të thuash ti. Dëgjo pra! Ai i madhi i gjermanëve i kërkoi Sefedinit tetëdhjetë punëtorë që të hapnin themelet e repartit kryesor të fabrikës. Që ta marrësh vesh ti, këta tetëdhjetë vetë ishin të tjerë, përvèç atyre që punonin gjec atë ditë. Gjermani bënte hesap që t'i hapte themelet fët e fët për katër pesë ditë. Mirëpo ku t'i gjente Sefedini kaq njerëz përmjéherësh, në një vend si Kurbneshi, që është në fund të dynjasë? Le pastaj që ishim në palcë të dimrit. Dha e mori me gjermanin që ta ujdiste ta bënte këtë punë me më pak punëtorë e në më shumë ditë, por nuk e kandisi dot. Doli, pra, nga zyra e gjermanit dhe shkoi fill e në vendin e themeleve. Pasi e pa mirë vendin, provoi vetë tokën dhe ju mbush mendja se, po të punohej me hov, puna mund të kryej edhe me gjysmën e punëtorëve që kishte kërkuar gjermani. Po të punohej derrce, ama. More vesh? Në mbrëmje u takua edhe një herë me inxhinierin gjerman dhe i tha atë që kishte menduar. Po ku donte ta dinte gjermani? «E pamundur! — i tha prerazi me anë të dragomanit. Hesapin e kam bërë me kalem. Asnjë punëtor më pak». Sefedini u gjet ngushtë. Ç'të bënte? Gjermani ngulte këmbë në të tijën, por edhe Sefedini nuk lëshonte pe. As edhe një gisht. Kështu u hëngrën me fjalë. Dhe u ndanë secili me kokën e vet. More vesh? Në të nesërmen na vajtka gjermani në vendin e themeleve. Aty puna me të vërtetë kishte filluar, por nuk kishte më shumë se tridhjetë vetë. Gjermani i numëroi një herë, dy herë, dhe i hipën xhindet. Duke u kthyer për në kaniter, takoi rrugës Sefedinin dhe i tha me duf: «Unë s'mund të pres këtu në këto malet tuaja, gjersa të mbarohet puna me një grusht njerëz. Mos harro se kontrata që kemi është me afat...» Ç'ke ti, mor i uruar, — deshte ta qetësonte Sefedini. — Po të mos ketë marrë fund puna e themeleve brenda ditës, që kërkohet, mua të më varësh.» «Unë kam ardhur këtu

për punë e jo për baste e për lodra» — ngriti zërin gjermani. — «Edhe unë për punën e kam fjalën. Se edhe ne dimë të punojmë që ç'ke me të» — u ndez aty për aty Sefedini, dhe, pa e zgjatur më shumë, vajti në vendin e themeleve. Aty mblodhi punëtorët dhe u tha: «Kështu e kështu e kam hallin. Doni të turpërohem tani? Po të turpërohem unë, turpëroheni edhe ju edhe gjithë kolektivi. Se do të dalë fjala e gjermanit». Pa t'u përveshën punëtorët tanë, e punuan për disa ditë gjer natën vonë! Bashkë me ta punonte edhe Sefedini. Me kazmë, or djale! More vesh? Thonë se natën e fundit kishte hequr edhe këmishën, dhë punonte lakuriq në mes të acarit të dimrit. E kuption, ç'do të thotë kjo?

— Po, për nder! Kështu ka ndodhur. E kam parë unë me sytë e mi, — vërtetoi Kola.

— Mirëpo puna qe trashur. Se gjermani ishte prekur në sedër. Ndaj priti edhe një ditë dhe, kur pa se punëtorët nuk ishin shtuar, i bëri një telegram ministrisë sonë. Kushedi se si e kishte sajuar atë dreq telegram, pa u nisën nga Tirana e na erdhën në Kurbnesh dy vetura me njerëz. Një alamet komisioni. More vesh? Bashkë me tanët ishin edhe dy gjermanë nga ata të Tiranës. Na mblodhën, pra, të gjithë në zyrën e gjermanit. I madhi i komisionit, një inxhinier me flokë të bardhë, kthente kokën nga ana e Sefedinit dhe e vështronte me inat, sikur donte t'i thoshte: «Ç'na bëre, ore Sefedin!» Po Sefedini s'e prishte terezinë hiç. Sefte foli ai yni. i madhi i komisionit. Pastaj inxhinieri gjerman foli gjerë e gjatë si ka qenë puna. E ç'nuk tha ai. «Po ti, Sefedin, ç'ke për të thënë?» — e pyeti si me qortim i madhi i komisionit. «Ç't'ju them me fjalë? Puna ka marrë fund. Dy tri orë para afatit, bilë — u përgjegj pa tekli Sefedini. «Ç'do të thotë kjo?» — «Ç'do të thotë kjo? Shkurt hesapi, themelet janë hapur» — tha me kokën lart Sefedini. Gjermani hapte sytë naa! I madhi i komisionit s'dinte cilin të qortonte tani. Të gjithë vështronin njëri-tjetrin pa folur. Pastaj këmbyen disa fjalë dhe vendosën të shkonin në vend përtë shikuar si qëndronte puna. Në krye shkonte Sefe-

dini për t'ju treguar rrugën. Sytë vërtet i kishte të skuqur nga pagjumësia, po zemra i këndonte nga kënaqësia. Kur mbërritën në vend, panë se themellet ishin hapur sipas projektit që kishte bërë inxhinieri gjerman. More vesh?

— Ç'bëri atëhere gjermani? — pyeti me kureshtje të madhe Burhani.

— Gjermani? Në fillim fërkonte sytë, se mos nuk shihte mirë. Pastaj i shtrëngoi fort dorën Sefedinit. Ç'të bënte më? Dhe qysh atë ditë, ore djalë mirë, u bë mik i ngushtë me Sefedinin. Sa kohë qëndroi aty në Kurbnesh, hesapet i bënte gjene me kalem, po për çdo gjë pyeste edhe Sefedinin. More vesh?

— Po për nder! — pohoi Kola. — «Ky është inxhiner pa diplomë» — thoshte gjermani për Sefedinin.

Ishë shumë vonë kur u hap përsëri dera e barakës. Njerëzit ishin të lodhur dhe nuk e ndjenë fare zhurmën. Vetëm usta Jorgji hapi një herë sytë dhe pa dy hije, që hynë në fjetore e ranë menjëherë në dyshek...

6

Terezina, apo doli të nesërmen në mëngjez te dera e klubit, pa për karshi mbi një skelë ndërtimi Sefedinin, që qëndronte më këmbë. Pranë tij, mbi një mur të porsandërtuar, rrinte inxhinier Andrea dhe inxhinier Sahiti, bashkë me një burrë tjetër rrondokop, që nga veshja dukej qartë se nuk ishte punonjës i ndërtimit. Terezina nuk ja dinte emrin atij burri të shkurtër, por dinte që ai ishte nënkyrytar i komitetit ekzekutiv të rrethit. Ai vinte shpesh në kantier, takohej me Sefedinin e me njerëz të tjerë të ndërtimit dhe interesohej për çdo gjë që kishte të bënte me qytetin e ri.

Biseda e tyre ishte e qetë dhe Terezina nuk dëgjonte se ç'thoshin. Por një herë biseda u gjallërua dhe Terezina dëgjoi fjalët e Sefedinit, që fliste si me inat:

— Prit, prit, shoku Ismail. Ti je si një njeri i kan-

tierit, që vjen gjithnjë këtu dhe na i di mirë hallet, ndaj të flasim hapur. Ju nga rrëthi na shtrëngoni pér punën e banesave, që të strehohen njerëzit sa më parë. Ata të ministrisë na kanë kapur pér fytì pér punën e uzinës. Përditë na marrin në telefon e na pyesin si shkojnë punimet atje. Ç'të bëjmë edhe ne më parë? Tani që ke ardhur pér të **qëndruar** pér një kohë në kantier, do t'i kuptosh më mirë hallet tona.

Zëri i nënkyrjetarit nuk dëgjohej, por nga lëvizjet e duarve dukej se ai përpiquej t'i mbushte mendjen bashkëfolësit pér dikë të rëndësishme.

— Gjersa na kërkonin një mori gjërash mbi planin, duhet të na jepni edhe fuqi punëtore mbi planin. Këtë di të them unë. Pilë, — u **dëgjua përsëri zëri** i Sefedinit.

Pak nga pak biseda e tyre u bë më e shtruar. «Unë thashë se do të ziheshin, po gjene ja gjetën kararin punës». — tha me vete Terezina dhe u kthyte pranë bufesë, sepse i pa ata që zbritën nga skela dhe u drejtuan nga klubi.

— Tani që bisedonim atje lart në skelë, më erdhi një mendim i ri, — dëgjoi ajo nënkyrjetarin, ndërsa u kishte vajtur në tavolinë pér t'u shërbyer. — Ndërtimi i kinemasë ka vajtur mbarë këto dy javët e fundit. Them pra, se po t'i shpejtonit pak më shumë punimet, do të mund ta zhvillonim këtu në qytetin e ri festivalin e rrethit.

— Ç'është ky festival? — pyeti Sefedini.

— Festivali folkloristik i rrëthit. Këtë vit mendojmë ta organizojmë më mirë se çdo herë tjetër dhe do të jetë një nder pér kantierin tuaj, po të zhvillohet këtu...

— Nuk e di. Për këtë punë merru vesh me kryeininxinierin. Ai e ka marrë përsipër punën e kinemasë.

— Ju e doni me skenë të përfunduar, me stola e me të gjitha pajisjet dhe anekset e tjera? — kërkoi sqarim inxhinier Andrea.

— Po, po, gati pér shfaqje.

— E kur zhvillohet ky festival?

— Në prak të festave të nëntorit.

— E pamundur! — ngriti zérin Andrea.

— Një ndërmarrje kaq e madhe të ngurrojë pér një gjë kaq të vogël? — tha i pakënaqur nënkyretari.

— Ndërmarrja është me të vërtetë e madhe, por ka edhe halle të mëdha. Folëm një herë pér ato, — donte ta mbyllte me kaq bisedën inxhinier Andrea.

Mirëpo nënkyretari nuk tërhiqej kollaj nga qëllimi i tij. Këtë e dinin mirë ata të ndërtimit...

Pas ndonjë çerek ore ata dolën nga klubi dhe u drejtuan pér në uzinë.

Aty nga dreka nënkyretari u kthye nga uzina dhe kërkoi Sahitin.

— E rregulluam, — i tha duke fërkuar duart me kënaqësi.

— Vërtet?

— Mori fund kjo punë. Po ju si shkoni me pregatitjet pér festivalin? — kaloi tani në një çështje tjetër nënkyretari.

— Të them të vërtetën, s'kam dëgjuar gjë. Di vetëm një gjë. Me amatorët merret Azisi.

— Cili Azis, ai eskanavisti?

Të dy burrat u drejtuan nga eskanavisti, që punonte pér ngritjen e dherave nga sheshi i madh përpëra klubit. Azisi ndaloi kovën dhe nxori kokën nga kabinë e eskanavitorit.

— Si je, Azis? — e përshëndeti i pari nënkyretari.

— Keni ndonjë punë të gjatë me mua? Ta fik motorin?

— Jo, ndonjëherë tjetër do të bisedojmë më gjatë. Tani doja të dija në se keni filluar nga pregatitjet pér festivalin folkloristik.

— Do të bëhet me të vërtetë këtë radhë? Se e keni shtyrë nja dy herë gjer tani....

— Do të bëhet patjetër në nëntor. Dhe do të bëhet këtu, në këtë kinemanë tuaj.

— Kinemaja jonë edhe në fund të dhjetorit, s'dihet nëse do të jetë gati.

Inxhinier Sahiti i foli diçka me zë të ulët. Azisi buzëqeshi një herë dhe vazhdoi më me qejf:

— Bukur! Kjo është një gjë e madhe. Po, për sytë e ballit! Sa për pregetitjet, shoku nënkyretar, mos kini gjajle. Edhe elementë kemi boll edhe veglat muzikore nuk na mungojnë. Këtu në kantier çiftelisë dhe lahatës i biem përnatë...

Lajmi që këtë radhë festivali do të organizohej në kinemanë e re të Gurrajt, u dha hov pregetitjeve që bë-heshin në të gjitha kooperativat bujqësore dhe qendrat e punës së krahinës.

Fshatrat e zonës së Gurrajt kishin një traditë të mirë në çështjet kulturalo-artistike. Në të gjitha festivalet e mëparshme, vendin e parë apo të dytë e fitonin këto fshatra dhe sidomos Lumëbardha, që kishte një grup artistik shumë të fortë. Disa herë ky grup artistik kishte marrë pjesë edhe në festivale kombëtare dhe një herë kishte dhënë shfaqje edhe për publikun e kryeqytetit.

Konkurenti më i fortë për grupet e vjetra do të ishte në këtë festival grupei i kantierit të Gurrajt, në gjirin e të cilët kishte pjesëmarrës nga të gjitha anët e Shqipërisë.

Azisi ju përvesh menjëherë punës së pregetitjeve. Elementët që do të merrnin pjesë në festival u gjetën pa ndonjë vështirësi të madhe. Në radhët e punëtorëve kishte edhe këngëtarë të zot, edhe valltarë, edhe instrumentistë popullorë, edhe rapsodë.

— Kemi një mungesë të madhe, — i tha një ditë Azisi Fatmirit.

— Çfarë?

— Na mungojnë femra.

— S'kemi ç'të /bëjmë. Nuk na kanë quajtur kot «qyteti i njëmijë beqarëve».

— Pa daleni, or burra, — hyri në bisedë Kola. — Atje në gurore punon një vajzë që këndon bukur. E kam dëgjuar një ditë dhe u habita.

— Ç'ta bëjmë vetëm një, Kolë? Të kishim të paktën nja dy tri.

— Merre, Azis, merre, atë vajzë të gurores, ajo vlen sa dhjetë, — e nxiti Lleshi.

Azisi u interesua menjëherë për këtë punë dhe grupit artistik të kantierit të Gurrajt ju ishtua edhe një vajzë...

Pas tri katër ditësh, sa po mbaronte melodja e sharrave, e çekanëve, e zdruktheve dhe e sqeparëve, në kinemanië e re fillonte një melodi tjetër: ajo e çiftelisë, e lahatës dhe e këngës popullore, që, në godinën ende të papërfunduar, jehonte në një mënyrë të çuditshme. Spektatorët e parë të grupit amator të kantierit ishin muratörë, marangozë, bojaxhinj, montatorë dhe elektriçistë, që me veglat e tyre të punës në dorë zinin nga një vend mbi ndonjë dërrasë, a mbi ndonjë tra ende të papërdorur dhe ndiqnin me vëmendje provat.

Dy ditë para fillimit të festivalit grupi artistik i kantierit bëri provën e përgjithshme. Inxhinier Andrea, duke ardhur ndaj të ngrysur nga uzina, u kthye një herë nga kinemaja për të kontrolluar punën e ditës. Rrugës le kishte zënë një vesë shi dhe e ndjente veten të mërzitur e të rraskapitur. Mirëpo ditën tjetër do të dorëzohej përfundimi i kinemaja dhe atij i duhej të shikonte me imtësi punimet e dy ditëve të fundit. Kur arriti te hyrja, u habit që nuk dëgjoi asnjë zhurmë. «Të kenë mbaruar fare vallë?» — tha me vete dhe, duke shkundur çizmet nga balta, hapi derën e kinemasë. Nga skena përhapej melodja e ëmbël e një lahute.

Inxhinier Andrea mbylli me kujdes derën dhe mbështeti trupin në mur. Nga skena vinte zëri i Kolës, që këndonte një këngë të vjetër trimërie.

Kola mbaroi dhe prapa skenës u dëgjua një zhurmë e lehtë.

Një dorë e vogël mënjanoi nga brenda të dyja pjesët e perdes, që bashkoheshin në mes dhe para skenës doli një vajzë e hollë e pak si zeshkane. «Nga na doli kjo? Mos është ajo e gurores?» — tha me vete inxhinier

Andrea dhe ndjeu si një rrëqenthje në trup, që as vetë nuk e dinte në ishte ngaqë ishte lagur ca nga shiu, apo nga bukuria e kësaj vajze, që e shihte për herë të parë. Harroi përsë kishte vajtur në kinema. Mbas pak vajza doli përsëri. Ai tani dëgjoi edhe fjalët që tha: «Grupi artistik i kantierit të ndërtimit mbyll programin...»

Ndërsa valltarët kërcenin në skenë, ai pyeti një punëtor që rrinte aty pranë dhe mori vesh se ajo quhej Dranë. «Dranë!» — pëshpëriti me vete. — Për herë të parë e dëgjoj këtë emër. Por edhe një bukuri të tillë...»

8

Ata të grupit artistik të fermës erdhën të parët mbi dy qerre të mëdha, duke kënduar dhe duke u rënë mënyrë demonstrative veglave muzikore. Qerret qëndruan në një lëndinë për këshifi kinemasë së re. Amatorët zbritën të gjithë përnjëherësh. Duket se disa kishin ardhur drejt për së drejti nga fusha me këpucë e çizme të baltosura, që nisen t'i fshinin në barin e vesuar të lëndinës.

Në sheshin përpara kinemasë kishte një gjallëri të jashtëzakonshme. Nga fusha e nga monopatet e malit po mbërrinin gjithnjë amatorët e grupeve artistike të fshatrave, të veshur me rrobat e tyre karakteristike.

Në orën e caktuar dera e kinemasë u hap tejpërtëj dhe njerëzit u sulën që të hynin të gjithë përnjëherësh. Te hyrja dhe brenda në sallë bëhej një zhurmë e madhe. Ruzhdju i gjatë dhe hundëmadh thërriste e bërtiste me sa fuqi që kishte, por asnjeri s'ja vinte veshin.

Në çastin e fundit, kur pritej të fillonte festivali, dera e vogël anësore e kinemasë u hap mengadalë dhe në sallë hyri inxhinier Andrea. Ai atë ditë kishte bërë plan të mbaronte më shpejt se zakonisht punën në uzinë e të kthehej në fjetore për t'u veshur e për t'u rregu-

lluar. Qëkurse kishte qenë student e kishte bërë zakon që në kinema e në teatër të shkonte me rrobat më të mira. Por në sektorin e uzinës ndodhnin gjithnjë të papritura dhe lindnin probleme të reja. Atë ditë kishin ardhur nga Ministria e Ndërtimit një grup inxhinierësh për të kontrolluar zbatimin e grafikut dhe ai kishte qenë i detyruar t'i shoqëronte, gjersa u futën në maqinë dhe u larguan për në Tiranë. Kështu që mbërriti në kinema në çastin e fundit dhe u fut në sallë ashtu siç ishte i parruar dhe me rrobat e punës.

Kur hyri brenda, nga reshtat e parë dëgjoi një zë që e thërriste:

— Inxhinier! Inxhinier Andrea!

Ktheu kokën dhe pa usta Jorgjin, që i bënte me dorë.

— Slikur t'a dija që do të vije, — i tha usta Jorgji — dhe mbajta një vend. Ulu!

— Si duken punët, usta?

— Kallaballëk i madh. Kanë ardhur nga ana e anës. Shikoja qëparë njerëzit që hynin valë-valë në kinema, e thosha me vete: «Nga u mblodh gjithë ky millet këtu?» Hala s'është mbushur tamam viti, qëkurse kemi ardhur për herë të parë, dhe shiko se ç'bëhet! More vesh? Merre me mend Andrea, si do të bëhet Gurraj pas dhjetë vjetësh. Eh, vetëm të jemi 'gjallë, që ta shohim!

Inxhinieri buzëqeshi një herë si për t'i treguar se e dëgjoi, por nuk i foli. Ruzhdju thërriti: «Mbani qetësi, shokë! Mbani qetësi!» Prapa perdes dëgjoreshin tinguj telash që akordoheshin.

— Po ti, usta, i ke qejf këto festivalë?

— Shumë! Unë në kinema shkoj shumë rrallë, kur ka ndonjë film me luftë. Por më shumë më pëlqejnë këngët, vallet, çiftelia, lahuta, kërneta... Kam qenë gjithnjë merakli i madh në kësi gjérash, qëkur isha vocrrak.

Perdja u lëkund pak nga një dorë që e tërhoqte dhe në paraskenë doli Azisi. Ai filloi të thoshte diçka, por qetësia nuk u vendos menjëherë në sallë. Bisedat

dhe pëshpëritjet vazhdonin ende, sidomos andej nga fundi i sallës. Befas, nga skena u përhap një melodi e ëmbël çiftelish. Perdja u hap mengadalë dhe spektatorët panë një orkestër të përbërë vetëm prej çiftelesh, që ekzekutoi një këngë për partinë. Kur mori fund kënga, nga shumë anë të sallës ushtuan zëra: «Bis! Bis!» Këngëtarët s'dinin si të vepronin dhe, për një çast, nqelën si të pavendosur. Në paraskenë doli Azisi, i cili thirri me zë të lartë:

— Shokë! Këtu është festival, nuk është një shfaqje e zakonshme. Në fund do të jepen çmimet. Prandaj mos bërtisni.

Skena u mbush nga grupi i valltarëve të Lumëbardhës, që nisën një valle të vjetër trimërie. Publiku e entuziazmuia. Usta Jorgji duartrokiste dhe thërriste si i ri. Disa ishin ngritur në këmbë. Në derën e madhe të kinemasë u dëgjuan trokitje të forta. Ata që ishin pranë hyrjes, dëgjuan të thirrura nga jashtë:

— Hapeni derën! Hapeni të hyjmë edhe ne!

— S'ka vend, or shokë! Dëgjoni apo jo? — u bërtiste Ruzhdiu nga brima e bravës.

— S'ka gjale, ne rrimë edhe më këmbë! — bërtisnin më me këmbëngulje ata nga jashtë, duke trokitur me forcë në derë.

— Inxhinier! — i tha si me qortim usta Jorgji. — Kinemanë e ke bërë të vogël. More vesh?

— Ashtu qe projekti.

— Sikur dinë ata që i bëjnë projektet në kartë, se ç'bëhet këtu në Gurraj...

Inxhinieri ktheu kokën nga ai dhe donte t'i thoshte diçka, por dikush nga mbrapa e ciku në shpinë e i dha një copë letër të palosur. E shpalosi me të shpejtë dhe dalloi shkrimin e inxhinier Burhanit. «Dil menjëherë dhe eja në zyrë! — i shkruante Burhani, — se të kërkon urgjentsht në telefon Tirana».

Befas dera e kinemasë u shpërthyte me rrapëllimë dhe në sallë hovën me dhjetëra njerëz të çdo moshe. Bashkë me ta u vërsul brenda edhe era e ftohtë dhe plot lagështi e natës vjeshtake. Për qisa minuta u bë si

një rrëmujë, por shfaqja nuk u ndërpre. Ata që hynë me forcë, u irreshtuan anës murit e në fund të sallës dhe, megjithëse në këmbë, ndiqnin urtë e pa fjalë shfaqjen...

— Tani do të dalin tanët, — i tha një punëtor usta Jorgjit.

— Po, të shohim ç'na kanë gatuar... Po inxhinieri q'u bë, or djalë?

— E thirrën urgjent në telefon...

— Ama edhe ata, e gjetën kohën...

Perdja u hap mengadalë dhe para spektatorëve doli Drana, konferencierja e kantierit të ndërtimit. Një zhurmë e mbytur u përhap valë-valë në gjithë sallën.

Konferencierja e skuqur në fytyrë nga emocioni shqiptoi diçka pér programin, por s'u dëgjuva mirë se ç'tha. Pa mbaruar mirë fjalën ajo, salla ushtoi nga të thirrurat e shumë të rinjve: «Bis-bis.»

— Eh, ajo s'ka nevojë të hapë gojën pér të kënduar; asaj i këndon bukuria — i tha usta Jorgjit punëtori që i rinte pranë.

— Ah kopilat! Duan ta shohin edhe më... Drana mbeti pér një cast si e hutuar. Hodhi një vështrim nga tavolina e zhurisë. Aty diçka lëvizi. Ajo i ktheu pér-njëherësh sytë gjetkë, sikur të kishte parë një gjarpér dhe, gati duke vrapuar, u zhduk prapa perdes.

Ata të rreshtave të parë, që vunë re se si ajo ndërroi çehre dhe u largua si me frikë, u shikuau midis tyre dhe thanë: «Ç'pati kështu?». Kur kthyen sytë nga vendi ku rrinte zhuria, panë se një burrë i shkurtër nga ata të fermës ishte ngritur përgjysmë si të ishte bërë gati pér t'u sulur. Njerëzit i bërtitën: «Ulu! Ulu!»

Në skenë doli Lleshi me lahitën në dorë. Salla kumboi nga melodja edhe e gjëzuar edhe e trishtuar e lahitës së lashtë.

Në mbarim të duartrokitjeve deriçka anësore e skenës u hap pa zhurmë dhe rrëshqiti në sallë inxhinier Andrea. Meqë korridoret ishin të zëna nga njerëz, ai e kishte të vështirë që të kthehej në vendin e tij të

mëparshëm dhe ju desh të qëndronte aty te qoshja. Pushimi po zgjatej si tepër. Njerëzit prisin me padurim konferencierien. Atëherë inxhinier Andrea dëgjoi prapa perdes Azisin, që thoshte me zë të ulët, por urdhërues: «Dranë! Ç'bën kështu? Mos na prish programin tanë. Dil shpejt!»

Dhe ajo doli. Fjalët e programit nisi t'i shqiptonte me zë që fërgëllonte nga një emocion i fortë. Pa mbaruar mirë fjalët, ndodhi diçka krejt e papritur...

Ai i fermës që para dy minutash kishte lëvizur nga vendi drejt skenës, me një të hedhur u gjend në paraskenë. Drana klithi një herë me të madhe e për një çast ju errën sytë; por përpara rrezikut e mblodhi veten shpejt. E shkathët dhe e zhđërvjellët siç ishte, arri i të futej prapa skenës. Burri e ndoqi me vrap nga pas dhe që të dy u zhdukën prapa perdes, që ende luhatej fort. Sa të hapësh e të mbyllish sytë inxhinier Andrea me një kërcim hipë në skenë; pas tij vrapuan tre katër vete të tjerë nga ata që rrinin në këmbë. Nga prapa-skenat u dëgjua një klithmë vajze dhe një dére që u hap e u mbyll me rrapëllimë. Nga thellësia e skenës u ndie edhe për disa sekonda të tjera një tollovi si e mbytur. Pastaj çdo gjë ra në qetësi...

Gjithë salla ishte ngritur më këmbë. Spektatorët shikonin njëri-tjetrin (dhe pyesnin të zemëruar e të çuditur: «Kush qe ai kapadai?» «Përse e ndoqi vajzën?»

Në atë çast u duk në skenë Azisi. Sado që përpiquej të tregohej i përmbytjatur, dukej se ishte i trondititur.

— Shokë! — thirri me një zë jo të natyrshëm. — Na ndodhi diçka e papëlqyer. (Por ne do të vazhdojmë festivalin tonë.

— Na thuaj, ç'ndodhi! Ç'ndodhi! — thërrisin ata nga fundi, që nuk e kishin parë mirë ngjarjen.

— Shokë! Ju lutem qetësi! Programi vazhdon, — tha Azisi.

— Kush qe ai maskara?

— Pse e ndoqi vajzën?

— Ç'u bë Drana?

— Drana është shëndoshë e mirë. Programi vazh-

don, — përsëriti prerasi Azisi dhe u zhduk pas perdes. Perdja u hap menjëherë dhe skena u mbush me valltarët e kantierit, që ekzekutuan një valle të shpejtë e dinamike. Salla filloj të qetësohej dhe ta ndiqte me dëshire shfaqjen.

Zhuria shpalli përfundimet dhe salla ushtoi nga duartrokositjet.

9

Usta Jorgji doli nga kinemaja dhe u nis për në fjetore. Rrugës takoi grupe njerëzish, që bisedonin për festivalin e në mënyrë të veçantë për çështjen e Dranës.

— Ama, kinemaja jonë u inaugurua bukur sonte; me vetëtima dhe bubullima, — u thoshte shokëve të tij një i ri, që punonte si elektricist bashkë me Gjetën.

— E di si më erdhë mua, byrazer, kur ai kapadaiu u hodh kundër Dranës? Thashë një herë të sulesha në skenë e ta kapsha për zverku...

— Sa për këtë hiç mos ki merak; ja numëroi mirë brinjët inxhinier Andrea. Thonë se i ka futur disa grushte turinje, që e hutoi fare...

Pranë urës prej druri, në kthesën e rrugës për në banesa, usta Jorgji pa një grumbull njerëzish, që bisedonin me zë të ulët.

— Është bela me vajzat sot, — thoshte njéri. — Ta nxijnë faqen kur të duash.

— Vajzë e pafytyrë kjo. Të del pa gjë të keqë në sytë e kaq burrave. Ke parë ti?! — shtonë tjetri. «Tjetër havaz ky» — tha me vete usta Jorgji, duke kthyer ftyrën nga ata. U mat një herë t'u hidhëndonjë thumb, ashtu siç dinte të thumbonte ai, por mendoi se do ta merrnin për të keq e mund të ndizëndonjë sherr dhe heshti. Para disa vjetësh a nuk mendonte edhe ai pak a shumë si ata?

«S'ka gjë, — tha me vete duke u larguar për në fjetore. Kantieri është si një dërstile i fuqishëm; por

ky dërstile, në vend që të ndreqë shajakun, ndreq rradaket e njerëzve...»

— Pa hyrë mirë në barrakë, pa Sefedinin që me një zdrullsh në dorë merrej me rregullimin e dritares.

— Nuk mbylljet dreqi, — i tha Sefedini para se ta pyeste ai. — Eshtë bymyer nga shirat e fundit dhe nuk puthitet mirë.

— Fshati digjet e plaka krihet. More vesh? — hodhi një thumb usta Jorgji, duke tundur kokën.

— Pse, ç'ka ndodhur? — pyeti Sefedini pa u larguar nga vendi i punës.

— Hajde, hajde! Vetëm ti këtu në Gurraj s'e ke marrë vesh hala atë që ndodhi në kinema.

— Ç'ka ndodhur, bre vëlla?

— U dogj kinemaja, Sefedin!

— Si ore, u dogj kinemaja? — u hodh Sefedini duke hedhur zdrukthin mbi një shtrat.

— Ç'të të them pra? Ti vetëm po të ishte djegur me të vërtetë kinemaja, do të veje atje. Ke parë, ore...

— Ç'më prishe gjakun, usta — tha i lehtësuar Sefedini. — Ne mezi le ndërtuan latë dreq kinema dhe ajo të digjej që ditën e parë. Pa më thuaj tani ç'ka ndodhur?

— Jo, s'ta them. Të kishe ardhur vetë atje.

— Më doli një punë e ngutshme, ore, s'më beson?

— Ta di mirë tabiatin unë nga raste të tjera.

— Ohu! Edhe ti usta na hape deftere të vjetra tani. Ja, po vjen Burhani e do të na kallëzojë çdo gjë, fill e për pe.

Inxhinier Burhani i kallëzoi Sefedinit për ngjarjet e kinemasë, Sefedini e dëgjoi në heshtje; në fund shtrëngoi një herë nofullat e tha si me vete:

— S'më pëlqejnë mua këto gjëra, hiç. Njerëzit që i bëjnë këto janë ngatërrestarë të ligj. Dhe nuk duhen pranuar as në shfaqje as në festa. Më kuption. Kjo ka rëndësi...

— E ishkreta vajzë! — tha si me vete Burhani. — Kur e pa atë rezilin që ju turr nga pas, i dha vravit

që të zhdukej në skenë, si thëllëza kur e ndjek skifteri.

— Që e ndjek bufi thuaj më mirë. More vesh?

— Prit tani kur ta marrë vesh i jati, se ç'do të bëjë! Hata e madhe do të bëhet.

— Është shumë e ngatërruar puna e kësaj vajze. Ajo e pleksur kishte qenë edhe më parë, por tani u bë lëmsh fare. More vesh? — tha si i menduar usta Jorgji dhe heshti.

Kur ata po bëheshin gati që të binin në shtrat, brofën te dera inxhinier Andrea dhe Kola, që kishin çuar Dranën në shtëpi. Asnjë nuk i pyeti, po të gjithë i vështronin në sy me kërshëri. Ishte e qartë se i prekte shumë fati i vajzës. Kola e kuptoi se ç'do të thoshin këto vështrime dhe u kallëzoi.

— Kështu, or vëllezër. Paska edhe njerëz që hala janë prapa dynjasë. Po, pér tnder!..

Inxhinier Andrea nuk shtoi asgjë. Kur të tjerët ranë pér të fjetur, u shtri edhe ai. Por gjumi nuk e zuri pér orë të tëra. Këtë radhë nuk ishte puna e zbërthimit të projekteve dhe telashet e përditshme të ndërtimit, që nuk e linin të flinte i qetë... Përpara syve të tij kalonin me radhë ngjarjet e asaj nate në festivalin folkloristik. Dhe gjithnjë më shpesh i dilte përpara fytyra e Dranës. Një herë si konferenciere, një herë duke vrapuar në skenë përpara rrezikut, një herë e pikelluar dhe e menduar në atë kthinen e vogël të barrakës së gurores. Herë-herë në qetësinë e plotë të natës, i dukej sikur i tingëllonte në vesh klithma e saj... Pastaj i dilnin përpara vështrimet e saj plot mirënjojje dhe fjalët e saj të pakta e plot kuptim... Në se klithma tregonte tmerrin që ajo kishte ndjerë përpara rrezikut të menjëhershëm, sytë pasqyronin parandjenjën e hidhur pér një rrezik të mëvonshëm, që i kanosej asaj... Oh! Ata sy të Dranës, ato vështrime të saj plot ankth e shpresë! — tha me vete Andrea, duke u kthyer nga ana tjetër në dyshek. — Ç'po ndodh-te, vallë, në atë çast në shpirt të saj. Përse kërkoi Malinë që ta conte në shtëpi? Nuk ka njerëz të tjerë

këtu në kantier? Ku ta dish? Në këtë çështje ka më pak gjëra të njohura dhe më shumë të panjohura... Kjo që ndodhi në këtë festival të çuditshëm nuk është një episod i rastit, i shkëputur dhe i vëtmuar. Përkundrazi duhet të jetë akti i një drame të tërë, të madhe e të fshehtë, fillimi i së cilës gjendet larg e thellë... Dhe me siguri kjo skenë nuk është akti i fundit...»

IV. HIJE DHE DRITË

«... *Dhe vajza e vogël habitej nga kjo botë e madhe që hapej para saj, nga kjo botë e gjerë që herë-herë shkëlcante nga një dritë verbuese, herë-herë errësohej nga një hije e zezë...*»

1

Rri Drana pranë dritarës së shtëpisë dhe shikon jashtë fushën e gjerë. Shumëkush, sidomos ata të vjetrit, këtë fushë e quajnë Gjolë, kurse të tjerët i thonë fermë. Nga dritarja, nëpërmes shkurreve e kaçubeve të dendura, dallohet turiri metalik i një maqine të madhe. Para disa ditësh, kur u dëgjua për herë të parë zhaurima e kësaj maqine gjigante, që po i afrohej lagjes së tyre, dolën të gjithë banorët, të mëdhenj e të vegjël, për ta shikuar nga afër. Atë ditë mësoi edhe Drana, se kjo maqinë quhej ekskavatori. Tani ekskavatori përkul turirin e tij të hekurt gjer te toka dhe ngre lart një kovë të madhe të mbushur me baltë, prej së cilës derdhet një curril uji i fëlliqur e i zi, si katran. Hap pas hapi, duke ngritur e duke ulur kovën e madhe, ekskavatori ecën më tutje dhe me krahët e tij të çelniktë hap një kanal...

Drana sot s'ka vajtur në shkollë. Jo vetëm sot. Ajo ka një javë që s'po vete në shkollë. Jo sepse s'do. Oh! Kjo është një histori e tërë...

Drana ka disa ditë që rri e mbyllur në shtëpi. I ati sot ka vajtur në pazarin e Mallunës dhe ajo e ndjen veten pak më të lirë. Ndaj del edhe në dritare. Është gjë e madhe të dalësh në dritare. Të dalësh në dritare e të shikosh lëvizjen, jetën, botën. Të shikosh në mbrëmje ata njerëz me çizme plot baltë e me rroba plot vajra maqinash, që kthehen me hap të rendë nga fusha për në barrakat e bonifikimit. Dritarja është e madhe, para saj parakalon një pjesë e vogël, sa një rrip i ngushtë, nga bota e gjerë. Por edhe shumë e madhe nuk është dritarja. Dritaret e shtëpisë së Martës, për shembull, janë më të mëdha. Ashtu do t'i pëlqenin edhe Dranës. Po i ati i Dranës mendon ndryshe. Ai thotë se dritaret janë bërë tepër të mëdha. Dhe është bërë pishman që i ka bërë kaq të mëdha! Sepse kështu hyn shumë dritë brenda në shtëpi; dhe ka sy në këtë botë, që s'e durojnë dot dritën e fortë...

Le të thotë. Tani s'ka se si t'i zvogëlojë. Ka marrë fund kjo punë. Drana ndjen në këtë çast një kënaqësi. Nga buron ky gëzim në zemrën e lënduar të vajzës? Ndoshta vjen nga shtëpia e bukur e plot dritë. Shtëpia është me të vërtetë e re dhe e bukur. Tjegullat e pullazit janë ende të kuqe, të kuqe, sikur kanë dalë sot nga furra. Por në oborr të shtëpisë së re ka baltë. Bo bo, sa shumë! Oborri është ende një copë fushë e purregulluar. Edhe rruga është e pashtuar. Po të kalosh andej, do të zhytesh gjer në gju me baltë. Ndaj njerëzit mbathin çizme. Ndryshe nuk mund të ecësh. Po Drana nuk i trembet baltës. Ajo zakonisht ecën zbathur. Kur ecën njeriu zbathur, ndjen fare mirë se sa e butë është toka. Kur shkonte në shkollë ajo vishte një palë çizme, që ja kishte sjellë si dhuratë tezja, ditën që kishte marrë rrogën. Qysh atëhere kanë kaluar afër dy vjet dhe këmba e Dranës është rritur, kurse çizmet kanë mbetur po ato që ishin një herë dhe i shtrëngonin shumë gishtërinjtë. Po ajo e duronte dhembjen. Për hir të shkollës ajo mund të duronte çdo gjë! Ah, shkolla, shkolla! Do të mbetet vallë si një kujtim i bukur, si një rreze drite mëngjezi, që ndriçon vetëm një çast dhe s'kthehet më?..

Drana i ka mbaruar të gjitha punët e shtëpisë dhe tani ka të drejtë të dalë në dritat për të soditur botën: njerëzit, maqinat, ekskavatorin, oborrin, rrugën dhe më tutje fushën e madhe...

Në këtë çast Drana është e lirë. Në shtëpi s'ka njeri tjetër. Dielli herë fshihet në mes të reve, herë del e ndriçon bregoret, plajat, fushën. Ashtu bën gjithnjë në vjeshtë. Por kjo s'ka rëndësi. Rëndësi ka që Drana e ndjen veten të lirë. Gjer kur? As që e mendon në këtë çast... Ajo tani është e lirë të fluturojë, të ngjitet lart e më lart e të udhëtojë ku t'i dojë qejfi...

Në shtëpinë e Dranës natën i mbyllin dritaret me kanate nga jashtë, sikur duan ta kthejnë shtëpinë në një kala. Rreth zjarrit rrinë miqtë e babait dhe tregojnë për ngjarje të vjetra, për vrasje, për hakmarrje. Por ajo përsëri fluturon jashtë shtëpisë, jashtë asaj kalaje të vogël, ku kërkojnë ta kyçin për jetë. Çdo e re në moshë të saj thurë endrra të bukura e bën plane të guximshme për jetën. Vajzën mund ta mbylli shë në të katër muret e shtëpisë, mund ta lidhësh me një litar të trashë te shtylla e çardhakut, por që ta ndalosh të ëndërrojë, është e pamundur!

Drana e mban mend mirë ditën kur u hodhën themelat e shtëpisë së re. Ajo atëhere ishte ende e vogël, po nuk e harron kurrë atë çast. I ati theri një dash të madh në themelin e shtëpisë, që gjaku i dashit ta bënte shtëpinë të fortë e të patundur. Në themelin e shtëpisë ranë edhe lotët e Dranës. Se ajo është rritur me lot në këtë shtëpi!

Një ditë tezja i kishte thënë: «Ky asht fati i cucave, moj zemër, s'ke ç'ban! Pastaj, një cucë që rritet pa nanë, si ti, e ka shumë ma keq se të tjerat». Vërtet, ajo nuk e mban mend nënën. Shumë herë pyet veten: «Si do të ishte vallë, nana eme? Si s'kanë ruejtë ndonji fotografi?» Edhe për këtë gjë kishte pyetur një herë tezen. Ajo i kishte thënë «Fotografitë e nanës sate humbën në kasollen e vjetër». «S'ka shpëtue asnji, asnji për be, moj teze?» «S'ma merr mendja. Ban vaki që

yt atë të këtë ndonji të fshehun kushedi se ku, po nuk e nxjerr se ai është burrë zakoni».

Dranës vërtetë nëna s'i kujtohej fare, por ajo gjyshen e mbante mend fare mirë. Sa e mirë kishte qenë gjyshja! Po pse e quanin «jevgë» gjyshen? Këtë Drana s'e dinte mirë; por një ditë pyeti atë që e kishte në vend të nënës. Dhe tezja i kishte thënë: «Gjyshja vërtet qe pak si e zezë në fytyrë, por zemrën e kishte të bardhë, shumë të bardhë, si bora».

Thoshin se gjyshja Dranën e donte më shumë nga tē gjithë nipërit dhe nga tē gjitha mbesat që kishte. Përse vallë? Ata që i dinin mirë çështjet e familjes, thoshin se ajo e donte më shumë Dranën, se vetëm Drana i ngjante asaj. Kjo edhe i pëlqente edhe s'i pëlqente Dranës. Po pse tē mos i pëlqente? Ndoshta kjo ndodhë sepse gjyshes i thoshin «jevgë». Po ky ishte një emër që ja kishin ngjitur ata që e rrëthonin, ata që nuk e donin; kurse tē tjerët thoshin: «Nga bukuria ajo s'ka pasur shoqe...»

I ati i Dranës nuk fliste kurrë pér këto gjëra. Ai mbante gjithë ato halle mbi supet e tij. Vetëm një herë, e mban mend Drana që ai kishte folur dhe kishte kallëzuar historinë e familjes. Jo në këtë shtëpi tē re, por në kasollen e vjetër kishin ardhur shumë njerëz. Ata flisnin shumë pak në fillim. Se kishin vajtur pér kryeshëndoshë e jo pér muhabet. Atë ditë ishte mbushur viti nga vdekja e së ëmës së Dranës që kishte myllur sytë në lulen e rinisë, pa mbushur tē njézetepesat. Do tē ishte viti i parë a i dytë i çlirimt atëhere, kur ajo vdiq në lindje e sipër. Atëhere i erdhi në shtëpi gjyshja, që tē merrej me irritjen e fëmijëve...

Kujtime dhe ëndrra trazohen e ngatérrohen në një ményrë tē çuditshme në mendjen e vajzës.

Befas matanë rrugës diçka u rrëzua me rrapëllimi. Drana ngriti kokën dhe pa një lis tē stërmadh, që qe shtrirë përdhe nga një buldozer i fuqishëm. «Bo-bo! Ç'fuqi tē madhe që ka! — murmuriti Drana. — Ta shkulë nga rrancha gjithë atë lis, që s'donte ta dinte as nga stuhitë. Shiko si duken rranjët e shkuluna, si

duert e preme të një përbindshi. Po ato rranijtë e tjera, ato rranijtë e vjetra, ma të forta janë se rranijtë e lisit, që nuk duen tē shkulen nga shpirti i babës tim?»

Dhe vajza e vogël habitej nga kjo botë e madhe, që hapej para saj, nga kjo botë e gjerë, që herë-herë shkëlqente nga një dritë verbuese, herë-herë errësohej nga një hije e zezë.

Jashtë në oborr u dëgjuan hapa tē lehtë. Drana u ngrit menjëherë më këmbë. «Ai do tē jetë, — belbëzoi. — Po si u kthyje kaq shpejt?» Dhe u vrenjt menjëherë në fytyrë. Bota humbi aty për aty shkëlqimin e më-parshëm. Një hije e zezë u zgjat si një perde e errët. Padashur nxori pak kokën nga dritarja dhe pa te shkallët e shtëpisë mësuesen e gjuhës e tē letërsisë. Oh! Sa u habit! Sakaq u skuq në fytyrë, sikur tē kishte bërë një faj tē madh.

— Dranë! — i tha mësuesja te kryeshkalla, duke e puthur si nënë. — Ç'u bëre, moj vajzë? Mos je gjë e sëmurë?

— Jo, zonjushë, nga shëndeti jam shumë mirë.

— Pse s'erdhe atëhere në shkollë? Klasa tē priste. «Ç'na u bë Drana», thoshin shoqet e tua. Vendi yt në bankë mbeti bosh për një javë rresht.

Drana uli kokën si e turpëruar dhe nuk foli.

— Ti, moj Dranë, që s'ke munguar asnëherë — i tha mësuesja duke i përkëdhelur flokët.

— Urdhno brenda, zonjushë! — u hodh vajza me guxim.

Mësuesja u fut në dhomë dhe u ul në një minder tē gjatë.

— Dranë! Ç'ke që rri kështu? Më duket se je ligur pak.

— S'kam gja, jo...

— Moj Dranë! Pse m'i fsheh mua ato që ke në zemër? Fomë hapur, moj vajzë, ç'po ndodh në shtëpinë tënde. Ç'po ndodh këtu në zemrën tënde? — i tha mësuesja duke i vënë dorën në kraharor.

Në vend tē përgjigjes Drana u shkreh në vaj dhe u kthyje nga ana e murit.

Mësuesja u ngrit me rrëmbim nga minderi, i vajti pranë dhe, duke i përkëdhelur flokët, i thoshte me zë të ulët:

— Ah, moj Dranë! Ti ke një plagë të thellë në zemër dhe e mban të fshehtë! Hape zemrën tënde, që të lehtësohesh. Ti je mësuar t'i ndrydhësh thellë në shpirt brengat e tua. Po tani ka ardhur koha që ta qash hallin tënd edhe me të tjerët, se vetë nuk i del dot mbanë.

Vajza ngriti sytë e përlotur, që shprehnin mosbesim, por edhe një shpresë të fshehtë...

— Mos mendo se je në mëshirën e fatit. Jo, moj vajzë! — i tha me përzemërsi mësuesja duke i lëmuar me dorë flokët e saj të zez. Në vend të përgjegjes vajza mbështeti kokën te prehri i mësueses dhe qau me ngashërim.

— Moj Dranë! Shumë gjëra të mira ke, po ato të shkretat lot si të dalin kështu përnjëherësh?

— Diçka më zien ikëtu brenda, zojushë.

— Dëgjo, Dranë, — i tha si me urdhër, sikur ta kishte në klasë. — Nesër do të vish në shkollë, patjetër!

— Jo, nuk vij! — ju përgjegj ajo, duke fshirë lotët me shuplakat e duarve. Unë mbytem ma mirë në kënetë dhe kështu si jam, nuk vij — tha ajo me vendosmëri, duke ngritur kokën me krenari. Sytë e saj të zez shkëll-qenin nën vetullat e vrenjtura. Lotët i kishin shterur menjëherë.

— Pse, si je?

— Ja, e veshun kështu; si dhia në mes të deleve.

— dhe tregoi veshjen e saj fshatare dhe shumë të vjetëruar.

— Dranë! Moj Dranë! Sa kollaj që prekesh, moj vajzë! Shpirti yt është si një tel çiftelie, që, pak tia prekësh, tingëllon menjëherë. Tani më jep fjalën që do të vish në shkollë, dhe ne do të përpinqemi ta rregullojmë atë çështjen e rrobave.

— Si do ta rregulloni? Baba nuk don të ndigjojë asnjë fjalë për këtë gja.

Mësuesja bisedoi gjerë e gjatë me Dranën dhe i

mbushi zemrën me kurajë. Kur ishte duke e përcjellë te dera e jashtme, Drana e pyeti si me ndrojtje.

— A keni ecun shumë në mësimë, zonjushë?

— Pse, ke frikë mos do të mbetesh prapa?

— Edhe kam. Unë nuk është jem bishti i klasës.

— Hiç mos ki frikë. Ti do të jesh prapë në krye të klasës. Kështu si thamë tanë. Unë sot a nesër do të vij përsëri...

2

Shkolla kishte qenë për Dranën jo vetëm vend mësimi, por edhe vend çlodhjeje nga punët e rënda të shtëpisë, edhe vend argëtimi. Me sa gjëzim nisej ajo në mëngjez për në shkollë! Kur dilte nga dera e oborrit, i dukej sikur dilte nga kafazi dhe fluturonte e lirë. Këtë gjëzim s'mund ta kuptionin ata që nuk dinin se si rronte ajo në shtëpi...

Drana kishte një histori të tërë me punën e shkollës. Kur ajo kishte mbushur shtatë vjet, në fshat buzë kënete u hap për herë të parë shkolla. Dhe sipas ligjit të partizanëve — ashtu flisnin asokohe në fshat — në shkollë duhej të shkonin edhe «cucat». I ati i Dranës s'deshi ta dërgonte çupën në shkollë. Atëhere i vajti në shtëpi mësuesi bashkë me kryetarin e këshillit dhe i thanë:

— Dodë, përsë nuk e dërgon vajzën në shkollë?

— Cuca ka punë në shtëpi. Ç'i duhet shkolla?

— Qeveria ka nxjerrë ligje që të shkojnë edhe vajzat në shkollë.

— Si, me punën e cucave merret qeveria?

— Dodë, mos kundërshto ligjin e qeverisë!

— Unë nuk kundërshtoj ligjin; unë shkoj sipas zakonit...

Pas dy javësh Dodës i erdhi një shkresë nga lokaliteti për të paguar gjobën. Atëhere ai e kuptoi se kjo qeveri nuk bënte shaka për punën e «cucave». Kështu u hap për Dranën rruga e shkollës...

Për disa vjet me radhë Drana jetoi në dy botë të

kundërtë: në botën e gjëzueshme e plot dritë të shkollës dhe në botën e mbyllur, të kufizuar e të mbytur të shtëpisë. Kjo botë e vogël dhe e zymtë e shtëpisë ishte si një ishull i vogël, një ishull shkëmbor që megjithëse sulmohej nga të gjitha anët nga dallgët e jetës së re, vazhdonte të qëndronte e të mos dorëzohej. Në shkollë Drana sikur merrte krahë. Sapo kthehej në shtëpi, i duhej t'i shkulte flatrat e të strukej skutave të errëta. Ajo e parandjente se një ditë do të shpërthente përlleshja midis këtyre dy botëve. Dhe rronte me frikë dhe me ankth.

Drana shkonte në shkollë e veshur me rroba fshatare. Po kjo nuk i bënte shumë përshtypje, se në vitet e para ashtu visheshin pjesa më e madhe e vajzave të klasës. E vërteta është se Drana, e ndoshta edhe shoqet e saj, i shikonin si me zili ato vajza që vinin në shkollë të veshura me fustan. Po këtë zili e mbanin të fshehur në zemër e nuk ja kallëzonin as shoqeve të ngushta.

Vit për vit pakësosheshin vajzat me rroba fshatare dhe shtoheshin ato që visheshin me fustan. Në klasën e gjashtë kishin mbetur vetëm tri shoqe me rroba fshatare. Ato veçoheshin nga vajzat e tjera dhe gjithnjë flisnin midis tyre me zë të ulët. Në klasën e shtatë mbetën dy: Drana dhe Marta. Ato të dyja zunë një bankë së bashku dhe e ndanin në mes turpin që ndjekin përpara klasës. Kështu vazhdoi puna për disa javë. Gjersa një ditë Marta erdhi në shkollë me një fustan, të ri e me një përparëse të porsa qepur, që shkëlqente punë e madhe. Vetëm Drana mbeti me rroba fshatare. Dhe mbeti vetëm një orë. Se gjatë pushimit rrëshqiti fshehtazi nga klasa dhe u largua nga shkolla. Oh, sa qau atë ditë Drana! Në klasë, sa vazhdoi mësimi i orës së parë, ajo e mbajti veten. Asaj i dukej sikur gjithë klasa shkonte nga ana e saj. Dhe s'deshi ta ulte veten. Por rrugës për në shtëpi qau me dënesë. Edhe ratën u mbulua e téra dhe qau në heshtje. Kujt t'ja thoshte hallin e kujt t'i shfaqte brengën e zemrës? Duke qëndruar e mbyllur në shtëpi ajo e lëndonte plagën e vet dhe e bënte më të madhe nga ç'ishte...

Të nesërmen nuk vajti në shkollë. Dhe nuk i tha njeri përsë qëndroi në shtëpi. I ati kur e mori vesh këtë gjë tha:

— Shumë mirë u ba; këtë desha edhe unë.

... Mësuesja e gjuhës, që ishte edhe kujdestarja e klasës së Dranës, ditën tjetër ndaj të ngrysur u duk përsëri te shkallët e shtëpisë së Dranës.

Këtë radhë nuk ishte vetëm; bashkë me të qe edhe sekretari i organizatës së rinisë të fshatit. I ati i Dranës apo ishte lëkthyer nga puna dhe rrinte pranë zjarrit. Kur pa të ldy vizitorët te dera, ndjeu habi dhe shqetësim së bashku.

Ata hynë brenda dhe në fillim folën për çështje të ndryshme. Pastaj sekretari e solli bisedën në çësh-tjen e Dranës.

— Ka ndonji ligj që i ndalon cuçat të vishen me rroba fshatare? — kundërshtoi i zoti i shtëpisë.

— Ligj nu këtë ka, por ka disa gjana që janë matë forta se ligjet, — i tha sekretari.

— Unë mbi ligjin ve zakonin.

— Po dëshirën e vajzës?

— Oh, q'më vjen për të qeshë! Dëshira e cucës, thotë! Po ajo asht kalama, or djalë, kalama!

— Drana kalama? Ajo është goxha vajzë, sivjet mbaron shkollën shtatëvjeçare, — kundërshtoi mësuesja.

— Sado që të rritet cuca, prapëseprapë...

Mësuesja kafshoi buzën kur dëgjoi këto fjalë. «E shkreta vajzë! — tha me vete. — Me ç'veriga të forta është lidhur!» Dhe bëri përpjekjen e fundit.

— E di si them unë? — tha ajo sikur ju drejtua sekretarit. — Meqë Doda ngul këmbë në të tijën, ne do të veprojmë ndryshe. Do të mbledhim ca të holla nga nxënësit e klasës, sa për të blerë një fustan për Dranën...

— Se mos e kam hallin për lekët unë? — ngriti zërin Doda i prekur dhe i fyer.

— Ndoshtha ju s'e keni për çështje paresh, por puna është që vajza juaj ka një javë që s'vjen në shkollë.

— Dhe ne s'mund ta lamë vajzën pa shkollë — plotësoi sekretari.

— Unë ju thashë nji herë, — thirri me të madhe i zoti i shtëpisë — Asht punë zakoni, më kuptoni? Po të jetë për lek, unë për evlatin tem nuk kursej asgja.

Biseda u acarua shumë. Asgjë nuk do ta prekte më shumë Dodën, se sa fjala e mësueses, e thënë në kohën e duhur. Nga krenaria e tij prej malësori bëri tërheqjen e parë. Nuk donte në asnjë mënyrë, që ata të dyshonin, qoftë edhe për një minutë, se ai qe dorështrënguar, ndaj nuk dëgjonte t'ja plotësonte dë-shirën vajzës së vet. Dhe pranoi t'i blente një fustan sa për të shkuar në shkollë. «Kur të kthehet në konak, ajo do të vishet përsëri si ma parë» — tha prerazi në fund.

Kjo qe një ndeshje e hapur e Dranës kundër asaj force, që kërkonte t'i mbyllte rrugën e jetës. Në këtë ndeshje ajo nuk fitoi plotësisht, por edhe nuk u mund. Në murin e trashë të fanatizmit u bë një e çarë. Kështu Drana mundi të vazhdonte shkollën, gjersa mbaroi klasën e shtatë. . .

3

Mbarimi i shkollës shtatëvjeçare shënoi një kthesë në jetën e Dranës, por një kthesë jo për të mirë. . . Ajo tani duhej të mbyllej përsëri në shtëpi dhe të merrej vetëm me punët e familjes. Por a mund të që-ndrojë në fole një zog, që i janë rritur puplat dhe ndjen se krahët i ka të fortë për fluturime të gjata?

I ati i kërkoi Dranës të vishej përsëri me rroba fshatare. Tani që kishte mbaruar shkollën, ajo i përkiste vetëm shtëpisë. Donte ta kundërshtonte një herë urdhërin e të jatit. Por e kuptoi se kjo nuk do t'i sillte asgjë të mirë, përkundrazi mund të shkaktonte përsëritjen e atyre skenave, që edhe kur i kujton tani Drana, ndjen rrëqethje në trup e neveri. Shtrëngoi, pra, grushtet në heshtje e nuk tha asgjë.

I ati, duke menduar se kjo qe një shenjë nënshtiri-mi nga ana e vajzës, i foli me zë të butë, ashtu si nuk i kishte folur prej kohe:

— Kështu, moj cucë, kështu. Ti tash je rritun dhe duhet me u gatit për me shkue te shtëpia e burrit.

Drana befas klithi një herë, doli me vrap nga ashefi, ku ishin duke biseduar, dhe ra në dyshek...

Ndodh ngandonjëherë në jetë, që njeriu të ketë një plagë të thellë, një plagë që e mban të fshehtë nga të tjerët, megjithëse e di se ajo kështu nuk mund të shërohet. Duke e mbajtur për një kohë të gjatë të fshehtë, njeriu fillon të rrojë me iluzionin se ajo, duke zënë një kore, po shërohet krejt. Por një ditë të mirë një dorë e pakujdeshshme e lëndon keq atë plagë dhe ai hidhet përpjetë, edhe nga dhembja therëse e çastit, edhe nga-që e ndjen menjëherë, se koha e iluzioneve ka marrë fund një herë e mirë...

Drana e dinte se i ati e kishte fejuar që në vogëli. Po si e qysh ajo as që e dinte, as që i bënte zemra të pyeste. Kishte marrë vesh nga të tjerët se i fejuari, që quhej Shtjefën, ishte nja tre vjet më i madh se ajo dhe bashkë me njerëzit e tjerë të shtëpisë punonte në një sektor të largët të fermës së re. Asgjë më shumë. Ajo të jatin e të fejuarit, Pjetrin mustaqemadh e namuslli, e njihë shumë mirë. Ai vinte shpeshherë në shtëpi dhe i ati ja shtronte me raki e me gjithë të mirat. Edhe vëllezërit e Shtjefnit, e në mënyrë të vecantë Nduen, që ishte djali më i madh i shtëpisë së Pjetrit, ajo e kishte parë dhe e kishte takuar kushedi sa herë. Por të fejuarin as që e kishte parë ndonjëherë me sy dhe as që dëshironte ta shihte...

Një ditë që kishte pyetur tezen sesi do të rronte ajo me një burrë që nuk e donte, pat marrë këtë përgjegje:

— S'kam qfarë me të thanë, moj Dranë. Puna e cu-cave kështu asht, e ngatërrueme boll. Po ban vaki edhe ma keq, se ka cuca që i martojnë me burra pleq, a të moshuem fort. Ti vërtet që nuk e njeh burrin tand, por e di oë asht djalë i ri e jo plak. Pa mendo ato cuca të tjera, të shkretat!.. — dhe tezja pa e përfunduar fjalën

psherëtiu thellë, duke kujtuar martesën e saj të pafat...

Drana e donte shumë tezen dhe i besonte menjëherë pér çdo gjë që i thoshte. Por këtë radhë nuk u besoi fjalëve të saj, se ato ishin në kundërshtim me atë që ajo ndjente në zemër e me parandjenat e saj pér të ardhmen.

I ati nuk i foli më Dranës pér punën e martesës. Por kjo nuk mund të merrej si shenjë e mirë. Zakonisht ai fliste më të rrallë në shtëpi. Të paktën në sytë e Dranës kështu paraqitej: i heshtur dhe i rëndë. Po Drana e ndjente tanë irrezikun më afër... Atë e shqetësonë para së gjithash puna e pajës, që preqatitej në shtëpi me paret, që i ati kishte marrë nga krushku.

Krahas preqatitjeve pér martesën kishte diçka që nuk shkonte në rregull në planet e kurdisura nga të dy krushqit. I ati i dhëndërrit vinte tanë më shpesh në shtëpi dhe bisedonte fshehtazi me krushkun. Drana nuk arrinte dot të merrte vesh se ç'toshin ata; dhe kjo ja shtonte më shumë shqetësimin dhe ankthin.

Një mbrëmje në shtëpi plasi sherri pér punën e martesës së Dranës. Të nesërmen, kur i ati doli në oborr, që të nisej pér në punë, Drana i vajti pas. Ishte e qartë se donte t'i thoshte diçka. Ai ktheu kokën dhe e vështroi me ngulm, sikur kishte një kohë të gjatë pa e parë. Sa ishte ndryshuar cuca! Sa ishte ligur! Sa ishte zverdhur!..

— A don gja? — e pyeti vajzën me një butësi, që s'ishte e zakonshme pér të.

— Unë do të shkoj te tezja, — ju përgjegj ajo e qetë, por e vendosur.

— Të ka thirrë ajo?

— Jo, do të shkoj vetë; nuk e ndjej vedin mirë...

Ai i hodhi një shikim plot dhimsuri, bile u mat një herë që të zgjaste dorën e t'i përkëdhelte flokët e zez, që i ngjallnin kaq kujtime të rinisë... Por e mblodhi menjëherë dorën grusht dhe uli kokën, sikur të kishte bërë një gjë të turpshme, që nuk i ka hije burrit. Pas pak e pyeti si me inat:

— Të pashë se po mblidhje do rroba sot në mën-
gjez. Mos ke ndër mend t'i marrësh me vete?

— Jo! — i fshehu të vërtetën Drana, — i rregu-
llova në 'dollar.

Ai e vështroi edhe një herë me dhimsuri të fshe-
hur. Pastaj mori belin në krah dhe u nis. Por, para se
të dilte nga dera, u kthyesh edhe një herë dhe i thirri:

— Me kë do të shkosh te tezja?

— Asht edhe nana e Martës që shkon për në
Mallunë.

— Thashë se mos kishe ndër mend të shkojshë ve-
tëm, se atje në Gurraj janë mbledhë turli-turli njerëzish,
— përfundoi ai dhe u nis për në fushë pa e kthyer
më kokën që ta shikonte edhe një herë.

Drana mori këllëfin e jastékut të mbushur me rro-
bat e saj dhe u nis për te tezja. Sa herë të tjera e
kishte bërë këtë rrugë! Po këtë radhë nuk shkonte si
mysafire për pak ditë. Kishte bërë edhe ajo një plan
për të ardhmen. Pse të merreshin të tjerët me fatin
e saj? A nuk i takonte në radhë të parë asaj vetë të
mendohej e të vendoste për këtë gjë?.. Kur doli te
rruga e madhe, ktheu edhe një herë kokën sikur donte,
së bashku me shtëpinë, të përshëndeste edhe fëmijinë
e saj të hidhur..

4

Tezja e Dranës, Maria e dhemshur dhe fjalëpaktë,
banonte në një barrakë nga ato të ndërmarrjes «Ruga-
-Ura», që ishin ndërtuar pranë gurores. Ajo ishte një
pesë-gjashtë vjet më e madhe se motra, e ëma e Dranës.
Si të gjitha çupat e shtëpisë edhe ajo që martuar me
mblesëri në një fshat të vogël të malësisë. Burri, që
ishte shumë më i madh se ajo në moshë, merrej me ato
pak ara që kishte rrëth kullës. Pas çlirimtë ai zuri punë
në hapjen e rrugëve të reja dhe në asfaltimin e atyre
të vjetrave. Në vitet e para familjen e kishte lënë në
fshat, sepse, siç thoshte edhe vetë, «Kantieret e ndër-

marrjes «Rruga-Ura», qëndrojnë mbi rrota dhe aty ku janë në mbrëmje, nuk i gjen në mëngjes». Po kur u hap gurorja e madhe në Gurrat ai deshi të vendosej në kantier dhe qe nga të parët që e mori familjen me vete, duke u strehuar në një nga barrakat e ndërmarrjes. Pas dy-tre vjetësh kantieri lëvizi përsëri drejt veriut. Në atë kohë ai u sëmur dhe vdiq.

Tezja e priste Dranën gjithnjë me përzemërsi të hapur, sikur ta kishte vajzë. Mbesa i ngjallte në 'shpirt njëmijë kujtime përmotrën fatkeqe. Duke mbrojtur vajzën jetime dhe duke e mbajtur në shtëpi, asaj i dukej sikur plotësonte një dëshirë të thellë të së motrës, e cila kishte mbyllur sytë me emrin e vajzës së vogël në gojë. Veç kësaj Drana sillte në shtëpinë e saj të heshetur pranverën e rinisë, lgëzim e dlrësi. Në shtëpinë e tezes ajo gjente atë që i mungonte në shtëpinë e saj; ndaj nuk rinte e trishtuar dhe e menduar, si në shtëpinë e vet, por e gëzuar dhe e qeshur, ashtu siç qe natyra e saj e vërtetë. Gjatë ditës tezja shkonte në punë në fidanishten e largët, kurse Drana bënte punët e shtëpisë e kujdesej përmjetë, sidomos përmë voglin, që ende nuk shkonte në shkollë. Kështu që edhe tezja edhe fëmijët e donin shumë Dranën dhe bënin çmos që ta mbanin sa më shumë pranë tyre. Bile, sa herë Drana bëhej gati që të largohej nga shtëpia e tezes, djali i vogël qante me lot, se nuk donte të ndahej nga vajza e dashur, që e nxirrite jashtë në lëndinë dhe nuk ja prishte hatrin kurrë...

Më në fund ajo vajti në shtëpi të tezes përmjet një kohë të pacaktuar. Tezes ja tha troç se s'kishte ndër mend të kthehej më në familje. Ishte e qartë se këtë radhë i ndjente krahët të rritur dhe ishte gati të fluturonte me guxim, e vendosur që të mos futej më në kafaz...

I ati e lajmëroi disa herë që të kthehej në shtëpi, por ajo gjente shkaqe gjithnjë të reja, që ta shtynte kthimin përmë vonë. Sa më shumë ngulte këmbë i ati, aq më tepër përpiquej ajo të lëshonte rrënje të thella në vatrën mikpritëse të tezes. Këmbëngulja e të jatit i ngjallte dyshime dhe i shtinte frikën...

Drana qe ende e vogël, por përvoja e hidhur e jetës e kishte pjekur parakohe. Ajo kishte dëgjuar se shumë vajza të atyre anëve i kishin çuar me zor në shtëpi të burrit, apo në befasi, pa u thënë as gjysmë fjale. Dhe në kësi rastesh rënkitet dhe lotët e vajzave fatkeqe përpinqeshin t'i mbulonin me zhurmën e këngëve dhe të daulleve...

Papritur e papandehur Drana mori vesh nga një grua që punonte në fermë, se të fejuarin e saj e kishin marrë ushtar. «Oh, sa mirë!» — u hodh ajo nga gëzimi dhe kërceu me qejf në atë barrakë të vogël, që asaj i dukej njëmijë herë më e bukur e më e ngrohtë se sa shtëpia e të jatit. Tani e kuptoi mirë përsë u kishin mbetur në baltë planet e të dy krushqve dhe përsë bisedonin fshehtaz nga të tjerët...

Në atë kohë kantieri i Gurrajt ishte në të krijuar dhe Drana zuri punë në mensën e sektorit të gurores, pa ditur se ajo qe vajza e parë që hynte në punë në ndërmarrjen e re.

I ati, kur e mori vesh se ajo kishte hyrë në punë pa e pyetur atë, shtrëngoi një herë grushtet dhe kafshoi buzët me zemërim, por nuk tha asnjë fjalë. Planet e errëta preqatiten në heshtje dhe në fshehtësi të madhe...

5

I ati i Dranës qe i fundit në fshat që mori vesh se ç'kishte ndodhur me të bijën në kinemanë e re të Gurrajt. Në krye, sado që bëri sikur nuk u besonte fjalëve të botës, ju duk sikur i ra çatia e shtëpisë dhe e zuri brenda. Pak nga pak, duke e marrë veten, e ndjeu më shumë peshën që i rëndonte në shpirt dhe nisi të mendohej se ç'duhej të bënte që «të vinte nderin e familjes në vend».

Ai nuk e urrente Nduen, djalin e madh të krushkut, që ishte bërë shkaktar të merrej nëpër gojë e bija. Në shpirtin e tij sundonin disa rregulla të ngurta, që nuk e lejonin ta shikonte ngjarjen me gjakftohtësi dhe

të nxirrte përfundime të sakta e të drejta. Kështu që gjithë mllfin e zemrës e derdhi kundër Dranës...

«Që në vogëli kështu ka qenë, si një kedh i pabindun!» — tha me vete duke kërcitur dhëmbët. Dhe aty për aty mori këtë vendim të prerë: «Do ta sjell përsëri në vathë e do ta lidh atje te trungu i manit, gjersa t'i vijnë mendtë...»

Në mbrëmje, kur u ndezën dritat në kantier, ai ktheu një herë kokën andej dhe shtrëngoi grushtet, sikur i kanosej një armiku të egër, i cili, me gjithëse ndodhej larg, me dorën e tij të gjatë i kishte dhënë një shuplakë të fortë...

Në këtë çështje nuk ishte i interesuar vetëm ai, por edhe i ati i dhëndërrit. Mirëpo Pjetri nuk ndihej fare. Doda priti me ankth dy-tri ditë, por krushku as që vinte ta takonte, as që dërgonte ndonjë haber. Kjo heshtje ishte një shenjë e keqe për Dodën.

Në shpirtin e tij filluan dyshimet. Po, kur sillte ndër mend miqësinë e tij të vjetër me të, thoshte me bindje: «S'asht e mundun! Pjetri asht burrë zakoni dhe nuk mund ta bajë kurrë nji turp të tillë».

Më në fund e mbledhi mendjen të bëhej ai më i vogël dhe të shkonte vetë në shtëpinë e krushkut. Pjetri e priti ndryshe nga herët e tjera. Sipas zakonit ja shtroi me raki, me meze e me gjithë të mirat. Po në fjalët me të qe shumë i kursyer dhe i përbajtur. Dhe sikur e largonte bisedën nga çështja kryesore. Doda e pa veten ngushtë dhe u detyrua ta hapte vetë këtë muhabet.

— Tash, o Pjetër, — i tha me sytë përdhe, — duhet të bisedojmë edhe për hallin tonë. Si do t'ja bajmë asaj pune? ..

— Mue më pyet? Ti e ke në dorë, — ju përgjegj tjetri shkurt e prerë.

— Jo vetëm unë, të dy bashkë.

— Prit, tash t'i qërojmë mirë hesapet. Ato që ndodhën në atë dreq kantieri, që na erdhi për bela te pragu i derës, e mori vesh gjithë kazaja. Dhe fajin e ke ti. Po, për besë!

— Unë?

— Besa, ti, Dodë, ti! Sa herë të kam thanë: «Dodë, mblidhe cucën në shtëpi! Mos e lësho azat si nji pelë në mes të mëzave».

Doda uli kokën dhe nuk tha gjë, Pjetri me fjalët e tij ja kishte lënduar plagën e vjetër, që e mbante të fshehur.

— Kjo punë asht ndrashë shumë, o Dedë, — vijoi pas paik i zoti i shtëpisë. — Kur e ndigjova se ç'kishte ndodhë atje në kantier, sikur më ra qielli në kokë... Po, pér besë! Dhe në mbramje, e di si ishim na këtu, në familje? Sikur të kishte ra një tërmët i fortë në themelet e shtëpisë. E çfarë tërmëti, se... Pastaj plasi grindja...

— Grindje?... Pse?

— Oj ky! Pse, thotë. Ti e ke konakun në fshat, vëlla, dhe s'të ndigjon veshi se ç'thonë bota. Pastaj atje jeni të gjithë të lidhun njani me tjatrin. Këtu i thonë fermë dhe janë mbledhun njerëz nga çdo anë. Ja fillojnë havazit pér atë që ëndodhi, ndaç në punë, ndaç në rrugë, ndaç në klub... Pastaj Ndues i kanë hequn veshin atje në mbledhje... Dhe ja kanë heqë fort, saqë hala i dhemb. Po, pér besë!... Për tri ditë rresht djali nuk shkoi në punë. Pse, thue 'ti... Nga turpi, bre, nga turpi!... Dhe ma tha açik: «Babë! Nuk e duem cucën e Dodës pér nuse. Dera e shtëpisë sonë asht e myllun pér atë!» Ja si plasi grindja në shtëpi. M'u nda familja më dysh, bre burrë! Se vajzat, megjithëse ma të vogla, nuk pajtohen me mendimin e Ndues...

— Uf! — bëri Doda nga sikleti.

— Kështu, or mik! Puna ishte gati në të prishun. Unë e mbajta pezull. I vuna në kandar të gjitha: miqësinë, fjalën e dhanë, nderin e familjes... Dhe prapë nuk i dhashë dot karar kësaj pune, se kandari nji herë anon andej, nji herë këndeje. Po, pér besë!...

Pjetri pushoi. As Doda nuk tha ndonjë fjalë. Ngriti një herë kokën dhe vështroi bashkëfolësin, sikur donte t'i thoshte: «Po pastaj?»

— A nuk e pimë edhe nji, o Dodë? — tha më në fund i zoti i shtëpisë. Për miqësinë tonë të vjetër! — ngriti pak zërin Pjetri dhe tringëlli gotën me atë të

Dodës. Vështrimet e tyre u takuan. Pjetri buzëqeshi një herë dhe, pasi e ktheu gotën, vazhdoi:

— Meqë më erdhe në konak, o Dodë, kandari sikur anon tash vetëm nga nji anë: nga ana e miqësisë. Po, për besë!.. Kjo do të thotë që unë do t'u vë kapak të tanave e do ta çoj këtë punë gjer në fund. Shtjefnin e kam djalë të urtë, si qengj, e nuk do të ma kthej fjalën. Nduen, që asht disi i pashtrem, them se do ta bind... .

— Kështu, mik! Kjo asht fjalë burri, — tha i leh-tësuar Doda. .

— Me një kusht ama.

— Si ta kesh qejfin ti.

— Cucën do ta kthejsh menjiherë në shtëpi...

— E kam ca të vështirë, por do ta baj, — u përgjegj me bindje të përbajtur Doda.

— Të vështirë? Pse, bre burrë? A nuk asht evlati yt?

— Asht mesele e gjatë, o Pjetër. Ohu! — tha Doda dhe u mat një herë t'i hapte zemrën mikut të tij të vjetër e krushkut besnik. Po në çast u pendua përsëri dhe u mjaftua vetëm me një lëvizje të shpejtë të dorës së majtë, që donte të thoshte: «Lene, ma mirë, o Pjetër, mos ma lëndo këtë plagë, se e kam shumë të vjetër e të 'thellë»...

I zoti i shtëpisë e vështroi një herë ngultas në fytyrë dhe mblofdhi buzët, se s'mund të kuptonte q'po ndodhëtët në shpirtin e mysafirit. Doda uli menjëherë kokën, sikur donte të fshihte mendimet e tij nga syri depërtues i krushkut.

— Ti, Dodë, diçka më fsheh mue, — i tha pas një heshtjeje të gjatë e të mërzitshme.

— Pasha zotin, jo, bre burrë!

— Unë të shoh se ti je në siklet të madh. Dhe ma merr mendja se do të jetë për punën e cucës. Ma thuej pra, si e ke hallin: nuk të bindet ajo, apo ka ndonji pengesë tjetër në mes.

— Asht punë e ngatërrueme fort, o Pjetër...

— A nuk bajmë nji gja, o Dodë? Të ma lesh mue këtë punë në dorë që ta çmbështjell unë lamshin...

— Po si do ta bash?

— Ç'ke ti, asht puna jeme si do ta baj. Po s'e bana unë që ajo të vijë vetë e të trokasë te dera e shtëpisë, mos më thançin Pjetër Lleshi...

— Ku ma gjen, o mik! Po të ma kryeje këtë punë, do të më nxirrje nga një hall i madh. Po nuk e di se si mund ta bash këtë punë. Se cuçat sot nuk janë si moti...

— Si do ta baj? ! Mos të shkoj mendja se do të dërgoj Nduen ta rrëmbejë natën?

— Besa, më shkoi mendja...

— Jo, bre Dodë, jo. Çdo punë kryhet me marifet. Doda e vështronte me kurrestje e si me dyshim.

— Kam unë nji mik, o Dodë, atje në kantier, — vijoi ai — pér kryet e mikut. Unë do të bisedoj me të qysh nesër në mëngjes dhe ai e di vetë pastaj. Ti vetëm nji gja të bash: të lesh derën e shtëpisë hapun, se jam i bindun që pér dy-tri ditë ai do t'i japë fund kësaj pune. Po, pér besë! ..

Ata biseduan shumë gjatë asaj nate dimri. Dhe kur u ndanë në mëngjez, ishin të sigurtë se punën e kishin vënë në vijë një herë e përgjithmonë. Por nuk ishin vetëm ata që bënin plane pér fatin e Dranës.

P J E S A E D Y T E

I — ORA E VENDIMEVE TË MËDHA

«Çdo emër nga ata që do të merrnin pjesë
në ndërtimin e oxhakut, të kujtonte çarje
tunelesh, devijime lumenjsh dhe diga hi-
drocentralesh...»

1

Fillimi i Vitit të ri solli me vete ndryshime shumë
të mëdha në Gurraj, që erdhën fare papritur e në
befasi për të gjithë...

Një ditë të kthjellët e të ftohtë shkurti mbërriti në
kantier ministri i ndërtimit. Ai, para se të shkonte në-
për objektet e ndryshme, i tha Sefedinit si me të qeshur:

— E, Sefedin, nga do t'ja fillojmë ?

— Unë them nga Uzina, — ju përgjegj pa të keq
Sefedini.

— E pse jo nga banesat? Po të jemi në rregull
me banesat, nuk do të jemi keq me uzinën; se ata që
ndërtojnë uzinën, këtej nisen në mëngjez... A po jo?

Sefedini e nuhati ku e kishte fjalën ministri dhe
ju përgjegj me një buzëqeshje kuptimplotë:

— E kuptova, shoku ministër, e kuptova c'doni
të thoni. Këto pallate që ngrihen këtu ndoshta nuk do të
ishin përfunduar ende, po të mos na kishin dhënë vetë
punëtorët një mësim të mirë si mua ashtu edhe krye-
inxhinierit.

— Këtë mësim mos e harroni kurrë! — u tha mini-
stri qetë-qetë.

Në sektorin e uzinës, ku punonte pjesa më e madhe e specialistëve veteranë, ministri shumë vetë i njihet me emër. Duke biseduar me një grup punëtorësh mbi një skelë të lartë ai dalloi midis të tjera të Lleshin dhe i tha:

— A na ke bërë ndonjë këngë për qytetin e ri, o Llesh?

— Vetëm një, shoku ministër?

— Por kur do t'i dëgjojmë?

— Po të rrish sonte këtu, ke për t'i dëgjuar me siguri; se ne ditën punojmë për qytetin e ri e natën i këndojmë këngët më të bukura...

Pasdite ministri bëri një takim me kuadrot kryesorë të kantierit. Në këtë takim, përveç të tjerve, i lajmëroi edhe për disa vendime që ishin marrë nga ministria në bashkëpunim me komitetin e partisë për rrethin. Kantieri i Gurrajt ngruhej në ndërmarrje kombëtare të klasit të parë. Sektori i uzinës dhe ai i banesave bëheshin kantiere më vete. Përgjegjës i kantierit të uzinës caktohej Fatmiri, kurse i atij të banesave, Baftjari.

— E, c'thoni ju? — i pyeti ministri duke i vështruar me radhë.

— Edhe sikur të ishte bërë me vota, ata do të zgjidheshin. Po, për nder! — tha i pari Kola.

— Për Baftjarin kisha një gjë, — tha si me shaka Azisi. — Të mos e lëjë kritikën të ndryshket, tanë që u bë përgjegjës.

Baftjari buzëqeshi e nuk tha gjë. Në vend të tij u përgjegj Sefedini.

— E di vetë Baftjari atë punë...

Pastaj ministri kaloi në probleme të tjera. Njërit dëgjonin në heshtje, që të mos u shpëtonte asnë fjalë. Sefedini rrinte serioz, me vështrim diku larg, sikur donte të shikonte diçka jashtë dritares, që të tjerrët nuk e dallonin dot. Kur ministri përmendte veprat e tjera që do të ndërtohen në Gurraj, Kola fërkonte duart dhe lëvizte shpatullat, ashtu siç bëjmë kur duam t'i përvishemi një pune të madhe e të vështirë. Fatmiri

prekte lehtë mjekrën me dorën e majtë, se kishte tri-katër ditë pa u rrojtur dhe ministri i kishte hedhur një thumb të vogël. Lleshi diçka i pëshpëriste Kolës në vesh. Ndoshta i thoshte se kishte ndër mend të bënte një rapsodi edhe për veprat e reja, që tani përmendeshin vetëm me një fjalë. Inxhinier Andrea po vizatonte një fabrikë të madhe në blokun e shënimeve, që e mbante gjithnjë me vete. Qëkurse ishte në shkollën fillore, atij i pëll-qente të vizatonte ndërtesa të mëdha, fabrika të reja dhe ura të vështira e të komplikuara. Shumë herë vizatonte edhe në kopertinat e librave të shkollës. Mësu-esit e qortonin për këtë gjë, po ai nuk hiqte dorë, se siç thoshte vetë: «E kishte në gjak këtë mani». Edhe tani me disa vija të thjeshta e të goditura, po i jepte formë një fabrike të madhe, që zinte krejt faqen e blokut dhe zgjatej edhe më tej. Më në fund ja edhe oxhaku i lartë i fabrikës prej nga dalin fjolla të dendura tymi të zi...

— I dhe fund menjëherë fabrikës së re, inxhinier,
— i tha Azisi që i rrinte pranë.

— Po, më letër çdo gjë përfundohet lehtë e shpejt,
— ju përgjegj me zë të ulët inxhinieri.

— Afër mendjes, sa lehtë është ta sajosh atë në
letër, aq e vështirë është që ta ndërtosh me të vërtetë...

— Pa dale, Azis, të dëgjojmë se ç'hotë ministri,
— i tha inxhinieri duke mbyllur blokun e shënimeve.

Të gjithë zgjatën kryet përparrë për të dëgjuar më
mirë. Disa vështronin njëri-tjetrin sikur donin të pyes-
nin. «I tha me të vërtetë këto fjalë ministri, apo na u
duk neve?»

— Po shokë! — vijoi ministri, duke i theksuar mirë
fjalët. — Ndaj mund të bëhen ndryshime dhe modifi-
kime në projektin fillestar të uzinës. Nënkuptohet
se këto ndryshime nuk bëhen kot së koti, po për një
arësyё të fortë. Ju lutem të më kuptioni drejt. Maqineritë
e parashikuara për uzinën që po ndërtoni ju, nuk do
të vijnë nga ai vend që ishin planifikuar. Pse, do të thoni
ju... Ju shpjegova edhe më parë e po jua them edhe
një herë me pak fjalë. Disa nga shtetet miq po dre-

dhojnë, shokë. E po na dalin nga fjala. Më kuptioni? Nuk e kam fjalën vetëm pér projektet dhe maqineritë e uzinës së Gurrajt, por në përgjithësi pér rrugën që duhet ndjekur. Ata po dalin nga binarët. Dhe këtu është burimi i së keqes. Çështja është shumë serioze, se ka të bëjë me të tanishmen e me të ardhmen e vendit tonë dhe të socializmit në përgjithësi. Më kuptioni?....

Ministri fliste me gjakftohtësinë e tij karakteristike. Inxhinier Andrea hidhte ngandonjëherë vështrime të shpejta hetuese nga ana e Sefedinit. Por ky vazhdonë të shikonte diku larg, sikur nuk po ndodhët asgjë e jashtëzakonshme. Por po ta vëreje më me kujdes buzët i kishte më të shtrënguara se zakonisht si në çastet kur merrte vendime të guximshme.

— Kam edhe diçka tjetër, — tha ministri pas një heshtjeje të shkurtër. — Punën e oxhakut të uzinës. Ju keni punuar me vrull dhe keni ecur mirë në të gjitha repartet dhe anekset e uzinës. Po oxhakun s'e keni filluar ende. Ju e kuptioni mirë, dhe sikur të mbarohen repartet e tjera, edhe sikur të përfundohet krejt uzina, pa oxhakun s'mund të vihet në funksionim. Lëre pastaj që këto kanë lidhje midis tyre dhe duhen ndërtuar në një kohë... Ndoshta fajin më të madh e kemi ne të ministrisë, që ju kemi mbajtur me premtim se do të vijë nga jashtë skela metalike pér ndërtimin e oxhakut. Po ja, të themi se skema metalike nuk do të vijë fare nga jashtë. Do ta lëmë oxhakun pa e ndërtuar?..

«Gjendja qenka shumë serioze, — thoshte me vete inxhinier Andrea. — S'ka dhjetë ditë që drejtori i maqinerisë në ministri më tha se pér skelën metalike i kishin bërë një telegram urgjent atasheut tonë tregëtar... Ndërsa tani ministri thotë se mund të mos vijë fare. C'po ndodh në këtë mes?

Kur u ngrit pér t'u larguar, ministri u tha:

— Pér ato që dëgjuat, bëni çmos që të evitonit thashëthemet. Kureshtja e sémurë vetëm dëm mund të na sjellë. Partia, pér çdo gjë që do të ndodhë, do të japë sqarimet e duhura në kohën e duhur... .

Sefedini dhe inxhinier Andrea biseduan edhe veç me ministrin pér shumë probleme të kantierit. Në çastin e ndarjes ai i vështroi një herë me dashamirësi dhe u tha:

— Mund të kemi tallaze të reja e të mëdha në rrugën tonë, shokë. Po ju mbahuni të papërkulur. Shpatullat tona janë të forta e mund të mbajnë çdo peshë. Si thua ti, Sefedin?

— Të forta si shkëmb, shoku ministër! — ju përgjegj me bindje të plotë Sefedini...

2

Kaluan disa javë me punë normale e të qetë, në goftë se mund të quhet e qetë puna në kantier. Fjalët e ministrit nuk ishin harruar, por nuk kishin pasur ndonjë rrjedhim të menjëhershëm. Tani i shqetësonte të gjithë çështja e oxhakut. «Vërtet, si do të bëhet puna e oxhakut, po të mos vijë skela metalike?» — thoshte me vete inxhinier Andrea, sa herë shkonte në uzinën apo kur hapte projektet e uzinës. Por sado që mundohej, nuk gjente asnje zgjidhje. Ky problem i shqetësonte edhe të tjerët që drejtpërdrejt apo tërthorazi kishin të bënin me ndërtimin e kësaj vepre të madhe industriale.

Një ditë mbërriti në kantier që në mëngjez një telegram urgjent: «Drejtori së bashku me kryeinxhinerin të nisen menjëherë pér në Tiranë». Sefedinin mezi e gjetën andej nga depoja e karburantit, që ndërtohej jashtë periferisë së qytetit. Mirëpo Sefedini kishte mba-thur çizme të gjata, se vendi qe me baltë. Që të mos ktheheshin përsëri në qendër të kantierit e të vonohe-shin çizmet i ndërroi me këpucët e një gjeometri, që bënte disa matje në territorin e depos së karburantit. Dhe u nisën menjëherë pér në Tiranë. Këpucët e gjeometrit qenë të ngushta dhe e shtrëngonin shumë Sefedinin, kështu që, kur zbritën nga maqina mezi ecte në shkallët e në korridoret e ministrisë. Po kur u fu-

tën nëpër zyra, u dolën përpara gjëra të papritura dhe puna e këpucëve u harrua fare...

Drejtori i drejtorisë së projekteve industriale u tregoi planet dhe projektet e reja, duke u shpjeguar në vija të përgjithshme se cila ishte përbajtja e atyre ndryshimeve. Inxhinier Andrea e pa menjëherë se këto nuk ishin aspak ndryshime të vogla dhe ktheu kokën nga ana e Sefedinit, sikur donte t'i thoshte: «Ç'thotë ky? Si mund të ndryshohet projekti tani? Të ishte në fillim, mund të shtrohej ky problem. Po tani ne kemi bërë gjithë atë punë. Kjo do të thotë të kthehem i mbrapsht...»

Sefedini e kuptoi se ç'donte t'i thoshte ky vështrim i inxhinierit, por nuk ju përgjegj dhe u kthye nga ana e drejtorit.

— Sefedin! Më jep një cigare, — i tha Andrea me zë të ulët duke e shkundur me bërryl.

— Vendose ta pish, inxhinier? — ju përgjegj Sefedini duke nxjerrë paqetën e cigareve.

— Nga halli, — i tha me sinqueritet Andrea.

Sefedini u kthye nga ai dhe i buzëqeshi një herë, pa i thënë gjë...

Në fund drejtori u tha:

— Porosia nga ministri është: — Ju ta studjoni mirë çështjen dhe të na përgjigjeni të shumtën pas njëzet ditëve nëse do të ketë mundësi t'i bëni këto modifikime pa shkelur afatin përfundimtar të dorëzimit të uzinës. E qartë?

— Po si mund të bëhet kjo? Mrekulli nuk bëhen në shekullin tonë. Aq më pak në ndërtim, — nuk u përbajt dot pa thënë inxhinier Andrea.

— Mos harroni edhe një gjë — shtoi drejtori. — Tani e tutje mund të hasni më shpesh në mungesa matterjalesh. Shumë gjëra që priteshin nga jashtë nuk do të vinë.

— Atëhere?! — u hodh Andrea.

— Mos u ngut, ti, inxhinier, — ju drejtua tani Sefedini. — Do ta pleqërojmë një herë punën me shokët, do të mendohemi e pastaj. Ehu! Kjo është një punë

që kërkon mend, por edhe durim edhe diçka tjetër akoma.

Andrea e vështroi një herë si me inat e donte ta pyeste: «C'është kjo diçka tjetër?» Po ishte i sigurt që Sefedini do t'i përgjigjej shkurt: «Entuziazëm dhe shpirt prej punëtori». Ndaj nuk foli dhe shkeli fort cigaren me këmbë, se s'kishte ç'të bënte tjetër. Ai e shihte qartë se puna që ishte bërë gjer atëhere për ndërtimin e uzinës, gjithë parapregatitja që kishte bërë ai me inxhinierët e tjerë për zberthimin e projekteve si dhe masat organizative që kishin marrë për zbatimin e tyre, po përbyseshin fund e krye. Ndaj u alarmua së tepërmë dhe i tha Sefedinit me zë të ulët:

— Kjo është përbysje, vëlla, përbysje e vërtetë.

Sefedini nuk i foli, por u kthye dhe e vështroi një herë me inat.

Pasdite në ministri u thanë në mënyrë të prerë: «Skela metalike nuk vjen. Oxhaku duhet ndërtuar me mjete të tjera e me mundësitetona». Për këtë u ngarkuan posaçërisht Sefedini me kryeininxhinierin që ta zgjidhënin në vend me forcat e veta dhe të bënин një raport të veçantë personalisht për ministrin.

Me nja dy-tri orë natë ata zbritën me nxitim shkallët e Ministrisë së Ndërtimit dhe u nisën menjëherë për nënë Gurraj. Në timon u ul inxhinier Andrea. Tani e kishte marrë patentën e shoferit dhe shpeshherë Postolin nuk e merritte me vete, por e linte në ofiqinën e riparimit të automjeteve.

— A nuk qëndron pak të hamë një kafshatë bukë atje te Zogu i Zi? — i tha Sefedini kur morën Rrugën e Durrësit.

— Që tani të hamë darkë?

— Si të bëjmë? Në kantier do të arrimë shumë vonë.

— Mua s'më hahet fare sonte. Po deshe, hamë ndonjë gjë rrugës.

— Mirë thua, në mensën e fermës ka kos të mirë.

— Kush të tha?

— Kalova një ditë andej me Baftjarin dhe hën-

grëm një kos me qumësht delesh, lere se ç'kos qe!..

— Edhe mua më ka marrë malli për një kos të mirë.

— Mirë, pra. Atje matanë urës së Droyës kthehu nga e majta.

Inxhinier Andrea ja shkeli gazit, sa s'kishte ku të shkonte më. Sefedini rrinte pranë tij i heshtur duke vështruar gjithnjë përpara. Në një lkthesë të fortë, që Andrea e mori me shpejtësi, ai u hodh lart, gjer te mbulesa e maqinës.

— U troshite pak, ta ngas më ngadalë? — i tha inxhinier Andrea, sa për të hapur bisedën.

— Jo, bre, hiç. Mua më pëlqen kur maqina ecën me shpejtësi të madhe.

— Edhe mua. Se maqina, or vëlla, nuk është qerre, as talikë.

«Kështu më pëlqen edhe mua të mendohem kur udhëtoj, — tha me jetë Andrea, — por jo sonte, që e kam kokën daulle.

— A nuk qëndron pak, inxhinier? — i tha befas Sefedini.

— Do të zgresësh gjë? — e pyeti Andrea, duke frenuar maqinën në vend.

— Jo. Them të shtrihem atje prapa në sedile e të fle pak.

— Interesant! Të zë gjumi sonte?

— Mbrëmë e di kur kam fjetur? Nga ora dymbëdhjetë e ca. Dhe sot në mëngjez jam ngritur në ora pesë...

— Edhe unë vonë kam rënë, por sonte zor që të më zërë gjumi...

— Këtu në maqinë, or vëlla, nuk mund të bëjmë asgjë për hallin që kemi. Ti ke të paktën timonin në dorë dhe merresh me diçka. Ndërsa unë ç'të bëj? Prandaj do të marr një sy gjumë tani, që të jem pastaj esëll. Kjo ka rëndësi.

— Ka njerëz e njerëz — tha si me vete Andrea.

— Inxhinier! — thirri Sefedini duke zënë vend në sedilen e prapme të maqinës. — Ndërtimi është si

deti në stuhi. Një dallgë kalon, tjetra fillon. Dhe njëra
është më e fortë se tjetra. Ohu! Sa furtuna kemi kaluar
gjer tan!..

— Unë të thashë edhe atje në ministri: kjo është
përbysje!..

— Edhe sikur të jetë ashtu si thua ti, inxhinier, pra-
pëseprapë neve na takon që gjendjen e përbysur ta
vëmë përsëri në këmbë. Kjo ka rëndësi — tha Sef-
dini dhe e mbylli bisedën.

I përkultur mbi timonin Andrea i merrte kthesat e
rrugës me shpejtësi e nervozizëm. Herë-herë kthente
kokën mbrapa, por Sefedini nuk ndjehej fare. Nata qe
e qetë. Në rrugë kishte fare pak lëvizje. Ngandonjë-
herë dëgjohej zhurma e traktorëve, që lëronin tokën
pranë xhadesë e dukej një dritë që lëvizte poshtë e
lart.

Befas maqina frenoi me zhurmë dhe u ndal.

— Ç'është? ç'është? — pyeti Sefedini, duke u ngri-
tur menjëherë me sy të përgjumur.

— Asgjë. Erdhëm.

— Në fermë?

— Jo, bre, në Gurraj.

— Po ne nuk thamë të hanim darkën në fermë?

— Uh! Harrova fare.

— U shastise fare, bre burrë!..

— Tani s'kemi ç'bëjmë, shkojmë nga fjetorja them
unë; usta Jorgji do të na gostisë me ndonjë gjë.

— Jo, inxhinier, jo. Ustai do të na mbajë me llafe
gjer në mëngjez. Unë them të shkojmë nga Fatmiri.

— Në këtë orë te Fatmiri? Është shumë vonë.

— Le të jetë vonë. Fatmiri është yni. Llafosemi
një herë me të, e po të ketë ndonjë gjë hamë, sa për
të thyer urinë.

— Sefedin! Ora është dhjetë e ca... .

— Hajt, pra! Ndize motorin! Ti e di që unë i kam
zët vizitat, po kur kam ndonjë punë të ngutshme i ngrë
edhe nga dysheku shokët e ngushtë të punës.

Fatmirin e gjetën në kuzhinë duke gdhendur një
kornizë të madhe prej druri e duke dëgjuar muzikë nga
radioja, që ishte vendosur në bufe.

— Kuzhinë është kjo këtu apo oficinë? — tha me të qeshur Andrea, duke treguar veglat e punës mbi tavolinë.

— Më ka falur Burhani një fotografi të Leninit dhe desha të bëja një kornizë që ta ve këtu në shtëpinë e re, — ju përgjegj qetë Fatmiri. — Po ju prej Tirane vini tani? — pyeti pas pak Fatmiri.

— Drejtpërdrejt dhe kemi sjellë me vete erëra të stuhishme, Fatmir, — e nisi i pari Andrea.

— Dale, bre inxhinier, të shohim njëri-tjetrin një herë — ndërhyri Sefedini. — Po kusia atje në zjarr ç'ka brenda? — ju drejtua tani Fatmirit duke i treguar një tenxhere të vogël mbi sobë.

— Gjellë pér nesër, vëlla.

— Sikur ta dinte Malia që do t'i vinin sonte mysafirë në shtëpi.

— Pse, ore, pa ngrënë jeni ju në këtë orë?

— Lere, Fatmir, lere, kishim ndër mend të hanim një kos të mirë me qumëshët delesh, por inxhinieri harrroi të merrte kthesën pér në fermë e na solli këtu me barkun bosh.

— Pse s'thoni atëhere? Apo nuk kam një kusi fasule kokërrmëdha nga ato të Dibrës me një copë pastërmë nga fshati.

— Oh, ho, ho! mos e zgjat më Fatmir, — tha Sefedini me padurim.

— Unë s'dua, — tha inxhinieri duke vënë mbi tavolinë vandakun e skicave e të projekteve që mbante në dorë.

— Ne malësorët kemi një zakon, inxhinier. Njerezve që na vijnë në shtëpi në këtë orë u japim o bukë, o dru. Tani zgjidh e merr, — or vëlla, — shtoi si me shaka Fatmiri duke mbushur me gjellë dy pjata të thella, që nxorri nga bufeja. Në atë qast radioja filloi transmetimin e lajmeve të fundit të ditës.

— Pa dale, të dëgjojmë njëherë se ç'thotë — e ndërpren bisedën inxhinier Andrea.

Sefedini ngriti kokën dhe vështroi nga ana e ra-

dios. Fatmiri mbeti në këmbë me zdrukthim e vogël në dorë. Spikeri fliste ngadalë «Lufta që po u imponohet partisë dhe popullit tonë, do të jetë e gjatë dhe e vështirë. Por vështirësitë nuk e kanë trembur kurrë partinë e popullin tonë...»

— Dëgjuat? — pyeti inxhinier Andrea, kur mbaroi transmetimi i deklaratës së Komitetit Qendror të Partisë.

— Janë ato që biseduam edhe atje në ministri — u përgjegj Sefedini.

— Po mua s'më thatë asgjë, bre burra! Si qëndron puna? Folët që parë për erëra të stuhishme, por nga na vinë këto erëra? — pyeti Fatmiri edhe i qetë si kur-doherë, por edhe me një ton shqetësues këtë radhë,

— Nga të gjitha anët, Fatmir edhe nga Lindja edhe nga Perëndimi, — ju përgjegj inxhinier Andrea.

— Le të vijnë nga të duan, mali s'trembet nga bora, as nga stuhia. Vetëm më shpjegoni se si qëndron puna...

— Ja, sa të hamë pak bukë e do të bisedojmë. Ne për këtë qëllim kemi ardhur këtu, — i tha Sefedini.

Radioja po transmetonte: «Tani japim komentin: «Gjermania Perëndimore çerdhe e rrezikshme në zemër të Evropës».

Të tre burrat dëgjonin në heshtje. Fatmiri, pasi mblodhi pa zhurmë në një kuti veglat e punës, u ul për karshi inxhinierit.

— Tëmën! u tërbuan zagarët! — shau Sefedini duke u ngritur më këmbë, kur mori fund transmetimi i komentit.

— Ulu, Sefedin, ulu të mbarojmë punën tonë, — i tha inxhinier Andrea.

— Po. Kjo është përgjegjja më e mirë, që ne mund t'u japim atyre — plotësoi me gjakftohtësi Fatmiri.

Inxhinier Andrea i shpjegoi Fatmirit shkurt e qartë përsë i kishin thirrur në ministri dhe çfarë u kishin thënë atje. Sefedini rallë e tek shtonte ndonjë gjë që ai e quante të rëndësishme. Fatmiri tundte lehtë kokën, sikur këto që dëgjonte të ishin gjëra të zakonshme e të

natyrshme, që ai s'i dëgjonte për herë të parë. Kjo i bëri përshtypje inxhinierit dhe, kur mbaroi shpjegimin, e pyeti menjëherë:

— Hë, si të duket tanë puna?

Fatmiri u mendua një hop dhe, duke e vështruar inxhinierin në sy, u përgjegj lirshëm:

— E vështirë është, byrazer. Shumë e vështirë. Por s'ka gjë që s'bëhet.

— Një fjalë goje është.

— Ti, inxhinier, mos e merr kështu. S'do mend se kjo është një peshë e rëndë, shumë e rëndë. Po s'do ta mbajmë vetëm ne të tre. Jemi njëmijë e pesëqind njërez; njëmijë e pesëqind shpatulla prej punëtori. Apo e kam gabim?

— Po, aq jemi, — vërtetoi Sefedini.

— E sheh, pra? Këto shpatulla të bashkuara e di ç'mund të bëjnë? Mund ta ngrenë malin e Gurrajt në hava. Poo! Nesër, inxhinier, kur do ta shtrojmë çësh-tjen me shokët, do të të duket më pak e rëndë.

Në atë kohë radioja tha: «Transmetuam këngë e valle nga festivali kombëtar i ansambleve të klasës punëtore».

— Ja, kjo s'më pëlqen mua! — tha befas Sefedini duke i rënë tavolinës lehtë me dorë.

— Pse? — u habit Fatmiri.

— Ore, ne jemi të rrëthuar nga të gjitha anët nga armiq. Ku kemi nge të merremi me këngë e valle?

— Po si thua ti, Sefedin?

— Si them unë? Ja, ore të ndërtojmë! Të ndërtojmë natë e ditë. Kjo ka rëndësi. Që t'ju tregojmë atyre qenërve... Inxhinieri vuri buzën në gaz.

— Ne jemi të aftë edhe për punë, edhe për mbrojtë edhe për këngë e valle — i tha Fatmiri.

Kishte kaluar mesnata kur të dy burrat u ngritën për t'u kthyer në fjetore.

— A nuk flini këtu, bre burra? — u propozoi me sinqeritet Fatmiri.

— Joo! Ja ku e kemi barrakën tonë. Pastaj nesër

në mëngjez do të nisemi që me natë për në punë, — kundërshtoi Sefedini.

— Sefedin ngadalë se mos zgjojmë fëmijët, — i tha inxhinier Andrea në korridor, duke i shtrënguar krahun.

3

Mbledhja e këshillit teknik të ndërmarrjes qe e shkurtër por e stuhishme. Inxhinier Andrea, që ishte ngarkuar të paraqiste raportin për ndryshimet në projektin fillestar, duke folur, u tregoi një planimetri të uzinës, ku tregoheshin me vija të kuqe ndryshimet nëpër objektet e ndryshme të kompleksit industrial. Vijat e kuqe ishin aq të shumta në projektin fillestar të uzinës, saqë i mbulonin vijat e tjera dhe i jepnin projektit pamjen e një harte lufte, ku paraqiteshin me ngjyrë të kuqe operacionet luftarake. Një zhurmë pëshpëritjesh u përhap në zyrë dhe nga ndenjëset e fundit u dëgjua një zë: «Ç'ndryshime, ore!» Andrea e ngjiti projektin në mur dhe përmendi me shifra të përafërtë volumin e punës dhe materialet që do të nevojiteshin për të kryer ndryshimet. Në fund foli shkurt, fare shkurt e me nxitim, për ndërtimin e oxhakut të madh. Me kaq e mbylli raportin e tij pa shfaqur asnjë mendim dhe asnjë dyshim për realizimin e këtyre ndryshimeve. Po zëri i tij dhe mënyra se si fliste tregonin qartë se ai nuk ishte i bindur për ato që thoshte. Edhe në fytyrë dukei si i vrarë dhe i kapitur, jo aq nga lodhja, se sa nga një shqetësim i thellë që e hante nga brenda. Atyre të vjetërve, kur e panë kështu, ju duk tamam si ato ditët e para, kur kishte ardhur në kantier për herë të parë. Kur mbaroi rapporti, Sefedini shtoi aty për aty:

— Harrove një gjë inxhinier! — Dhe, duke ju drejtuar të tjerëve, vazhdoi: — Tani na kërkohet edhe kjo: pasi ta shoshitim mirë këtë çështje, t'i përgjigjemi ministrisë, të shumtën brenda njëzet ditëve, nëse na mban kurrizi që t'i bëjmë të gjitha këto ndryshime, pa lëvizur

dhe pa shkelur afatin përfundimtar pér dorëzimin e uzinës. Më kuptoni? Kjo ka rëndësi... Siç e shihni edhe vetë, puna është me spec. Nëse dikush do të thotë se kjo detyrë që na ngarkohet është e vështirë, unë do t'ju thosha troç: dhjetë herë e vështirë, ore shokë! Ne tani do të tregojmë sa na vlen lëkura. O do të shtrojmë bythët këtë radhë që të dalim faqebardhë, o do të ngecim në baltë e do të na marrë djalli. Po unë them se ne do ta kalojmë edhe këtë lumë; dhe do ta kryejmë këtë detyrë të vështirë. Ne gjer tani s'jemi turpëruar asnjetëherë. Tani kemi edhe një arësyte tjeter që t'i përvishemi punës si asnjetëherë tjeter. Ata të pabesë, që na hiqeshin gjer dje si miq, duan të na lënë në baltë. Ndaj neve nabiie barra e rëndë që me krahët tonë e me mendjet tonë tu themi atyre: «Kot e keni. Ne nuk do të ngelemi kurre në baltë. Dhe as na trembet syri nga asgjë. Ne uzinën tonë do ta ngremë me dhëmbë, dhe oxhakun do ta naltojmë gjer në qiell, me shpatullat tonë, që ta shikoni ju të gjithë, që s'na doni të mirën e të pëlcisni nga inati!».

Kaq tha Sefedini dhe u ndal papritmas. Zëri i tij kishte një theks të veçantë këtë radhë. Ai foli më mengadalë se herët e tjera. Anëtarët e këshillit teknik dhe punëtorët e tjerë, që ishin thirrur në këtë mbledhje, vazhdonin ta vështronin me ngulm edhe pasi mbaroi dhe u ul në vendin e vet. Për një kohë në zyrë ra heshtje. Njerëzit ishin zhytur në mendime. Dukej sikur askush tjeter nuk kishte pér të shtuar ndonjë gjë. Papritmas u ngrit inxhinier Sahiti. Ai kishte bërë një preqatitje të veçantë pér punën e oxhakut dhe leksi disa shifra.

— Ky do të jetë oxhaku më i madh dhe me i lartë i vendit tonë, — filloi ai. — Lartësia e tij do të jetë afro nëntëdhjetë metra. E dini ç'do të thotë kjo? Kjo është sikur të kesh pér të ndërtuar një pallat prej tri-dhjetë katesh. Një gjë e tillë nuk është ndërtuar gjer tani tek ne. Pastaj, ku do të mbështetesh pér ta ndërtuar oxhakun? Mbrëmë bëra shpejt e shpejt një hesap. Do të nevojiten afro një milion e dyqindmijë kilogram

ferrobeton për ndërtimin e oxhakut. Me se do të ngrihet gjithë kjo peshë në një lartësi të tillë?

— Pse na i thua këto, inxhinier? — e ndërpree me zë të ashpër Sefedini.

— Pse i them këto? — inxhinier Sahiti e humbi për një çast dhe u skuq në fytyrë. — Sepse këto të dhëna janë të vërteta dhe duhet të dihen nga të gjithë.

— Ore s'ka nevojë të na shurdhosh veshët me shifra tani. Ti na thuaj vetëm një gjë: mund ta ndërtojmë ne oxhakun apo jo? Kjo ka rëndësi...

— Pa skelen metalike, në asnje mënyrë!

— Kështu thua ti?

— Kështu thonë qitapet, librat, jo unë. Edhe mbrëmë shfletuan gjithë ato manuale e revista me Andrenë e me Burhanin dhe nuk gjetëm asnje rast, që të jetë ndërtuar një oxhak i tillë pa mjete mekanike. S'ka llafe këtu...

— Atë që s'e kanë bërë të tjerët, do ta bëjmë ne. Më kuption? Kjo ka rëndësi. Dhe ti mos u beso më shumë librave, se sa njerëzve... Ulu! — i bërtiti Sefedini.

Inxhinier Sahiti nuk donte të ulej e protestoi. Bashkë me të nisën të flisnin edhe të tjerë. U bë një rrëmujë e madhe. Inxhinier Andrea, që rrinte gjer në atë çast kokulur dhe i mërzitur, i bëri disa herë shenjë me dorë Sahitit që të ulej, por ai nuk donte të dëgjonte e vazhdonte të thoshte:

— Kam edhe shifra të tjera shumë interesante! Po, shumë interesante!

Më në fund Sefedini u ngrit në këmbë dhe vendosi rregullin.

— Flokët e mi nuk kanë për t'u bërë përsëri të zez, pa oxhaku do të ndërtohet se s'bën. More vesh? — tha nga vendi ku ishte ulur usta Jorgji.

Në sallë plasi gazi Njerëzit sikur shpëtuan nga një mërzitje e nga një peshë e rëndë dhe vështruan nga ana e ustait me simpati. Një brigadier nga fundi i sallës thirri:

— Të lumtë, o usta! Ti na nxjerr gjithnjë nga balta.

Njerëzit qeshën përsëri. Vetëm Sefedini nuk qeshi. Në atë çast u ngrit Fatmiri.

— Unë them të mos marrim sot vendim. Se nuk
është një çështje e vogël, or shokë, që ta vendosim në
çast. Do të mendohemi një herë, do të bëjmë hesape...
Po! Se kalemin mund ta përdorim edhe ne, de, jo ve-
tëm inxhinierët — thumboi Fatmiri dhe vështroi nga
ana e Sahitit. — Tani është puna që të mos na ikin
ditët vetëm me fjalë. Prandaj unë them të grumbulloj-
më më tepër forca në uzinë e të fillojmë punën me dy
turne. Vetëm kështu do të arrimë që hem të kryejmë
ndryshimet, hem të mos shkelim afatin e dorëzimit
përfundimtar...

— Të punosh natën me këtë ngricë në korpusin
kryesor të uzinës, është punë që s'bëhet, — tha dikush
nga fundi.

— Ne në Kurbnesh kemi punuar me dy turne edhe
në mes të acarit, — ju përgjegj Sefedini.

— Atëhere mos na kërkoni cilësi, — kundërshtoi
tjetri përsëri.

— Ore cilësi do të të kérkojmë, që ç'ke me të...
Ku jemi këtu?

Njerëzit nisën të flisnin përsëri me radhë e pa
radhë.

— Qetësi, shokë! — thirri Sefedini. — Fjalën e ka
Kola.

— Ç'i duam fjalët e grindjet? — tha Kola. — Ta
provojmë një herë vetëm me një brigadë. Po të dalë
mirë, i ndajmë të gjitha forcat me dy turne. Po për
nder!

— Atëhere të fillosh ti me brigadën tënde! — ju
hodh nga vendi inxhinier Sahiti.

— Me gjithë qejf, shoku inxhinier. Qysh sonte po
të doni. Dhe do të shikosh se puna do të shkojë revan,
— tha Kola dhe u ul.

Në fund u vendos të bëhej një provë për disa ditë
me një brigadë të zgjedhur. Dhe si e tillë u çaktua ajo
e Kolës. Për çështjen e oxhakut nuk u muar asnjë ve-
ndim, gjë që tregonë se ky ishte problemi më i vë-
shtirë për atë çast.

Inxhinier Andrea nuk shfaqi asnjë mendim. Kjo u

bëri përshtypje të gjithëve. «Kjo është më keq, — thoshte me vete Sefedini, kur mbylli mbledhjen. — Se po të kishte folur kundër, do t'i jepnim edhe atij një përgjegje të mirë, ashtu siç i dhamë Sahitit. Si duket ai ka ndër mend të flasë në ndonjë rast tjetër. Që të jetë edhe më i pregetitur. Mirë, o inxhinier Andrea, mirë. Ne gati jemi gjithnjë...»

* * *

Në fund të mbledhjes Fatmiri qëndroi pak në korridor duke pritur Sefedinin. Kur doli nga sala Sefedini, ai e mori si mënjanë dhe nisi t'i thoshte diçka me zë të ulët. Inxhinier Andrea u kaloi fare pranë, pa u thënë gjë.

— Inxhinier! — i thirri Fatmiri. — Pse bën sikur s'na sheh?

— Thashë mos kishit ndonjë sekret, prandaj nuk ju fola — gjeti një përgjegje aty për aty Andrea.

— Ne s'mbajmë sekrete nga ti, — i tha Fatmiri dhe i futi krahun. — Kemi një hall tjetër tanı...

— Çfarë?

— Sefedini ka nënën të sëmurë. I ka ardhur një telegram urgjent që në mëngjez, që të niset për në shtëpi, mirépo ky ngurron e nuk vendos dot. Si thua ti?

— Të niset menjëherë, — tha me gojën plot Andrea.

— Kështu i them edhe unë, por s'i mbushet mendja. «Kemi gjithë këto halle këtu, — thotë, — si do të largohem unë nga kantieri tanı që puna qëndron në tehun e briskut?»

— Nënën s'ke ku e gjen nesër, pa hallet mund të zgjidhen edhe nesër edhe pasnesër, — tha si i menduar Andrea.

— Unë kam që në mëngjez që përpinqem t'i mbush mendjen. Këtu ke kryeinxhinierin, — i them, — pastaj jemi dhe ne të tjerët.

Sefedini e vështroi një herë Andrenë nga koka në këmbë. U mat një herë të thoshte diçka, po përsëri u

përbajt. Po të fliste do t'i thoshte me siguri: «Nëna e sëmurë atje në shtëpi, ti i sëmurë këtu në kantier. Ja përsë nuk marr dot një vendim. Pa të ishe ti në rregull, do të kisha mendjen të fjetur e do të isha nisur menjëherë...»

— Vendose, byrazer? — e nxiti edhe një herë Fatmiri.

— Dreq o punë! Se si vijnë të gjitha hallet përnjëherësh, — tha Sefedini, po më i çelur tani.

Më në fund vendosi që të nisej po atë natë. Në çastin e ndarjes i shtrëngoi një herë fort dorën Andresë dhe e kapi prej krahu, sikur donte t'i thoshte: «Hë! Të mbajnë shpatullat? Tani të dua!»

4

Megjithëse gjumi e kishte zënë shumë vonë atë natë, inxhinier Andrea u çua të nesërmen më herët se zakonisht. Kokën e ndjente të rëndë dhe trupin si të vrarë, po kur u ngrit, sikur e mori veten menjëherë. Atë ditë kishte me të vërtetë shumë punë. Në mëngjez do të shkonte një herë nga uzina, që të shkonte ç'punë ishte bërë dhe të jepte udhëzime të reja. Po andej nga banesat e qytetit të ri ku s'kishte vajtur për pesë ditë rresht? «E braktisëm fare atë sektor, — tha me vete. — Ka hakë usta Jorgji. Sot duhet të shkoj edhe atje. Patjetër. Pastaj duhet të kaloj edhe nga drejtoria se, meqë mungon Sefedini, kushedi se ç'telashe do të ketë edhe andej...»

Por mendimi se do të kishte shumë punë gjatë ditës, sikur e lehtësoi ca. Dhe së bashku me Kolën u nis për në uzinë. Rrugës u bashkua me shumë punëtorë e teknikë, që shkonin për në punë duke biseduar me gjallëri e duke bërë shaka. Fytyra pak nga pak po i çelej. Sa i pëlqenin mëngjezet në kantier, kur të gjithë niseshin për punë! Ndaj kishte qejf të vazhdonte rrugën bashkë me ta gjer në uzinë. Mirëpo nga mesi i rrugës dëgjoi një zë të fortë që e thërriste:

— Inxhinier Andrea! Inxhinier Andrea!

Ktheu kokën dhe pa Baftjarin që ecte me hap të shpejtë, thuajse me vrap, që ta arrinte.

— S'është punë kjo, inxhinier! — i foli Baftjari prej së largu, i revoltuar.

— Ç'ke prapë?

— Më keni lënë pa bukë, or välla, pa bukë.

— Si pa bukë, ore?

— Ja, kështu që të them unë. Më keni lënë pa çimento. A mund të ndërtosh pa çimento?

— Si kështu, o Baftjar?

— Më ka mbajtur me prentime Qakua i furnizimit. Më kuption? Fjalë të mira, gurë në trastë, — i thonë kësaj pune...

— Po me Sefedinin s'ke biseduar?

— Ç'të bisedoja me Sefedinin? «Ç'ke ti, — më tha edhe mbrëmë Qakua. — Nesër në mëngjez, çimento do ta kesh në vend». Kur shkova sot në sektor, gorica! U nisa menjëherë për në drejtori e më thanë që Sefedinit se q'i ka ndodhur në familje dhe ka ikur natën për në fshat. Prandaj të zura në mes të rrugës.

— Nga dreka do të vij vetë andej nga ju.

— Në drekë? Ç'të të dua unë në drekë? Ke marifetin ta kapësh tanë Qakon, para se të largohet për ndonjë vend? Pa të pres unë gjer në drekë, më iku dita...

— E, ç'ta bëj Qakon?

— Ç'ta bësh? T'ja mbledhësh të dy këmbët në një këpucë e ta shtrëngosh të na furnizojet me çimento. Ja, ç'ti bësh... Dhe fjalët t'i këtë më të pakta! — shtoi në fund si me inat Baftjari.

— Kushedi se si e ka hallin dhe ai i shkreti!...

— S'di unë si e ka hallin ai. Unë dua çimento! — nguli këmbët tjetri.

Inxhinier Andrea e pa veten ngushtë dhe u detyrat të kthehej për në drejtori. Atje e prisnin edhe tre-katër të tjerë për nevojat e sektorëve ku punonin. Kështu që u vonua më shumë se dy-tri orë. Kur u nis më në fund për në uzinë, mendjen e kishte te Sefe-

dini. S'kishin kaluar ende njëzet e katër orë që ai ishte larguar dhe e ndjeu menjëherë mungesën e tij...

Sa të hyje në territorin e rrëthuar të uzinës, të bënte për vete melodia e ashpër, por edhe e këndshme e betonjerave, transportierëve, vinçave dhe e kamionave që shkarkonin materiale gjithandej. Për Andrenë ishte bërë e njojur dhe tërheqëse kjo melodi. Ajo e bënte që të harronte çdo gjë tjetër e të futei menjëherë në vallen e madhe të ndërtimit. U drejtua për në korpusin kryesor, ku mund të gjente Fatmirin e, së bashku me të, të kalonte nga repartet. Te sheshi i madh, ku punonin hekurthyesit, një saldatriçe i verboi sytë. Ktheu kokën nga ana tjetër dhe si në mjegull ju duk sikur pa një fytyrë të njojur që e tërhiqte shumë kur e shihte. Ferkoi një herë sytë dhe menjëherë dalloi Dranën, që priste aty në këmbë.

- Ti, këtu? — e pyeti me habi.
- Poo, — ju përgjegj ajo dhe uli kokën.
- Pse ke ardhur?
- Kam nji hall.

Andrea i hodhi një vështrim hetues. Ai s'e kishte parë kurrë Dranën në kantierin e ndërtimit të uzinës. Ç'hall do të kishte, vallë? Mos i kishte ndodhur ndonjë gjë me familjen, me të jatin, a me ata të krisurit e familjes së Pjetrit? Bëri një hap drejt saj dhe e pyeti përsëri me zë më të ulët, por më të ngrohtë.

- Të ka ndodhur gjë në familje, a?
- Jo, kam nji hall tjetër, më kanë pushue nga puna, — ju përgjegj ajo me një frymë dhe u skuq në fytyrë.
- Kush të pushoi nga puna?
- Martini, përgjegjësi i gurores.
- Kur?
- Ka tash tri ditë.
- Po pse të pushoi?
- Kështu i deshi qejfi.

Një hekurthyes, që sapo kishte mbaruar punën me disa shufra hekuri të shtrira përdhe, fshiu një

herë ballin e djersitur me mëngën e komino shes dhe, duke i ardhur fare pranë, i tha:

— Është vazhdimi i asaj ndodhie në kinema, inxhinier!

— Jo, bre! — nuk ju besua inxhinierit.

— Dëgjomë mua ti. Ne biseduam gjerë e gjatë me vajzën.

— Mos të ka ndodhur ndonjë gjë atje në punë, moj Dranë? — u kthye tani nga ajo inxhinieri.

Ajo u bë menjëherë si lulëkuq në ftyrë, kur dëgjoi që ai i foli në emër. Por e mblodhi veten në çast dhe ju përgjegj shkurt:

— Asgja...

— Po si të tha atë ditë Martini që të pushoi nga puna?

— Ti duhet të ikësh nga kantieri, — më tha, — e të shkosh te prindët. Njerëzit e tu të presin. Përse të rrish në shtëpinë e huej? Ktheu në shtëpi sa ma parë.

— E sheh inxhinier? — i tha hekurkthyesi.

Andrea ra në mendime. Drana u kthye përgjysmë nga ana e hyrjes së kantierit dhe bënte sikur vështronë maqinat që hynin e dilnin pa pushim. Por në të vërtetë ajo priste me pa durim se ç'do t'i thoshte ai.

— Po ti kë doje të takoje këtu? — e pyeti më në fund Andrea, para se të merrte një vendim.

— Unë kërkova drejtoren, por s'e gjeta; erdha këtu për me i qa hallin shokut Fatmir, por as atë s'e gjeta.

— Ku është Fatmiri? — u kthye Andrea nga hekurkthyesit.

— Këtu qe, — ju përgjegj njëri nga ata, — por ka ndonjë orë që hipi në një kamion dhe vajti nga baza e materialeve të parafabrikuara.

— Fati em i keq, — ja ktheu Drana duke pshëritur lehtë.

— Ti mos u mërzit, Dranë — i tha Andrea me një përzemërsi, që e bëri edhe atë vetë të habitej...

Vajza ndjeu një rrëqethje të fortë, kur ai i foli në emër.

Në atë çast ra çanga për pushimin e drekës. Betonierat dhe maqineritë e tjera të ndërtimit pushuan njëra pas tjetrës dhe, në vend të zhurmës së tyre shurdhuese, dëgjohej tanë qartë zukatja e qindra njerëzve, që merreshin me ndërtimin e uzinës. Hekurkthyeshit lanë punën menjëherë, por në vend që të drejtoheshin për në mensë, ju afroan inxhinierit dhe njëri nga ata i tha:

— Kot i bien në qafë vajzës, inxhinier.

— Ky është një turp i madh për kantierin tonë, — shtoi tjetri.

Pak nga pak rreth tyre u grumbulluan edhe punëtorë të tjerë. Ata, pasi merrnin vesh se ç'kishte ndodhur, shprehnin haptazi zemërimin e tyre.

— Dranën e kanë pushuar nga puna? «Vajzën e kantierit?» — tha i revoltuar Lleshi.

— Në vend që ta përkrahim me çdo gjë që kemi në dorë! — tha një buldozorist i shkurtër, sa po zbriti nga maqina e tij.

— Dëgjoni, bre burra! — u thoshte hekurkthyesi që kishte biseduar në fillim me inxhinierin. — Është çudi, por ka edhe midis nesh njerëz që marrin anën e prapanikëve dhe të fanatikëve.

— Dranën s'duhet ta lemë kështu ne! — tha me ton të vendosur buldozeristi. — Njerëzit e ligj kanë thurur një kurth të fshehtë dhe fijet e këtij kurthi arrijnë gjer në kantierin tonë. S'do mend se këto fije janë shumë të holla, por ne i shohim fare qartë.

— Drana duhet të fillojë menjëherë nga puna. Kjo është kryesorja, — tha prerasi hekurkthyesi.

Vajza vështronë punëtorët që grumbullohen aty e bisedonin për hallin e saj, si për ndonjë hall të tyre dhe habitej. Në fillim kishte ndjerë njëfarë ndrojtje, se nuk deshi që puna e saj të bënte bujë në gjithë kantierin. Por pak nga pak po e kuptonte më qartë se s'kishte pse të ndruhej.

— Besoj se edhe kryeininxinieri ka për të qenë i një mendjeje me ne, — tha përsëri hekurkthyesi.

— Për çfarë çështje? — pyeti ai, sikur nuk e kishte mendjen atje dhe s'dinte përsë flisnin.

— Ja, që Drana të fillojë menjëherë nga puna.
— Të fillojë nga puna që tani — thërritën disa të tjerë.

— E di si është puna, inxhinier Andrea? — u hodh hekurthyesi i parë, sikur të fliste në emër të të gjithëve. — Drana ka qëndruar pa punë tri-katër ditë. Dhe s'ka pér të qenë ndonjë hata e madhe sikur të mbetet në shtëpi edhe gjer nesër në mëngjes. Po e di pse ngulim këmbë, që ajo të fillojë menjëherë nga puna? Që t'i tregojmë asaj qyqes, që këndon avazin e vjetër, se kantieri nuk i duron këto gjëra.

— Hë të lumtë goja! — thirrën disa.

Inxhinier Andrea e kuptoi menjëherë se s'kishte pse ta zgjaste. Forca e kantierit, gjaku i kantierit, shpirti i kantierit ishin ata. Prandaj priti sa ra çanga pér rillimin e punës dhe i tha vajzës:

— Tani ti zgjidh një punë që të pëlqen. Apo dëshiron të kthehet përsëri në mensën e gurores?

— Jo, ma mirë këtu, — ju përgjegj ajo shkurt e thjesht.

— Atëhere, po të duash, fillo qysh tani.

Drana vështroi një herë rrëth e rrötull, sikur kërkonte diçka; pa humbur kohë rrëmbeu një karro dore dhe e çoi pranë betonierës pér ta mbushur me llaç. Pas dy tri minutash kaloi pranë Andresë me karro të mbushur, sikur fluturonte nga një gëzim i ri, që s'e kishte ndjerë më parë. Kur u largua disa hapa, ktheu një herë kokën dhe i buzëqeshi me dëritë... Inxhinier Andrea mbeti si i gozhduar në vend duke e vështruar gjersa ajo humbi në mes të njerëzve. Tela-shtet dhe shqetësimet e ditëve të fundit u çdukën pér një lëcast si prej një force magjike, që buronte nga sytë e zeza të Dranës...

Në mbrëmje, kur u kthye Fatmiri nga baza, Andrea i kallëzoi me hollësi punën e Dranës. Fatmiri tundi njëherë kokën si i menduar 'dhe i tha:

— Çudi me këta njerëz si Martini. Ditën punojnë këtu në kantier dhe duket se mendjen e kanë të kthjellët si qelli i beharit. Por natën kthehen pranë

familjes, pranë shokëve të tyre të vjetër dhe bëhen përsëri skllevër të zakoneve të vjetra. Kantieri ynë është si një fener i ndezur në mes të kësaj krahine, ku sundonte më parë errësira. Po edhe errësira nuk rri e struktur nëpër qoshe; edhe ajo lëviz, edhe ajo luf-ton kundër dritës...

5

Inxhinier Andrea, kur u kthyte natën në kantier, gjeti vetëm usta Jorgjin që flinte. Soba qe shuar prej kohe, por në fjetore ishte ngrohtë. Shtrati i Sefedinit ishte bosh. «Tani do të jetë në shtëpi, — tha me vete Andrea. — Kushedi, do ta gjejë vallë të gjallë nënën? Po Kola ku është? Shiko, shiko! Harrova fare. Kola është atje, në frontin e punës. Me gjithë brigadën e tij, ai ka marrë përsipër të bëjë një eksperiment. Pra, më takonte edhe mua të isha atje. Po pse s'vajta?»

U ul në shtrat dhe zuri kokën me duar. Gjatë ditës, duke u marrë me punë të ndryshme, sikur e kishte harruar problemin e madh e të vështirë, që kishte për të zgjidhur. Dhe ishte lehtësuar shumë. Por tani që u kthyte në barrakë, dilema e ditëve të fundit i delte përsëri përpëra më e mprehtë se kurrë...

Pse s'vajta në uzinë për të shikuar se si shkon turni i natës? S'është puna se harrova, or jo! Kjo që thashë më parë, ishte sa për të gënjer veten. Po me fjalë e me sofizma ndoshta mund të gënjesht të tjerët, e jo veten... Unë nuk vajta në turnin e dytë se s'kam sy e faqe t'u dal përpëra punëtorëve. Kam frikë se do të më vështrojnë të gjithë e do të më thonë: «Pse shkëputesh nga ne, inxhinier? Për më shumë se një vit kemi bërë së bashku gjithë atë rrugë. Rruga kishte qenë me gropë e me pengesa, po prapëseprapë ne çamë drejt përpëra. Ndërsa tani që na doli një kthesë e madhe, ti po e ngatërron hapin...» Nuk do ta harroj kurrë mbledhjen e djeshme. Kur flitej për oxhakun, Kola më vështronte me ngulm, sikur donte të më thoshte:

«Folë një fjalë edhe ti, o inxhinier! Fjala jote peshon shumë». Po unë nuk fola. Unë heshta edhe më vonë kur mori përsipër Kola të punonte në turnin e dytë. Prandaj sot në mëngjes ai më shikonte ndryshe nga herët e tjera. Po sikur të nisem e të shkoj tanë atje në uzinë? Ora është dhjetë e gjysmë. Për gjysmë ore do të jem aty. Kola do të më dalë përpara e do të më përqafojë. «Erdhe?» — do të më thotë. — «Sa mirë bëre, Andrea! Po, për nder!»

Ky mendim i fundit sikur e joshi për një çast dhe zgjati dorën për të marrë çizmet, që i kishte futur nën shtrat. Po përsëri ngurroi e ngeli si i pavendosur. Njérën çizme e kishte mbathur, tjetrën e mbante në dorë. Nuk ishte lodhja fizike që e bënte të ngurronte, as acari i natës së dimrit. Ishte diçka tjetër më e thellë. «Të pranoj për një çast, — nisi përsëri arësyetimet me vete, — se ndryshimet në projektin fillestar të uzinës i bëmë brenda një kohe rekord, ashtu siç na thanë ata të ministrisë. Po oxhakun si do ta bëjmë? Në punën e oxhakut s'ka llafe, or vëlla. E tha mirë Sahiti në mbledhje: Oxhaku do të ketë një lartësi sa një godinë tridhjetëkatëshe. A është ndërtuar gjer tanë tek ne një godinë e tillë? Jo! Atëhere?.. Edhe po të ndërtohet më vonë, të themi pas pesë-gjashtë vjetëve, do të sillen nga jashtë skela metalike të posaçme. Me siguri. Atëhere si do ta marrim përsipër ne ta ndërtojmë oxhakun pa gjë në dorë? Me çekiçin e usta Jorgjit dhe entuziazmin e Kolës nuk ndërtohen dot vepra të tillë. As edhe me yryshet e Sefedinit. Se duhen ngritur një milion e dyqindmijë kilogram peshë... Me se do t'i 'ngresh?... Dhe në një front të ngushtë si oxhaku, ku s'ke ku të mbështetesh, ku s'ke ku të lëvizësh...»

Kjo peshë e rëndë, që nuk i largohej nga mendja, i dukej sikur i rëndonte mbi kurriz dhe e bënte të përkulej. Kjo peshë i thyente edhe vullnetin, në atë çast që ai matej të nisej për në uzinë, ku punonte brigada e Kolës.

Usta Jorgji u kthyte nga ana tjetër dhe shtrati kërciti lehtë. Inxhinieri e vështroi një herë dhe tha:

«Ky është i lumtur». Mendoi një herë që ta zgjonte plakun e mirë dhe t'i kërkonte një këshillë, si prej babai. Po përsëri ndërroi mendje. «Pse ta zgjoj? — pyeti veten. — Usta Jorgji, sado që në shumë raste ka treguar simpati përmua, këtë radhë do të përsëritë po ato fjalë që tha në mbledhjen e djeshme: «Flökët e mi nuk kanë pér t'u bërë përsëri të zez, pa oxhaku do të ndërtohet se s'bën».

Inxhinieri mbeti me njérën çizme të mbathur e me tjetrën në dorë. Asnjëherë tjetër në jetën e tij nuk ishte gjetur ballë përmallë një dileme të tillë. Nga shifrat e librave, nga letërsia teknike që kishte lexuar, nga konsultimi me inxhinierët e tjerë kishte nxjerrë një përfundim. Po nga ana tjetër vendosmëria e Sefedinit, entuziazmi i Kolës, gjakftohtësia e Fatmirit dhe humori i usta Jorgjit, jepnin një përfundim tjetër. Ku do të bazohej? Si do të vepronte? Cilën rrugë do të zgjidhët?

Nuk ishte hera e parë që përbollonte vështirësi. Në javët e para të ardhjes në Gurraj kishte hasur shumë pengesa e mungesa. Por ato ishin të një natyre tjetër. Ato vinin një nga një e kapërceheshin përsëri një nga nië. «Në atë kohë unë isha si zogu në fluturimet e para e në largësi të vogla, — mendoi. — Krahët i kisha të pastërvitura, po rrëth e rrotull kishte pemë të shumta, ku mund të qëndroja, sa herë më merreshin mendtë. Tani krahët i kam me të vërtetë më të fortë. Po a mund të fluturoj aq lart, sa më kërkohet? Në fazën e parë të ndërtimit të kantierit, vështirësitë vinin shkallë-shkallë. Dhe gëzimi që ndjeja përfitoren e parë më iepët forca të reja, që të hidhesha në sulm përfitoren tjetër... Ndërsa tani ka ardhur çasti vendimtar. Është punë e lehtë që t'i shkruajmë ministrisë se oxhakun do ta ndërtojmë me mjetet që kemi në dorë. Po sikur të mos arrijmë ta realizojmë? Sikur të pësojmë një katastrofë? Ç'bëhet pastaj?! Unë habitem nga ndonjëherë me vendosmërinë e Sefedinit. «Atë që s'e kanë bërë të tjerët, do ta bëjmë ne» — i tha dje me inat inxhinier Sahitit. Tani as unë nuk

e di ku bazohet ai kur flet kështu. Sigurisht ai nuk mund t'i bëjë ato përllogaritje që bën Sahiti. Po gjithë ajo përvojë e madhe në ndërtim, si nuk e bën që të jetë më i matur, më i përbajtur? S'e di. Këtu është thelbi. Këtu qëndron sekreti. Po të pësojmë ndonjë fatkeqësi, përgjegjësia kryesore do të bjerë mbi shpatullat e mia. «Sefedini është zbatues i mrekullueshëm, — do të më thonë, — por për studimin e çështjes së oxhakut je ngarkuar ti». Nuk mund t'u them se studimin e kësaj çështjeje e kam bërë së bashku me inxhinierët e tjerë të ndërmarrjes. «Ti je violina e parë në këtë ndërmarrje, — do të më thonë. — Ende s'e ke kuptuar këtë gjë të thjeshtë?» Po q'duhet bërë atëhere?

Meqë s'mund të gjente një zgjidhje, hoqi çizmen nga këmba e djathtë, u ngrit në këmbë dhe bariti poshtë e lart në barrakë për t'u lehtesar. Pastaj ju afroa tavolinës dhe hapi disa projekte si çarçafe të mëdha. Sa herë i kishte kaluar nga dora këto projekte gjatë këtyre ditëve të fundit! Mbi një letër të bardhë bëri disa përllogaritje me laps. «Përsëri aty del, — belbëzoi. S'ka shaka në matematikë. Dhe shkenca s'merrret me yrysh...» I nervozuar siç ishte, hapi sirtarin me forcë për të futur projektet. Nga krisma e fortë e sirtarit usta Jorgji çeli sytë përgjysmë.

- Sa është ora? — pyeti si për gjumësh.
- Mesnata ka kaluar, — ju përgjegj inxhinieri.
- Je në vete, Andrea? — i tha ustai duke u ngritur përgjysmë. — Hala s'ke rënë për të fjetur?
- Kisha një punë të ngutshme, usta.
- Do të marrësh veten më qafë me këto kartëra, or djalë! More vesh?
- Ti e di edhe vetë, usta, se pa projekte s'ka ndërtim.
- Mirë, or djalë, mirë, po jo në këtë orë.
- Ç'të bësh?
- Ç'të bësh? Dëgjomë mua tanë: ti e di se unë kam punuar një jetë të tërë në ndërtim. Në punë të lehta e të vështira. Në dimër e në behar. Në shi e në diell. More vesh? Por kam patur një rregull, ama. Ditën punë e natën gjumë...

— Qysh nesër kështu do të bëj edhe unë, usta,
— i tha si me të qeshur inxhinier Andrea.

— Hajde menjëherë e shtriu në dyshek, përndryshe do të ngrihem vetë që të shuaj dritën. More vesh?

Inxhinier Andrea fiku dritën dhe ra për të fjetur. I pëlqente ai ton si i ashpër i usta Jorgjit, se i kujtonte të jatin, që bënte sikur u bërtiste fëmijëve, pa u zemëruar kurrë...

Në barrakë ra përsëri një qetësi e thellë. Inxhinier Andrea rri i shtrirë në shtrat me sy të hapur. Gjumi nuk i zë kollaj shpirrat e shqetësuar. I kujtohen vitet e rinisë së parë, kur èndërronte të merrte pjesë në ndërtim veprash të mëdha, veprash kolosale. Dhe padashur buzëqesh me naivitet. Filloi të mendohet: «Vërtet që èndrrat e mia të rinisë po bëhen realitet. Se vepra të tilla të mëdha, si uzina kimike e Gurrajt, janë shumë më të mëdha se ato që paraftyroja atëhere në fantazinë e shfrenuar të rinisë së parë... Suhiti kishte nxjerrë disa shifra interesante, që nuk arriti t'i thoshte në mbledhjen e djeshme të këshillit teknik, se e ndërpree Sefedini. Uzina në fakt përbëhet nga dyzet objekte. Vëllimi i dheut që èshtë gërmuar dhe do të gërmohet èshtë baras me dheun që gërmohet përhapjen e themeleve të 896 godinave me njëzet e katër apartamente secila. Rrugët e brendshme të uzinës janë disa kilometra të gjata. Vetëm materiali hekur që do të përdoret këtu, do të mjaftonte për të shtruar një rruge hekurudhore mbi pesëdhjetë kilometra të gjatë. E di ç'do të thotë kjo?.. Dhe kush i mban mend tanë shifrat e tjera që ky djalë i palodhur në punë studimesh ka nxjerrë nga përllogaritjet që ka bërë. Këto shifra janë me të vërtetë térheqëse. Por kur janë objekt studimi e jo realizimi. Edhe mua do të më pëlqente të nxirrja përmasat e një vepre të mbaruar e të bëja krahasime interesante. Mirëpo tanë puna èshtë ndryshe; jo t'i marrësh këto shifra nga realiteti e t'i hedhësh në letër, por t'i marrësh nga letra e t'i vësh në jetë. Këtu èshtë thelbi... Vështirësia për mua ndoshta rrjedh edhe përnjë arësyte tjetër. Para se të viajë në Gurraj, isha më

tepér një spektator i jetës, që e vështroja nga dritaret e drejtorisë së projektit. Tani kam hipur në skenën e jetës, që të luaj vetë një rol jo të vogël. Po a do të jem në gjendje?»

Befas dera e barrakës u hap pa zhurmë. Në errësirë u duk një si hije që ecte duke shkelur lehtë në majë të gishtave.

- Ti je, Kolë? — pyeti me zë të ulët inxhinieri.
- Unë jam, Andrea. Hala s'ke fjetur ti?
- Kam fjetur pak, — e gënjeu inxhinieri.
- Mos të zgjova gjëkafshë unë?
- Jo, bre, ka qëkur që më ka dalë gjumi.
- Fli tani, është shumë vonë. Ora është tre e ca.
- E di. Po ju si dolët andej?
- Ne? Mirë, nuk dolëm keq.
- Domethënë puna ka ecur normalisht?
- Revan!
- S'keni patur vështirësi, pengesa?
- Pengesa? Sa të duash. Po ne pse ishim atje?

Një brigadë komplekse, një ushtri e tërë.

Kola hoqi çizmet e baltosura dhe shtoi:

— S'ka gjë që s'bëhet Andrea! Mjafton të jesh i vendosur. Po, për ndër!

Inxhinier Andrea, si ai që ka mizën nën kësulë, këto fjalë i mori si një thumb, që i drejtohej atij dhe heshti. Por Kola as që kishte ndër mend ta thumbonte inxhinierin dhe pas pak i tha me përzemërsinë e tij të zakonshme.

— Vetëm një gjë, Andrea: duhen vënë disa llamba tē tjera pesëqind qirinjshe, që tē bëhet gjithë vendi ditë.

— Llamba the? Punë që bëhet kjo. I themi nesër Gjetës. Po pa dale njëherë. Gjetën sikur e kemi dërguar për elektrifikimin e fshatit.

— Mos e hiq Gjetën inxhinier. Të marrë fund puna e fshatit që tē shohi edhe ata pak drithë.

— Jo, jo, nuk e heq. Ata kanë edhe ndonjë javë punë për ta çuar dritën gjer në lagjen më të largët. Do të dërgoj një elektricist tjetër nga ata tē banesave.

— Po të bëhet edhe kjo, mund të fillohet menjëherë puna me turne me të gjitha forcat. Po, për nder! ..

— Dale, bre! Të shohim përfundimet. Të kthehet edhe Sefedini një herë... .

— Erdhi Sefedini, — tha Kola.

— Si erdhi Sefedini! — u habit inxhinieri. — S'është e mundur... .

— Erdhi të them. Atje e kishim gjer tanı... .

— Habitem. Ai ka pasur nënën të sëmurë.

— E di, e di. Nuk u nis mbrëmë ai me Postolin? Natën arriti në shtëpi. Nënën e gjeti më mirë dhe pasdite mori përsëri rrugën për në kantier. Aty nga ora dymbëdhjetë e shohim ne në uzinë! Ç'është e vërteta, edhe ne u habitëm kur e pamë... .

— Po ç'tha për nënën?

— U bë më mirë, — tha, — e kaloi dhe këtë radhë.

— Interesant!

— Janë të forta malësoret, Andrea. Po, për nder! Unë shoh nënën time, që i ka kaluar të tetdhjetat e gjene mbahet mirë.

Inxhinieri ra në mendime e nuk foli më. Biseda me Kolën sikur e kishte lehtësuar ca.

— A nuk flemë tanı, Andrea? — i tha Kola.

— Kohë pér gjumë është, — ju përgjegj inxhinieri me zë të ulët që mezi dëgjohej.

Mbas pak në barrakë u dëgjua një gërhitje e lehtë. Kolën e kishte zënë gjumi menjëherë.

«Nieri i mrekullueshëm! — tha me vete inxhinier Andrea. Unë i mora për thumba në fillim fjalët e tij, po e kisha gabim... Po Sefedini, si u kthyte aq shpejt? Nga sa thonë ata që e njohin prej kohe, ai kësh-tu bën gjithnjë. Por tanı kishte një arësyte të fortë që të rrinte ca më shumë në shtëpi. Ç'e bëri që të kthe-hej menjëherë? Pa dale! Mos është kthyer kaq shpejt, mbasi s'ka më besim tek unë? Si më vështroi në çastin që do të nisej për në shtëpi! Bile u mat një herë të më thoshte diçka, por në çastin e fundit u përbajt e nuk foli. Ç'do të më thoshte vallë, po të kishte folur? Do të më qortonte? S'prish punë?! Mirë thotë usta

Jorgji, se të bërtiturat e Sefedinit janë si përkëdhelje. Ai, meqë s'di të përkëdhelë, të bërtet... Po të kishte folur në atë çast, ndoshta do të më kishte thënë: «Ti, inxhinier, nuk je më në binarë. Prandaj mblidhu. Kjo ka rëndësi». Por ai heshti, u nis për në fshat dhe u kthyen menjëherë. S'më zë besë më. Kjo është për mua më e rëndë nga njëmijë fjala të ashpra. Oh! sa turp më vjen tani!»

Andrea mbuloi fytyrën me shuplakat e djersitura nga shqetësimi që e mundonte...

6

Dielli i dimrit perëndoi shumë shpejt. Pak nga pak errësira e natës mbuloi çdo gjë: fushën, kodrat dhe malin e lartë të mbuluar me borë... Vetëm kantierin nuk e bëri dot zap muzgu i murrmë. Shkëlqimi i fortë i llambave të mëdha elektrike, që ishin vendosur atë ditë në gjithë territorin, ku ndërtohej uzina, e kthyen këtë vend në një ishull drite, në mes të detit të errët të natës.

Puna e turnit të dytë kishte filluar nga dy orë më parë në gjithë frontin e punës. Dhe ai nga çasti në çast po merrte një vrull gjithnjë më të madh.

Inxhinier Andrea nuk ndjente më atë lodhje dhe rraskapitje që kishte provuar në orët e para të mën-gjezit. Kjo mund të duket e quditshme, sepse njeriu, në kushte normale, është më i freskët në mëngjez dhe më i lodhur pasdite. Mirëpo me inxhinierin ndodhë tani diçka e veçantë. Tensioni i punës në turnin e dytë e kishte bërë për vete dhe e kishte lehtësuar nga një peshë e rëndë, që e dërmote orë e çast gjatë ditëve të fundit. Ai rendte nga sektori në sektor e nga reparti në repartitë atë uzinë vigane ku të duhej një orë rrugë më këmbë, që të përshkoje të gjitha repartet dhe anekset e saj.

Atë tanë e shqetësonte mbi të gjitha një gjë: në disa reparte punohej për ndërtim; ndërsa në disa sektorë për prishje e ndryshime themelesh e muresh. Kitështë frikë se mos ngatërrroheshin forcat dhe materialet;

se mos përdorej ndonjë material tjetër për tjetër dhe jo sipas parashikimit e sipas projektit dhe prishej kësh-
tu cilësia. Kontrollonte me kujdes gjithshka dhe jepte
udhëzime e sqarime. Po e vërteta ishte që nuk shikonte
gjëkundi ndonjë çregullim. Organizimi i punës nëpër
repartet e sektorët e ndryshëm i ngjante një maqine të
madhe e të komplikuar me shumë pjesë dhe aparate.
Dukej që marshet, që vinin në lëvizje të gjitha këto
mekanizma mbaheshin nga një dorë e fortë dhe e
sigurtë. Ju kujtua Sefedini. «Vërtet, — tha me vete, —
ku do të jetë Sefedini tan? Ai do të ketë vajtur andej
nga korpusi kryesor», dhe u drejtua nga qendra.

Korpusi kryesor po merrte gjithnjë e më shumë
formë. Në mes të reparteve e të anekseve të shumta
të uzinës, që ndërtoheshin përreth, ai dukej si gjoksi
i fuqishëm i një organizmi të gjallë. Inxhinier Andrea
hipi në skelat e korupsit kryesor. Mbi kapriatat meta-
like lëviznin me shkathtësi montatorët, si xhonglerë
të një cirku të çuditshëm. Dritat e ngjyrshme dhe
xixat e panumërtë që lëshonin saldatriçet atje lart
mbi kapriatat, kur i shikoje për herë të parë, të duke-
shin si fishekzarre të një festë fantastike.

Inxhinier Andrea qëndron mbi një skelë dhe vë-
shtron poshtë. Nga të gjitha anët ngrihen shtylla,
mure, plinta dhe skela. Një buldozer shtyn me kraharorin e
tij të çelniktë prigje të mëdha dherash. Betonierat pu-
nojnë pa pushim; zhurma e tyre mbizotëron në këtë
simfoni shurdhues, ashtu si mbizotëron gërneta në një
orkestër të muzikës populllore. Ato bluanë me grykësi
betonin që dredhet si lumë për ngritjen e soletave, të
mureve e të bazamenteve. Dy vinça të mëdhenj ngrenë
lart plinta të rënda e shtylla të stërgjata betoni, për
t'i ulur pastaj dalëngadalë në vendin e caktuar. Atje i pre-
sin krahe të stërvitur, që i vendosin mbi bazamente të forta.
Në këtë punë çdo gjë duhet drejtuar me saktësi e mje-
shtëri...

Në ato reparte, ku bëheshin ndryshime dhe modifi-
kime, sipas projektit të ri, dukeshin shtylla të rrë-
zuara dhe themele të hapura rishtas. Vende-vende mbi

themelet e thella dalloheshin koka e shpatulla nje-rezish, që dukeshin për një çast e zhdukeshin përsëri, sikur i përpinin hendeqet, që kryqëzoheshin si vija të një vizatimi të ngatërruar...

Inxhinier Andrea ngeli për një kohë pa lëvizur mbi skelën e lartë, duke vështruar me èndje ato mizëri shtyllash e kolonash prej ferrobetoni, soletat ende të pa-përfunduara dhe skeletet e çelikta të pambuluara. Për një çast ju duk sikur s'kishte përpara tij një uzinë të madhe në ndërtim, por një qytet antik, që sapo qe zbuluar nga një ekspeditë e madhe arkeologjike. Por ky mirazh u zhduk menjëherë. Ai kushedi sa herë i kishte studjuar dhe i kishte i zbërthyer projektet e ndërtimit të uzinës kimike, që mbushnin një dollap të madh. Kur zhytej për orë të tëra mbi këto projekte, nuk shihte vetëm vija kat-rore e trekëndësha, por reparte të mëdha të përfunduara e të ndriçuara për bukurin, maqineri të montuarë mbi bazamenti të forta dhe një oxhak gjigant, prej nga dilnin pa pushim fjolla tymi të murrmë, që humbisnin në qiellin e kaltër. Edhe në këtë çast i doli përpara syve uzina e përfunduar. Bile ju duk sikur dëgjoi edhe zhurmën e maqinerive, që ishin venë në lëvizje. «Kjo është poezia e inxhinierit» — mendoi dhe vuri buzën në gaz.

— Inxhinier Andrea! — dëgjoi një zë të fortë nga prapa.

U kthye menjëherë dhe pa Lleshin, që e thërriste me zë të lartë, që të dëgjonte në këtë zhurmë shurdhuese maqinash e mekanizmash nga më të ndryshmet.

— C'është? — ju përgjegj ai.

— Të kërkon Fatmiri. Të pret atje në repartin e përpunimit të lëndës të parë. Eja shpejt!

— Ka ndodhur ndonjë gjë?

— Jo, po nuk mund ta zbërthejë projektin e sallës së bluarjes së lëndës së parë.

— Nuk është atje Sahiti?

— Është, po se ç'ka një shtesë me laps, që e ke bërë ti me dorën tënde për disa materjale që na mungojnë.

Inxhinier Andrea zbriti me shpejtësi nga skela dhe u drejtua nga reparti i përpunimit të lëndës së parë.

Duke kaluar me hapa të shpejtë nëpër labirinthin e shtyllave, të mureve dhe të hendeqeve, ai pa Kolën, që me lëvizje të duarve drejtonte punë për vendosjen e plintave.

— Punë të mbarë, Kolë! — e përshëndeti prej së largu.

— Mbarë paç! — ju përgjegj Kola, pa kthyer kokën nga ai.

Inxhinieri nuk u habit aspak nga ky qëndrim i Kolës. E dinte mirë që Kola në atë çast ishte si dirigjent i një orkestre. Kur i vajti më pranë, ai pa se në ftyrën e Kolës shkëlqenin bulëza djerse, megjithëse që një natë e ftohtë dimri. Bulëzat e djersës i rrëshqisnin si rrëke drejt qafës.

Sahiti me Fatmirin kishin hapur një projekt mbi një arkë të madhe bosh dhe nuk e vunë re fare Andrenë, që u kishte vajtur pranë. Në atë çast brofi nga ana tjetër Sefedini.

— Andej nga reparti i prodhimit të gatshëm nuk do të na mjaftojnë plinat, — tha me një zë të vrazhdë.

Fatmiri e vështroi një herë si me habi dhe nuk i tha gjë.

— Ç'më vështron kështu, Fatmir? — foli ai për së dyti. — Hesapin nuk e kemi bërë mirë.

— Dale, or jahu. Ne kemi dërguar maquina në bazë për të ngarkuar plinta të tjera, — ju përgjegj me të qetë Fatmiri.

— Me dy maquina që ke dërguár ti, s'kemi gjë. Duhen edhe dy-tri maquina të tjera. Kjo ka rëndësi.

— Të dërgojmë maquina të tjera.

— Ku t'i gjesh pa, në këtë orë? ! Është atje pranë mullirit të granilit një kamion, por nuk e di ku është shoferi.

— Është zisi i Prokopit, — u hodh e tha Lleshi.

— Po Prokopi ku është?

— Qëpari flinte aty në kabinë.

— Flinte? — ngriti zërin me inat Sefedini. —

Gjeti kohë për të fjetur i uruari. Mirë, mirë, e rregulloj unë tani...

— Gjynah, o Sefedin! — ndërhyri me të butë Lleshi. — Lëre Prokopin të flejë ndonjë orë. Se ka dy net pa vënë gjumë në sy...

— Ore, je në vete ti? Neve na vjen festja vërdallë, kurse ky më përrallis. Hidhi shpejt një kovë me ujë të ftohtë në fytyrë. Nesër le të flejë sa t'i dalë gjumi nga hunda...

— Ta shikoje Prokopin, o Sefedin, se si i qenë skuqur sytë, — ndërhyri tani Fatmiri.

— Ohu, edhe ti Fatmir!..

— E di si të bëjmë? — propozoi inxhinier Andrea.

— Lëreni Prokopin të flejë. Sa për të ngarë maqinën marrim Postolin.

— Mirë, po ku është Postoli?

— Atje te çezma. Po lan gazin.

— Ekstra fare, — tha Fatmiri, duke qeshur. —

Për Prokopin do të jetë mrekulli. Do të nanuriset në maqinë duke vajtur e duke u kthyer nga baza, si ndonjë fëmijë në djep.

Postoli, kur hipi në maqinën e Prokopit, provoi një herë marshet dhe tha:

— Sa shumë është nxehur kjo maqinë!

— S'do mend, — i tha Fatmiri. — Ka dy ditë që s'ka pushuar thuajse fare. Kam frikë se do t'i shkrijnë hekurat...

Ndërsa Sefedini po merrej me problemin e furnizimit me plinta e shtylla nga baza materialeve të parafabrikuara, inxhinier Andrea përpinqej të zbérthente projektin që kishte një shtesë të bërë me dorën e tij. Kur dhe pse e kishte bërë këtë shtesë?

— Mos e ke bërë atë natë që u ktheve nga Tirana me projektet e reja? — e pyeti Sahiti.

Ju kujtua menjëherë. Për një pjesë materialesh që nuk do të vinin më nga jashtë, ai kishte bërë disa shënimë për zëvendësimin e tyre me materjale të tjera, qysh atë natë në Ministrinë e Ndërtimit.

Por pastaj i kish harruar. Se atëhere ishte aq i tru-

llosur nga ndryshimet që pësonin projektet e uzinës! E keqja ishte se edhe disa materjale të tjera, që ai i kishte shënuar në projekt, nuk i kishin në magazinë. Si do të bënин?

Vështroi një herë orën dhe mblodhi buzët.

— Do shumë akoma që të mbarojë turni? — pyeti Sahiti.

— Edhe ndonjë gjysmë ore, — ju përgjegj Andrea.

— Sonte ka mbarim pune e jo mbarin turni, — u tha Fatmiri. — Se s'mund ta lëmë punën e filluar në mes...

Inxhinier Andrea nuk foli. Bariti dy-tri herë poshtë e lart dhë pastaj u nis përsëri për në korpusin kryesor. Atje duhej të kishte vëmendjen më shumë se në çdo sektor tjetër. Kaloi edhe një herë nga brigada dhe hipi përsëri në skelën e lartë të korpusit kryesor. Dritat e një kolone maqinash u kthyen nga xhadeja e madhe dhe u futën në territorin e uzinës. Tani dritat e tyre nuk ndriçonin më si më parë, kur qenë nisur. Nga lindja po zbardhëllente; errësira e natës po tretej dalëngadalë. Në qìell yjet nuk xixëllonin më si thëngjij të ndezur, por si një prush i mbuluar me në shtresë të holle hiri, që bëhej gjithnjë më e trashë...

Maqinat u ndalën para shtyllave të sallës së madhe për prodhimet e gatshme. Meqë pushoi zhurma e mororit, Prokopit i doli gjumi dhe vështroi si i pataksur:

— Ku jemi këtu? Ej, ti, shok! C'kérkon ti në maqinën time? — tha i përgjumur.

— Fli Prokop! Fli vogëlush! Tani të çoj unë në shtëpi te nëna, — i tha me seriozitet të shtirur Postoli.

— Si the, ore? — pyeti një herë ai me inat dhe u hodh në këmbë. Prokopi, kur mori vesh se si ishte puna qeshi më shumë se të tjerët...

Kur puna mori fund dhe brigadat u nisën për në qytet, inxhinier Andrea vështroi edhe një herë uzinën në ndërtim, e krahasoi me ditën e mëparshmë dhe tha me vete: «Kur puna kryhet me një hov të tillë, bien poshtë të gjitha kalkulimet që njeriu bën me normat e zakonshme të ndërtimit që gjenden nëpër libra. Siç du-

ket paska edhe një aritmetikë tjetër, së cilës unë ende nuk i kam zbuluar sekretet...»

Në bunkerin e madh të lëndës së parë atë ditë do të hidhjej soleti. Koha mbante për mrekulli. Punëtorët e brigadave që do të merrnin pjesë në këtë punë kishin ardhur me kohë. Megjithatë ata nuk filluan nga puna në orën e caktuar...

Inxhinier Andrea shkon poshtë e lart në oborrin e gjerë të uzinës në mes të togjeve të mëdha të zhavorrit e të rërës. Ai e ka zakon të shëtisë në vetmi kur i duhet të marrë ndonjë vendim me rëndësi. Por tanë i lëdh hapat me nxitim dhe kokën e mban të ulur. Është më se e qartë se është në skilet të madh...

Në një çast ngre pak kokën dhe vështron lart nga ana e skelave të ndërtimit. Atje duket Fatmiri, që, si një sogjetar në mazgallat e një kalaje, vështron gjithnjë nga ana e xhades. Fatmiri e kap shikimin e inxhinierit dhe i bën shenjë me dorë, sikur do t'i thotë: «Ende nuk duken».

Inxhinieri mbledh një herë buzët me nervozizëm dhe qëndron për një hop në vend. Po të kishte ndonjë njeri aty pranë do t'i thoshte: «E shikon? Në historinë e ndërtimit nuk besoj të ketë ndonjë rast tjetër, që të jenë ndërmarrë vepra kaq të mëdha në kunditët aq të vështira».

Ju kujtua takimi me inxhinjerët dhe teknikët e zbatimit një ditë më parë. Teknikët e kishin parë projektin e bunkerit dhe kërkonin sqarime. Ai, pasi u shpjegoi mirë e qartë çdo gjë, u tha me ton të prerë:

— Asnjë shhangje nga projekt. Puna është delikate dhe me përgjegjësi. Vepra të tillë ndërtohen të paktën për një shekull...

— Si t'ja bëjmë hallit që s'kemi hekur ashtu siç e kërkon projekt — tha me gjysmë zë Fatmiri.

— Atë s'e di unë.

— Si s'ka hekur? — tha një teknik i ri aty nga fundi.

— Ja që s'ka, or shok. Nuk na ka ardhur — ju përgjegj shkurt Fatmiri.

Asnjë tjetër nuk foli. Takimi kishte marrë fund por njerëzit nuk dilnin. Inxhinier Sahiti u përkul pak dhe i tha në vesh Andresë.

— C'është kjo përsëri?

— Nuk e dëgjon?

— Bisedo një herë me Sefedinin.

— Ç'të bëjë edhe Sefedini, or vëlla? Se mos e ka hekurin në magazinë dhe e kursen! Lere pastaj që Sefedini ka dy-tri ditë që rropatet poshtë e lart me shëfin e furnizimit për sigurimin e disa materialeve.

Inxhinier Andrea solli ndërmend edhe diçka tjetër. Projektet e zbatimit, që hartonte ai, Sefedini i aprovonte zakonisht pa ndonjë vërejtje. Ndërsa kohët e fundit i shqyrtonte me imtësi dhe jo rrallë i shënonte me shkronja të trasha, të shkruara me laps: «Ky konstruksion të bëhet me materjal vendi». «Në këtë objekt të përdoret vetëm çimento nga ajo e Vlorës».

Në atë çast u dëgjua nga lart zëri i Fatmirit:

— Po vijnë, inxhinier, po vijnë!

Tre kamiona të vjetër qëndruan njeri pas tjetrit në mes të oborrit të madh. Nga kabina e kamionit të parë zbriti Sefedini. Ai i pëershëndeti me dorë ata që ishin aty pranë dhe bëri që të ngjitej lart mbi skelat. Te shkalla e drunjë u takua me Fatmirin.

— S'bëmë gjë, o Fatmir. S'gjetëm as në Durrës dhe u kthyem duarbosh.

Në skelen e lartë u mblohdhën punëtorët. Kur u ngjit atje dhe inxhinier Andrea, dëgjoi Sefedinin që u thoshte:

— Pse, s'e di unë që jemi në hall të madh? Edhe këtë e di që ju s'mund të bëheni hekur, ashtu si tha Nekiu. Por do t'ja gjejmë çarenë edhe kësaj pune. Tani forcat e këtushme të kalojnë në ndonjë sektor tjetër. Të mos humbasim kohën kot. Kjo ka rëndësi...

— Ndërkohë ne do të bëjmë ç'mos që t'i sigurojmë

materialet që na mungojnë — ndërhyri shefi i furnizimit që rrinte pranë Sefedinit.

— E di si them unë? — e mori fjalën Fatmiri. — Kjo punë që thotë Qakua mund të shkojë gjatë. Që pari rrija këtu duke pritur dhe thosha me vete: Sikur të bëjmë një projekt tjetër, më të thjeshtë, për këtë bunker, duke përdorur hekurin që kemi në magazinë?

— A mund të bëhet kjo?

Sytë e të gjithëve u kthyen nga inxhinier Andrea, që kishte zënë vend mbi një grumbull tullash. Ai u mat një herë që t'i përgjigjej shkurt e prerë: «Kjo që thoni ju s'mund të bëhet. Këto janë gjëra të kalkuluara kush e di sa herë nga specialistë të zotë...». Por sytë e tyre flisnin aq shumë në atë çast! Ai e kuptoi me një herë se ky takim këtu në skelat e ndërtimit ishte takimi vendimtar dhe jo si ai i djeshmi që kish organizuar ai me pak njerëz në zyrën e vogël të Fatmirit. U menjua për një hop dhe u tha:

— Ta mendojmë njëherë, or shokë! Kushedi, mbase edhe bëhet...

— Hë të lumtë, Andrea! — S'u përbajt pa thënë Kola.

— Ja që po çahet rruga — tha Fatmiri. — Në dy drejtime, bilë. Ata të furnizimit do të përpilen për të siguruar materialet. Inxhinierët tanë do t'i bien lapsit. Apo jo? — përfundoi ai duke u kthyer nga Andrea. Inxhinieri tundi pak kokën sikur deshi të shprehte edhe dyshim edhe një farë shprese.

— Tani ku do të shkojnë këto brigada, Fatmir? — pyeti Sefedini.

— Front pune kemi andej nga bazamenti i kalla-jave. Po nuk e di a do të na mjaftojnë traversat e hekurit.

— Po të mos na majftojnë do të heqim ato të rrugës së dekovilit për në gurore.

— Po kur të kemi nevojë për gurë me se do ta transportojmë? — pyeti një punëtor i ri.

— Gurët? — ngriti zërin Sefedini. — Me krahët tonë, po të jetë nevoja. Pse habitesh, or djalë? Puna

është që të mos ndërpritet hovi i punës as edhe një minutë. Kjo ka rëndësi.

Punëtorët zbritën nga skelat për në frontin e ri të ndërtimit. Kola u kallzonte disa të rinjve me zë të lartë:

— E di ç'na ka ndodhur një herë në Selitë të Dajtit? Ngelëm për disa ditë pa gozhda... Po për nder. Pa gozhda! Ku kishim ne aso kohe ato gjëra, që kemi sot? Dhe mbeteshim në baltë për një hiç, që i thonë fjalës. Po e lenë punëtorët punën pa e kryer? Jo, ore, jo! Mbaj mend se na duhej të përfundonim me ngutje armaturën në një galeri anësore. Si t'ja bënim? «Zbulova një magazinë me gozhda» — na tha një karpentier i vjetër. «Ku, ore?» i thamë ne. «Ja ku e kemi» na u përgjegj ai duke na treguar një barakë të vjetër, që e kishte ndërtuar një shoqëri italiane pranë një guroreje. — Ne e kuptuam ku e kishte fjalën karpentieri i moshuar dhe i ramë barakës së vjetër aty për aty. Që ju kam llafin, or djema, duke prishur barakën, nxirrinim gozhda. i drejtonim mirë e mirë dhe i dërgonim atje në frontin e galerisë, ku punonin karpentierët. Po për nder. Ehu! Sa hendeqe të tilla kemi kapërcyer!...

8

Pamvarësish nga këto vështirësi Sefedini ishte i mendimit të mblidhni kolektivin e të merrnin një zotim të guximshëm: sipas këtij zotimi afati përfundimtar i dorëzimit të uzinës nuk do të pësonte as shptytjen më të vogël, «as edhe një sekondë», siç thoshtë vetë.

Këtë mendim Sefedini ja tha edhe Andresë një ditë të shtunë në mëngjez. Ai hyri në zyrën e kryeinixhierit pa trkitur te dera. Ndoshta kishte ndërmend të bënte një bisedë të gjatë me të. Por, kur pa rreth tavolinës Burhanin dhe Sahitin, sikur ndërroi mendim dhe pyeti sa për të kaluar radhën:

— E, si shkon puna?

Të dy inxhinierët e rinj u ngritën nga vendi në shenjë respekti.

— Doje gjë? — e pyeti inxhinier Andrea, pa lëvizur fare.

— Mbaroni një herë punën.

— Kjo puna jonë është me valë të gjata...

Sefedini, duke bërë poshtë e lart në zyrën e vogël, u shpjegoi me pak fjalë mendimin e tij.

— Kjo që thua ti, Sefedin, është një gjë e para-kohshme, — tha prerazi Andrea.

— Pse? — ngriti zërin Sefedini duke qëndruar në vend.

— Sepse ende nuk e kemi vënë punën në vijë. Ende nuk dimë me saktësi sa punë e sa kohë do të na nevojitet që të bëjmë ndryshimet sipas projektit të ri dhe çngatërresa e ç'mungesa materialesh do të na dalin. Ohu, ka avaze kjo punë. Pastaj, mos harro punën e oxhakut, që s'dimë nga ta fillojmö.

Inxhinier Andrea vazhdoi të radhitte argumenta pas argumentash për të mbrojtur mendimin e tij. Sefedini kishte mbështetur trupin në mur dhe e vështronë me bisht të syrit. Burhani me Sahitin shikonin njëri-tjetrin dhe prisnin nga çasti në çast të shpërthente ndonjë grindje e madhe midis të dy drejtuesve kryesorë të ndërmarrjes, siç kishte ndodhur shumë herë.

— Mbarove? — i tha Sefedini me një buzëqeshje të hidhur.

— S'të majftojnë këto që thashë?

— Dëgjo, atëhere. Ti thua se duhet të presim që të shohim sa punë e sa kohë do të na nevojitet të kryejmë ndryshimet sipas projektit të ri. Kurse unë e shoh që tanë se si do të shkojë puna e ndryshimeve. Më kupton? Kjo ka rëndësi... Nëse ti nuk e sheh këtë gjë, hapi sytë mirë... — dhe qëndroi pa e përfunduar frazën. Pastaj u hodhi një shikim të treve me radhë dhe doli nga zyra, duke mbyllur derën me forcë.

Burhani dhe Sahiti u habitën që Sefedini nuk nguli këmbë të bëhej e tija, ashtu siç vepronë za-

konisht. Por më shumë nga ata u habit inxhinier Andrea. Sapo u mbyll dera e zyrës, ai zuri ballin me dorën e majtë dhe qëndroi për një kohë të gjatë i heshtur dhe i menduar. «Unë prisja që ai të zemërohej me mua e të bërtiste, — thoshte me vete. — Do të ishte më mirë të kishte ndodhur kështu. Se grindjet tonë të mëparshme tregonin se na ndante diçka për një çast, por na bashkonin fort njëmijë gjëra të tjera. Ndërsa tanë hendeku që është hapur midis nesh është më i thellë se çdo herë tjetër. Sepse na ndan një gjë e madhe. Dhe kjo s'mund të zgjidhet me disa të bërtitura e me disa fjalë të ashpra të thëna sa për të nxjerrë dufin. Po si mund të zgjidhet atëhere?..»

Ditët e fundit Sefedini mbante një qëndrim tjetër kundrejt tij. Në bisedat e tyre nuk ndihej më përzemërsia dhe afrimi i mëparshëm. Sefedini bisedonte me të vetëm për çështje pune, dhe po të shihte se pikëpamjet e tyre nuk përputhesin, ai i binte shkurt ose e linte bisedën në mes dhe largohej. Ashtu siç kishte bërë edhe tani..

Ajo që e preokuptonte më shumë Andrenë, ishte çështja se edhe shokët e tjerë të kantierit, si Fatmiri, Baftjari, Kola, sikur e vështronin tanë me një sy tjetër. Vetëm usta Jorgji i fliste me po atë përzemërsi si edhe më parë... Ky qëndrim i shokëve të vjetër të kantierit, me të cilët ishte lidhur aq ngushtë, e shqetësonte shumë, aq sa natën i dilte ngandonjéherë gjuimi dhe pyeste veten: «Përse po largohen nga unë shokët e mi më të mirë?.. Do të ishte mirë të bisedoja një herë me ta. Po sikur ata të më thonë: «Nuk jemi ne që largohemi po ti; po, je ti që shkëputesh nga ne» si tu përgjigjesh? S'e di. S'mund të them asgjë me siguri. Dhe as që mund t'i gjej një zgjidhje të shpejtë e të saktë kësaj pune. Se këtu nuk shtrohet çështja nëse unë ndahem apo nuk ndahem nga këta shokë të mirë, që më kanë hyrë në zëmër; as që e kam fjalën përfatim tim si inxhinier, po nëse do ta çojmë gjer në fund punën që kemi marrë përsipër, apo do të

dështojmë me turp duke mbajtur mbi supe një përgjegjësi të rëndë përpara gjithë vendit...»

Mbrëmjeve e ndjente gjithnjë më rëndë veçimin e tij nga shokët e nga miqtë. Një natë më parë, kur po ktheheshin nga uzina, ai u mat një herë t'i afrohej Sefedinit dhe t'i thoshte: «Dëgjo, Sefedin. Mos mendo se unë kam ndryshuar. Të siguroj se jam ai i mëparshmi. Në qoftë se ngurroj t'i hedh hapat ashtu siç i hedh ti, e di përsë e bëj? Sepse më duket se ti ecën me shpejtësi të madhe dhe pa marrë parasysh gropat dhe hendeqet që na dalin përpara. Po duke ecur kështu, ka rrezik që të rrëzohesh, vëlla. Mban mend ç'më ke thënë natën e Vtitit të ri kur kërcyem së bashku? «Ashtu të më mbash edhe ti në punë, që të mos rrëzohem. Se po të rrëzohem unë, të tërheq edhe ty pas...» Është punë me përgjegjësi të madhe ajo që na kërkohet, vëlla, nuk është shaka. Pa mendo një herë sikur të dështojmë! C'bëhet pastaj?..» Por e parandjente se s'do t'ja mbushte dot mendjen Sefedinit dhe nuk i tha gjë.

Ai në atë çast s'e dinte që edhe Sefedini nga ana e tij kishte menduar një herë ta thërriste e t'i thoshte: «Eja këtu, inxhinier. Hajde të bisedojmë një herë shtruar. Ç'ke? Zbraze një herë barkun nga ato dyshime që të hanë nga brenda si krimba. Vetëm kështu mund ta kapërcesh lumin. E di si bëjnë fshatarët kur duan të kalojnë një lumë të fryrë e të turbull, si këtë lumë që kemi për të kapërcyer ne tanë? Kapen fort me njëri-tjetrin dhe bëjnë një zinxhir më të fortë se lumi. Më kupton? Kjo ka rëndësi...» Por pasi ishte kon-sultuar me Fatmirin, kishte ndërruar mendim. Sepse Fatmiri i kishte thënë: «Unë mendoj të mos i thuash gjë tanë për tanë Andresë. Se kushedi, bën vaki që ti rrëmbehesht e na e prish punën më keq. Poo!» «Atëherë bisedo ti me të» — kishte ngulur këmbë Sefedini. «Jo, Sefedin, — i qe përgjegjur Fatmiri. — Tani për tanë s'ka nevojë t'i themi ndonjë gjë. S'ka ardhur koha. Unë shoh se ai punon tanë më shumë se kurrë. Poo! Lëre gjithë ditën që copëtohet poshtë e lart, por edhe

natën nuk largohet nga uzina para se të vihet në vijë puna e turnit të dytë...» «Sa pér punë s'ke ç'i thua...» kishte shtuar Sefedini. «E pe, pra? Ndaj të them se as unë as ti nuk do t'ja mbushim dot mendjen me fjalë.» «Po kush do t'ja mbushë mendjen atëhere? Usta Jorgji me dokrra e me shpotira?» «E di kush do t'ja mbushë mendjen atij? Vetë puna. Dhe mbi të gjitha përfundimet e punës sonë. Poo! Ditën që do të duken qartë përfundimet e punës që kemi nisur pér të ndërtuar oxhakun dhe pér të kapërcyer vështirësitë e parashikuara, ai do të fillojë të bëjë kthesë. Kështu ma merr mendja mua. Poo!»

... Burhani me Sahitin, që s'i dinin mirë këto gjëra, mbetën pér një kohë në heshtje, duke vështruar herë pas here kolegun e tyre, që dukej si i vrarë dhe i dërmuar.

— Si shkon puna andej nga banesat? — e pyeti Sahiti Burhanin, sa pér të hapur bisedën.

— Njëfarë soji, — u përgjegj tjetri. — Ditët e fundit sikur është shtuar vrulli në punë në sektorin tonë.

— Në përgjithësi pulsi i ndërmarrjes rreh më fort gjatë këtyre ditëve, — pranoi Sahiti.

— Ndoshta këtu bazohet Sefedini që thotë të marrim zotimin e t'i përgjigjemi menjëherë ministrisë.

— Pse, ta merr mendja se mund të përfundohet uzina brenda afatit të caktuar me gjithë këtë punë suplementare që na duhet të bëjmë? — pyeti si me habi Sahiti.

— Po të vazhdojë puna me këtë vrull që ka marrë ditët e fundit, s'është çudi që të arrihet.

— Ta thotë ndonjë tjetër këtë, që s'di të bëjë llogari e që s'ka ide nga vështirësitë e ndërtimit, hajde de, po ta thuash ti, Burhan!. — thërriti Sahiti.

Andrea ngriti pak kokën *dhe e vështroi kolegun* si me qortim, *sikur donte t'i thoshte:* «*Edhe ti e thua këtë fjalë, o Burhan?*» Por edhe Burhani e shikoi një herë me ngulm, sikur po i përgjegjej: «Këtë e tregojnë

faktet, Andrea. Sot faktet janë ende të pakta, por ato dita-ditës shtohen e bëhen më bindëse.»

Sahiti u ngrit në këmbë dhe nxori një blok të vogël nga xhepi. Pasi gjeti një faqe të mbushur me shënimë të shkruar me laps vazhdoi:

— Kam bërë një përllogaritje pér ditët e punës që do të na nevojiten pér të kryer ndryshimet...

— Ti, Sahit, gjithnjë me përllogaritje merresh...

— Me shifra e me fakte, vëlla! S'ka këtu llafe. Inxhinieri kështu duhet të jetë. Me lapsin në dorë... Po i lemë mënjanë ndryshimet në projektin fillestar dhe po marrim punën e oxhakut. A mund t'i gjejme zgjidhje punës së oxhakut?

— Sa pér oxhakun, ke plotësishht të drejtë; po s'u zgjidh nga lart kjo punë, s'kemi ç'bëjmë ne, — pranoi Burhani, sikur të ishte një çështje që nuk pranonte asnijë diskutim.

— Atëhere si të marrim zotime e t'i shkruajmë ministrisë, ashtu siç thotë Sefedini?

Burhani nuk foli më. Edhe Sahiti vuri blokun në xhep dhe heshti. Pas pak ju afrua dritares dhe qëndroi pér një kohë më të shkruar jashtë.

— Sa është ora? — pyeti më në fund Andrea, sikur të ishte zgjuar tanë nga gjumi.

— Ora po shkon nëntë, — ju përgjegj Burhani.

— Ç'thua? Atëhere shkojmë, se na afrohet ora e takimit me brigadierët.

— Të dhemb koka, Andrea? — u kthye nga ai Sahiti.

— Plasa këtu brenda. Hajdeni të dalim...

Kur dolën nga zyra, Andrea u tha:

— Shkojmë më mirë në këmbë. Dua të eci pak që të shpihem e të freskohem.

Ata nuk kundërshtuan dhe vazhduan rrugën kështu më të shkruar, drejt uzinës. Sahiti me Burhanin ri-filluan bisedën që kishin nisur më zyrën e krye-inxhinierit. Dhe përsëri më shumë gjëra nuk u pajtuan. Andrea, edhe këtë radhë nuk foli. Ndoshta e preku-ponte fakti që edhe Burhani më shumë çështje po merrte anën e Sefedinit. Apo ndoshta e konsideronte

të tepërt të shfaqte përsëri mendimin e vet, që e kishte shprehur disa herë me radhë gjatë ditëve të fundit? Mos kishte filluar të ndryshonte pjesërisht edhe ai pikëpamje, por i vinte turp ta pranonte këtë gjë haptazi përpala syve të dy kollgëve? «E pamundur! — tha me vete, sikur nuk ishte i sigurtë as përveten e tij dhe kërkonte të bindej edhe një herë. — Këtu, nuk është puna për një gjë të vogël, për një gjë të dorës së dytë, që mund të bësh një sy të verbër e një vesh të shurdhër, që të mos prishesh me një shok pune. Në rastin tonë, o del e bazuar pikëpamja jonë, o del e saktë pikëpamja e Sefedinit dhe e Fatmirit me shokë. Edhe oxhaku, o ndërtchet i téri në gjithë lartësinë që duhet të ketë, o do të rrëzohet fare, duke shkaktuar një fatkeqësi, që do të bjerë mbi tërë kantierin, por në radhë të parë mbi kokën time. . .»

Frokopi me kamionin e ngarkuar me tulla po vinte prapa tyre. Te kthesa e madhe pranë uzinës, fillonte një e përpjetë dhe aty të gjitha maqinat që shkonin drejt veriut, dashur pa dashur ngadalësonin shpejtësinë. Prokopi i ra disa herë burisë dhe ata u mblohdhën grumbull anës rrugës. Prokopi ndali për një çast maqinën, nxori kokën nga kabina dhe u thirri me të madhe:

— Kështu, de! Ka lezet kur shkoni që të tre së bashku...

Ata e përshëndetën me dorë Prokopin, gjersa u largua maqina dhe shoferi nuk u duk më. Inxhinier Andrea tundi një herë kokën e tha me vete: «Nga jashtë duket sikur jemi bashkë që të tre. Por pikërisht tani që ecim xhadesë së bashku, jemi më larg njëri-tjetrit se çdo herë tjetër. Se në fakt secili nga ne të tre ka mendimin e vet rrëth problemit themelor që kemi për të zgjidhur. Burhani qysh sot mendon ndryshe nga ne për punën e uzinës. Nesër mund të përqafojë mendimin e Sefedinit edhe për çështjen e oxhakut. Ndërsa Sahiti, ndonëse tregohet ca i papjetkur, është treguar i prerë gjer tani. Ai ka një besim absolut në shifrat e aritmetikës. Sa përveten time,

një gjë mund të them: po zhytem gjithnjë më thellë në detin e dyshimeve...» Nuk e vazhdoi më tutje mendimin, se ndjeu një shtrëngim të fortë në kraharon...

Ndërkokë kishin arritur në oborrin e uzinës. Atje ai u nda nga inxhinierët e tjerë dhe u drejtua nga korpusi kryesor. Nga një skelë e lartë i bënte shenjë me dorë Fatmiri dhe sikur i buzëqeshte. «Ai nuk e ka provuar kurrë torturën e dyshimeve...» — tha me vete inxhinier Andrea dhe ju ngjit me shkathtësi shkallëve të përkohshme për të vajtur te Fatmiri. Kur hipi lart, u qetësua, nuk ndjente më as dhembje koke, as shtrëngim në kraharon...

9

Të shtunën pasdite Malia nuk i hoqi rrrobat e punës, ashtu siç bënte zakonisht, kur kthehej në shtëpi. Ajo puthi fëmijët, që kishin dalë për ta pritur tek shkallët, rregulloi shpejt e shpejt disa gjëra në kuzhinë, vuri vajzën e vogël në gjumë dhe mori një leckë dhe një thikë të vjetër në dorë për të pastruar pllakat e dyshemësë së ballkonit nga cirkat e nga njollat e suvatimit. Për Malinë këto nuk ishin ditë të zakonshme. Ajo s'kishte as një javë që kishte hyrë në apartamentin e ri. Dhe kishte njëmijë gjëra për të rregulluar. Por telashet, që të vinte për fije çdo gjë në shtëpinë e re pas punës në kantier, e bënин që të ndjente një gëzim të ëmbël, siç ndjen njeriu në prak të një festë të madhe.

Gjatë gjithë javës ajo kishte sistemuar çdo gjë në kuzhinë, në dhomën e gjumit e në atë të prites. I kishte mbetur vetëm ballkoni. Do ta përfundonte edhe këtë punë e pastaj do të mblidhej me fëmijët në kuzhinë për të kaluar mbrëmjen e së shtunës së parë në banesën e re, e për të pritur ditën e diel, kur do t'u vinin shokë e miq për t'i uruar për apartamentin e ri.

Ajo lidhi një shami të shumëngjyrshme në kokë dhe doli në ballkon. Duke pastruar dritaret nga gëlqerja e suvatimit, vështron te poshtë njerëzit që nxitonin të mblidheshin në banesat e tyre të reja, që lëshonin ende një kundërmim të athët nga suvatimi i freskët. «Sikur të vinte sonte edhe Fatmiri shpejt! — tha me vete Malia. — Por nuk besoj. Qëkurse është bërë përgjegjës i kantierit për ndërtimin e uzinës, ka shumë andralla në kokë dhe kthehet shumë vonë në shtëpi. Por edhe kur është këtu, mendjen atje e ka, në uzinë».

Malisë, duke kruar me shkathtësi cirkat e gëlqeres e të suvasë, ju kujtua koha që ajo punonte me vinçin për ndërtimin e këtyre pallateve. Ja këto shtylla betoni e këto hekura të ballkonit ajo i kishte ngritur lart me vinçin e saj.

«Cdo njeri ndjen një gëzim të madh kur hyn në një banesë të re, — thotë me vete Malia. — Por ai që ka punuar me duart e veta dhe ka derdhur djersë vetë për ndërtimin e godinës ku banon, ndjen me sigrui një gëzim më të madh.»

Që nga dita e martesës së saj me Fatmirin, ka jetuar nëpër kantiere të ndryshme. Në fillim në Ulëz, pastaj në Kurbnesh e tani në Gurraj. Po në të gjitha kantieret e tjera ka jetuar nëpër barraka të përkohshme, se edhe koha e qëndrimit të tyre atje ishte e shkurtër. Ndërsa këtu në Gurraj qëndroi vetëm disa muaj në barrakën e gurores dhe para një javë ka hyrë në këtë apartament të ri, që tani e rregullon dhe e zbuluron me duart e veta. Padashur Malia vuri buzën në gaz. Ju kujtua biseda e të birit, Skënderit, me të jatin, të dielën e kaluar:

— Babi, — pyeti djali, — kur kaluan përparrë banesave të porsandërtuara. — Kurbneshi është më i madh apo Gurraj?

— Tani për tani është Kurbneshi, — ju përgjegj Fatmiri. — Por Gurraj do t'ja kalojë shumë shpejt edhe shumë qyteteve të tjera të Shqipërisë. Poo...

Djali atëhere u hodh nga gëzimi dhe i shtrëngoi fort dorën të jatit, se e quante veten qytetar të Gu-

rrajt... «Vërtet — tha Malia me vete, — sa shpejt
ecin punimet këtu në Gurraj! Atje në Kurbnesh kishte
disa pallate dykatëshe, ndërsa në Ulëz ka pasur vetëm
barraka».

Sa kujtime ju ngjallën menjëherë Malisë kur solli
ndërmend barrakën e madhe të ndërtuar shpateve të
një bregoreje atje në Ulëz, në Kakërdhok!

Në atë barrakë bëheshin nganjëherë edhe dasma.
Asaj i kujtohet tani dita e martesës së saj me Fatmirin.
Atje qenë mbledhur tërë ata njerëz nga kantieri. Disa
këndonin me çifteli e lahitë, disa të tjera i binin kër-
netës dhe daulles. Në krye të tavolinës rrinte usta
Jorgji. Ajo aso kohe nuk e njihet ustanë aq mirë dhe
si nuse përpinqej të mbahej serioze. Po ku të linte ustai
me shakarat e tij të pafund? «E që thoni ju, or burra,
— thoshte ustai kur erdhi mirë në qejf, — na u shkul
gjithë djalëria e Shqipërisë e na u grumbullua këtu
në Ulëz. Nga Jugu e nga Veriu, djem e vajza mizëri.
Ata na punojnë këtu nja dy-tre muaj dhe na ikin
përsëri pér në shtëpi. Mirë po vajzat nuk do të kthe-
hen tamam sa kanë ardhur. More vesh? Njëra nga
ato u kap fort nga grepi i një shokut tonë. E të kujt
pa, i Fatmirit tonë të urtë e fjalëpaktë... Mirë thonë
andej nga ana jonë që në kësi gjërash të kesh më shu-
më frikë nga lumi i qetë e i thellë, se sa nga një
lumë zhurmëmadh e poterexhi. Apo jo, moj nuse?» —
i ishte drejtuar asaj ustai dhe gjithë salla jehoi nga
të qeshurat. Bashkë me të tjerët qeshi edhe ajo,
nusja...

Malia u përmend se dëgjoi një zë gruaje që kë-
ndonte një këngë. Ajo s'e kishte dëgjuar asnjëherë tje-
tër këtë këngë. U përkul pak mbi ballkon dhe pa një
grua të re, që pastronte xhamat e dritareve në apart-
amentin e saj duke kënduar. Malia s'e kishte parë
kurrë më parë këtë grua të veshur me rroba fshatare.
Megjithatë i buzëqeshi me dashamirësi. Edhe gruaja e
porsaardhur pushoi së kënduari, e vuri buzën në gaz
si shenjë përgjegje. Malisë i bënë përshtypje rrobat e

zeza të gruas së panjohur, që tregonin se ajo kishte ardhur nga Malësia e Madhe. Edhe gruas që kishte ardhur nga fshati i tërhoqi vëmendjen veshja e Malisë. Ndoshta ajo s'kishte parë kurrë gjer atëhere një grua të veshur me pantallona tamam si burrat. Ndaj punonte dhe bënte q'bënte hidhje sytë lart me kureshtje të madhe. Në një çast sytë e tyre u takuan.

— Kur ke ardhur? — e pyeti Malia gruan e panjohur, duke ndërprerë punën.

— Mbramë, — u përgjegj tjetra me leckën në dorë.

— Nga fshati?

— Po.

— Larg këtej?

— Ehu! Larg fort. Nga malcia.

— Si të duket apartamenti?

— Nuk ndigjova gja...

— A të pëlqen konaku?

— Besa fort. Vetëm nji gja s'më ka pëlqye. S'kena as votër, as oxhak.

Malia nuk u habit aspak nga këto fjalë të malësorës. Edhe ajo, kur ishte martuar me Fatmirin, në ditët e para e kishte ndjerë shumë mungesën e oxhakut.

— Mos u mërzit, — i tha pas pak. — Ç'e do oxhakun? Po të marrësh një sobë, të bëhet puna më mirë...

— Ç'të bash? Kena me u mësue me gjana të reja... Oj! Po më qan cuca, — tha malësorja dhe u zhduk nga ballkonî.

Brenda nga kuzhina u dëgjuan zëra të gëzuara fëmijësh. «Erdhi babi! Erdhi babi!». «Të ketë ardhur me të vërtetë Fatmiri kaq shpejt?» — tha me vete Malia dhe duke fshirë duart me nxitim, hyri brenda në shtëpi. Në mesoren e hyrjes u takua me të shoqin.

— Erdhe Fatmir? Sa mirë! — i tha ajo me një frymë.

— Kemi gjëkafshë këtej?

— Jo, s'kemi asgjë; por më pëlqen të mblidhemi sonte me fëmijët pranë zjarrit, meqë është e shtuna e parë që jemi në shtëpinë e re...

— Mirë po...

Fatmiri nuk e mbaroi fjalën. Të dy fëmijët e vegjël i kishin kapur duart dhe i thërrisin me të madhe: «Merrmë mua, babi! Merrmë!» Ai i mori në krahë që të dy dhe hyri i pari në kuzhinë. Pas tij hyri dhe e shoqja.

— E di, Mali, unë do të dal përsëri, — i tha ai më zë të ulët.

— Ende s'mbarcve punë?

— Erdha të ha një kafshatë bukë e të marr me vete inxhinier Andrenë. Sonte do të bisedojmë për herë të fundit pér atë çështje.

— Pér oxhakun?

— Po, dhe ndoshta do të marrim vendim një herë e mirë.

Malia uli kokën dhe nuk ju përgjegj menjëherë. Ajo kishte biseduar edhe herë të tjera me të shoqin pér këtë gjë dhe në shpirtin e saj bëhej një luftë e madhe që ende s'kishte marrë fund.

— Fatmir! Mos i harro këta, — i tha pas një heshtjeje të shkurtër, duke i treguar fëmijët.

— Fëmijët? Po ne pér këta punojmë, — ju përgjegj Fatmiri duke ngritur lart të vegjilit, që zgjatnin doçkat pér të kapur tavanin.

— Pa shiko, moj Mali, — i tha ai me të qeshur.

— Edhe këta kërkojnë të arrijnë sa më lart. Poo...

Malia vuri buzën më gaz dhe i shtroi të shoqit që të hante.

— Ulu, — i tha. — Mos ha në këmbë. Kushedi në ç'orë do të kthehesht.

— Do të vonohem shumë.

— Sonte kam edhe unë shumë punë pér të rregulluar shtëpinë.

— Lëre edhe ndonjë punë për nesër, moj grua,
— i tha si me shaka Fatmiri.

— Nesër do të na vijnë mysafirë, Fatmir.

— Le të urdhërojnë. Ne kemi pritur boll mysafirë, kur ishim në barrakë, e jo tani që kemi alamet shtëpi...

Pastaj u ngrit nga karrigja dhe u drejtua nga mesorja për të veshur peliqen.

— Mos ikë, babi, mos ikë! — thërrisin me të madhe të dy fëmijët.

— E pe? S'të lënë të ikësh. Duan të të mbajnë këtu.

— Merri pak me të mirë, Mali, gjersa të dal unë te shkallët, — i tha ai me zë të ulët, — se e di si më vjen kur i dëgjoj të qajnë?

— Kanë hakë fëmijët, Fatmir. Kur vjen ti në mbrëmje, i gjen në gjumë. Edhe kur ikën gjene në mengjez, ata janë hala duke fjetur...

— Ç'të bëjmë, moj grua? — ju përgjegj ai, duke i ledhatuar fëmijët, që i shkonin pas drejt derës së jashtme të apartamentit.

— Uh! Harrova të puth vajzën, — tha befas Fatmiri dhe u kthyte drejt dhomës së gjumit, ku flinte vajza e vogël, që sapo kishte mbushur motin.

— Sa qetë fle, moj Mali! — i tha Fatmiri së shqes duke qëndruar për një çast në këmbë, pranë shtratit të vajzës së vogël.

— Avash mos e zgjosh, se s'do të të lëjë të ikësh pastaj. Këta të tjerët kanë nisur të kuptojnë diçka dhe mund t'u thuash edhe ndonjë fjalë, kurse asaj s'ke ç'i bën.

— Vogëlushja! — tha Fatmiri si me vete dhe e puthi në ballë. Pastaj doli nga dhoma, duke ecur në majë të gishtave. Malia i rregulloi mirë peliqen dhe e përçolli gjer te kryeshkalla.

— Domethënë, Fatmir, i dhe karar asaj pune të oxhakut, — i tha ajo në çastin që do të ndaheshin.

— Po, po, ka marrë fund kjo punë, — ju përgjegj ai me vendosmëri.

— Dalç faqebardhë! — i tha ajo me zë të ulët, që mezi u dëgjua dhe i shtrëngoi me dorë krahun e djathtë...

Puna e oxhakut i kishte vënë të gjithë njerëzit në lëvizje. Inxhinier Sahiti çdo mbrëmje bënte përllogaritje dhe nxirrte shifra të tjera suplementare, që ai i quante «interesante», lidhur me volumin e punës dhe materialet, që do të nevojiteshin për ndërtimin e oxhakut. Bile të dielën që kishte vajtur në Tiranë, kishte shfletuar në bibliotekë libra e revista ndërtimi dhe kishte mbushur blokun me shënimë mbi oxhaqet më të larta në botë e mbi mekanizmat e komplikuara që ishin përdorur për ndërtimin e tyre. Dhe kur u kthyen në kantier, u foli për këto shokëve të tij «sa përkuriozitet». Mirëpo nga të gjitha këto të dhëna dilte gjithnjë i njëjti përfundim: Për ndërtimin e oxhakut të madh duhej të vinte nga jashtë skela metalike. Pa këtë as që mund të bëhej fjalë për një ndërmarrje të tillë.

Inxhinier Andrea kishte lexuar disa materjale mbi ndërtimin e oxhaqeve, megjithatë, këto shifra të Sahitit i dëgjonte me vëmendje të madhe, por nuk thoshte gjë dhe nuk shprehte ndonjë mendim. I dukej sikur i kishte thënë të gjitha në mbledhjen e këshillit teknik dhe në bisedat që kishte patur në fillim me Sefedinin e me Fatmirin. Por në të vërtetë sa herë gjente kohë të lirë, veçohej nga të tjerët, merrte lapsin në dorë e, me shkathësinë që kishte fituar në vizatim, projektonte oxhaqe dhe lloj-lloj shkallësh e mjetesh të tjera për ngritjen e materialeve dhe të njerëzve gjatë punës së ndërtimit. Gjatë atyre ditëve edhe në kapakun e kutisë së cigareve bënte shpeshherë po atë gjë. Një ditë që i zgjati usta Jorgjit paqetën që t'i jepte një cigare, plaku e mori atë në dorë, vështroi tri oxhaqe të vizatuara mbi kartonin e bardhë, pa disa shifra

anës të shkruara me nxitim dhe tha, duke tundur kokën me kuptim:

— Ne s'ja gjejmë kararin punës për të ngritur një oxhak, kurse inxhinieri ynë na ka bërë fët e fët tri oxhaqe të mira...

— Në letër, ama, — ju përgjegj inxhinier Andrea, duke futur me ngutje paqetën në xhep, sikur të kish te frikë se mos i zbulonin ndonjë sekret.

— Në letër, po! Se kështu e keni ju inxhinierët; sefte i bëni veprat në letër dhe pastaj fillon ndërtimi i tyre i vërtetë. More vesh?

— Këtë radhë, usta, na ka ngecur sharra në gozhdë...

Plaku e vështroi një herë si me dyshim, por nuk i tha gjë. Edhe inxhinier Andrea nuk e zgjati më këtë bisedë me usta Jorgjin. Po punën e vizatimit të oxhaqeve e vazhdoi. Çdo herë që bënte në letër një oxhak, studjonte një variant të ri ndërtimi. Po gjithnjë i dilte një pengesë që ja rrëzonate të gjitha kalkulimet. «E ka thënë mirë Arkimedi, — thoshte me vete. — Më jep një pikë ku të mbështetem...» Por këtë punë nuk e ndërpree, gjë që tregonte se nuk i kishte humbur të gjitha shpresat për ndërtimin e oxhakut me forcat e veta, me forcat e kolektivit.

Fatmiri ndoqi një rrugë krejt të ndryshme. Ai e bisedoi për herë të parë këtë çështje me Kolën, me Lleshin e me Azisin. Ashtu siç e priste, Kola u tregua menjëherë i gatshëm dhe në fund të bisedës i tha:

— T'ja fillojmë një herë, pastaj shohim e bëjmë. Edhe Lleshi me Azisin i thanë se nuk i zinte gjumi për shkak të oxhakut.

Sefedinin mezi e gjeti një ditë pak si të lirë dhe ja shpjegoi se ç'kishte ndër mend të bënte. Ky i fundit e dëgjoi me vëmendje dhe, kur do të ndaheshin, i shtrëngoi dorën dhe i tha: — Unë s'mund të të them tani se e ke këvur kaun prej briri. Por të siguroj vetëm për një gjë: nga unë do të kesh çdo ndihmë e çdo përkrahje.

Inxhinier Andrea dhe kolegët e tij të tjerë nuk

e dinin se ç'po bënte Fatmiri me shokët e tjerë. Prandaj u habitën të shtunën në mbrëmje, kur i thirrën në uzinë për një konsultë. Ky ishte një takim pak si i çuditshëm. Në qoshen e një hangari të madh, ku ruheshin veglat e punës dhe maqineritë që përdoreshin për ndërtimin e uzinës, ata panë një oxhak në miniaturë të ngritur me baltë. Ky oxhak, që ishte një kopjim nga projekti i oxhakut të uzinës, nuk ishte më shumë se një metër i lartë. Nga gryka e tij dilte një si makara e vogël, që të kujtonte më shumë një lodër fëmijësh, se sa një mekanizëm të vërtetë. Nga rrøta e vështronin këtë oxhak të zvogëluar dhe s'e kuptonin ende përsë e kishin ngritur këta veteranë të kantiereve.

— Këtë oxhak e kam bërë unë bashkë me Kolën dhe dy-tre shokë të tjerë, — tha Fatmiri, kur u mblo-dhën të gjithë. — Ne s'jemi inxhinierë dhe s'dimë të bëjmë projekte në letër. Ndaj kemi sajuar këtë oxhak të vogël dhe kemi bërë disa prova për të shikuar nëse do të ishte e mundur të ngremë oxhakun e madh. Poo!

— E në ç'përfundim keni arritur? — nuk u përm'bajt pa pyetur inxhinier Sahiti.

— Ne kemi arritur në përfundim se mund ta ndërtojmë oxhakun e madh. Po tani presim të dëgjojmë çfarë do të na thoni edhe ju. Ndaj ju kemi thirrur.

— Interesant! — jehoi si bubullimë zëri i Baftjarit.

— Sikur jeni nxituar pak në nxjerrjen e përfundimit, — u hodh dhe tha Sahiti.

— Prit të dëgjojmë një herë, — ju drejtua atij inxhinier Andrea.

Fatmiri u shpjegoi me fjalë të thjeshta e të qarta nga ishin nisur e si kishin menduar ata të punonin për ndërtimin e oxhakut. Njerëzit e dëgjuan me vëmendje.

— Unë s'kuptova një gjë, — tha në fund Sahiti.

— Ku do të mbështeteni për të vazhduar ngritjen e trupit të oxhakut mbi njëzet metra të lartë?

— Ju thashë, or jahu, — ju përgjegj qetë-qetë

Fatmiri. — Oxhaku do të jetë i gjerë disa metra. Ne do të ndërtojmë shkallë druri nga brenda. Ndërtimi do të bëhet pjesë-pjesë. Mbi pjesën e mbaruar do të ngremë kallëpë dërrasash dhe aty, pasi të vendosim hekurat sipas projektit do të derdhim beton. Kështu do të veprojmë për çdo dy-tre metra. Kur të mbarojmë me një pjesë, do të bëjmë dizarmimin e pjesës së poshtme dhe do të vazhdojmë më lart...

— Po dizarmimin e pjesës së jashtme si do ta bëni? — pyeti inxhinier Andrea, i sigurtë se kishte qëlluar në shenjë.

— Këtë doja të pyesja edhe unë, — tha aty për aty Sahiti.

— E kemi menduar edhe këtë, — u përgjegj me gjakftohtësi Fatmiri. — Ç'është e vërteta kjo do të jetë puna më e vështirë. Por ja kemi gjetur karar edhe kësaj pune. Dhe ja si do të bëjmë: Do të varet një njeri me litar nga maja e oxhakut...

— Të varet një njeri me litar?! — u dëgjuan pëshpëritje në hangar.

— S'kemi q'bëjmë; s'ka rrugë tjetër. I kemi menduar të gjitha mundësitë; kemi pyetur edhe shokët e tjerë më të vjetër se ne. Dhe na është mbushur mendja top se po të lidhet një njeri me litar e të lëshohet nga ana e jashtme, mund ta bëjë dizarmimin.

— Po a mund të punojë një njeri i varur në litar, që të dizarmojë dërrassa të rënda të ngjitura në beton? — pyeti Sahiti.

Fatmiri sikur ra ngushtë. Këtë gjë ndoshta s'e kishte menduar. Atëherë i erdhi në ndihmë Kola.

— E kam provuar unë, — tha me plot gojën. — Në digën e hidrocentralit. Po, për nder! Lartësia atje nuk ishte aq e madhe sa do të jetë këtu, por sidqoftë një provë është bërë.

— Po nga do të mbahet ky njeri, që do të varet në litar? — pyeti inxhinier Burhani.

— Ja, nga kjo makaraja këtu, që do të lidhet fort në ganxhat e oxhakut nga brenda, — ju përgjegj Fatmiri, duke i treguar atë mekanizëm të vogël prej

lënde druri, që dilte mbi grykën e oxhakut në miniaturre.

— Fundi i fundit dy burra të fortë mund ta mbajnë fare mirë edhe me dorë, sa kohë të vazhdojë dizarmimi, — tha nga vendi i tij Azisi.

U bënë edhe shumë pyetje të tjera dhe Fatmiri ju përgjegj të gjithave, ashtu siç i kuptonte ai. Pasat pyetjet mbaruan dhe Fatmiri u ul mbi një arkë bosh. Në hangarin e madh dëgjoheshin biseda të gjalla nga të gjitha anët. Njerëzit shfaqnin mendimin e tyre, pyesnin njëri-tjetrin, kallëzonin ngjarje nga objekte të vështira, që kishin ndërtuar dhe shfaqnin mendime pro ose kundër kësaj iniciative të Fatmirit e të Kolës. Në hangar bënte ftohtë dhe atmosfera në fillim ishte si e ngrirë. Por tani njerëzit sikur nuk e ndjenin më të ftohtit. Oxhaku në miniaturë, i bërë nga duart e Fatmirit e të shokëve të tij të ngushtë i tërhiqte të gjithë dhe sikur i ngrohte fare mirë.

— E, si thoni ju? — ju drejtua të gjithëve Sefedini, i cili gjer në atë çast nuk e kishte hapur gojën e nuk kishte shprehur ndonjë mendim.

Bisedat dhe pëshpëritjet u fashiten menjëherë. Në hangar ra një heshtje e thellë. Nga rreshti i parë i ndenjëseve u ngrit Sahiti me një pelice të re bojë kafe e me pantallona shumë të ngushta, që e bënин tē dukej më i hollë nga ç'ishte.

— Folë, Sahit, folë! — i tha Sefedini.

— Që nga çasti kur hyra këtu në hangar dhe e pashë atë oxhak në miniaturë, — tha duke treguar oxhakun prej balte, — m'u duk si një lodër fëmijësh. Po dale, thashë me vete, të dëgjojmë një herë se ç'na kanë gatuar këta shokë. Tani që dëgjova shpjegimet e Fatmirit u binda më mirë se ne po humbasim kohën kot, duke u marrë me kësi lojrash.

— Kështu menion ti, inxhinier? — ju përgjegj zjarr pér zjarr Sefedini dhe nga sytë sikur i dolën xixa.

— Po si të mendohem? A ka vend këtu që të mendohem ndryshe? Në rastin tonë kemi pér të ngritur një oxhak vigan prej betonarmeje, e jo një kotec pu-

lash prej dërrasash! — ngriti zërin Sahiti dhe hapi defterin e tij të trashë.

— Po të fillosh prapë me numra si atë ditë, më mirë ulu që tani, — e ndërpree Sefedini.

— Të lutem, mos më ndërpree. Se si do të flas unë me shifra apo pa shifra, kjo është puna ime.. .

— Ulu! Ulu Sahit! — thirrën disa.

— Lereni, ore të flasë, — kundërshtuan disa të tjerë.

— E ç'e duam? Që të na ngatërrojë mendjen me numra?

— Unë them se sot s'mund të shfaqim asnje mendim; duhet të mendohemi një herë mirë, të bëjmë kalkulime, — propozoi Burhani.

— Kurse mua më është mbushur radakja se mjaft kemi mbetur duke pritur e duke menduar, — u dëgjuai si bubullimë zëri i fortë i Baftjarit. — Fatmiri me Kolën kanë bërë një punë të mirë. U lumtë! Tani na duhet që mendimin e tyre, ta vëmë në jetë. Po sikur të na dalin vështirësi? Le të dalin. Ne këtu do të jemi. Shpatullat tona janë të forta dhe mendjen e kemi top që të bëjmë hesape të reja.. .

— Ama, ç'na the edhe ti, Baftjar?

— Ore ç'thotë ky, të bëjmë prova me jetën e njerëzve? Apo e merr punën e oxhakut si Nastrandini shtëpinë, që e kishte ngritur mbi një qerre që ta kthente nga të donte?

Nga të gjitha anët dëgjoheshin zëra. U bë një zallamahi e madhe si asnje herë tjetër. Vetëm inxhinier Andrea rrinte si mënjanë e nuk merrte pjesë në këtë polemikë. Ai kishte hapur fletoren e shënimave dhe diçka shkruante. Ata që ishin larg, mendonin se ai vizatonte ndërtesa e fabrika, ashtu siç e kishte zakon. Por ata që i rrinin pranë tij, panë se ai këtë radhë shkruante shifra e bënte llogaritje.

Për çudinë e të gjithëve Sefedini nuk ndërhynte për të vendosur rregullin. I pëlqente që të dëgjonte mendimin e të gjithëve para se të merrte një vendim.

U ngrit për të folur inxhinier Andrea. Zhurma

pushoi menjéherë, bisedat u ndérprenë dhe vështrimet e të gjithëve u drejtuan nga ana e tij. Ai i vështroi një herë të gjithë në heshtje. Fytyra e tij dukej si e hequr dhe e zbetë. Sytë i kishte si të buhavitur e pak të skuqur anëve nga pagjumësia. Anën e kujt do të mirrte vallë ai në diskutimin e tij? Sefedini ishte i sigurt se Andrea do të përpinqej ta rrëzonte projektin e paraqitur nga Fatmiri dhe shokët e tij, ndaj po bëhej gati që t'i jipë një përgjegje. Sahiti fërkonte duart me kënaqësi, duke pritur që ai t'i mirrte hakun kundër Sefedinit, që nuk e kishte lënë ta mbaronte diskutimin e vet.

— Çështë e vërteta, — filloj ngadalë inxhinier Andrea, — ne të gjithëve sa jemi këtu, na ka shqetësuar e vazhdon të na shqetësojë shumë çështja e oxhakut. Ja, pra, një pikë ku bashkohemi që të gjithë. Ndarja e si të thuash, ndryshimi i mendimeve dhe i pikëpamjeve fillon kur shtrohet konkrëtisht çështja për ta ndërtuar oxhakun. Ky ndryshim është bërë më i madh e më i thellë që nga ajo ditë kur na thanë se na bie barra ta ndërtojmë oxhakun pa skelë metalike. Atëhere secili nga ne, kush më shumë e kush më pak, ju përveshëm punës për të gjetur një zgjidhje për këtë problem të vështirë. Se pa oxhak, s'ka as uzinë; këtë e kemi të qartë të gjithë..

Andrea qëndroi për një çast, fërkoi një herë ballin me dorën e majtë si për të sjellë ndër mend diçka që i shpëtonte dhe vazhdoi më lirshëm:

— Edhe unë kam projektuar disa variante për ndërtimin e oxhakut me forcat tonë. Por asnë variant nuk e kam çuar gjer në fund. Pse, do të thoni ju. Pse kam ngecur në pengesa, që mua më ishin dukur të pakapërcyeshme. Atë variantin e ngritjes nga brenda me shkallë prej druri e kam kapur edhe unë. Por jam tèrhequr pastaj ngaqë më dukej se puna e dizarmimit nga jashtë ishte diçka e pamundur. Kalkulimet e mia gjer këtu arrinin. Këtu ishte caku që nuk kalohej dot me rregullat e zakonshme të punës. Më tej fillonte e jashtëzakonshmjë. Pra, unë erdha gjer te buza e oxha-

kut, pashë poshtë greminën dhe u têrroqa. Fatmiri me shokët e tij kanë ecur më tutje. Ata thonë: për dizarmimin do të varet një njeri me litar. Mua s'më shkonte mendja te një gjë e tillë. Sepse e shikoja si të pamundur. Kola thotë se u bëka edhe kështu; se ai ka punuar i varur në litar në digën e hidrocentralit. Tani është ndryshe në digë, ndryshe në oxhak me një lartësi prej tetëdhjetë e ca metrash. Në digë ke ku të mbështetesh, ke si të manevrosh, ndërsa këtu... Sidoqoftë këtu ka diçka të re, ka një xixë, ka një farë të vogël, që ne duhet ta shohim mirë e ta vlerësojmë...

Sahiti e vështronte Andrenë me sy të zgurdulluar e thoshte me vete: «Është në vete ky njeri, apo flet përqart? Me një farë sinapi do të ngrihet oxhaku më i lartë i Republikës?». Fatmiri e vështronte me një buzëqeshje të qetë, ndërsa Sefedini fërkonte duart, ashtu si bënte më parë Sahiti.

Pasi folën edhe shumë të tjerë, u vendos që të bëheshin përllogaritje të gjithanshme para se të merrj një vendim përfundimtar. Sefedini në fund u tha:

— Edhe unë jam i një mendimi me ata që thanë se tani duhet të punojë kalemi. Inxhinierët ja ku i kemi. Le ta mprehin kalemin që t'i bëjnë hesapet mirë e saktë edhe për gjérat më të vogla. Le të numërojnë edhe qimet e postiqes po të duan. Po unë them me bindje të plotë se oxhaku ka për t'u ndërtuar me sigruri. Kjo do të jetë një punë e madhe, shokë. Në këtë furtunë të egër, që e rreh vendin tonë nga të gjitha anët, Shqipëria ngrihet si një kala. Kështu do të ngrihet lart edhe oxhaku ynë si Shqipëria jonë. Ku ka nnder më të madh, shokë, se sa të marrësh pjesë në një punë si kjo? — dhe me kaq e mylli konsultën.

Inxhinier Andrea u nis nga hangari drejtpërdrejt për një fjetore, pa kaluar nga mensa. Aty s'gjeti njeri. As që u kthyte njeri atë natë nga ata që flinin atje.

Usta Jorgji, ashtu si bënte zakonisht çdo të shtunë, kishte vajtur si mysafir në shtëpinë e Palit në fshat. Kola nuk u duk fare dhe Sefedini u kthye pas mesnate.

Hoqi peliqen me ngathtësi dhe ju afrua tavolinës së punës për të shikuar një variant të oxhakut, që e kishte bërë vetë disa ditë më parë. Po përsëri ndërrroi mendim dhe u shtritë në shtrat, ashtu siç ishte, me gjithë rroba. Nuk i hiqej nga mendja konsulta që ishte bërë në hangarin e madh të uzinës dhe ai oxhak në miniaturë që kishte bërë Fatmiri dhe shokët e tij. Herëherë i dukej se iniciativa e këtyre punëtorëve e kishte vënë punën e oxhakut në rrugën e zgjidhjes. Dhe i vinte që të ngrihej, të merrte lapsin në dorë e të bënte në letër një projekt të ri të oxhakut, me shkallët e brendshme, me makaranë në grykë dhe me litarin që varej nga makaraja me një njeri të lidhur nga mesi. Pastaj të bënte llogaritje për peshat që do të ngrihen, për materialet që do të përdoreshin, për cilësinë e betonit, për trashësinë e dërrasave që do të vihen, në armaturën e faqeve të oxhakut e për shumë gjëra të tjera, që i vinin në mendje të gjitha përnjëherësh. «Kaq inxhiniera jemi këtu në kantier dhe nuk i dhamë dot zgjidhje kësaj pune, — thoshte me vete. — C'do të thonë njerëzit nesër kur do të marrin vesh këtë që bënë Fatmiri dhe Kola? «Haram e paçin bukën që hanë!» — do të thonë për ne». Dhe një emir, e fshehur diku thellë në shpirtin e tij, përpigjet të nxirri krye. Atëherë propozimi dhe projekti në miniaturë i Fatmirit dhe i shokëve të tij i dukeshin si qesharakë. «Të varet njeriu me litar, për të bërë dizarmimin! Po sikur të këputet litari? Sikur të rrëzohet krejt makaraja? Pse, zgjidhje është kjo? Të flijohen njerëz si në kohërat e vjetra! C'e do pastaj? Domethënë të ndërtojmë oxhakun duke derdhur gjak, duke humbur njërrëzit më të mirë të kantierit? Jo, or vëlla, s'është punë që bëhet kjo! Le po kush të lejon që të veprosh kështu! Sikur ta vinim në zbatim këtë ide të Fatmirit e të Kolës e të pësonim ndonjë katastrofë, do të vinin ata

të ministrisë e do të na thoshin: «A jeni në vete ju? Ti, ti, Andrea, si kryeinxhinier! Si e ke lejuar një gjë të tillë?» Mirë e tha Sahiti: «Kjo punë mua më duket si një lojë fëmijësh». Kështu, pra... Po sikur gjithë puna të vazhdojë normalisht, pa ndonjë aksident e pa ndonjë dështim dhe oxhaku të përfundohet nga brigada që mendon të formojë Fatmiri me specialistët më të mirë të kantierit? Ç'bujë do të bëjë! Do ta marrë vesh gjithë Shqipëria!»

Meqë nuk mund të gjente një rrugë të sigurtë që të dilte nga qorrsokaku, ku vërtitej për ditë të tëra me radhë, vendosi të hiqte mendjen nga këto çështje, duke lexuar ndonjë gjë. Zgjati dorën mbi komodinë dhe mori një gazetë «Zëri i popullit». E shikoi në faqen e parë dhe pa se ishte e javës së kaluar. «S'ka gjë, — tha me vete, — unë kam disa ditë me radhë që nuk e kam ndjekur rregullisht shtypin». Në faqen e katërt të gazetës pa fytyrën e një vajze të gjakosur. E palosi gazetën më dysh dhe lexoi poshtë fotografisë: «Vajza e vogël zezake Gloria Floid e plagosur nga racistët e tërbuar të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në qytetin Alabama». Vajza e vogël dukej sikur e vështronë me sytë e saj të mëdhenj e të përlotur. «Kriminel! — tha me vete Andrea, duke myllur sytë përgjysmë. — Atë që bëjnë në vendin e tyre kundër zezakëve, duan ta bëjnë edhe kundër popujve të tjerë. Edhe kundër nesh, sigurisht...» Dhe shtrëngoi grushtin e dorës së majtë.

Në krye të faqes së katërt lexoi: «Demostrata të fuqishme të punëtorëve grevistë nëpër qytetet e Italisë». Pak më poshtë ishte një lajm tjetër: «Provokacion i ri i imperialistëve amerikanë në bregdetin e Kinës Lindore».

Inxhinier Andrea e ktheu me nervozizëm gazetën në faqen e parë. I tërroqi vëmendjen një titull me shkronja të mëdha: «Plani i vitit të parë të pesëvjetës së karit në sekторin e ndërtimeve u realizua dhe u tejkalua». «Në këto shifra përmblidhet edhe aktiviteti ynë, këtu në Gurraj, — mendoi Andrea. — Interesant!

Me gjithë pengesat e mëdha, me gjithë mungesat që u shkaktuan nga blokada, planet tonë realizohen dhe tejkalohen në të gjithë sektorët. Shembull më i qartë për këtë është ai i ndërtimeve. Përse të shkoj larg? Unë shkoj punën këtu në Gurraj. Vështirësitë janë shtuar aq sa s'thuhet gjatë muajve të fundit. Megjithatë vrulli i punës është rritur. Ku qëndron sekreti i këtij vrulli të ri që ka përfshirë gjithë vendin? Po ja, kudo ka njerëz të tillë si Fatmiri e shokët e tij, që janë gati të varen me litar në një oxhak nëntëdhjetë metra të lartë që të mos dështojë ndërtimi i veprave të mëdha...»

Gazeta i ra nga dora në dysheme. Por ai nuk e zgjati dorën që ta nxirrte përsëri. «Jetojmë në ditë me të vërtetë të vështira, por të mbushura me ngjarje të mëdha, — tha me vete. — Edhe këto ngjarje që zhvillohen këtu në kantierin tonë kanë një kuptim shumë të madh, sepse tregojnë se si rrëh pulsi i një populli të tërë. Ç'hol të madh ka marrë populli ynë gjatë këtyre vjetëve të paktë të jetës së lirë! Këtë hov të madh duan t'ja ndalin me çdo mjet ata që s'i duan të mirën. Po nuk duhet të ndodhë kjo. Nëasnje ményrë nuk do të ndodhë!»

Ju kujtua përsëri konsulta, Fatmiri, Kola, fjalët e Sefedinit.

«Kjo luftë që zhvillohet këtu tek ne, është një gjë e madhe, — vazhdoi arësyetimin e tij Andrea. — Se nuk është puna për një oxhak të thjeshtë, po për ndërtimin e uzinës së parë, që do të jetë baza e industriës kimike në vendin tonë. Këtë gjë e kanë kuptuar më mirë se unë, Fatmiri, Kola, usta Jorgji e të tjerë. Prandaj nuk janë tërhequr para vështirësive edhe kur ato duken si të pakapërcyeshme. Ata janë gati të punojnë edhe të varur me litar që ta përfundojnë uzinën me çdo kusht. Mësimi i parë që mund të nxjerr nga këta është guximi. Po, guximi, që nuk i ka munguar kurrë popullit tim. Nesër në mëngjes do të shkoj të takohem me Fatmirin. Duhet ta marr shumë seriozisht pro-

pozimin e tij...» Dhe i lehtësuar disi u zhvesh me ngut dhe ra për të fjetur.

12

Ishte ende herët dhe, kur arriti te dera e apartamentit të Fatmirit, qëndroi për një çast si i pavendosur. «Sot është ditë e diel, — mendoi. — Ditë pushimi. Mos janë duke fjetur ende? Ç'më erdhi që të ngrihem kaq shpejt?». Por dëgjoi zëra fëmijësh brenda dhe trokiti lehtë te dera...

Fatmirin e gjeti në kuzhinë me vajzën e vogël në krahë. Po ai nuk ishte vetëm. Pranë radios pa Kolën, që dëgjonte me èndje një këngë popullore me çifteli.

— Prandaj nuk erdhe mbrëmë në fjetore; na ke fjetur këtu te Fatmiri. Dhe unë thashë q'na u bë ky njeri, — ju drejtua Kolës inxhinier Andrea i kënaqur që e gjeti aty.

Në atë çast hyri në kuzhinë Malia, me një përparsë të bardhë të veshur mbi fustan. Inxhinier Andrea, që e shikonte përditë Malinë me kominoshet e spërkatura me llaç e gëlgqere, sikur nuk e njoihu menjëherë të veshur kështu si një amvisë e mirë. Ajo i tha si me shaka:

— Dëgjova, shoku kryeininxinier, që i the Kolës se ka fjetur këtu tek ne mbrëmë, ë?

— Po, — ju përgjegj Andrea pa ditur se ku do ta nxirrite fjalën zonja e shtëpisë.

— Se mos ka ardhur për të fjetur Kola këtu tek ne?

— Po përsë ka ardhur?

— Ku di unë, le ta thotë vetë përsë ka ardhur. Inxhinier Andrea ngeli një hop duke vështruar një herë Kolën një herë Malinë. Kola buzëqeshte e nuk thoshte gjë.

— E ka fjalën që fjetëm shumë vonë, — tha Fatmiri duke marrë hopa vajzën e vogël.

— Ore s'kanë fjetur fare të them. Unë isha e lodhur mbrëmë e fjeta para se të vinin ata. Sot në mëngjez u ngrita shumë herët, se kisha pér të larë rroba. «Ç'u bë ky njeri?» — thashë me vete, kur pashë se Fatmiri s'kishte ardhur pér të fjetur. Kur dola në mesore, dallova dritë të ndezur në kuzhinë. Hap derën e ç'të shikoj? Fatmiri me Kolën rrinën si lugetër, ngrënин një oxhak të lartë me copa të vogla dërrasash e fjaloseshin sikur të ishin atje majë oxhakut.

— Ashtu qe puna këtë radhë, — e ndërpree Fatmiri.

— Të ishte vetëm këtë radhë ta bëja kabull, or burrë...

— Pse ndodh shpesh kështu, moj Mali?

— Po si, ore. Qëkurse është caktuar në kantierin e uzinës, Fatmiri është bërë si mysafir në shtëpi.

— Kështu kanë qenë këto ditë me telashe të mëdha. Po, pér nder! — tha Kola duke mbyllur radion, se kishte filluar tani të transmetonte muzikë klasike.

— Unë them se po merrni edhe ju avash-avash huqet e Sefedinit, — tha me të qeshur Malia.

— Çfarë huqe, moj? — e pyeti si me qortim Fatmiri.

— Ja, të bridhni gjer në mesnatë nëpër objekte e të takoheni me njerëzit tuaj një herë në tre muaj...

— Po ne përnatë jemi në shtëpi.

— Edhe jeni edhe s'jeni në shtëpi. E di si them unë, shokt Andrea? — ja ktheu tani në emër Malia.

— Ju të ndërmarrjes bëni gabim të madh. Mbledhjet që bëni atje në uzinë apo në zyrat e drejtorisë pér fundojini atje.

— Po ne atje i përfundojmë.

— Jo, nuk i përfundoni atje. I vazhdoni pastaj në shtëpi. Jo u vendos ashtu, jo u vendos kështu, — shtoi Malia, ndërsa i jepte kafen mysafirit. — Lëre pastaj Fatmirin, që më flet edhe natën në gjumë.

— E ç'thotë? — pyeti me gjallëri Andrea.

— Kush i vë re se ç'thotë. Po ja, jo na mungon cimentoja, jo na mungon hekuri. E pastaj nis e zihet.

Një herë më zihet me Sefedinin, një herë me ty, — përfundoi Malia.

— Ehe! — qeshi me të madhe inxhinier Andrea.

— Avash, moj grua, se na nxore të gjitha të fshehtat në shesh, — ju përgjegj Fatmiri, duke u shkelur syrin të tjerëve.

— Po ti na nxore të gjitha sekretet e ndërmarrjes, o Fatmir, — i tha inxhinier Andrea me lot në sy nga të qeshurit.

— Tani të na thuash një gjë, moj Mali, — ndërhyri pas pak Kola. — Me cilin zihet më shpesh burri yt: me Sefedinin apo me Andrenë?

— Me Sefedinin, sigurisht, — ju përgjegj ajo duke vështruar nga ana e inxhinierit.

— E thua që të më bësh qejfin, a?

— Jo jo! e kam me gjithë mend, — tha Malia dhe, pasi hapi dritaren, shtoi: — U bë kuzhina gjithë tym nga cigaret...

Inxhinier Andrea prej kohe s'kishte qeshur ashtu me gjithë qejf. Pas atyre ditëve plot telashe, ngatërresa e net të tëra pa gjumë, kjo atmosferë e ciltër familjare e kjo bisedë e përzemërt me shokët e tij të punës, qe pér të si melhem në një plagë të fshehtë, por të thellë. Ai kishte ardhur këtu në shtëpinë e Fatmirit me një qëllim të caktuar: të bisedonte me të pér disa gjëra që ende s'ishin përcaktuar mirë në lidhje me oxhakun e të kthejë përsëri në fjetore a në zyrë pér t'u zhytur përsëri në vizatime e në kalkulime pa mbarim. Por aq shumë i pëlqeu biseda, saqë nuk i bënte zemra të hynte në temë menjherë. Do të kishin kaluar më shumë se dy orë, kur biseda e gjallë sikur u fasht ca dhe ai i tha të zotit të shtëpisë:

— Unë Fatmir erdi pér atë çështjen e djeshme.

— Sa mirë bëre, inxhinier! Dhe ne me Kolën thoshim se mos kishe ikur dhe s'kishim ku të të gjenim.

— Pse?

— Sepse kemi shumë gjëra pér të biseduar së bashku. Poo!

— A nuk shkojmë në vend? — propozoi Kola.

— Si thua ti, inxhinier? — pyeti Fatmiri.

— Kështu do të jetë më mirë, — mbeti dakord edhe inxhinier Andrea.

U nisën pra, që të tre pér në uzinë. Atje gjetën vetëm rojen, xha Idrizin, që mërzitej tepër gjatë ditëve të pushimit, kur mungonin punëtorët. Hangari i madh i mbushur me vegla pune e mekanizma të ndryshme ndërtimi, të jepte përshtypjen e orkestërës pas mbarimit të shfaqjes. Oxhaku në miniaturë, si një lojë fëmijesh e braktisur, dukej tani më i vogël në këtë hangar të madh pa njerëz. Po kur filluan të flisnin Fatmiri e Kola, u dulk sikur ky oxhak prej balte po rritej e po naltohej gjithnjë më shumë përparrë syvetë atyre që flisnin, por edhe përparrë syve të inxhinerit, që ndiqte bisedën e tyre i heshtur dhe i menduar...

13

Nga banesat e reja të qytetit e nga barrakat tanimë të vjetruara të kantierit, njerëzit niseshin grupe pér në punë. Në rrugën e shtruar, që të conte pér në uzinë, dukej një lëvizje e gjalléri e madhe. Ishte ende herët dhe bënte ftohtë. Por qe një i ftohtë i thatë dhe i lezeçëm, që të skuqte pak faqet e duart dhe asgjë më shumë. Ishte java e parë e marsit dhe marsi sjell me vete edhe buzëqeshjen e parë të pranverës edhe kërcëllimën e fundit të dhëmbëve të dimrit. Megjithëse dielli ende s'kishte dalë nga maja e malit të lartë, njerëzit gëzoheshin, se do të kishin një ditë të **kthjellët me mot të mirë. Punëtorët e ndërtimit, që punojnë vazhdimisht jashtë edhe kur bie shi edhe kur fryn murrlani, janë "gjendje të cmojnë më shumë se të tjerët, se sa vlen një ditë me diell në prakun e pranverës...**

Te sheshi i madh përparrë klubit lumi i njerëzve që **vinin** nga qyteti i ri, bashkohej me përruin e atyre që zbrisnin

nga fshatrat dhe pastaj të gjithë së bashku, vazhdonin rrugën për në uzinë. Befas mbi pullazin e kinemasë së lagur nga vesa e mëngjezit, u duk një njeri i gjatë. Njerëzit kthyen kokën andej dhe shquan Ruzhdiun, që s'kishte njeri në kantier që të mos e njihite. Ai ju drejtua menjëherë altoparlantit, të vendosur prej kohe mbi kulmarin e pullazit dhe me një pinsë në dorë nisi të shtrëngonte diçka me forcë. Nga hinka e altoparlantit doli një zë si i ngjirur, që herë pas here ndërpritej e nuk dëgjohej mirë. «Vini re... re!» Ruzhdiu u përkul përsëri mbi altoparlant, rregulloi difektin dhe zëri i folësit nga qendra e zërit të kantierit u dëgjua qartë: «Vini re! Vini re!»

Disa u bënë kureshtarë dhe pyetën Ruzhdiun nga rruga:

— Ç'kemi, o Ruzhdi?

— Kemi gjëra të reja, shokë! Gjëra të reja! — thirri Ruzhdiu nga pullazi me një zë më të fortë se altoparlanti.

— Ç'e duam altoparlantin që ma kanë vënë aty lart? Ku ka altoparlant më të mirë se Ruzhdiu? — bëri shaka një nga kalimtarët.

— Ngadalë, or shok, të marrim vesh një herë se ç'po bëhet. Si është puna o Ruzhdi, pa na thuaj tani...

— Nuk jua them tani. Në drekë nga qendra e zërit do të jepet një lajm me rëndësi, — ju përgjegj Ruzhdiu me një buzëqeshje kënaqësie e me një krenari të fshehur, që ai ishte në dijeni për lajinin e rëndësishëm, ndërsa të tjerët jo.

— Mos është si ajo punë e parvjetshme, o Ruzhdi, në Shkopet me atë filmin luftarak që na reklamoje aq shumë? — i thirri me të qeshur një eskavatorist trup-gjatë. Edhe disa të tjerë që e dinin këtë histori qeshën nga fjalët e eskavatoristit. Dhe ja ç'kishte ndodhur atëhere në Shkopet: Ruzhdiu, duke ditur se ndërtuesve të hidrocentralit u pëlqenin shumë filma me luftë, thërriti me të madhe një ditë të shtunë buzë akshamit: «Urdhëroni shokë në kinema për të parë filmin luftarak «Kasta Diva». Njerëzit e mbushën atë natë sa-

llén e kinemasë, po kur panë tjetër për tjetër i bërtiten Ruzhdiut. Dhe ai ju përgjegj: «Ku ta dija unë i shkreti? Unë me mendjen time thosha se do të kishte përleshje me dragonj e me diva...»

— Këtë radhë jo, — u foli Ruzhdiu nga lart. — E kam me gjithë mend se është një gjë e madhe për kantierin tonë.

— Ç'do të jetë vallë? — pyesnin punëtorët njëri-tjetrin. Rreth tyre u grumbulluan edhe të tjerë, që dëshironin të merrnin vesh sa më parë lajmin e madh. Mirëpo ora për fillimin e turnit të mëngjezit po afro-hej dhe ata u nisen për në uzinë... Edhe ata të turnit të natës, që ktheheshin nga puna për në shtëpi, e panë Ruzhdiun mbi pullazin e kinemasë, por ishin të lodhur e të përgjumur dhe e përshëndetën me kokë pa i thënë gjë...

Në drekë nga qendra e zërit u përhap anembanë kantierit lajmi: «Fatmir Reçi formoi një brigadë komplekse, që mori përsipër të ndërtojë oxhakun e madh të uzinës. Nesër bëhet inaugurimi i hapjes së themelive». U lexuan emrat e specialistëve të zgjedhur, që do të merrnin pjesë në brigadën për ndërtimin e oxhakut. Çdo pjesëmarrës kishte një histori më vete. Çdo emër të kujtonte carje tunelesh, devijime lumenjsh dhe diga hidrocentralesh, në veprat e mëdha të pesë-vjeçarëve.

Njerëzit, edhe ata që s'dinin gjë fare edhe ata që kishin dëgjuar se diçka po ziente në kantier për punën e oxhakut, mbetën për një çast pa folur. Pastaj shpërthyen nga të gjitha anët komente, mendime, vërejtje, parashikime, lavdërimë.

— E! Fatmir Reçi! E bëre fora këtë radhë! Të lumtë! — thoshte një punëtor i moshuar, duke hyrë në mensën e kantierit bashkë me një shok më të ri.

— Fatmiri ka trup të vogël që s'ta mbush syrin, por ai ka zemër të madhe. Mirë thotë usta Jorgji që ai është si një lumë i thellë, që s'bën zhurmë, por të mbaron punë, — shtoi tjetri.

Aty pranë tavolinës së tyre rrinin në këmbë pranë

banakut hekurkthyes, karpentierë e betonistë që bisedonin me zë të lartë:

— Dale, or juhu! — thoshte një karpentier që s'kishte shumë kohë në kantier. — A nuk është Fatmiri përgjegjës për ndërtimin e uzinës.

— Po, ai është i téri.

— Si u bëka brigadier atëhere?

— Ti Meto nuk e njeh mirë as jetën e kantierit as Fatmirin, — ju përgjegj një betonist me kominoshe të spërkatura me llaç. — Fatmiri, që kurse e mbaj mend unë, pumëtor i thjeshtë dhe brigadier ka qenë. Këtu në Gurrax u bë përgjegjës sektori.

— Pastaj, or vëlla, — plotësoi një hekurkthyes i shkurtër, — përgjegjës të sektorit vë një tjeter. Kësi njerëzish nuk gjen kollaj, të të marrin përsipër të ndërtojnë oxhakun më të lartë të Shqipërisë pa patur asnjë mbështetje. Kam dëgjuar se inxhinierët tanë thoshin se ky oxhak s'mund të ndërtohet pa ardhur një hallat i madh nga Evropa.

— Po, po, e kam dëgjuar edhe unë këtë gjë. Ndërsa Fatmiri me shokët e tij dalin dhe thonë: bëhet edhe pa të; ç'keni ju? E marrim përsipër ne!

— Dhe do ta bëjnë ata me siguri.

— Oj ky! Si buka që hamë, ore...

14

Fatmiri doli vonë atë natë nga zyra e kantierit të uzinës, që gjendej në një barrakë të vogël në mes të oborrit, të rrëthuar nga të gjitha anët me grumbuj të mëdhenj zhavorri e rëre, me stiva të larta dërrasash e materialesh të tjera ndërtimi. Dokumentat e kantierit ja kishte dorëzuar që paradite Baftjarit, që ishte caktuar në vendin e tij. Të nesërmien në mëngjez do ti dorëzonte atij çelësat e sirtarëve së bashku me kyçin e derës së zyrës dhe do të shkonte në vendin e caktuar pér hapjen e themeleve të oxhakut.

Kur doli nga zyra, në dritëhijen e mesores së

ngushtë të barrakës pa një djalë të gjatë, që ju afroa si me ndrojtje. Fatmiri e vështroi me kujdes dhe kur e njoihu, thirri si me habi:

— U?! Ti je, Gjetë?

— Unë, — ju përgjegj djaloshi duke ju afroar më shumë.

— E po si je, o Gjetë, si shkon, — e pyeti Fatmiri duke i zgjatur dorën. — A lodhesh nga pak a?...

— Dhe pa i dhënë kohë djaloshit të përgjigjej vijoi: — S'të shohim fare, o Gjetë, si kështu?

— Ja, me punë, shoku Fatmir; tash ma se nji muej kena qenë në fshat, për elektrifikim.

— Po kjo punë sikur mori fund.

— Ka tri ditë që ja çuem dritën edhe shtëpisë më largët.

— Shumë mirë, bre Gjetë, ju lumtë! Po babën si e ke?

— Mirë asht. Të ban të fala.

— Edhe ti ti thuash shumë të fala nga ana ime.

— Faleminderës, por ai ju pret në shtëpi. Sa herë më ka porositë t'ju them të na urdhroni në shtëpi, ti, e Sefedini, e Kola e inxhinier Andrea...

— Kemi pasur shumë punë, bre Gjetë, ndaj s'kemi ardhur.

— Ndryshe thotë baba: «Më harruen miqtë e parë të kantierit».

— S'është e vërtetë, i thuaj Palit. Shqiptari s'e harron kurrë mikun.

— Vetëm usta Jorgji na del si edhe ma parë, — shtoi Gjeta.

— Ju vjen ustai në shtëpi?

— Ou! Çdo javë.

Fatmiri vuri buzën në gaz dhe tha duke tundur lehtë kokën:

— Ustai i shikon këto gjëra... Po!

Duke ecur njëri pranë tjetrit, kishin dalë në oborrin e madh të uzinës. Fatmiri i hodhi një vështrim hetues djaloshit dhe e kuptoi se ai diç dëshironte t'i thoshte.

- Doje gjë, Gjetë? — e pyeti me dashamirësi.
- Unë kam ardhë për me të folë për çështjen e punës, — ju përgjegj djaloshi si i stepur.
- Si, nuk je mirë aty në brigadën e elektricisteve?
- Jo, aty jam shumë mirë, po... — dhe i riu ngeci.
- Hë, Gjetë! Folë! Ç'ke?
- Ja, due me ardhë në brigadën tandem...
- Në ndërtimin e oxhakut?
- Fatmiri i buzëqeshi një herë Gjetës dhe i ra lehtë me dorën e majtë shpatullave.
- E ke me gjithë mend? — e pyeti, pasi bënë disa hapa pa folur.
- Po, po! — ju përgjegj djali me guxim më të madh tani.
- Po a e ke menduar mirë këtë punë?
- Çfarë të mendohem? Atje besoj se do të ketë punë për vendosje kabllosh elektrike, për elektro-arganot e për gjana të tjera. Lene pastaj që unë mund të baj çdo punë tjetër...
- Nuk e kisha fjalën aty, — i tha Fatmiri. — Po doja të thosha se atje puna do të jetë e vështirë. Sa më lart që të ngrihet oxhaku, aq më e vështirë do të bëhet. Poo!
- E di...
- Dhe ta merr mendja se mund ta bësh, or djalë?
- Si nji e nji që bajnë dy. Më merr nji herë, shoku Fatmir, e po s'e bana mirë punën që do të më ngarkosh, të më përzesh menjiherë.
- Fatmiri qëndroi aty në të dalë të kantierit. Një llambë e fortë elektrike ndriçonte krejt vendin rrëth e rrrotull. Ai shikoi një herë fytyrën e nxirë nga dielli të Gjetës, i shtrëngoi një herë krahun më forcë dhe e kuptoi menjëherë se s'kishte të bënte më me një të ri që s'di ç'kërkon, por me një djalosh të formuar në punë, që fliste me vendosmëri.
- Domethënë të është mbushur mendja se mund ta bësh? — e pyeti edhe një herë Fatmiri.

— Si buka që hamë... Mandej kam edhe nji gja: më thanë se atje njerëzit do të punojnë me litar. Edhe unë mund të punoj kështu.

— Shiko, shiko!

— E kam me gjithë mend — Gjeta fliste tanë lirshëm. — A e ke pa atë shkamb të zhveshun që bie thikë mbi gurore? Aty vinin në dimën tufa pëllumbash, të egjér. Ne çunat e lagjes sonë shkonim aty natën për t'i zanë. Por a mund të kacaviresh lehtë gjer aty lart ku strukeshin pëllumbat? Atëherë doli nji çun e tha: «E dini si bahet kjo punë? Të varet njeni nga nalt me litar». Po kush të varej se... Unë e kundrova nji herë vendin, m'u mbush syni se mund ta bajsha këtë punë dhe u thashë shokëve: «Sillni nji litar të fortë e varem unë». E kështu bana. U lidha me litar dhe u futa brenda në guvë, ku strukeshin pëllumbat...

Fatmiri qeshi me qejf dhe i tha si me shaka:

— Po këtu nuk është puna për të kapur pëllumba...

— As unë nuk jam ma kalama — nguli këmbë djaloshi.

— E di si do të bëjmë, Gjetë? Nesër do të vendosim për punën tënde. Ti mendohu edhe një herë sonte, bisedo edhe me Palin...

— S'më thotë gja baba për kësi punësh.

— Mirë, mirë, ti fjalosu një herë me atë.

— Dhe nesër të paraqitem tek ti?

— Po të të mbushet mendja rishtas...

— Ka marrë fund kjo punë! — thirri me gëzim Gjeta dhe mori monopatin drejt fshatit.

II. FRYMËMARRJA E QYTETIT TË RI

«Ardhja e familjeve të para i dha një notë të re qytetit në ndërtim. Nëpër rrugët e kantierit u dukën jo vetëm gra, por edhe fëmijët e parë, që vështronin rreth e rrotull me kureshtje të madhe. Dhe ndërtuesit, me duart e tyre të ashpra e plot kallo, i përkëdhelnin me dashuri, sikur të ishin të tyre...»

1

Inxhinier Andrea, duke u marrë përditë me problemet e vështira, që i kishin dalë aq papritur në ndërtimin e uzinës e të qytetit të ri, sikur e kishte braktisur për një kohë çështjen e Dranës. Ai nuk e kishte harruar aspak, por të paktën nuk tregonte më atë interesim, si në ditët e javët e para pas festivalit folkloristik. E vërteta është se sa herë e takonte vajzën në labirintin e rruginave, a në skelat e panumërtë të uzinës, ndjente si një fërgëllim të befasishëm në gjithë trupin e një rrähje të fortë zemre në kraharor.

Në një nga ditët e stuhihme, kur duhej të merrej një vendim pér ndryshimet në projektin fillestar e sidosmos pér ngritjen e oxhakut të madh të uzinës, ai e pa prej së largu Dranën, që kaloi me shpejtësi dhe u fsheh prapa një kapice të madhe shtyllash betoni. Megjithëse nuk e kishte andej punën, ai ndërroi menjë-

herë rrugë dhe u drejtua nga ajo. «Vajza e kantierit! — me një carro dore transportonte tulla e materiale të tjera ndërtimi, nga vendi i shkarkimit te vinç i madh, ku punonte Malia. Kur zbrazi karron, fshiu shpejt e shpejt me mëngë ballin e djersitur dhe u kthyte me vrap. Vetëm atëhere e vuri re Andrea se ajo qe vesur me pantallona. Fytyra i qe nxirë nga dielli dhe kishte marrë tamam pamjen e një punëtoreje të ndërtimit.

Ashtu siç ecte me shpejtësi, era i ngrinte flokët e zez mbi ballin e lëmuar dhe i jipte një hijeshi të veçantë.

Inxhinier Andrea i doli përpara dhe i tha si pa të keq.

— Tani po, të kanë lezet këto rroba...

— Hape rrugën! — mundi t'i thoshte ajo duke kthyer nga e majta karron dhe u bë prush në fytyrë.

Andrea donte t'i fliste edhe më, por ajo u largua me të shpejtë drejt grumbullit të madh të tullave e të materialete të tjera të ndërtimit. Po pasi bëri disa hapa përpara, ajo qëndroi pak, ktheu kokën dhe i buzëqeshi si me ndrojtje sikur donte t'i thoshte: «Mos i merr për keq fjalët e mia, se unë nuk zemërohem me ty. Sikur ta dije se ç'ndjej në zemër kur të shoh, që po i afrohesh vendit ku punojmë ne!»

Ai mbeti edhe pak aty në vend duke vështruar nga ana e saj, tek përkulej për të mbushur karron me tulla. Ja kishte ènda që të priste gjersa ajo të kalonte përsëri pranë tij, që t'i thoshte ndonjë fjalë, por mendoi se mund të binte në sy dhe u largua. Më vonë, kur puna e oxhakut u duk sikur kishte marrë një rrugë, të paktën gjer në ndërtimin e pjesës së parë, ai kalonte andej thuajse përditë. Por nuk e gjente gjithnjë Dranën me carro në dorë duke vrapuar poshtë e lart. Ajo mbaronte punën që kishte për të bërë, grumbullonte një sasi materialesh pranë vinçit, pastaj shkonte te Malia për të vështruar nga afër se si i lëvizte ajo marshet, ganxhat dhe litarët e çeliktë të asaj maqine të madhe. Një ditë Andrea kaloi andej në kohën e pushimit të drekës dhe e pa Dranën të hipur

në kabinë, ndërsa Malia i shpjegonte se si funksiononin mekanizmat e drejtimit të maqinës. Ajo e pa nga kabinë e vinçit dhe u skuq e tëra në fytyrë.

Kur filloi puna e pasditës, ai gjeti rastin dhe i tha Malisë si me shaka:

— Si shumë afër e mban Dranën, moj Mali.

— Jemi bërë shoqe të ngushta, shoku kryeinixhiner, — ju përgjegj ajo, duke e vështruar me një buzë-qeshje të hollë që tregonte se asaj nuk i kishte shpëtuar qëllimi i Andresë.

— Ajo kërkon të mësojë përdorimin e vinçit. Ka ndonjë të keqe këtu?

— Përkundrazi.

— Dhe unë ja mësoj zanatin...

— Ashtu?

— Po, po! E di sa me qejf e ka?

— Po të jetë kështu, pse s'na thotë që ta ndihmojmë? Ta vëmë në ndonjë kurs, a?...

— Nuk do të ishte keq të merrte pjesë në ndonjë kurs, shoku kryeinixhinier. E di sa e zgjuar është? Ta dish se ka për të ecur shumë përpëra, se edhe shkollën e natës e ndjek, edhe në kurs mund të marrë vjesë.

— Po të na kishte thënë.

— S'e njeh mirë ti inxhinier. S'kërkon gjë përvete ajo, joo! As që i lutet njeriu. Është tamam malësore, ta dish.

Andrea u mat një herë që t'i thoshte: «E njoh, e njoh», por u pendua se me këto fjalë mund ta bënte bashkëfolësen që të dyshonte akoma më shumë. Malia e vështronë që rrinte kështu si i menduar e i pavendosur, e thoshte me vete: «Ka rënë në siklet të madh ky... Është e qartë se diçka ndjen ai për Dranën. Si s'më ka thënë gjë ajo? Po ku ta dish! Ndoshta as ajo vetë s'di gjë me siguri. Fillimi i dashurisë është si një zjarr i vogël, që edhe mund të kthehet në flakë, por edhe mund të shuhet nga era».

— Do ta shohim këtë çështje, do të interesohem edhe unë për Dranën, — tha më në fund inxhinier

Andrea dhe u largua për në oficinë, ndërsa Malia i hodhi një vështrim të shpejtë, sikur donte t'i thoshte:
«E kuptova shoku kryeinxhinier, e kuptova...»

Pallati pesëkatësh i qytetit të ri, megjithëse qe mbaruar prej kohe, nuk ishte marrë në dorëzim nga komiteti ekzekutiv i lokalitetit, për shkak të disa mungesave në instalimet hidraulike të apartamentave. Ndreqja e këtyre difekteve u bë me vonesë, kështu që ky pallat u dorëzua në prak të pranverës, tre muaj e ca pas dorëzimit të pallateve të tjera.

Inxhinier Andrea kishte mundësi të merrte prej kohe një dhomë për vete, ku të punonte natën me projektet e ndërtimit, ashtu siç e kishte zakon. Mirëpo aq shumë i kishte pëlqyer shoqëria me banorët e parë të barrakës së parë, saqë nuk i bënte zemra të ndahej nga ata. Edhe kur përfunduan pallatet e para dhe ju caktua një dhomë e mirë, ai e shtyu nga dita në ditë largimin e tij nga fjetorja. Kështu që dhomën e caktuar për të, që të mos mbetej për një kohë të gjatë bosh, ja dhanë një punëtori, që kishte nevojë të mëdhe për strehim. Por tani që përfundoi pallati pesëkatësh s'mund ta shtynte më shumë largimin e tij nga barraka. Po ja ndjente gjithnjë e më shumë nevojën.

Një pasdite të freskët, në fillim të pranverës, ai doli nga barraka numër një me një valixhe e një vandak të madh projektesh në dorë. Rrugës për të vajtur në banesën e re, mendonte e thoshte me vete: «Koha që qëndrova në këtë barrakë të vogël, më duket edhe e shkurtër edhe e gjatë. Ka kaluar afro një vit e gjysmë që nga dita që fjetëm për herë të parë aty me usta Jorgjin, me Sefedinin, me Fatmirin, me Kolën e me Postolin... Por mua më duket sikur qe dje. Sa ngjarje ama, kanë ndodhur këtu, gjatë kësaj kohe!... E sa kujtime po marr me vete ngajeta imë në atë barrakë të vogël!.. Prandaj dhe qëndrova

atje pér një kohë aq tē gjatë. Po mos ka edhe ndonjë arësyet tjetër? Ka, si s'ka. Ka një arësyet tjetër që as vetes nuk doja t'ja shifaqja haptazi; se më pëlqente ta lija më mirë kështu tē turbullt e tē papërcaktuar. Por tani s'mund ta mbaj më tē fshehtë nga vetja ime. Jo! Kështu pra. Gjersa flija aty në barrakë, e konsideroja veten si banor tē përkohshëm tē Gurrajt, ashtu siç qe e përkohshme edhe barraka vetë. Dhe s'më bënte zemra tē vendosesa në një godinë me themele tē forta, se më dukej sikur do tē lëshoja rrënëtë tē thella në tokën e këtushme. E kjo s'më pëlqente ta pranoja. Po tani s'e kam më atë frikë. Iku ajo si vapa me gushtin që i thonë fjalës...»

Në shkallën e mesit tē pallatit pesëkatësh, ku gjendej edhe dhoma e tij, pa një kamion që shkar konte plaçka shtëpiake. «Po vinë banorët e qytetit të ri, po vinë» — tha me vete, duke ecur ngadalë. Rrotat dhe parafangot e kamionit ishin bërë tërë baltë, sepse kishte bërë një udhëtim tē gjatë. Dy fëmijë dhe një mesoburrë kishin hipur mbi karrocerinë dhe shkarkonin radhë e pa radhë sende tē ndryshme shtëpie: një dollap tē vjetër, një sofër tē madhe, enë kuzhine dhe shtresa e mbulesa ngjyra-ngjyra. Inxhinier Andrea i përshëndeti njerëzit që shkarkonin kamionin dhe u fut në shkallë.

Jashtë derës së apartamentit tē parë ai pa një djep druri bosh. Djepi qe mjaft i vjetër, por lulkat e bëra me bojë tē kuqe në dërrasat e holla, dalloheshin ende mirë. «Hë, — ja bëri me vete inxhinieri, duke vënë buzën në gaz. — Kushedi sa fëmijë janë rritur në këtë djep! Tani ai eshtë bosh; por nesër pasnesër nuk do tē jetë më pa gjë brenda. Ata që do tē lindin këtu do tē jenë banorët e ardhshëm tē këtij qyteti, që po ndërtojmë ne tani. Ndoshta ky djep ka qenë gjer tani në ndonjë kullë tē moçme; ndërsa fëmijët që do tē lindin këtu, do tē rriten në apartamentet plot drithë tē qytetit tē ri...»

Duke ju ngjitur shkallarëve u pengua në diçka dhe rrëzoi një vandak tē madh që ra përdhe pa bërë

zhurmë. «Dreq! — tha ai, — çfarë do të jetë kjo?» Ngriti vandakun e lehtë dhe pa se ishte penguar në ca rrigoza. Edhe në katin e fundit atë ditë kishte ardhur një familje e re në apartamentin karshi dhomës së tij. Në kryeshkallë kishte ende rrangulla, që nuk ishin futur brenda. Midis të tjerave pa përséri rrigoza. Buzëqeshi padashur dhe tha: «Shtresat e varfëra po hyjnë në pallatet e reja. Vegjëlia merr në dorëzim qytetin e vet.»

Hyri në dhomë, la valixhen prapa derës, vështroi një herë rrëth e rrötull dhe u kënaq. Kola e kishte rregulluar dhomën mirë. Hodhi vandakun e projekteve mbi shtratin e shtruar dhe hapi dritaret e dhomës. Përpara tij u hap një panoramë jo e panjohur për të. Por tanë që e vështronë nga kjo dritare e lartë, ju duk sikur e shihte për herë të parë. Në bregoret që ngriheshin njëra pas tjetrës, shkurret e dendura kishin mugulluar, ndërsa në malin që ngrihej madhështor prapa tyre, pylli shekullor ende nuk e kishte ndjerë afrimin e pranverës. Nga ana tjetër shtrihej fusha, një fushë e gjerë dhee rrafshëtë, që mbaronte ajte ku filonte deti i kaltër. Vendësit thoshin se kjo fushë para disa vjetësh mbushej në verë me lejlekë e në dimër me rosa, kurse tanë, në vend të tyre të shihte syri kudo traktorë dhe eskavatorë...

Puna e parë që bëri Andrea kur hyri në dhomë, ishte që të vendoste radion. Pastaj hapi valixhen, mori disa libra dhe një takëm boje e nisi të rregulonte tavolinën e vogël, të vënë në mes të dhomës. Në atë çast u dukën te dera usta Jorgji me Kolën. Plaku si gjithnjë mbante sqeparin në brez.

— Mashalla! Mashalla! Sa mirë e takamise, or djalë, — nisi i pari usta Jorgji, duke vështruar rrëth e rrötull.

— E po kështu duhet. Këtu nuk je më në barrakë dhe çdo gjë duhet të jetë e bukur, e hijshme, — shtoi Kola.

— Kur e rregullova kaq shpejt, bre Andrea?! Pa dale, ç'më shohin sytë këtu? — ndërrroi befas bisedën

dhe u drejtua nga shtrati i inxhinierit për të vështruar nga afér disa fotografi të ngjitura në mur. -- Shiko ç'vajza të bukura, ë?

— Janë vajza të botës, usta!

— Unë kujtova se do të ishte edhe e jotja, këtu...
— Jo, bre usta, jo.

— Leri llafet tani Andrea. Nga unë do të fshihesh ti?

— S'më beson? Ja shihi... janë marrë nga revistat...

— Kjo këtu lart një herë nga ty i ka kthyer sytë, miku im. Sikur të vështron në beben e syrit, duket. More vesh? Dhe sikur do të të thotë: «C'bën hala, or djalë! Pse s'kujtohesh pak edhe për mua?» Po nejse. Tani ke ndonjë gjë për të rregulluar këtu? Se unë kam marrë edhe hallatet me vete.

— Sikur i more vetëm sot ti veglat me vete, — deshi ta ngacmonte Kola. — Ti nuk ndahesh kurrë nga çekiçi e nga sqepari. Edhe në klub, edhe në kinema me sqeparin në brez shkon.

— Pse, bëj keq thua ti? Edhe në klub edhe në kinema bën vaki që të hyjnë në punë hallatet e ustait. Se atje në ndenjëse ku do të ulesh, mund të ketë ndonjë gozhdë të pambërthyer mirë, që të shpon e të gris pantallonat edhe brekët bile. More vesh?

— Ustai është hazër-xhevap, — tha Kola si përt'i ardhur në ndihmë inxhinierit.

— Këtë radhë nuk erdha kot, xhanëm, me hallatet në dorë. U mendova një herë dhe thashë: «Kush i ka ndërtuar këto pallate të qytetit tonë? Ja, unë, Kola, Lleshi, e më the e të thashë. More vesh? Tani, or babë, pse të fshihemi prapa gishtit? Ne e kemi zakon që të lëmë ndonjë gjë mangut a të bërë keq. Apo jo, o Kolë?

— Po këtu në dhomën time sheh ndonjë të metë, usta? — pyeti inxhinier Andrea.

— Do të thuash për ndonjë gjë mangut?
— Pikërisht.

Usta Jorgji bëri sikur vështroi një herë gjithë

dhomën, dhe duke i shkelur syrin Kolës, u përgjegj:

— Oj ky! A ka ndonjë gjë mangut, thotë! Ka, edhe një gjë të madhe, bile!

— Çfarë? — pyeti me interesim inxhinier Andrea duke shikuar nga të gjitha anët e dhomës.

— S'të bie në sy, or pëllumbi im? Të mungon nusja, Andrea, nusja! More vesh?

— Shiko ku e hodhi fjalën ustai!

— Pse, e paktë është kjo? Ç'e do një odë të bukur si kjo, pa nusen brenda? Me këto goca në letër që më ke ngjitur atje në mur, do të ngelesh ti?

— Jam në qejf sonte, — vijoi pas pak usta Jorgji.

— Ti gjithnjë në qejf je, dhe të këndon gjuha pa pushim, — e ngacmoi Kola.

— Unë nuk jam murg, or babë, që të rri turri-varur. More vesh? Po sonte jam me të vërtetë në orë të mira.

— Pse këshfu, o usta? — e pyeti inxhinieri.

— Nuk e di si të ta shpreh, or djalë i mirë. Po ja, sa herë përfundon një godinë e re dhe shoh familje të hyjnë në oda ku kam punuar edhe vetë, ngazëllehem menjëherë. Dhe më vjen të këndoj. More vesh?

— Pa pirë raki?

— Më mirë me pak raki, sigurisht. Rrobi i do të gjitha, or byrazer. Ja, edhe inxhinieri ynë, nuk do të kishte bërë keq të kishte marrë ndonjë litroshe me raki sonte...

— Rakinë mund ta marrim edhe tani, o usta, po s'kemi as gota, as pjata, as meze.

— Ore, gotat e pjatat mos i zërë në gojë, se bëjmë edhe pa to. Sa për meze, po, ke hakë. S'pihet e shkreta pa një çikë tagji...

— Ndonjë ditë tjetër usta. Të thërrasim edhe Fatmirin, edhe Sefedinin...

— Tani i ka rënë në të. Të kemi edhe Sefedinin këtu e të filloni ju pastaj nga tuajat. Jo si do të bëjmë për oxhakun, jo na mungon çimentoja, jo kemi ngelur prapa me planin e më the e të thashë... Jo, or babë.

Rakia lyp me të vërtetë meze të mira, por do edhe muhabet të émbël. More vesh?

Vizitorët e parë të dhomës së re u larguan dhe inxhinier Andrea mbeti vetëm. Hapi radion e vogël sa një kuti dhe bariti poshtë e lart në dhomë. Dhomë e re dhe e pastër i falte një kënaqësi jo të vogël, por në thellësi të shpirtit ndjente njëkohësisht edhe një si zbrzesirë. Qëndroi pranë tavolinës dhe vështroi projektet e mbështjella në vandak. Hodhi një shikim të shpejtë në dhomë dhe vuri buzën në gaz. Ju kujtua dëshira e tij e vjetër që të kishte një dhomë për vete, një dhomë të mirë, «sa për një beqar». Kur kishte filluar nga puna në drejtorinë e projektiveve, punë e parë që kishte bërë, ishte të siguronte një dhomë. Tani që kishte një dhomë të tillë, që s'ë kishte pasur asnjëherë, e shikonte se kjo gjë nuk i mjaftonte...

Muzika që transmetonte radioja, mori fund. Inxhinier Andrea e mbylli radion dhe hapi dritaren. Një erë e freskët, që zbriste nga mali, mbushi dhomën menjëherë. Ai mbështeti bërrylat mbi parvazin e dritares dhe vështroi jashtë. Në pallatin përballë, një dritë u fik. Por edhe në errësirë atij i dukej sikur dallonte njerëzit që bëheshin gati të flinin. Pak më poshtë, në katin e parë, dukej një dritë e ndezur. Prapa perdeve të dritareve dalloheshin hije njerëzish që lëviztin. «Qytetit të ri, banorët e parë i dhanë një hijeshi të vecantë. Mirë thotë Fatmiri se tymi që del nga oxhaqet e apartamenteve të reja është frymëmarria e qytetit tonë të ri...»

I erdhën ndër mend ato që kishte lexuar nëpër libra, për ndërtimin e qyteteve të mëdha. «Në ato kohëra, duheshin dhjetëra e qindra vjet për të ndërtuar një qytet të ri. Në fillim ngríhej një fshat i vogël në ndonjë gji deti o pranë një lumi të madh. Pastaj do të kalonin shekuj që qyteti të merrte formë... Ndërsa tek ne tani të ndërtohen nga hiçi një qytet i ri me një shpejtësi të quditshme. Para një viti banorët e këtyre pallateve flinin nëpër barraka...» Ju kujtuan fjalët që i thoshte usta Jorgji atë ditë të festivalit në kine-

ma. «Merre me mend, Andrea, si do të bëhet Gurraj pas dhjetë vjetësh! Eh! Vetëm të jemi gjallë që të shohim!».

«Sa në qejf ishte sonte usta Jorgji! — vijoi bisetdën e tij me vete inxhinier Andrea. — Ndoshata edhe gëzimi që ndjeva unë sot kur hyra në dhomë, ka po atë burim, si ngazëllimi i ustait dhe nuk vjen nga shkaku që mora dhomë për vete. Këto pallate që u ndërtuan këtu, unë i kam vështruar i pari kur qenë si kuti të vogla në letrat e mëdha të projekteve, që më vonë kanë hedhur shtat mbi këtë truall nga duart e ndërtuesve...»

Nga ana e kodrës naltohej një pallat pesëkatësh, ende i papërfunduar. Një llambë e fuqishme elektrike hidhte dritë përpara godinës karabina, ku kishte makineri dhe materiale të tjera ndërtimi. Roja i natës bridhë poshtë e lart mbështjellë me një kapotë të vjetër ushtarake. Befas roja ndaloi. Një burrë i gjatë me një peliqe të vjetëruar doli nga qoshja e godinës dhe ju afroa rojes. Ata të dy biseduán, bënë një copë rrugë bashkë rrëth godinës karabina e ndezën nga një cigare. Pastaj burri i gjatë ju ngjit kodrës ku ndërtohej depoja e madhe e ujësjellësit.

«Mos éshtë Sefedini? — u habit inxhinier Andrea. — Po ai do të jetë» — tha pas pak kur pa më mirë siluetën e tij të gjatë që humbi prapa disa shkurreve të kodrës. «Interesant me këtë njeri! Nuk e zë gjumi pa bërë një inspektim në të gjitha objektet. Në fillim ai ka qenë një enigmë përmua. Ç'i shijon jetës ai? — pyesja veten. Në shtëpi shkon rrallë e përmall. Në kinema shkon apo nuk shkon një herë në vit. I rakisë nuk éshtë. Librat nuk i zë me dorë. Dëfrime të tjera nuk di. Atëhere? Por duke jetuar me të, pashë se ai ka një pasion të madh: pasionin e ndërtimit. Pasionin e ndërtimit e kanë të gjithë këta, që rrojnë në kantier, por ai e ka më të fortë se të tjerët. «S'ka gjë më të bukur se sa të ndërtosh» — thotë shumë herë Sefedini. Fatmiri thotë mirë për atë: «Sefedini ka një thes me të meta, por ka një të mirë të madhe, që i fshin

të gjitha huqet dhe veset që ka: merakun për punën e ndërtimit».

Dritat u fikën një nga një nëpër dritaret e apartamenteve. Qyteti i ri po flinte. Inxhinier Andrea mbylli dritaren me kujdes dhe ra në shtrat. Po dritën e la të ndezur, se nuk i flihej. Nuk i hiqej nga mendja Sefedini. «Tani, — mendoi, — do të jetë majë kodrës. Të jetë edhe ai romantik? Pse jo! Secili nga ne është romantik sipas mënyrës së vet. Njeri gjen poezi në një gjë që tjetri e quan dhe e vështron si gjënë më të zakonshme... Tani Sefedini do të jetë duke u kthyer për në fjetore dhe në shpirt ndjen po atë kë-naqësi që provon njeriu, pasi lexon një libër të bukur. Po nesër në mëngjez e ke që në agim te oxhaku i uzinës...»

Oxhaku i kujtoi të gjitha telashet dhe ngatërrresat e ditëve të fundit.

Në dhomë kishte një qetësi të plotë. Edhe në rrugët ende të pashtuara të qytetit të ri, nuk ndjehej asnjë lëvizje. Herë-herë arrinte gjér aty zhurma e hapave të rojes së natës në sheshin e madh përparrë godinës karabina. Andrea vështroi një herë në tavan. Duke vështuar tavanin, se si ju kujtua për një çast dhoma që kishte pasur në Tiranë, para se të vinte në Gurraj. Sa kujtime të ëmbla i zgjonte ajo dhomë e vogël në atë rrugicë mu në qendër të qytetit! Kjo dhomë e re këtu në Gurraj ishte për të si një letër e bardhë, që i fliste vetëm për të ardhmen... Dhe menjëherë përparrë syve të tij doli Drana, ashtu si e kishte parë ditët e fundit të veshur me pantallona e duke vrapuar me karron e mbushur me tulla e llaç, apo në kabinën e vinçit duke lëvizur marshet...

«Po pse Drana? — pyeti veten si me habi. U përpoq të mendonte diçka tjetër. Por një zhurmë shurdhuese betonjerash, vinçash, eskavatorësh, buldozerësh e trasportjerësh, ashtu siç ndodhë kur puna në ndërtim arrinte në kulm, ja kaptoi mendimin. Dhe mbi këtë zhurmë të potershme mbizotëroi kërkëllima e një karroje, që i kalonte me shpejtësi aty përparrë. Sapo

largohej karroja disa hapa më tutje, një vajzë qeshkane kthente kokën dhe e vështronë në sy me një buzë-qeshje që fliste aq shumë! Pas pak ajo largohej, por fytyra e saj i mbetej e ngulitur në mendje dhe zemra e tij vazhdonte të rrihte me shpejtësi. «Në fillim këtë çështje e kam marrë si diçka të vogël; tani po shoh se ajo vajzë po më hyn në zemër — tha përsëri me vete. — Si mund të shpjegohet kjo? Unë nuk jam axhami në kësi gjérash. Kushedi sa herë u kisha thënë shokëve se në punët e dashurisë nuk duhet nxituar, sepse nuk është aspak e lehtë të njohësh mirë një vajzë. Po për Dranën puna qëndron ndryshe. Ç'është e vërtetë mua më magjepsën në fillim sytë e saj të zeza, sytë e saj të bukur, që sa herë t'i shikosh aq më të bukur të duken. Po tani sikur nuk janë vetëm syt që më tërheqin... Para disa ditësh erdhën këtu në Gurraj ata të hidrogjeologjisë që bëjnë shpime në fushë për të gjetur burime uji për nevojat e uzinës e të qytetit të ri. Kryegjeologu më mori me vete dhe vajtëm në vendin e kërkimit. Rrugës nuk më kallëzoi gjë për zbulimin që kishin bërë. Kur ju afruam vendit ku bëheshin shpimet, pamë ujin e kthjellët, që gëlononte me hov nga një pus i thellë. «E shikon?» — më tha kryegjeologu. — «Është fat i madh për qytetin e ri... Ky ujë i kthjellët e i kristaltë, që buron këtu, vjen nga bjeshkët e largëta, nga shkrirja e borës në malet e larta. E ja që na doli këtu mu te dera e qytetit tuaj...» Në atë çast m'u kujtua Drana zeshkane e syzezë, që ashtu si uji i kristaltë edhe ajo kishte zbritur nga malësia dhe tani është bërë «vajza e kantierit»... Ç'të veçantë ka Drana, përvëç bukurisë, që më t'rheq aq shumë? Mos është guximi i saj që të çajë përrapa në jetë? Vërtet q'peshë e madhe rëndonte e rëndon ende mbi shpatullat e saj të njoma! Gjithë fanatizmi dhe prapambetja e shekujve, donin t'ja mbyllnin asaj rrugët e jetës... Por ajo nuk ju nënshtrua fatit të verbër. Gjer tani ka bërë hapa shumë të guximshëm për të thyer prangat, me të cilat e kishin lidhur këmbë e duar që në fëmini. Atë ditë që e thirri Fatmiri që

t'i thoshte se Martini i gurores e kishte pushuar pardrejtësish nga puna, ndaj atij i qe hequr veshi fort, ajo uli kryet, u skuuq në fytyrë e tha me një frymë: «Kantieri asht ba pér mue nanë e babë...» Dhe pérnjëherësh më vështroi mua. Sa shumë fliste vështrimi i saj! Se ç'zjarr digjte në sytë e saj të zi! Donte të fliste edhe më, donte të thoshte edhe diçka tjetër, por zéri ju mbyt në fyt dhe doli si e ciruar nga një peshë e rëndë. Ja, kjo éshtë Drana, që hallet e jetës nuk e kanë thyer por e kanë bërë më të fortë. Andrea solli ndér mend se ç'kishte ndjerë në atë minutë pér atë vajzë të vuajtur dhe një dridhmë e fortë i kaloi në kraharon.

I shtrirë në shtrat në dhomën e tij të re, në këtë pallat të ri, pér ndërtimin e të cilit edhe ai ka derdhur mundin e tij, e ndjen veten edhe të gëzuar edhe të shqetësuar. I vinë ndërmend bisedat e tij me shokët para se të vinte në Gurraj dhe planet që bënte atëhere pér martesën. «Para se të mbush të tridhjetepesat, si do që të vijë puna, nuk marto hem. Përse të nxitohem?» Kështu mendonte e kështu fliste në atë kohë. Po tan? Ai para katér-pesë muajve mbushi të njëzetetetë. Dhe atëhere bëri një festë të vogël aty në barrakë...

Sipas mendimit të mëparshëm, i duheshin ende disa vjetë që të lidhë fatin e vet me një grua. Po si mendonte tan: «Nuk éshtë thënë që të bëhet domosdo kështu — Se kjo punë nuk i ngjan aspak projektit të një ndërtese që bëhet me laps dhe ka një grafik të caktuar pér tu kryer. Se në këtë mes éshtë edhe një faktor tjetër, që unë më parë e nënvoileftësonja, por tan filloj të ndjej mirë forcën e tij...»

«Ah, moj Dranë!» pëshpëriti dhe u hodh nga shtrati. Eci disa herë nga një qoshe në tjetrën të dhomës së re. Herë-herë ngryste vetullat nga kujtime të largëta, herë-herë vinte buzën në gaz. «Endërrroja gjithnjë të gjeja një vajzë edhe të pashme, edhe të mençur, edhe të ndershme, edhe me shkollë. Vetëm kështu mund të kesh një shok jete që të merresh vesh — më pëlqente të përsërisja. Dhe mendja më shkonte te

Shemshiu, te shoku im i ngushtë i shkollës. Gruaja e Shemshos është arkitekte; ai inxhinier. Ata përveç dashurisë i bashkon edhe puna. Me një grua të tillë si e Shemshos të ka lezet të fjalosesh. Në sallon të shtëpisë së tyre mund të gjesh lloj-lloj albumesh nga arkitektura e vendeve të ndryshme nëpër shekuj. Dhe kur ndizet biseda për qytete të vjetra e të reja, ajo të bën për vete jo aq me njojuritë e saj se sa me pasionin e madh për arkitekturën... Po Drana?...»

Për një çast ju duk sikur Drana e vështroi më zemërim të thelli. «Mos u prek moj Dranë, — donte t'i thoshte. — Ti ke diçka të veçantë për mua që s'e kanë pasur vajzat e tjera që kam njojur gjer tanë.»

U shtri përsëri në shtrat dhe mbylli sytë.

Natën i doli Drana në èndërr. Ajo një herë ju shfaq si atë natë, që e kishte parë për herë të parë në provat e festivalit. Pas pak i doli e veshur me kominoshe aty në oborrin e uzinës. Po jo me karrocë dore. Ajo kishte hipur në një skelë dhe i pëshpëriti: «Andrea! Eja!» I zgjati dorën dhe ai hipi në skelë. Të zënë prej dore të dy u ngjitën më lart në muret ende jo të përfunduara të uzinës. Ai i shtrëngonte dorën dhe ajo i buzëqeshte. Punëtorët e ndërtimit i vështronin me dashamirësi. Dhe ai nuk ruhej më nga syri i tyre. Ja dhe usta Jorgji. I hodhi një vështrim nga poshtë dhe i thirri: «Më të lumtë, Andrea! Kështu të dua!»

Gjumi i doli para se të lindte dielli.

U vesh me të shpejtë dhe u nis për në uzinë, ku e priste tanë edhe Drana. Hapat i hidhite shpejt, sikur fluturonte, që të arrinte sa më parë atje...

Usta Jorgji nuk e dintë se organizata bazë e partisë, duke marrë në shqyrtim çështjen e ngritjes profesionale të punëtorëve, kishte marrë vendim që disa të rinj nga kantieri të dërgoheshin në teknikumin e ndërtimit e në shkollat e rezervave të punës. Një nga

ata ishte edhe Pashku, i cili vazhdonte të punonte gjithnjë me usta Jorgjin.

Kur i tha Azisi se do të shkonte në shkollë, djaloshi u hodh lart nga gëzimi. Po pas pak, sikur u kujtua për diçka, që në çastin e parë s'e kishte menduar fare, uli kokën dhe pyeti:

— Kur duhet me u nisë?

— Pasnesër, — ju përgjegj Azisi.

— Kaq shpejt?

— Sa më shpejt aq më mirë, Pashk. A po jo?..

Djaloshi tundi një herë kokën sikur donte të thoshte: «Kështu është, por ku mund ta dish ti se si e ka hillin tjetri?..»

— Sot e nesër mund të shkosh në fshat e pasnesër vjen herët në mengjez, — ndërhyri Burhani, që s'e dinte mirë gjendjen familjare të Pashkut.

— Unë në katund s'kam njeri — ju përgjegj si me drojtje djaloshi. — Po desha të bisedoja nji herë me nji njeri që kam këtu në kantier.

— Me Fatmirin?

— Jo, me usta Jorgjin.

— Mirë, o Pashk, mirë. Ti bëhu gati, pa me usta Jorgjin e rregullojmë ne punën.

Mirëpo usta Jorgji e priti me këmbë të para Azisin, kur i foli për punën e Pashkut.

— Je në vete ti, o Azis? — e ndërpree ustai si i revoltuar, pa mbaruar mirë fjalën tjetri. — Pashku po bëhet që tani murator i mbaruar, përsë ta dërgoni në shkollë?

— Pashku është i ri, usta, dhe do të shkojë përrpara. Prandaj, ti, po t'i duash të mirën, mos i myll rrugën...

— Unë nuk e lë djalin, more vesh? — ja preu shkurt usta Jorgji. — Kur më dërguan këtu në banesa, i thashë edhe Sefedinit edhe kryeinxhinierit: «Unë shkoj atje vetëm me një kusht: të marr me vete edhe Pashkun».

— Po qysh atëhere ka kaluar aq kohë.

— Ore, ç'i duam llafet? Unë s'e lë djalin e pikë!

Le të vijë Sefedini apo inxhinier Andrea të flasin me mua pér këtë punë. More vesh?

Azisi, kur e pa se usta Jorgji ngulte këmbë në të tijën, ngarkoi inxhinier Andrenë që t'i kthente mendjen plakut. Mirëpo ustai i kundërshtoi edhe inxhinierit.

— E ç'do të mësojë atje në shkollë djali? — pyeti me mospërfillje.

— Një herë do të mësojë zanatin.

— Domethënë do të mësojë pér murator. Ja sepse më vjen inat mua, — tha si i prekur në sedër usta Jorgji. — Ta dërgojmë djalin në Tiranë, atje ku s'ka njeri fare, e përse? Që të bëhet murator. Po pse, bre Andrea, më mirë se unë do ta mësojnë ata në shkollë? Është turp pér mua një herë, që kam dyzet e ca vjet me çekiçin në dorë. More vesh?

Inxhinier Andrea vuri buzën në gaz dhe ju përgjegj:

— Dëgjo, usta, ti mos e merr pér fyerje këtë. Pashku ka nevojë të shkojë në shkollë; atje mund edhe të mos bëhet murator, se mund ta caktojnë pér elektricist, hidraulik, betonist e ku di unë... Pastaj ndërtimi ecën përpara, usta, nuk qëndron në vend. Ndryshe ndërtonit ju para tridhjetë a dyzet vjetësh, ndryshe ndërtojmë ne sot, ndryshe do të ndërtojnë ata nesër... Më kupton?

— Jo, s'të kuptoj hiç. Se ato gjëra të reja, që thua ti, një zanatçi i mirë i mëson në kantier. Duke punuar e duke mësuar. Ashtu siç i mësova edhe unë, edhe tjetri edhe tjetri. Dhe ma merr mendja se i mëson fare mirë. More vesh?

Inxhinier Andrea u habit me këmbënguljen e usta Jorgjit. Ai s'e priste një gjë të tillë nga plaku i urtë. Kur pa se ustai nuk donte të dëgjonte asnje fjalë, e humbi më në fund durimin dhe përdori një taktkë tjeter.

— Po të jetë kështu, përse s'e mbajte edhe ti djalin tënd në kantier? Përse e dërgove në shkollë që të bëhet inxhinier?

Me këto fjalë inxhinier Andrea goditi në shenjë. Plaku këtu kishte pikën më të dobët. Këtë e dinin të gjithë shokët e vjetër. Nga sa thoshin shokët e tij të ngushtë atë ditë që i kishte dalë bursa djalit të usta Jorgjit për të vazhduar studimet e larta në Fakultetin e inxhinierisë, usta Jorgji kishte blerë raki dhe e kishte djegur fare me të gjithë shokët. «Golloborda, — u thoshte i entuziazmuar në kulm, — punën e çekiqit e ka patur me tapi dhe ka nxjerrë ustallarë pa hesap. Po inxhinierë vetëm taní në kohën e partisë po nxjerr. More vesh? Pse të shkojmë larg? Djali i usta Jorgjit, i muratorit, që s'ka vajtur asnjë ditë në shkollë dhe i dridhet dora, sikur ngre një kuintal peshë, kur merr penën që të vëjë imzanë në kartë, e pra, djali i usta Jorgjit do të bëhet inxhinier me shkollë të madhe! A mund të ketë gjë më të mirë për mua?» — thërriste nga gëzimi veterani i ndërtimit.

Përshtypja që i bënë ustait fialët e inxhinier Andresë, kur i përmendi punën e djalit, që shumë e madhe dhe e menjëhershme. Usta Jorgji ra në mendime e pastaj tha me zë të ulët, sikur të fliste me vete.

— Mund të jetë edhe kështu Andrea. Do ta pleqësoj mirë me mendjen time këtë punë, do të bisedojoj edhe me Pashkun dhe do të të them. More vesh?..

... Ditën që të rintjtë e kantierit do të niseshin për në shkollë, Pashku erdhi në sheshin e madh përpara klubit, i shoqëruar nga usta Jorgji. Djaloshi që kishte hedhur shtat gjatë vitit të fundit, kishte veshur një palë rroba të reja, që e tregonin më të madh nga që ishte. Po edhe usta Jorgji kishte veshur ato rroba prej shajaku, që i vishte vetëm gjatë festave të mëdha, apo kur shkonte me leje në fshat.

— Po sqeparin s'e ke marrë sot me vete, o usta!
— donte ta ngacmonte Azisi.

— Jo, s'është ditë për sqeparin sot, — ju përgjegj ustai serioz.

Azisi nuk i tha gjë tjetër se e pa që ustai rrinte si shumë serioz dhe i menduar. Bashkë me Azisin u

habitën edhe të tjerët, që e dinin se ustai nuk rrinte dot asnjë minutë pa folur e pa bërë shaka.

Një maqinë nga ato të parkut të ndërmarrjes që-ndroi përpara klubit. Të rinjtë hipën me nxitim në karroceri. Në çastin që do të përshëndetet me shokët e kantierit për të hipur në maqinë, sytë e Pashkut u mbushën me lot.

Për çudinë e të gjithëve pas Pashkut hipi në maqinë edhe usta Jorgji.

— Po ti usta, nga shkon? — e pyeti inxhinier Andrea.

— Do të përcjell djalin gjer në Tiranë, — ju përgjegj ustai duke zënë vend pranë Pashkut.

— Po si kështu në befasi? Ti s'na the gjëkafshë mbrëmë.

— Duhet ta kishit marrë me mend vetë, Andrea...

Dhe sikur do t'i zbulonte ndonjë sekret të madh, u përkul nga maqina dhe i tha inxhinierit në vesh:

— Kështu kam përcjellë edhe djalin tim, kur u nis herën e parë për në shkollë të madhe, para tre vjetësh. More vesh?

Shpresat e njerëzve u ngjasin shumë sytheve të pemëve, që në fillim nxjerrin krye si me frikë e ngurrim, por po t'i ngrohë mirë dielli i prillit, çelin menjëherë e formojnë bisqe që rriten me shpejtësi e në kulm të pranverës harlisen e bëhen degë, që lëshojnë lule dhe lidhin kokrra. Po nuk ndodh gjithnjë kështu me sythët e pemëve, as edhe me shpresat e njerëzve... Se ka raste që pikërisht në ditët e para të pranverës, dielli fshihet prapa reve të zeza, fryn murllani dhe shpërthen stuhiia dhe sythet e njoma mbijidhen krus-pull nën sjetullat e degëve, që të gjejnë pak ngrohtësi e të shpëtojnë nga rrebeshi. Ndryshe ka rrezik që të përcellohen nga ngricat e natës, apo të goditen e të rrëzohen përdhe nga breshëri.

Drana, që kishte provuar vuajte të mëdha qysh në fémini, e dinte mirë këtë gjë; por e ndjeu edhe një herë fort një mbrëmje të kthjellët e të freskët në prak të pranverës, kur po kthehej nga puna për në shtëpi të tezes, në gurore.

Gjatë muajve të fundit ajo sikur kishte gjetur një getësi shpirtërore, që s'e kishte provuar kurrë më parë. Në mëngjez nisej e shkathët dhe e gëzuar për në uzinë e në mbrëmje, me gjithëse e lodhur nga puna e ditës, merrte çunin e vogël të tezes e dilte lëndinave për të mbledhur lulet e para të pranverës. Tanimë qe bërë e njobur në gjithë kantierin dhe e ndjente veten si në mes të një familjeje të madhe.

Gjatë kohës së pushimit të drekës ajo shkonte shpeshherë te Malia për të parë se si punonte shoqja e saj e ngushtë në atë vinç të madh. Si kaloi shumë koh, Drana mësoi ta ndizte motorin e të lëvizte marshet dhe veglat e tjera të asaj maqine të fuqishme. Herëherë Malia e lejonte atë ta përdorte edhe vetë vinçin, duke i qëndruar mbi kokë. Çfarë gëzimi ndjente Drana në të tilla raste! Kur duart e saj të holla kapnin marshet dhe ngrinin lart arka të rënda, që s'mund t'i lëviznin nga vendi as dhjetë burra, ajo e ndjente veten të fortë si ato kabllot e çelnikta që nuk thyheshin nga asnje peshë... Dhe në mbrëmje i kallëzonte tezes për punët e ditës dhe ushqente ëndrra të reja që s'i kishin shkuar kurrë ndër mend më parë.

Në ambientin e ngrohtë të kantierit s'mund të mos çelnin në shpirtin e saj sythet e para të shpresave të reja.

Një mbrëmje të freskët pranvere Drana po kthehej për në shtëpi. Anës së rrugës ishte një kumbull tufshake, që Drana e vështronë me kënaqësi sa herë kalonte andej. Këtë herë kumbulla ishte mbuluar nga llule të bardha e dukej si një nuse e re. Drana qëndroi dhe e vështroi. Në thellësi të shpirtit ndjeu menjëherë një dridhtërim gëzimi që e shtyu në ëndërrime të guximshme...

Të ishte vallë nga pranvera që po afrohej? Apo

ishte diçka tjetër më e madhe, që ja mbush zemrën me ngazëllim?...

Kur ju afrua barrakës në mugëtirën e mbrëmjes pa një si hije që doli nga dera e prapsme dhe rrëshqiti drejt rrugës nga vinte ajo. Para se t'i afrohej mirë, Drana njoju tezen, që diçka mbante në dorë.

— Dranë! — i tha ajo mbesës me një ton urdhë-rues. — Merre këtë fustan e futu te konaku i Fatimes pér me u ndérrue e me heqë pantallonat!

— Pse? — pyeti e shqetësuar Drana.

— Ka ardhë yt atë.

— Oh! — psherëtiu vajza sikur ta kishte goditur njeri në zemër.

— Vishu nji herë ti, se kena kohë me kuvendue.

— Teze! Unë s'vij fare brenda...

— E ku ke me shkue?

— Kam vend pér të fjetë. Shkoj te Malia.

— Jo, Dranë, s'asht mirë kështu. Po të fshihesh sonte, ai ka me të gjetë nesër.

Drana mbeti pér një çast e menduar dhe e pavendorosur.

— Hajde, tash! Ndigjon? Ai nuk asht si ma parë.

I ka ranë millefi dhe asht zbutun boll...

Drana hyri pas tezes në konak, e veshur tani me një fustan të vjetër, që i rrinte pak i ngushtë. I ati që rrinte pranë zjarrit, ktheu kokën nga dera dhe e vështroi nga koka në këmbë. Por nuk i foli menjëherë. Në vështrimin e tij dalloheshin edhe dashuria atnore, që e shtynte ta thërriste pranë të bijën e ta përqafonte me mall, edhe krenaria e fyter e një burri zakoni ndaj një vajze rebele. Të dyja ndjenjat e kundërtta po përlesheshin ashpér në shpirtin e tij dhe pér një çast u duk sikur mbizotëroi zemërimi i mbledhur në thellësi të tij prej një kohe të gjatë. Por dhimsuria atnore e mundi më në fund mërinë dhe kjo u pasqyrua menjëherë në sytë e burrit të vjetër.

— Erdhe, moj bijë? — i tha me një zë të çuditshëm, që dukej sikur dilte nga brendësia e tokës.

— Po, tatë, erdha.

- Si ja çon?
- Njifarësoj!
- Afroju ma këndej
-
- Tash vjen nga puna?
- Poo!
- Gjithnjji kështu vonë kthehet ti andej?
- Si të ndodhë.
- Ban vaki që të kthehet edhe ma vonë, — tha pa djallëzi tezja.

— E shef? — shpërtheu plaku me inat, sikur bisedonte me ndonjë njeri tjetër, që as Drana as tezja nuk e shihnin. Pastaj uli kokën dhe pshërëtiu thellë. Sa të hapësh e të mbyllësh sytë vështrimi i tij u bë përsëri i egër. Drana e vuri re mirë këtë ndryshim dhe u drodh e tëra...

Një heshtje e rëndë mbretëroi për një kohë në barrakën e vogël. Dëgjoheshin vetëm të kërciturat e një tufe karthiash, që kishte hedhur tezja në zjarr.

Drana shtirej sikur vështronte zjarrin në oxhak, por ajo bënte si bënte dhe hidhte vështrime të fshehta nga i ati, që rrinte pa folur e pa lëvizur në krye të minderit.

I ati i Dranës ngriti një herë kokën dhe i vështroi me radhë të dy gratë.

- A deshe gja? — e pyeti aty për aty tezja.
- Pelës a i ke shti ndonjë send me ngranë?
- Posi, i kam shti nji herë kur erdhe dhe prapë kam me i shti...

Drana i hodhi një vështrim kuqtimplotë, ndërsa me mendjen e saj thoshte: «Sa shumë kujdeset për pelën!..»

— Bane pak shpejt, Mari, se due me u nis, — i tha pas pak mysafiri.

- Tash ke me u nisë? Nesër në mengjez ma mirë.
- Jo, kam me u nisë sonte. Se nesër sabah-sabah do të jem në fermë.

Drana kafshoi një herë buzët nga inati dhe për

pak i ra fulterja nga zjarri. Tezja e shikoi si me qortim, por nuk i tha gjë.

Pasi hengrën darkë, i ati i Dranës ndezi një cigare dhe tha:

— Ne, moj cucë, i dhamë dum punës që ti përfestat të kthehesh në shtëpi. Të tjerat ke me i marrë vesh nga tezja.

— Ma mirë të kishte qëndrue sonte këtu e t'i kishe folë vetë cucës, — i tha si me ndrojtje tezja.

— Ja thue ma mirë ti, se grue me grue merreni vesh ma lehtë.

Në çastin që do t'i hipte pelës, i tha zonjës së shtëpisë:

— Këtej duhet me ikë natën njeriu. S'asht për ne ky vend këtu, moj Mari!

— Kantieri? — e pyeti ajo.

— Dreqi vetë! — tha me përcëmim dhe u zhduk në errësirën e natës pa hënë...

— Ma zuni këtu në shtëpi gjithë pasditen. Kur u ktheva nga fidanishtja, e gjeta te shkallët. Dhe ja nisi menjicherë kangës — tha tezja mengadalë.

— E c'tha? — mundi të pyeste Drana me një zë si të mbetur.

— Cuca me u kthyen në shtëpi përfestat, — më tha. — Pas festave vjen edhe ai me leje nga ushtria dhe i vemë shpejt e shpejt kapak kësaj plage...

— Kush ai, moj teze?

— I fejuemi yt...

— S'kam ndonji të fejuem! — ja bëri Drana me inat dhe brofi në këmbë.

— Ulu, ulu, moj vajzë, ulu të kuvendojmë, — i tha tezja me të butë. — Me mue po merr inat ti?

Drana kafshoi buzët dhe uli kokën si e turpëruar.

— Ma kanë sjellë këtu, teze, — i tha, duke vënë gishtin në hundë. — S'durohet ma...

— E vune re sa i zbutun ka qenë këtë herë yt atë? — i tha tezja, kur ajo u ul pranë saj.

— Kushedi, mund të jetë edhe ma keq, — tha Drana me mendjen gjetiu.

— Pérse ma keq?

— Kur duen ta fusin në grackë nji njeri, e marrin me të mirë. Kështu banin edhe me pelat kur bridhnin azat në kënetë, para se të thahej. I zinin me të mirë ato dhe pastaj u hidhnin laku në fyt, që t'i nxirrnin në pazar...

— Fijet e kësaj pune janë fort të ngatërrueme dhe çdo gja mund të bajë vaki. Po ti nuk din nji gja, veç. Atij i kanë heqë veshin atje në katund. Dhe ja kanë hequn fort, bile.

— Si, si? — tha Drana me padurim.

— Kanë shkue këta të kantierit, moj cucë, atje në katund, kanë bisedue me ata të këshillit, dhe e kanë sha boll tët atë.

— Nuk ndigjova mirë moj teze; pa ma thuej edhe një herë — ngriti zérin Drana, ndërsa zemra i rrithë fort në kraharor.

— Ka shkue këndeje në katund, ai i gjati, moj, ai që punon andej nga lumi me atë maqinën e madhe, se si e ka emnin...

— Azisi, moj teze?

— Ai me dy-tre të tjerë. Dhe ja kanë rregullue mirë shpinën Dodës.

— Po nga e din ti, teze? Ai ta tha këtë?

— Ai, kush tjetër. Nuk e pe se si ishte këtë herë si pulë e lagun? «Kanë ardhë kohna të këqia, — më tha para se me ardhë ti. — Të mos kesh në dorë as evlatin tënd...»

— Drana psherëtiu si e lehtësuar dhe sytë e saj shkëlqyen nga një flakë e brendshme.

Kështu, moj Dranë. Çhu tash të flemë, se u ba vonë. Nesër kemi me u nis që me natë në punë.

— Fli ti, teze, fli. Mua s'më flihet.

Drana ra shumë vonë pér të fjetur atë natë. Në shpirtin e saj pérlesheshin me furi ndjenja të kundërtë: Ajo e shihte qartë se koha po i ngushtohej si një lak në fyt dhe rreziku nga planet që kurdiste i ati së bashku me atë tjetrin, me Pjetrin fjalëmadh e kapadai, po i trokiste te dera. Por nga ana tjetër edhe

shpresa, që do ta çante më në fund rrugën e jetës, e do të shpëtonte një herë e mirë nga kthethrat, në të cilat kishte rënë që në vegjëli, kurrë nuk kishte qenë më e fortë këtë radhë...

Në rrugën e saj të jetës kishte dalë një njeri tjetër, Andrea. Dhe në zemër të saj kishte lindur një ndjenjë e re: dashuria! «Qysh atë natë atje në kineema, kur ndodhi ajo hataja me atë të krisunin, se ç'ndjeva nji gja të veçantë për këtë njeri, që më doli në mbrojtje, — thoshte tani me vete Drana. — Pak ma vonë kur më përccoli gjer këtu në barrakë, se si më shikonte. Kaluen ditë të tana pa u takue. Por unë e sillsha ndër mend orë e çast. Dhe fjalët e tij më tingëllojshin, në vesh pa pushim. Po atë ditë që më doli në befasi përpëra aty në uzinë e më foli si një njeri që e njihsha prej kohe? Pastaj erdhën takimet e tjera. Ajo e kuptonte fare mirë se ndodhej përpëra një udhëkryq. Por tani nuk ngurronte më përrrugën që do të zgjidhte. Ajo nuk do të priste duarkryq vendimin e të tjerëve për të ardhmen e saj. «Derisa të tjerët nxitohen t'i japin udhë punës seme, përsë të mos mendohem unë vetë përfatin tem? Unë nuk jam e vogël që të më marrin të tjerët prej dore e të më çojnë ku të duen ata. Mjaft ma kësisoj!...» — tha me vete dhe hapi me ngut dritaren e vogël. Hëna e vonuar sapo kishte dalë mbi vetullën e malit. Një fllad pranveror frynte nga ana e fushës. Dhe ky fllad bashkohej me atë fllad rinor që dilte nga zemra e saj e dëlrë. Drana e vështroi hënën se si shkëputej pak nga pak nga mali e fillonte të lundronte në kupën e errët të qiellit. Ju duk më e bukur se çdo herë tjetër.

Ajo në këtë barrakë të vogël, nuk e ndjente veten pa njeri në botë. Mbi kryet e saj ndjente një dorë që e mbronte, dorën e fortë të kantierit. Dhe në zemër të saj, së bashku me dashurinë, lindte një forcë e re, që i jepte krahë dhe guxim...

III. MUND TË VIJË AJO DITE...

«Çdo tullë e çdo gur është vendosur nga një dorë njeriu, nga një njeri i ndërtimit. Çdo mur, çdo ndërtuesë e çdo vepër ka në themel pika djerse, që i kanë lidhur fort me tokën që i mban...»

1

Në ndërtimin e oxhakut të madh merrte pjesë vetëm një brigadë prej njëzet e pesë vetësh. Por punën e kësaj brigade pararojë e ndiqte tërë kantieri dhe tërë qyteti i ri. Bile lajmi i fillimit të punimeve për ndërtimin e oxhakut kishte flutuar shumë larg dhe një ditë erdhi nga Tirana në Gurraj një gazetar së bashku me një fotoreporter. Ata donin të bisedonin me ndërtuesit e të merrnin disa fotografi për gazetën. Fatmiri që e takuan në vendin e punës, u tha:

— Tani për tani nuk ka asgjë të jashtëzakonshme. Puna ka disa javë që ka filluar dhe siç e shikoni, ne jemi ende në themele. Kjo tregon se kemi ngelur prapa. Apo jo?

Inxhinier Andrea i tha gazetarit:

— Vështirësitë e vërteta do të fillojnë nga pesë mbëdhjetë metra e lart. Pasi të kalohen të njëzet metrat, të ngjitesh çdo centimetër më lart, do të jetë gjithnjë më e vështirë. Ju, ndoshta keni ardhur para kohe këtu tek ne...

Megjithatë gazetari gjeti material interesant nga

jeta e nga puna e pjesëmarrësve në ndërtimin e oxhakut dhe në gazetë u botua një reportazh, që nuk kaloi pa u vënë re nga lexuesit.

Çdo pemë, sa më e lartë dhe më e madhe bëhet, aq më të thella i ka rrënjet në tokë. Nga ky rregull nuk përjashtohen as veprat që ndërtojnë njerëzit. Themellet e oxhakut ishin mbi pesë metra të thella. Për hapjen dhe mbushjen e tyre u punua afro një muaj. Inxhinier Andrea vinte aty përditë. Ai shikonte punën, maste e kontrollonte me kujdes materialet që përdoreshin për themelet e çdo gjë tjetër që kishte të bënte me oxhakun. Në mbrëmje takohej me inxhinierët e tjerë dhe bisedonin për problemet që u kishin dalë gjatë ditës. Pastaj në dhomën e vet ai vazhdonte të bënte përllogaritje e skica për çdo pjesë të oxhakut të madh.

Edhe inxhinier Sahiti tregonte një interesim të vecantë për ndërtimin e oxhakut. Ai përveç punës që i ~~caltonin~~, ~~mbante përditë shënimë për sasinë e ma-~~ terialeve që përdoreshin, për vëllimin e punës që kry- hej përditë e për pengesat që u dilnin. Në blokun e tij të shënimeve tanë kishte dy lloje shifrash e shëni- mesh, që i kishte ndarë në dy kapituj me këto mbi- shkrime: «materiale nga libra», «materiale nga praktika». Dhe kjo ishte diçka e re për të. Kapitulli i dytë nuk ekzistonte më parë në blokun e tij të madh. Ai në the- llësi të shpirtit edhe dyshonte në mundësinë e ndërti- mit të oxhakut nga «një brigadë ustallarësh e beto- nistësh të thjeshtë». Dhe këto dyshime i mbështeste, siç thoshte vetë, «në të dhënat e shkencës dhe të praktikës së përbotshme në ndërtimin e objekteve shumë të larta». Po atëherë përsë i mbante ato shënimë për oxhakun në defterin e tij, ku mund të gjeje shifra edhe për minierat më të thella në botë edhe për gra- tacielet e Nju-Jorkut edhe për kullén Eiffel?.. Një- herë që e kishte pyetur inxhinier Burhani për këtë çështje, i qe përgjegjur si për një gjë që nuk i jiptë rë- ndësi: «Kot. Më pëlqen që të mbaj shënimë për çdo gjë». Por në të vërtetë nuk ishte kështu. Vinin çaste kur

Sahiti thoshte me vete: «Këta të brigadës së Fatmirit janë qind për qind të sigurtë se do ta ndërtojnë oxhakun me forcat e tyre. Mrekulli në botë nuk ka. Po, ku ta dish? Me vendosmërinë që kanë ata, ndoshta ja arrijnë qëllimit. Atëherë këto të dhëna mbi ndërtimin e këtij oxhaku do të studjohen edhe nga të tjetrët, se është diçka e re në fushën e ndërtimit. Sigurisht kjo do të bëhet vetëm në rast se do t'ja dalin në krye punës, që kanë marrë përsipër. Po sa larg qëndron ky objektiv! Kam lexuar në një libër se në ndërtim, largësitë horizontale maten e llogariten me kilometra, ndërsa ato vertikale me metra dhe në këndita speciale, do të thosha unë, me centimetra. Këtë doja t'ja shpjegoja një ditë Sefedinit, por ai ma preu shkurt: «Këto janë profka, teorira pa kuptim» — më tha. — Ke parë? Teorira, or vëlla. Po këto teorira, që ti i përcmon, kanë dalë nga një praktikë shekullore. Tani ju i kini hyrë një valleje të rrëzikshme. Ta shohim ku do të na nxirrn! Është shpejt ende që të flasim.

Pjesëtarët e brigadës për ndërtimin e oxhakut e dinin që në kantier kishte njerëz, të cilët dyshonin për punën që ata kishin marrë përsipër. Po ata nuk kishin kohë që të merreshin me arësyetime të tilla. Jo vetëm sepse jetonin ditë e natë me pulsin e ndërtimit, por edhe sepse që në javët e para e panë mirë se puna që kishin ndërmarrë ishte më e vështirë nga ç'kishin parashikuar. Në ditët e para të hapjes së themelive Sefedini kishte thënë: «Duhet të bëjmë një grafik edhe për oxhakun». Inxhinier Andrea e kishte kundërshtuar këtë mendim, se s'kishin asnë të dhënë për të përpiluar një grafik pak a shumë të saktë. Sefedini kishte ngulur këmbë dhe grafiku që pregatitur. Mirë po ai u përbys që në fazën e parë të hapjes së themelive...

Në truallin ku do të ngrihej ky gjigand, që hapur një gropë e madhe dhe e thellë. Pas hapjes së gropës filloj puna e vështirë dhe me përgjegjësi për hedhjen e themelive. Gropa e madhe mbushej gjithnjë me ujë edhe nga shirat, po edhe nga ujët që buronte vetiu

nga toka. Një motopompë punonte vazhdimisht përzbrasjen e ujit të turbullt bojë-bakri; po gropë sapo zbrazej, mbushej përsëri me ujë. Fatmiri, me çizme të gjata në këmbë, që e bënин të dukej më i vogël nga çishte, punonte vazhdimisht brenda në ujë. Nga maqinat zbrazeshin me rrapëllimë shufra hekuri e beton e përsëri shufra hekuri e beton... Prokopi me zisin e tij riportabël bënte disa rrugë në ditë nga baza a nga lumi në themellet e oxhakut.

— Na lodhi, or byrazer, — i tha një ditë Kolës nga kabina e maqinës, që e kishte afruar buzë gropës së madhe. — Kjo është si një vorbull e pangopur, që në vend të ujit thith hekuri e beton dhe nuk ngopet kurrë...

— Themelet duhet të jenë të forta, Prokop, — ju përgjegj Kola nga poshtë. — Se oxhaku do të ngrejë shtat drejt qiellit. E di si themi ne andej nga ana jonë? «Sytë nga qelli, por këmbët në tokë». Po pér nder!..

2

Sefedini, pa nënvleftësuar aspak sektorët e tjerë, punën e ndërtimit të oxhakut e ndiqte me një interesim të veçantë. Vonesa që vihej re në hedhjen e themeleve të oxhakut, e shqetësonte përditë e më shumë. Megjithatë ai qe i sigurt se puna e filluar do të kurorëzohej me sukses të plotë.

Pasi u hodhën themellet e oxhakut, Sefedinin nisi ta shqetësonte diçka tjetër: në brigadën e oxhakut qenë grumbulluar disa nga specialistët më të mirë e kuadro nga më të zot të ndërmarrjes. Këtë përbërje të brigadës, në ditët e para të entuziazmit të përgjithshëm, që kishte ndezur në gjithë kantierin iniciativa e guximshme e këtyre njerëzve, e kishte aprovuar edhe ai. Mirëpo një gjë e tillë kishte dobësuar gjer në një fare pike sektorët e tjerë. Prandaj mendoi të bënte disa ndryshime dhe disa specialistë t'i kthente përsëri në

sekторët e mëparshëm, ose t'i transferonte në sektorë të tjera. Dhe këtë punë e nisi me Kolën.

Një ditë, aty nga mbarimi i orarit, thirri Fatmirin dhe i tha pa hyrje e stérhyrje:

— Fatmir, unë them që Kolën ta térheqim nga brigada jote.

— Kolën? — u çudit Fatmiri.

— Kolën, bre, binjakun tënd. Unë e di që s'do të vijë mirë, por s'kemi q'bëjmë. Kemi nevojë edhe gjetiu. S'mund të lëmë dy nga brigadierët më të mirë të ndërmarrjes në një sektor, qoftë edhe në një sektor të tillë të vështirë, siç është oxhaku.

— E ku thua ti të shkojë Kola? — e pyeti Fatmiri, para se të shfaqte mendimin e vet.

— Kolën ta dërgojmë përgjegjës në kantierin e banesave. Atje puna çalon nga të dyja këmbët dhe ka nevojë pér një dorë të fortë, pér një dorë të stërvitur.

Fatmiri qëndroi pér një kohë i heshtur dhe i menduar.

— E di si është puna, o Sefedin? Si ta térheqim Kolën nga oxhaku? Ai qe nga të parët që u lidh me këtë punë. Unë të kam thënë edhe herë të tjera, që ai më ka shtyrë edhe mua ta merrnim përsipër këtë punë. Poo! Më mirë të largohem unë andej, se sa Kola...

— Dëgjo, Fatmir, shkurt hesapi. Unë e di që s'do të të pëlqejë as ty as Kolës ky transferim, por ne nuk bëjmë këtu siç na pëlqen, por ashtu siç e kërkon puna. Kjo ka rëndësi.

— Mirë, o Sefedin; gjersa është pér të mirën e punës, le të bëhet kështu. Po hajde t'ja mbushish mendjen Kolës, pa...

— Ty të takon kjo punë Fatmir.

— Mirë e ke ti, Sefedin. Hem më merr dorën e djathë nga brigada, hem më ngarkon të marr hanxhar, ta pres vetë dorën time, — tha si i zemëruar Fatmiri.

Kola u hodh përpjëtë sapo dëgjoi fjalën e parë pér largimin e tij nga brigada e oxhakut.

— Je në vete, Sefedin? Unë të largohem andej? Bota të përblyset. Po pér nder!..

— Po ne të bëjmë përgjegjës kantieri, o Kolë, të ngrejmë. Më kupton.

— Ore ministër të më bësh, unë nuk ndahem nga Fatmiri, gjersa të marrë fund maya e oxhakut e të vendoset atje tubi i tymit. Po për nder!

Fatmiri e la nja dy tri ditë në heshtje këtë punë. Pastaj e mori mënjanë Kolén dhe i foli për transferimin e tij në kantierin e ndërtimit të banesave.

— Edhe ti ma thua këtë fjalë, o Fatmir? — i tha Kola si me ankim.

Fatmiri i foli gjerë e gjatë që t'ja mbushte menjen.

— Domethënë puna është që të ndahemi, — tha me hidhërim Kola.

— Pse, ndarje është kjo, o Kolë? Unë nga oxhaku e ti nga skelat e banesave do të merremi vesh përditë me shenja. Poo! — donte të bënte një shaka Fatmiri, por kur pa se Kola ishte me të vërtetë i prekur në sedër, i tha me seriozitet. — Dëgjo, Kolë! Mendo një herë sikur të kenë nevojë të më dërgojnë mua në një kantier dhe ty në një kantier tjeter. Si thua ti, nuk do të shkojmë? Do t'i themi partisë se ne të dy kemi punuar gjithnjë së bashku dhe tani nuk ndahemi?

Më në fund Kola mori një herë frymë thellë dhe u kthyte nga shoku i tij i ngushtë.

— Ma kishteë enda të punonim së bashku, o Fatmir, gjer në ditën kur do të dilnin fjollat e para të tymit nga oxhaku i madh. Po për nder! Po gjersa është kështu si thua ti...

Kryerja e ndryshimeve në profilin fillestar të uzinës s'kishte si të mos sillte një farë pëshjtellimi në gjithë punën e kantierit. Duke grumbulluar forcat më të shumta dhe një pjesë të mirë të maqinerisë në ata sektorë që pësuan ndryshime më të mëdha, shumë sektorë të tjerë mbeten prapa. Kështu që u desh një për-

pjekje e madhe pér tē normalizuar punën nē gjithë frontin e ndërtimit. Si masë e parë qe zgjerimi i punës me dy turne edhe nē sektorët ndihmës e tē largët tē ndërmarrjes, siç ishte baza e preqatitjeve tē materialeve tē parafabrikuara.

Kjo bazë qe krijuar anës së lumi, ujërat e tē cilit nē kohën e shirave përhapeshin tejpërtej mbi gjithë shtratin e gjerë. Ndërsa nē pranverë e nē verë, lumi dukej si një rrëke e vogël, e lodhur dhe e rraskapitur nga puna e rëndë që ka bërë pér tē transportuar nga malësia e largët me miliona tonelata zhavorr e baltë. Idenë pér krijimin e bazës nē këtë vend si tē fshehtë, ku lumi bënte një kthesë tē fortë, e kishte dhënë i pari inxhinier Andrea. «Këtu do tē kemi pranë lëndën e parë, — i kishte thënë Sefedinit, — si rërën, zhavorrin dhe gurin pér tē bërë granil. Pastaj kemi edhe ujin...» Dhe Sefedini kishte dhënë pëlqimin menjëherë.

Baza e materialeve tē parafabrikuara kishte mbetur pér një kohë tē gjatë si një sektor i dorës së dytë dhe i parëndësishëm i kantierit. Aty qe ndërtuar vetëm një barrakë e vogël me dërrasa tē pazdrukthuara dhe asgjë tjetër. Gjithë puna zhvillohej jashtë nē natyrë. Prandaj ishte e vështirë dhe e rëndë.

Inxhinier Andrea vinte këtu shpeshherë, shikonte punën që bëhej dhe mendonte pér organizimin e saj. Duke biseduar me punëtorët e pakta që punonin nē bazë, ai u thoshte:

— Mos u mërzitni, or shokë. Se ky sektori juaj është tani i dorës së fundit pér kantierin. Por do tē vijë dita që do tē bëhet një fabrikë e vërtetë. Se një qytet i ri, që ndërtohet nē kohën e betonit, s'mund tē ecë përpëra pa këto materiale që dalin nga duart tuaja...

Dhe me tē vërtetë zgjerimi i frontit tē ndërtimeve dhe ndryshimet që po bëheshin nē shumë reparte tē uzinës, kërkonin më shumë shtylla prej çimentoje, plinta, qyngje e panele betoni tē madhësive tē ndryshme. Prandaj ju desh ta organizonin punën edhe këtu me dy turne.

Natën e dytë tē punës me dy turne, inxhinier

Andrea u nis nga kantieri për në bazë. Largësia nuk "qe e madhe, por ai i tha shoferit.

— Jepi, Prokop!

— Mirë thua, ti inxhinier, — ju përgjegj shoferi — po ja, këtu në këto kthesa të zë pritë «zeshkani».

— Edhe natën?

— E di sa dinak është? Kur bie nata, ne shoferët pandehim se nuk na sheh njeri dhe ja shkelim gazit. Kur fap! Të del ai përrpara: «Hajde, — të thotë, — patentën shpejt. «Dhe sa të hapësh e të mbyllësh sytë ta merr latën...»

Maqina mori majtas dhe u fut në shtratin e gjerë të lumit, që, siç thoshin fshatarët, vetëm tri ditë në vit mbushej tejpërtej me ujë. Një rrugë e hapur nga rrotat e maqinave, gjarpëronte në shtratin e thatë të lumit, të cilën vetëm një sy i stërvitur mund ta gjente natën. Maqina bëri një kthesë dhe u ndal pranë një eskavatori, që në errësirë të jepte përshtypjen e një shpendi gjigand me një sqep të stërgjatë... Pak më tutje dukeshin grumbuj të mëdhenj rëre e zhavorri, gati për t'u ngarkuar në kamion.

— Azis! Ku je, bre, Azis? — thirri nga kabina Prokopi.

— Erdha! — u dëgjua në errësirë një zë i fortë dhe në dritën e zbetë të hënës u dallua shtati i gjatë i një burri, që po afrohej, duke fshirë fytyrën me këndin e kominoshit.

— Të mori gjumi, o Azis? — e pyeti si me shaka inxhinieri.

— Ç'të bësh, or vëlla! Kjo punë këtu në lumë është me hope. Kur vijnë maqina, jam mirë. Kur ato mbushen dhe largohen, mbetemi vetëm unë, eskavatori dhe lumi. Me eskavatorin s'kam ç'të llafosem më, i kam thënë të gjitha. Mbetet vetëm lumi. Hajde tani, të kam rixha, të llafolesh gjithë natën me lumin, — tha Azisi dhe hipi në kabinë.

Motori i eskavatorit u ndez dhe në qetësinë e natës zhurma e tij u ndje fort. Pas pak kamioni u mbush me rërë.

— Gati! — thirri eskavatoristi dhe zbriti nga kabina.

— Do të vish ti, inxhinier? — e pyeti Prokopi.

— Jo, bre! Unë do të kthehem kur të mbarojë turni.

— Mirë, pra, kur të bëj rrugën e fundit, vij e të marr unë. Këtu do të jesh?

— Jo, te baza.

Kamioni u nis për në kantier. Inxhinieri ju afroa eskavatoristit dhe i tha:

— Tani, gjersa të vijë ndonjë maqinë, pushim.

— Ky pushim, që thua, ti inxhinier, të lodh më shumë se puna. Po për sytë e ballit!

— Ore, sikur fryn këtu, — tha inxhinieri, duke ngritur pak jakën e xhaketës.

— Bën ftohtë këtu, inxhinier. Banorët e këtyre anëve, thonë se ky lumë sjell më shumë erë se sa ujë. A nuk ulemi atje pranë eskavatorit, se na mbron pak nga era?

U ulën që të dy mbi guralecat e lumi me kurrizin nga eskavatori. Pak më tutje shkëlqenin dritat e fortë të bazës për materiale të parafabrikuara.

— Sa tokë ka ngrënë ky lumë! — nisi i pari bisedën inxhinieri.

— Gjene ka bërë një të mirë, inxhinier. Ka sjellë rërë e zhavorr pa hesap. Sikur ta dinte që një ditë do të ndërtohej këtu një qytet i tërë, — ju përgjegj eskavatoristi.

— Erdhi një kohë, or vëlla, që na hyjnë në punë edhe gjérat që na dukeshin si fare pa vlerë.

— Po, për sytë e ballit! Unë rri këtu në mes të shtratit të gjerë të lumi e mendohem: «Sa vështirë do të ishte për ne, sikur ta kishim larg rërën dhe zhavorrin!.»

Ndërsa Azisi fliste, Andrea thoshte me vete: «Këtyre u është bërë zakon që çdo gjë ta shohin me syrin e ndërtuesit. Mua ende jo...» Dhe ju kujtua një bisedë e Sefedinit para disa javësh. Po udhëtonin të dy së bashku me një gaz për një sharrë në një pyll të malë-

sisë, prej nga furnizohej kantieri me lëndë druri. Rrugës gjetën një gjeolog dhe e morën në maqinë. Gjeologu u kallëzoi pér kërkimet që po bëheshin atyre anëve dhe pér pasuritë e mëdha minerale që fshihnin në barkun e tyre malet nga kalonin. Andrea e ndiqte me vëmendje kallëzimin e gjeologut dhe herë-herë i bënte pyetje pér t'u informuar më mirë. Sefedini dukej sikur s'e kishte mendjen aty. Vetëm një herë tha: «Atje në Kurbnesh kishim afër lëndën e drurit dhe gurin, po rërën dhe zhavorrin e sillnim nga shumë larg. Dhe kjo na nxirre telashe boll. Po do ti një ditë, duke hapur një galeri në thellësi të malit, minatorët gjetën një shtresë të trashë rërë! Eh, ç'ishte një rërë! E pastër, e imët, e bardhë, tamam pér ndërtim. Të gëzohej shpirti ta shikoje. Po q'e do? Qe vonë. Kur u zbulua rëra atje, ne u kishim dhënë fund punimeve kryesore të ndërtimit...»

— U mërzite, o inxhinier? — ja ndërpree mendimet Azisi.

— Po ti si bën, Azis, kur e ke punën natën? A mërzitesh ndopak?

— Të të them se nuk mërzitem, inxhinier, do të të gënjeja. Të punosh me eskavator larg kantierit e larg shokëve, është gjithnjë punë e vështirë. Po natën është dy her e vështirë. Kur mbetem vetëm në errësirë, s'kam ç'bëj dhe rri, duke vështruar andej nga xhadeja se mos vinë kamionat. Se, kur vinë maqinat, bisedoj me shokët, de, dhe mërzitja ikën, e merr me vete lumi.

— Ja, sikur po vinë, — tha inxhinieri, duke treguar nga xhadeja.

— Jo, nuk janë tonat ato, inxhinier!

— I njihke edhe natën ti, Azis?

— Po si, ore?

— Po nga i njeh, nga dritat?

— Nga dritat, nga zhurma e motorit...

Inxhinieri u ngrit. Vështroi një herë andej nga xhadeja dhe tundi këmbët që të shpihej.

— Po ikën, inxhinier?

— Do të shkoj një herë nga parafabrikatet.

— Edhe unë do të vij andej, po të ngarkoj maqinat një herë...

Inxhinieri çau përmes shtratit të gjerë të lumi. Zhurma e hapave të tij mbi guralecat e lumi dëgjohej fort në qetësinë e natës. Kur ju afrua bazës, dalloi njerëzit që punonin për mbushjen e kallépeve me llaç e beton. Pranë stivave të mëdha të shtyllave prej betoni, të qyngjeve e të pllakave, dallohej një autovinçë, që në atë çast ngarkonte një kamion me plinta të rënda.

Ai bisedoi me punëtorët dhe vështroi me kujdes cilësinë e pllakave e të shtyllave, që ende s'ishin tharë mirë. Pastaj nxori metrin nga xhepi dhe nisi të maste bazamentin e plintave. Shoferi i kamionit ngriti një herë duart dhe thirri nga ana e vinçit:

— Mjaft!

Shoferi hyri në kabinë dhe kamioni u nis. Inxhinieri vështroi nga ana e vinçit dhe u habit, kur pa një fytyrë të njobur vajze, që e vështronte edhe ajo me një buzëqeshje tëmbël, sikur donte t'i thoshte: «Përse të vjen çudi që më sheh këtu? S'ka asgjë pér t'u çuditur!»

Andrea dyshoi pér një çast se mos i bënин systë. Vështroi edhe një herë edhe u bind. Ishte ajo, Drana, «vajza e kantierit», që në atë çast fiku motorin e vinçit dhe me një leckë të vogël nisi të pastronte mirë xhamin e kabinës pér ta vështruar më mirë.

«Me këtë që bën, ndoshta më fton t'i shkoj pranë» — tha me vete inxhinieri dhe, duke kaluar nëpërmjet kapicave të shtyllave e të pllakave, ju afrua vinçit. Ju kujtua menjëherë biseda që kishte bërë me Malinë aty në shesh përpara uzinës. «E di sa qejf ka që të bëhet vinçiere?» — i kishte thënë atë ditë Malia. Ai i kishte premtuar Malisë se do të bënte qmos ta ndihmonte Dranën të futej në ndonjë kurs kualifikimi. Por ajo as që i kishte kërkuar atij ndonjë ndihmë. «Mirë e ka kuptuar Malia, — tha me vete inxhinieri. — Ajo është tamam malësore kryelartë dhe nuk i lutet njeriu pér asgjë. Po si e ka rregulluar dhe mori patentën pér të drejtuar vinçin?»

Para dy tri javësh ai e kishte parë Dranën, ndërsa qe duke pritur në mesoren e barrakës ku qe mbledhur komision i kategorizimit të ndërmarrjes. Kur e kishte parë atje, edhe ishte çuditur edhe ishte gjëzuar. Qe matur një herë të futej në dhomën e komisionit, që ta dëgjonte Dranën se si do t'u përgjigjej pyetjeve. Mirëpo e thirrën atë ditë për nënsektron e banesave; atje e priste Sefedini, se do të piketonin vendin, ku do të ngrihej shkolla e mesme e qytetit të ri. Dhe qe larguar pa arritur t'i thoshte asnjë fjalë Dranës.

«Mirë në atë çast, — hahej tani me veten, — po në mbrëmje a të nesërmen përsë nuk u interesova të merrja vesh se si kishte vajtur ajo në provime? Më marrin zvarrë telashet e ngatérresat e punës së përditëshme! Kur kthehem në dhomë, Drana më kujtohet orë e çast, ndërsa ditën kur dal në punë, sikur e harroj. Jo, xhanëm nuk është e vërtetë që e harroj por, si të thuash, nuk e çoj punën më tutje.

Ndërkohë ai i qe afruar vinçit. Drana rrinte brenda në kabinë gati për të ngarkuar një kamion që sapo kishte ardhur nga kantieri. Ai e vështroi edhe një herë nga afër. Ajo dukej tani pak si më e hequr në fytyrë por syt e saj shkëlqenin sa asnjëherë tjetër. «Kushedi sa mund e përpjekje i janë dashur asaj, që të arrinte gjer këtu!» — tha me vete inxhinieri; mendimet ja ndërpren zëri i fortë i shoferit që thirri:

— Gati, shoqe!

Ganxha e çelniktë e vinçit kapërtheu një plintë dhe e ngriti lart, sikur të ishte një pupël e lehtë. Pastaj kulla e vinçit lëvizi dhe plinta u luhat disa herë në ajër mbi karrocerinë e maqinës.

— Lëshoje! — thirri përsëri shoferi.

Plinta e rëndë, që peshonte disa kuintalë, u lëshua me kujdes dhe u shtri gjerë e gjatë mbi karrocerinë e maqinës. Përsëri kulla e vinçit lëvizi dhe ganxha e çelniktë kapi një plintë tjetër.

«Dhe të mendosh se gjithë këto vegla prej çeliku lëvizin dhe drejtohen nga një dorë e brishtë vajze, që tani do të jetë nxirë nga vajrat e maqinës!» — tha me

vete inxhinieri dhe ndjeu një kënaqësi të thellë në shpirt.

Hodhi një vështrim nga Drana, por ajo tanë dukej sikur nuk e kishte më mendjen te ai. Duart e saj lëviznin me shpejtësi dhe sytë e saj të zez vështronin me kujdes peshat e rënda që lëshoheshin në karrocerinë e kamionit të madh.

Kamioni u ngarkua shpejt dhe u nis. Drana ngriti një herë dorën e djathë, por Andrea nuk e pa mirë në se ajo e bëri këtë gjest për ta përshëndetur, apo për të rregulluar flokët që i kishin rënë mbi ballë. Një forcë e madhe e tërhoqi drejt vinçit.

— Si shkon? — i bëri ai me dorë, kur u afrua edhe pak.

Ajo hapi derën e kabinës së vinçit dhe e pyeti:

— A fole gja? — ndërsa vështrimi i saj thoshte. «Përse më flet prej së largu?»

— Si e ke punën? — i tha ai përsëri, duke bërë një hap përpara.

— Punën? Në vijë e kam.

Ai ju afrua më shumë dhe vuri dorën mbi motorin e vinçit, por e tërhoqi menjëherë.

— Djeg shumë, — i tha aty për aty.

— Si të mos djegë. Ka gjashtë orë e ca që punon. As unë nuk e di sa maqina kemi ngarkue sonte.

— Po a mërzitesh këtu natën vetëm?

— Pse të mërzitem? Ja ku e kam shokun, — ju përgjegj ajo, duke vënë dorën mbi motorin e vinçit dhe sikur i buzëqeshi pak.

Andrea e vështroi një herë në sy — dhe nuk dalloj as gjurmën më të vogël të atij dëshpërimi që pasqyrohej në sytë e saj atë natë të paharruar të festivalit folkloristik. Drana nuk e vështronte më me ndrojtje e përlulësi, por me një besim në vet-vete, që s'e kishte pasur asnjëherë tjetër.

Me një të hedhur Andrea hipi në kabinën e vinçit dhe i zgjati dorën.

— E kam dorën me vaj maqine, — i tha ajo, duke e tërhequr pak.

— S'ka gajle, kështu duket më e bukur, — ju përgjegj ai dhe ja shtrëngoi fort. Një rrymë e fortë përshkoi trupin e vajzës, që u pasqyrua edhe në fytyrën = saj.

— Bëka nxehjtë këtu brenda, — tha pas pak Andrea dhe u ul në motor karshi saj.

— Pse, jashtë ban ftohtë?

— Posi, tanë natën të than era. Fryka këtu nga gryka e malit.

— Unë nuk ndjej fare të ftohtë.

— Këtu të ngroh motori, pastaj vajzat e kanë zemrën më të ngrohtë, — bëri shaka Andrea.

Drana qeshi e kënaqur dhe, duke ulur pak kokën, e vështroi në sy. Edhe Andrea heshti për një kohë. Zemrat e tyre rrithnin fort dhe biseda e filluar vazhdonte me anë të vështrimeve.

— Fike motorin, Drana, — i tha ai pas paik. — S'besoj të vijnë më maqina.

— Ku ta dish? Ndoshta bajnë edhe nji rrugë. Po të shkarkojnë këtu afër në uzinë, kthehen shpejt e shpejt.

— Po të vinë, e ndezim përsëri, moj Dranë. Fike më mirë, se s'na lë të bisedojmë.

Ajo ktheu përnjëherësh kokën dhe e vështroi ngultas, sikur donte t'i thoshte: «Çfarë ke ndër mend të bisedosh me mue?». Po motorin e fiku menjëherë...

«Shenjë e mirë kjo. Është e qartë se i pëlqeka të bisedojë me mua», tha me vete Andrea dhe ju afroa më shumë Dranës. «S'më shkonte kurrë mendja — tha me vete — se do të takohesha me një vajzë malësore në kabinën e një vinçi, buzë lumi me pak ujë dhe shumë zhavorr. Ç'ndryshim, ë? Ndryshimin më të madh nuk e përbën vendi dhe ambienti, por njeriu me të cilin kam të bëj këtë radhë. Kot e kam që përpinqem të gjej fjalë të mëdha e fraza të stërholluara...»

— Domethënë, Dranë, u bëre më në fund vinçiere, — i tha me një mënyrë të natyrshme.

— Poo!

— Më thanë se të pëlqente shumë kjo punë.

— Vërtet, e di sa me qejf e kam, shoku inxhinier?
— ju përgjeg ajo duke e vështruar me një buzëqeshje
të ëmbël e me një përzemërsi që tregonte jo një atrim
të çastit.

— Malia ta ka mësuar këtë zanat?

— Malia ma thonte si me shaka në krye: «Hajde,
Dranë, me mue, të mësosh vinçin». Pak nga pak më
hyni në zemër kjo punë dhe ja që e mësova. Këtu në
kantier njerëzit edhe punojnë edhe mësojnë.

— Po pastaj?

— Pastaj, hiç. Vajta në kurs. Malia më bante praktikë
përditë.

— Po në provime si dole?

— Në provime? Kalova. Më dhanë edhe patentë
edhe kategorji. E di si më rrithë zemra atë ditë, inxhinier? — vazhdoi çiltër.

Andrea vuri re se biseda po bëhej gjithnjë më e
përzemërt. Ajo tregonte një atrim të madh karshi tij,
sikur të kishte biseduar kushedi sa herë përpara dhe të
kishin lidhur miqësi midis tyre. Ai i zuri dorën dhe ja
shtrëngoi lehtë. Ajo nuk e tërhoqi, por faqet e saj u
skuqën menjëherë dhe një drithmë e fortë, ja përshkoi
gjithë trupin.

— Po pse në turnin e natës, ti Dranë? — e pyeti
ai për të hapur një bisedë tjeter.

— Mua më pyet ti! Ti e din ma mirë se unë. A
nuk i rregullon ti me Sefedinin këto gjana?

Ai qeshi me të madhe.

— Pse qesh? Unë kështu kam ndigjue.

— Mirë, moj Dranë, po si të ra ty në fillim turni
i natës?

— Kush të vinte në turnin e natës? Malia? Ajo
ka fëmijë...

— Mirë që të la tezja...

— Pse të mos më linte? Baj ndonji gja të keqe?
Më thuej ti, që din ma shumë se unë...

— Nuk doja të thosha këtë, po ata të vjetrit sikur
nuk i shohin me sy të mirë këto gjëra.

— Ban vaki që atë e han nji krymb nga brenda, se

më kqyri pak me bishtin e synit, kur u nisa herën e parë pér turnin e natës. Po mue s'më tha gja, se ajo e din mirë që unë nuk ndigjova fjalën e babës, kur ishte puna që të bahesha robinë shtëpie...

Dhe u ndal menjéherë. Vetullat e saj të trasha u vrenjtën dhe në fytyrën e saj ra si një hije pezmatimi të brendshëm. Pér disa çaste ajo qëndroi kështu e heshtur, duke vështruar me ngulm një pikë të largët në errësirën e natës.

Dritat e një maqine u dukën te kthesa e rrugës që vinte nga kantieri.

— Po vinë maqinat, — tha ajo si me vete dhe tër-hoqi dorën nga dora e tij.

— Na prishën punë! — shtoi ai me zë të ulët dhe u ngrit në këmbë.

— Po ikën, a?

— Ngarko maqinat ti një herë, pastaj shohim. Do të gjejmë rast të bisedojmë më gjatë...

Ajo ktheu një herë kokën nga ai dhe i hodhi një vështrim hetues. Në çastin kur ai po zbriste nga kabina, ajo i buzëgashi një herë, sikur donte t'i thoshte: «Në se ke pér të më thanë ndonji gja, përsë nuk e thue? Përsë e shtyn nga dita në ditë?» Drana ndezi menjëherë motorin se maqinat kishin zënë radhë pér t'u ngarkuar.

... Nga lindja po zbardhëllonte; errësira e natës po tretej dalëngadalë. Turni mbaroi dhe ata që do të ktheheshin në qytet, hipën në maqinën e fundit. Drana mbylli dyert e kabinës së vinçit dhe u nis pér në maqinë. Po pa bërë tre katër hapa, u kthyte edhe një herë pér të kontrolluar në se dyert qenë mbyllur mirë. Kanimoni me punëtorët e turnit të natës qëndroi në uzinë dhe Andrea e Drana bënë së bashku një copë rrugë në këmbë. Drana ecte e heshtur në mes të punëtorëve të tjerë. Një grup të rinjsh, megjithëse të lodhur nga puna, ngacmonin njëri-tjetrin dhe flisnin. Njëri nga ata u kthyte nga Andrea dhe i hodhi një thumb.

— Inxhinier Andrea, — tha, — na është bërë shumë serioz sonte. A mund ta gjeni përsë?

— Do të jetë nga pagjumësia, — ju përgjegj një tjetër.

— Jo, bre! i është ngjitur edhe atij sëmundja e Sefedinit.

Ata qeshën me të madhe. Bashkë me ta qeshi edhe Andrea. Atje ku rruga kthehej për në gurore, Drana qëndroi dhe thirri: — Natën e mirë, shokë.

Dikush ju afrua dhe i tha diçka me zë të ulët.

— S'ka nevojë, shok. Shkoj edhe vetë. Ja ku e kam shtëpinë, — ju përgjegj ajo dhe në çastin e fundit hodhi një vështrim të shpejtë nga Andrea.

«Po t'i kisha propozuar unë, që ta shoqëroja gjer në shtëpi, çfarë do të më thoshte? — mendoi Andrea. — Ku ta dish? Atje te vinci u tregua e gatshme për bisedë. Ndoshata sepse qe mërzitur vetëm. Jo, asaj nuk i erdhi mirë kur u ngrita për të ikur. Dhe kur zbrita nga kabina, më buzëqeshi. A nuk vlen një buzëqeshje e një vajze më shumë se mijëra fjalë?»

Kur morën kthesën e rrugës së madhe, shkëlqyen dritat e qytetit të ri, si një rrip i ngushtë që çante errësirën e natës. «Dritat janë të pakta, se edhe qyteti është ende i vogël. Por qyteti do të rritet e do të zmadhohet me shpejtësi. Edhe dritat e saj do të shumëzohen. Pas një kohe jo shumë të largët, këtu do të bëhet një det i madh dritash. Dhe njerëzit do të shëtisin në këtë det dritash. Në mes të tyre do të jem edhe unë. Po vetëm? Pse jo me Dranën për krah? Gjithnjë e më shumë më shkon mendja tek ajo. Por se rrugët e qytetit të ri nuk janë ndërtuar ende, as Dranën nuk e kam përbri. Ajo tani po bëhet gati që të flejë atje te barraka e vogël e gurores. Dhe rrugët e qytetit janë ende projekte të myllura në sirtaret e zyrës sime. Po s'do të thotë gjëkafshë kjo... Ajo ditë mund të vijë...»

IV. KANTIERI VAJTON

«Duart e tyre janë të ashpra e plot me kallo, ndërsa zemrën e kanë të mirë e të butë».

1

Kantieri nuk fjeti gjithë natën e së shtunës. Kantieri jetoi disa orë me ankth. Kantieri u gdhi duke pritur lajme...

Aty nga mbarimi i orarit të punës u përhap si vetë-timë mandata: Kola ra nga skela, Kola është në rrezik. Gjithë njerëzit e kantierit u nisën nga barrakat e nga klubit, nga dyqanet e nga rruga dhe u drejtuan për në banesat. Në sheshin e madh përpëra një godine karabina maqinat kishin formuar një kolonë të gjatë. Shoferët kishin ndaluar në vend që të merrnin vesh se në ç'gjendje ishte Kola. Dhe meqë ata nuk niseshin përsëri, do të thoshte se punët ishin keq...

Vetëm zyra e vogël e postës mbeti hapur. Ç'punë ka pasur atë pasdreke centralistia e postës së Gurrajt...

... Nuk vonoi shumë dhe në kantier mbërriti mjeku. Po as ai s'bëri gjë. Goja e Kolës mbetej e myllur. Ai sytë i kishte si të hapura, por nuk shihte njeri. As nuk fliste dot. Vetëm zemra i rrizte akoma. Dhe mjeku i rrinte pranë atje te një dhomë e papërfunduar, që ishte kthyer në ambulancë. Pranë tij rrinte Fatmiri, i cili kishte vetëm një dëshirë. Edhe të tjerët që ishin grumbulluar rrëth barrakës kishin po atë dëshirë: të shpëtonte shoku i tyre...

Në qielin e kthjellët u duk një helikopter. Ai bëri si një rrëth mbi kantier dhe u ul në sheshin përpara barrakës. Zogu metalik e mori Kolën në krahët e veta. Bashkë me të plagosurin u nis edhe mjeku. «Mos ka ndonjë njeri të tij, që do ta shoqërojë?» — pyeti mjeku në çastin e fundit. «Si s'ka? — u përgjegjën disa. — Ai ka gjithë kantierin» Po përnjëherësh sytë e të gjithëve u kthyen nga Fatmiri. «Binjakët e kantiereve» s'mund të ndaheshin as tani. Fatmiri do të futej edhe në sallën e operacionit. Po të ishte e nevojshme dhe e mundur, ai do të jepte edhe gjakun e vet, që të shpëtonte Kola.

Helikopteri u ngjit lart në quell dhe zhurma e tij nuk u ndie më. Pas pak u zhduk fare në pafundësinë e qiellit. Por njerëzit vazhdonin të shikonin gjithnjë lart. Ai kishte marrë me vete Kolën, kishte marrë me vete një pjesë të kantierit, kishte marrë një pjesë të tyre...

Atëhere ata u nisën në heshtje. Por nuk vajtën në shtëpi. U grumbulluan përpara postës. Sheshi i vogël përpara postës u mbush menjëherë me njerëz, sikur të ishte ndonjë miting. «Kola mbërriti në Tiranë». Kjo fjalë doli në fillim nga goja e centralistes... «Kola mbërriti në Tiranë» — u transmetua gojë më gojë në grumbullin e madh të njerëzve. «Kolën e futën në sallën e operacionit» — tha centralistja. Dhe lajmi u transmetua vetëtimthi: «Kolën e futën në sallën e operacionit». Gjithë njerëzit heshtën.

Heshtja qe e gjatë, e rëndë, e padurueshme. Më në fund një zë u dëgjua në mes të heshtjes së rëndë.

— Moj shoqe! Nuk ka lajme të tjera!

— Nuk ka! Nuk ka!

— Pse nuk ka? Pse?

— Pa pyet edhe një herë, moj shoqe! Pyet! Pyet!

«Operacioni vazhdon» — ishte përgjegjja. Dhe hesh-tja vazhdoi, më e rëndë se përpara..

Te xhadeja u duk një drithë. Drita u shua për një çast dhe u ndez përsëri. Maqina u ndal. Usta Jorgji, Sefedini dhe inxhinier Andrea hipën në karroceri. Ata s'mund të prisin më në kantier. Kushedi se c'po ndodh-te atje, në sallën e operacionit! Gjatë gjithë rrugës ky

mendim nuk u hiqej nga mendja. Dhe nuk këmbyen asnjë fjalë.

«S'ka gjë që s'bëhet Andrea! Mjafton të jesh i vendosur. Po, pér nder!...» — i tingëllojnë në vesh inxhierit fjalët e Kolës, atë natë kur qe kthyer nga turni i dytë. «Këtu nuk je më në barrakë, dhe çdo gjë duhet të jetë e bukur e hijshme. Po pér nder!» — ju kujtuan fjalët që i tha atë natë kur i vajti në dhomë bashkë me usta Jorgjin. «Mirë se na erdhe Andrea! Oh, sa mirë bëre që erdhe. Sonte do të flesh këtu. Dëgjove. S'të lëmë të ikësh...» — i kishte thënë të nesërmen.

Në korridорin e gjatë e gjysmë të errët të spitalit ata u takuan me Fatmirin. Fatmiri nuk u foli. Dhe ata nuk e pyetën gjë. Fatmiri ktheu kokën nga ana e murit. Edhe ata kthyen kokën nga ana e murit tjetër. Katër burra, katër miq të ngushtë, qëndrojnë të heshtur në këmbë pér një kohë të gjatë në korridorin e spitalit. Jo se s'kanë ç'të thonë, por nuk është koha pér fjalë...

Herët në mëngjez në kantier u përhap lajmi i zi. Centralistes ju zu fryma e s'mund të fliste. Azisi, që rrinte aty pranë sportelit, i tha me padurim!

— Folë, moj shoqe, folë! Ç'ka ndodhur? Pse hesht?

Ajo pa hapur gojën i dha Azisit receptorin e telefonit dhe mbuloi sytë me një shami të hollë e të bardhë. Në vesh të Azisit mbërriti një zë që mezi dëgjohej: «Kola vdiq!». A e dëgjoi me të vërtetë? «S'është e mundur! Si the, ore shok?» — i thirri Azisi me inat. Pse nuk i vjen qartë zëri? Të jetë vallë nga largësia, apo edhe atij tjetri që telefonon nga Tirana i zihet fryma?

— Kola vdiq! — tha përsëri zëri.

— Kush je ti, or shok? — mezi mundi të pyeste Azisi.

— Unë jam Fatmiri, Azis, Fatmiri... Dëgjo: ne do të vimë atje nga ora nëntë. Bëni gati maqinat.

— Maqinat?

— Maqinat e kantierit. Do ta çojmë në fshat, Azis, në familjen e vet...

— Kolën?

Zëri nuk u dëgjua më. Humbi. Njerëzit lëvizën përsëri. Këtë radhë vajtin nga ana tjetër e kantierit...

V. PROVA E MADHE

«Kjo që ndodhi ka qenë një kthesë e madhe në gjithë jetën e kantierit. Një kthesë akoma më e madhe ka qenë përmua...»

1

Oxhaku i madh po dilte gjithnjë më lart mbi korpusin kryesor e repartet ndihmëse të uzinës. Ai i ngjante një selvie të rre, që rritet në mes të një pylli të dendur drurësh të shumëlojshëm. Ndërsa drurët e tjerë lëshojnë degë anash dhe kanë prirje më shumë përtu zgjeruar, selvia çan gjithnjë drejt qiellit, pa patur frikë nga erërat e forta që fryjnë aty lart. Kështu edhe oxhaku, megjithëse ndërtimi i tij kishte filluar shumë më vonë se objektet e tjera të uzinës, po ngrinte çdo ditë shtat si një trung i stërmadh, pa gjethë e pa degë, po me rrënje të thella, që e ushqenin përbukuri dhe e bënin që të rritej me shpejtësi. Këto rrënje ishin musklat e forta të ndërtuesve...

Gjer në pesëmbëdhjetë metra lartësi, ndërtimi i oxhakut vazhdoi normalisht, pa ndonjë ngatërrresë e pengesë të veçantë. Mbi këtë lartësi mënyra e ndërtimit do të pësonte ndryshime. Tani do të viheshin në jetë mendimet që kishte shprehur Fatmiri atë natë në hangarin e madh të veglave e të maqinerive të ndërtimit. Për atë natë ato kishin qenë vetëm fjalë. Tani do të

kalohej në vepra. Në vend të një fije spangoje, tani do të lëshohej një litar i fortë dhe në fund të litarit, në vend të një guri, do të kishte një njeri. Prandaj, kjo punë pritej me një farë shqetësimi, edhe nga ata që e kishin marrë përsipër këtë punë, edhe nga përgjegjësit kryesorë të ndërmarrjes, edhe nga gjithë punonjësit e kantierit.

Sefedini vinte këtu dy tri herë në ditë. Dhe gjithnjë hipte lart dhe vështronte një herë tokën poshtë. Dhe toka i dukej sikur largohej gjithnjë më poshtë... Edhe inxhinier Andrea nuk shkonte më në mëngjez në korpusin kryesor, por do të kalonte një herë nga oxhaku e pastaj do të shkonte nëpër repartet e tjera.

Oxhaku po merrte gjithnjë më qartë formën konike, dhe sa më lart shkonte, aq më shumë hollohej. Në bazë kishte një qemer të madh nga ku mund të futej brenda një karro e tërë. Andej fillonte shkalla e brendshme prej druri në formë spirali që me ngritjen e oxhakut zgjatej gjithnjë më lart. Punëtorët qëndronin mbi një skelë që ndërtohej nga brenda. Materialet nrriheshin përsëri lart nga brenda me një elektro-argano, që e kishin montuar Lleshi me Gjetën.

Një ditë të bukur pranvere skela e jashtme u hoq se nuk hynte më në punë. Inxhinier Andrea qëndroi aty gjithë pasditën. Kontrolloi një herë mirë shkallën, skeletin e brendshme, elektro-arganon dhe materialet e tjera. Çdo punë e bënte një herë dy herë e tri herë, ashtu siç vepronte ditët e para të punës, së tij në kantier. «Po ta marrësh hollë hollë, — thoshte me vete, — tani është puna më me përgjegjësi se në fillim. Atëhere, po të bëja një gabim, edhe mund ta rregulloja. Ndërsa tani, edhe gabimi më i vogël nuk ndreqet më... Se kemi të bëjmë me jetën e njerëzve...»

Fatmiri me një çekiq në dorë zërthenë copa dërrash nga sipërfaqja e jashtme e oxhakut për të shikuar në se qe tharë mirë betoni.

— Nesër do të fillojmë dizarmimin, — tha në fund me zë të qetë.

— A nuk e lëmë për pasnesër, Fatmir? — i propozoi inxhinier Andrea.

— Pse? Afati për tharjen e betonit ka mbaruar. Provova në disa vende dhe pashë që është bërë tamam. Poo! Si duket këtu lart betoni thahet më kollaj.

— Afër mendsh me gjithë këto errëra që fryjnë këtu lart, gjithë ky diell që e rreh oxhakun nga të kater anët...

— Pra, pse ta lëmë për pasnesër? Që të humbasëm një ditë?

Inxhinier Andrea nuk foli. Donte t'i thoshte që të provonin edhe një herë në se çdo gjë qe gati, por gjakftohtësia e Fatmirit fliste vetë. Vështroi edhe një herë poshtë nga gryka e oxhakut dhe lartësia ju duk më e madhe nga ç'ishte në të vërtetë. Atë natë në dhomën e tij bëri shumë përllogaritje. Dhe të nesërmen u nis për në uzinë më herët se zakonisht...

Pa lindur dielli i ditës së re Fatmiri u lidh mirë e mirë me litar e u var teposhtë oxhakut. Makaraja kërciti thatë. Sefedini shtrëngoi fort litarin me të dyja duart. Inxhinier Andrea i trondit tur ktheu kokën nga ana tjetër që të mos e shihte. Në atë çast nga maja e malit po lindte dielli. Hieja e oxhakut po zgjatej mbi një shesh të madh të mbushur me thasë çimentoje, hekurishta dhe qyngje të mëdha e të vogla. Fatmiri e pa një herë hijen e gjatë dhe mendoi vetëtimthi: «Sa e gjatë është kjo hije, aq i lartë do të bëhet oxhaku. Hieja e mëngjezit do të zvogëlohet e do të shkurtohet, kurse oxhaku ynë do të rritet e do të naltohet».

Në çastet e para Fatmiri ndjeu si një boshllék në kraharor dhe sikur ju muar fryma. Makaraja nuk lëvizi më dhe litari u tendos mirë. Fatmiri u luhat disa herë andej-këtej dhe zgjati duart drejt dërrasave të armaturës që të mbahej. Luhatja u ndal menjëherë. Atëherë ngriti kokën lart dhe pa Sefedinin që ishte përkulur dhe diçka donte t'i fliste. Po zëri i tij nuk dëgjohej. Inxhinier Andrea nuk dukej fare...

Kur hodhi një vështrim poshtë, dalloi Lleshin që zgjaste duart, sikur deshte t'i thoshte: «Fatmir! Hic mos ki gjale, vëlla. Mua këtu më ke. Edhe sikur të ndodhë ndonjë gjë, të pres unë në krahët e mijë.» Fatmiri e ndjeu

veten të sigurt. Sikur nuk ishte më i varur në ajër, po sikur ndodhej në mes të shokëve. Ndai i buzëqeshi një herë Lleshit e pastaj Sefedinit. Kurrë ndoniëherë tjetër nuk i qenë dukur më të dashur e më të mirë shokët. Ja, tani dalloi edhe Andrenë që e vështronë prej së larti me një ndjenjë admirimi. Fatmiri i buzëqeshi edhe atij. Pastaj shikoi poshtë tokën. Toka ju duk më e bukur dhe më tërheqëse, tani që nuk shkelte më mbi të, por e kundronte prej së larti.

«Tani erdhi çasti» mendoi dhe nxori sqeparin nga brezi. Para se të fillonte nga puna, u thirri një herë me të madhe njerëzve poshtë, duke bërë shenja me të dyja duart:

— Largohuni shokë! Largohuni!

Të gjithë u larguan. Vetëm Lleshi qëndroi në vend.

— Ikë! — ja bëri me dorë Fatmiri.

— Si e ndjen veten? — i foli Lleshi me të madhe.

— Si në qiell! — ju përgjegj me të qeshur tjetri.

Lleshi bëri disa hapa imbrapa pa hequr syrin nga shoku. Fatmiri ngriti dorën e djathtë dhe i ra me sqepar një dërrase të ngjitur mirë në beton. Dërrasa nxori një zhurmë të shurdhët, po nuk lëvizi nga vendi. Nga e goditura trupi i Fatmirit u luhat majtas e djathtas. Padashur vuri buzën në gaz: «Kujtova se jam mbi ndonjë skelë të fortë, — tha me vete, — me këmbë të mbështetura në tokë». Dhe i ra përsëri dërrasës. Tani nuk u luhat aq shumë se me dorën e majtë u mbajt nga një dërrasë tjetër.

«Do t'i gjejmë çarenë edhe kësaj pune» — mendoi dhe i ra përsëri dërrasës, më me forcë tani.

Goditjet e Fatmirit dëgjoheshin edhe lart, në grykë të oxhakut ku qëndronte Sefedini me Andrenë, edhe poshtë ku priste Kola. Këto goditje të forta ishin si të rrahurat e zemrave të tyre. Befas dërrasa e trashë e armaturës u shkëput nga betoni dhe u përplas me rrapëllimë mbi tokë. Fatmiri u kolovit disa herë nga përpjekja që kishte bërë dhe nga balli i tij i nxirë nga dielli rrëshqitën pika djerse, që ranë mbi themelat e oxhakut.

Fatmiri fshiu një herë ballin me dorën e majtë dhe

ju vu përsëri punës. Kola i foli diçka nga poshtë me zë të lartë, por ai nuk dëgjoi. Nuk e linin të goditurat e forta të sqeparit. «Tani e kam më lehtë, — thoshte me vete, — se u hap një e çarë në armaturë dhe kam nga i kap dërrasat e tjera. Mirë thonë se çdo fillim është i-vështirë. Nesër do të jetë akoma më lehtë...»

Pasi hoqi dy tri dërrasa të tjera, u bëri shenjë atyre që ishin lart që ta kthenin makaranë nga e majta. «Do t'i vi rrrotull oxhakut, — mendoi. — Kur e shikon prej së largut, të duket si një shtyllë e gjatë, por kur i rrrotullohesh kështu pak nga pak me sqepar në dorë, atëhere e kupton sa i gjerë është. Por s'ka gjë. Sa më lart të shkojmë, aq më i hollë do të jetë...»

Dërrasat binin njëra pas tjetrës mbi tokë, duke ngritur një re të vogël pluhuri, që luhatej për një kohë rrëth bazamentit dhe pastaj shpérndahej, gjersa të binte një dërrasë tjeter. Fatmiri një herë punonte me dorën e djathtë e mbështetej me dorën e majtë, një herë me të majtën e mbahej me dorën tjeter. Ngandonjëherë dora i rrëshqiste nga dërrasa ku mbahej dhe trupi i tij kolvitej si një shilarës. Ai kishte punuar një jetë të tërë mbi skela dhe nuk i merreshin kurrë mendtë në çdo lartësi që të gjendej, por kishte punuar ama gjithnjë me këmbët të mbështetura fort mbi një skelë. Ndërsa tani puna ndryshonte. Pak nga pak ndjente në këmbët një të mbirë, që i ngjitej gjithnjë më lart në trup. Prandaj herë-herë ndalej, ndërronte qëndrim dhe mirrte frymë thellë. Dhe përsëri u binte dërrasave me sqepar. Kur pushonte për një çast që të ndërronte sqeparin nga njëra dorë në tjetren, vështronte shokë të njojur që kalonin poshtë e që qëndronin ca në vend për ta vështruar më mirë. Disa nga ata e përshëndesnin dhe iknin; por ai nuk ua dëgjonte zërin; vetëm shenjat e duarve shihte. Po s'kishte si t'u kthente përshëndetjen...

Kur ra poshtë dërrasa e fundit e armaturës, dielli që ngritur lart në kupën e qiellit dhe digje si saç. Fatmiri vështroi për herë të fundit sipërfaqen e dizarmuar të oxhakut, dhe lëmoi me çekiç disa të dala betoni, që kishin ngelur në boshllëqet e dërrasave të ar-

maturës: «Duhet të dalë edhe i bukur» — tha me vete, pasi i dha fund punës. Pastaj u bëri shenjë shokëve që ta têrhiqnin. Makaraja kërciti thatë dhe litari nisi të mbështillej. Ndërsa po ngjitej, ai vështroi një herë poshtë që t'i bënte Lleshit shenjë me dorë, por, sado që vështroi mirë rrëth e rrrotull, nuk e dalloi gjëkundi. «Të ketë ikur vallë Lleshi?» — mendoi. Litari u mblodh dhe ai u gjend buzë grykës së oxhakut, pak më lart se shokët e tij që e prisnin. Një dorë e fortë e kapi përv krahu dhe e têrroqi brenda. Ai qe pak si i trullosur dhe nuk e dalloj menjëherë se e kujt ishte ajo dorë. Kur këmba i shkeli mbi dérrasat e ske-lës, ai ngriti trupin dhe në çast u gjend në krahët e Lleshit, që e puthte në fytyrë, duke belbëzuar: «Fatmir, vëlla! Të lumshin duart!» — dhe e shtrëngonte përsëri në kraharorin e tij të gjerë. Sefedini i shtrëngoi një herë dorën fort dhe pastaj e përqafoi me një përzemërsi, që s'ishte e zakonshme për të. Kjo gjë u bëri përshtypje të gjithëve sa ishin atje.

Inxhinier Andrea ktheu një herë kokën nga e majta: ai nuk mundi të kuptonte përsë sytë i qenë mbushur me lot. Për një çast u luhat dhe s'dinte si të bënte. Fatmiri po përqafohej me të tjerët. Atëhere Andrea, i shtyrë nga një forcë e brendshme, ju afrua Fatmirit, e përqafoi dhe e puthi me gjithë zemër. Buzët ju njomën nga djersa që i kullonte tjetrit në fytyrë. U mat një herë t'i thoshte diçka, por e pa se s'ishte kohë përfjalë dhe i ra lehtë me dorën e majtë në shpinë.

— Po ti je qull, bre Fatmir! — thirri dhe e têr-hoqi dorën menjëherë.

Atëhere vunë re se këmisha e trashë e Fatmirit ishte njomur e tëra, sikur të kishte dalë në atë çast nga uji.

— Tani zbresim shpejt e shpejt, — tha Lleshi dhe rrëshqiti i pari te poshtë shkallëve të ngushta.

Kur dolën nga qemeri i madh i oxhakut, e rrëthuan nga të gjitha anët njerëz, që donin të takoheshin me shokun e tyre të punës.

— Hapuni, shokë! — u thirri me të madhe Sefedini. — S'është kohë për kësi gjérash tani. Nesër në mëngjez këtu do ta keni Fatmirin.

Por ata nuk u hapën. Ishte hera e parë që urdhëri i Sefedinit nuk vihej në jetë. Dhe ai nuk nguli këmbë që të zbatohet...

2

Kur u larguan disa hapa nga oxhaku, Sefedini ktheu një herë kokën dhe vështroi prapa. Ndryshe nga rastet e tjera, këtë herë nuk e mbajti brenda gjëzimin që ndjeu.

— Pa shikoni, ore shokë! Sa i lartë duket oxhaku tani! — thirri dhe qëndroi në vend.

Pjesa e dizarmuar e oxhakut, që para disa orësh që veshur me dërrasa të vjetra, e bënte atë të dukej më i lartë, sikur të kishte hedhur shtat menjëherë.

Të gjithë së bashku u futën në një bufe të vogël aty në oborr të uzinës, pranë xhadesë. Rreth tyre u mblohdhën edhe të tjerë. Fatmiri u fut në një barrakë aty pranë për të ndëruar rrrobat. Sefedini porositi nga një kafe e nga një pijë për të gjithë. Lleshi qeshi me të madhe.

— Pse qesh, o Llesh? — e pyeti inxhinier Andrea.

— Është hera e parë që Sefedini futet në bufe për të pirë bashkë me shokët.

Sefedini e vështroi një herë vëngër, po nuk i tha asgjë.

— Nuk besoi të jetë kështu, — ja bëri inxhinieri, që t'i jepo hov bisedës.

— Atëhere pyesim bufetierin, — u përgjegj Lleshi dhe pa humbur kchë thirri: — Si thua ti, adash?

— Jo, kjo e sotmja është hera e dytë, — tha bufetieri — Shoku Sefedin ka hyrë edhe një herë tjetër këtu. E mbaj mend mirë, qe atë ditë që kishte përfunduar ndërtimi i këtij lokalit dhe kishte ardhur për të kontrolluar cilësinë e punimeve...

Ja plasën gazit që të gjithë. Bashkë me ta qeshi

edhe Sefedini. Fatmiri u kthyte me rroba të tjera dhe zuri një vend midis tyre.

— Si e ndjen veten? — e pyeti Lleshi.

— Mirë, o mirë.

— Është punë e vështirë Fatmir, ë? — e pyeti inxhinieri.

— Oj ky! — thirri Sefedini! — Si nuk është punë e vështirë? Të punosh i varur nga mesi a nga sjetullat, domethënë të punosh në hava.

— Kështu është, — tha qetë-qetë Fatmiri. — Me-që nuk mbështetesh gjékundi, të duket sikur s'ke fuqi që ta ngresh sqeparin që t'i biesh armaturës. Pastaj është luhatja. Ti i bie dërrasës dhe trupi të luhatet si një kallam. Dhe të ka ënda të mbështetësh këmbët në ndonjë vend të fortë. Të merr malli pér një çikë tokë. Poo!

— Dizarmimin tjetër do ta bëj unë, — tha Lleshi me gojë plot.

Sefedini e shikoi një herë si me inat.

— Pse më vështron kështu, o Sefedin?

— Sipas qejfit do të bëjmë këtu?

— Jo, kështu varur në litar nuk do të punosh asti Llesh as Fatmiri. Do të bëjmë një kafaz të mirë. Ja kështu — tha inxhinier Andrea dhe, pasi nxori një letër e një laps nga xhepi, vizatoi shpejt e shpejt një arkë të madhe, sa një kovë prej druri.

Sefedini e vështroi me kujdes kafazin e vizatuar dhe sikur ra në mendime.

— Nuk të duket i mirë? — e pyeti inxhinier Andrea.

— Kështu në letër është mrekulli, po duhet të mendohemi një herë, — tha Sefedini. — Se kafazi do të ketë luhatje të mëdha nga të goditurat dhe mund të na ndodhin gjëra të tjera.

— E ke fjalën pér ndonjë aksident?

— Sigurisht.

— E di si do të bëhet? — shtoi me bindje Andrea.

— Kafazi duhet përdorur, por njeriu të jetë edhe i lidhur nga mesi, pér çdo gjë që mund të ngjasë.

— Kështu po, s'kam asnje kundërshtim. Të bëhet kafazi menjëherë.

Sefedini piu shpejt e shpejt kafen dhe u ngrit.

— Dhe tani, djema, të shpërndahemi. Secili në punën e vet. Ti Fatmir, në shtëpi, — tha si me urdhër. Pastaj si u mendua pér një copë herë, u drejtua nga Andrea: — Sikur e kishim të shkonim andej nga baza sot, o inxhinier?!

— Duhet të shkojmë patjetër. Atje na pret edhe Sahiti.

Hipën në maqinë dhe u nisën. Rrugës nuk folën fare. Secili ishte zhytur në mendimet e veta sipas grafikut. Ato që ndodhën tek ne kohët e fundit, ishin si një vërshim, kur fryhen ujërat dhe s'ke nga t'ja mbash. Pa ujërat e vërshimit janë duke rënë. Tani na duhet të punojmë që t'i fusim ato përsëri në kanal. Kjo ka rëndësi. Kemi mungesa materialesh, por prapëseprapë do t'ja dalim... S'ka si bëhet ndryshe...»

Edhe inxhinier Andrea, duke marrë kthesat e rrugës me shpejtësi, mendohej: «Kjo që ndodhi, ka qenë një kthesë e madhe në gjithë jetën e kantierit. Një kthesë akoma më e madhe ka qenë pér mua. Tani një gjë duhet të pranoj: se unë kthesat e rrugës i marr kollaj, kur drejtoj maqinën si tani, por kthesat e jetës i marr me vështirësi, bile mund të them, me frikë. Përse vallë? Kur është puna pér të bërë përllogaritje, unë dal gjithnjë faqebardhë. Por kur shtrohet detyra që të realizohet një kthesë e fortë, unë mbetem në bisht. Dhe vendin e parë e zënë të tjerët. Ja, njerëz të tillë si Sefedini, Fatmiri, Lleshi e me radhë. Kjo ka një burim të thellë. Unë në fakultet, e pastaj në jetën time si nëpunës, kam studjuar nëpër libra dhe njoh mirë cilësitet kryesore të cimentos, të hekurit, të rërës, të gëlqeres, të gurit, të lëndës së drurit dhe mbaj mend formulat e rezistencës së këtyre materialeve të ndërtimit. Por nuk kam studjuar dhe nuk kam njohur ende mirë njerëzit, ata që ndërtojnë uzinën, oxhakun, qytetin e ri. Nuk është puna që të studjoj njerëzit në

përgjithësi, por të njoh mirë njerëzit tonë, ndërtuesit e vendit tonë, që kanë marrë përsipër që brenda disa pesëvjeçarëve, të bëjnë atë që s'është bërë tek ne për shekuj me radhë...» Përnjëherësh ndjeu se si i vërshoi në zemër një ndjenjë e gjëzueshme...

Kur arritën në bazë, shkeli frenin e gazit dhe maqina u ndal në mes kapicash, të mëdha shtyllash, qyngjesh, plintash e pllakash betoni... Aty kaluan gjithë pasditën. Më ndonjë orë natë u nisën për t'u kthyer në kantier.

— Inxhinier! Pa prit një minutë të shohim se ç'na kanë gatuar sot këta, — i tha Sefedini kur ju afroan uzinës.

Maqina u ndal dhe Sefedini përshkoi me hapa të mëdhenj e të shpejtë oborrin e madh. Pas pak ai humbi në labirintin e ndërtesave, që përbën kompleksin e uzinës. Por nuk u vonua shumë dhe doli nga një anë tjetër, duke fërkuar duart i kënaqur fort.

— Asnjëherë tjetër nuk është realizuar plani si sot, — i tha dhe zuri vendin e tij të mëparshëm në maqinë.

Sahiti donte të mësonte hollësira mbi realizimin e planit në sektorët e ndryshëm. Inxhinier Andrea dëgjonte shifrat që i jepte Sefedini, por mendjen e kish-te gjetëkë. «Është e qartë, — thoshte me vete, — se nuk është vetëm Fatmiri që sulmon drejt lartësive të mëdha. Shembullin e tij e ndjekin edhe të tjerët. Secili sipas mënyrës së vet. Punët po na shkojnë mbarë.»

3

Drana e kishte punën në turnin e parë atë ditë dhe u kthye mjaft herët në shtëpi. Ajo hoqi shpejt e shpejt rrobat e punës, rrregulloi disa gjëra në hashef dhe vajti te Fatimeja për të pyetur për orën. Gjithë atë ditë të gjatë vere ajo ndjeu një shqetësim të ëmbël, që me afrimin e mbrëmjes, ju shtua gjithnjë më shumë.

Tezja nuk ishte kthyer ende. Drana doli dy tri-

herë te dera dhe vështroi nga ana e rrugës. Ajo nuk dukej gjékundi. «Po sikur të mos kthehet gjersa të ngryset? — tha me vete, duke vështruar diellin që perrëndonte nga ana e detit. — Si do të bahet mandej? Kush do t'i mbajë fëmijët, po të mos kthehet ajo? Ata të fidanishtes kanë shumë punë në behar e punojnë me orar e pa orar». U fut përsëri në dhomë dhe ju duk sikur qe errur fare. «Shkoi ora» — bëlbëzoi dhe zemra i rrahu fort. Donte të shkonte edhe një herë te fqinja që të pyeste pér orën, por mendoi se kjo mund ta bënte të dyshonte Fatimenë dhe dërgoi djalin e madh të tezes.

— Ora ka vajtur gjashtë! — thirri vogëlushi nga dera dhe u lëshua tëposhtë shkallëve pér të vazhduar lojën.

Drana ndjeu një të rrënqethur në trup dhe tha me vete: «Do të nisem!» Ajo këtë vendim e kishte marrë më përpara, por tani mposhti edhe ngurrimet e fundit... Pa humbur kohë, vuri një pasqyrë të vogël e të rrumbullakët mbi parvazin e dritäres dhe nisi të krihte flokët, duke kënduar me zë të ulët një këngë që e këndonin të rinjtë e kantierit.

Tani që kishte marrë vendim, nuk përmbahej dot, ajo donte që të shkonte sa më parë ora. Mbrëmja vërtet po afrohej, por shumë ngadalë! Ajo ndaj të ngry-sur, do të takohej me Andrenë... Dhe pér Dranën, që pér herë të parë do të takohej me një djalë, kishte diçka të jashtëzakonshme...

Ajo edhe mbrëmë natën kur kishte rënë në dyshek, nuk e kishte ndjerë veten të qetë. Herë-herë pendohej që i kishte dhënë fjalën Andresë pér takimin e tyre të parë; herë-herë i dukej nata shumë e gjatë dhe sikur nuk do të vinte kurrë ai çast që ajo e kishte pritur prej kohe. Meqë nuk e zinte gjumi, sillte ndër mend fjalët që kishin këmbyer atje në bazën e materialeve të parafabrikuara. Ajo sapo kishte mbaruar punën dhe fshinte me një leckë duart, që i kishte larë me benzinë. Se nga kishte dalë ai atë çast nga stivat e shtyllave prej betoni, ajo as që e kishte ndjerë

fare... I qe afruar me hap tē shpejtē dhe i kishte folur jo si një i huaj, por si një njeri i afert.

— Dranë! Kur do ta vazhdojmë atë bisedë që kemi filluar?

Ajo, megjithëse e priste një gjë tē tillë, ngrysni një herë vetulla dhe e vështroi si me inat.

— Hë, si thua? — nguli këmbë ai.

— Ke pér tē më thanë ndonji gja?

— Oh, moj Dranë, sa kemi pér tē thënë ne tē dy!..

— Çdo gja që tē kesh, ma thuej këtu, — ju përgjegj ajo me një gjakftohtësi tē shtirur.

— Jo këtu, s'na lë zhurma e motorit, — bëri shaka ai.

— E fikim motorin po tē duash, — ju përgjegj edhe ajo me shaka e me një buzëqeshje tē lezecme.

Andej nga sheshi i pregetitjes së pllakave u dëgjuva zëri i Sahitet, që pyeste disa punëtorë.

— Mos keni parë kryeinshinierin, or shokë?

— Dëgjon? Të kërkojnë, — i tha ajo.

— Përsëri s'na lanë tē qetë, moj Dranë! Ndaj nësër në mbërëmje, aty nga ora shtatë, takohemi matanë banesave, atje te ai plepi i madh pranë sheshit sportiv...

Ajo e shikoi një herë si e hutuar. U mat një herë t'i thoshte se ajo s'kishte orë dhe do ta kishte vështirë tē shkonte tamam në kohën e caktuar, por ai, sikur ta kishte kuptuar mendimin e saj tē fshehtë, ja bëri të partë:

— Aty ndaj tē ngrysur, Dranë. Ika unë se më kërkojnë. Hajde, mirë u pafshim atje tanë!

Ajo uli kokën në shenjë pohimi dhe ai u largua me nxitim. Kjo shenjë e vogël qe e mjaftueshme pér tē.

...«Sikur tē mos shkoj në takim?» — mendoi pérnjë çast Drana, ndërsa ishte duke u krehur. Po pérnjëherësh u pendua që mendoi kështu. «Fjalë asht kjo?

— tha si e zemëruar me veten e saj dhe ngrysni vetullat e zeza. Dhe sikur tē mos shkonte vetëm fytyrën e saj në pasqyrë, por edhe fytyrën e tij, vuri buzën në gaz dhe pëshpëriti: «Andréa, ja ku po nisem! Nuk shikon që po bahem gadi? Si nuk do tē vij në takim?! Unë ta kam dhanë fjalën dhe do ta mbaj. Jo vetëm

për këtë takim të parë, po pér gjithë jetën teme. Lene mandej që nuk asht puna vetëm që t'i qëndroj fjalës... Ti e kuption edhe vetë, Andrea... Apo jo?...»

Mbylli një herë sytë me nië ndienië kënaqësie të thellë, po përnijëherësh i hapi si e tmerruar. Për një çast i ishte kujtuar ftyra e atij tjetrit, ftyra e kunatit të krisur, që e kishte ndjekur atë natë në festival. Aio vuri dorën në kraharor e mori frymë thellë. Pastaj pshëriku një herë si e lehtesar dhe, duke lënë krehërin në parvaz të dritares, bëri me dorë, një gjest sikur donte të thoshte: «Larg ju, hije të errësinës! Nuk ju tremben ma.»

Tisi i hollë i natës verore nisi të zbriste ngadalë nga ana e malit. Drana u rrëqeth e tëra. S'kishte më dyshime! U përkul edhe një herë në pasqyrë rregulloi me nxitim flokët. Po përsëri në pasqyrë pa edhe ftyrën e tij: «Po vij, Andrea, po vij!» — tha me atë buzëqeshje që e magjepste Andrenë. Te shkallët u dëgjuan hapa të lehtë. «Po vjen tezja» — tha me vete dhe u largua nga pasqyra.

— Ku ke me shkue, moj Dranë? — i tha tezja, kur e pa që bëhej gati të dilte.

— Do të shkoi te Malia, — i tha me një frymë dhe padashur kafshoi buzët. Ishte hera e parë që nuk i thoshte të vërtetën tezes.

— Në këtë orë? — tha tezja si e habitur.

— Më ka thirrë që ta ndihmoj pak në punët e shtëpisë — vazhdoi Drana dhe pa pritur përgjegje veshi fustanin e ri. E kishte qejf atë fustan, jo vetëm se i shkonte shumë pas shtatit, por edhe se i kujtonte diçka: ishte fustani i parë që ajo kishte blerë në kantier me rrrogën e saj të parë... Nga frika se mos i dilte ndonjë pengesë e papritur në minutën e fundit, ajo u ngut që të dilte sa më parë nga barraka. Tezja e vështronte si me dyshim. e thoshte me vete: «Pse ban kështu kjo cucë sonte? Mos ka ndonji gja që s'e di as unë?» Në çastin që ajo po dilte nga dera, tezja e porositi:

— Kthehu shpejt, Dranë!

— Mirë tëze! — ju përgjegj ajo dhe iku si era, sikur e ndiqte njeri nga pas. Ajo edhe rrugës ecte me hap të shpejtë, të nxituar. Fytyra i kishte marrë ngjyrën e trëndafilit të paçelur plotësisht. Sigurisht jo vetëm nga nxitim... .

4

Edhe për Andrenë ky takim me Dranën nuk qe diçka e zakonshme. «Çudi, — thoshte me vete kur u nis ndaj të ngrysur nga uzina për në vendin e takimit, — mezi e kam pritur këtë çast. Kështu si sot nuk më ka ndodhur as atëhere kur isha një çunak i ri dhe jam nisur për në takimin e parë. Çdo ditë kuptoj më mirë se kjo histori me Dranën vërtet filloj nga syt, por tani sikur hedh rrënje të thella në zemër...»

Që nga çasti kur Drana kishte dhënë pëlqimin e saj për të ardhur në atë takim, Andrea e kishte ndjerë menjëherë se një kthesë tjetër e madhe po filonte në jetën e tij. Konceptet që kishte pasur ai për dashurinë e për martesën, po vihesin tani në provën e jetës dhe shumë prej tyre shpërndaheshin si mjegull nga flladi i freskët i një mëngjezi pranveror.

Pa e ndjerë kishte kapërcyer bregoren dhe kishte marrë tëposhtë drejt xhadesë. Pak më tutje shtrihej një djerrinë e madhe që të rintjtë e kantierit e kishin kthyer në fushë sporti. Andrea, ndërsa ishte duke ju afruar fushës së sportit, nuk kishte as më të voglin dyshim për ardhjen e Dranës. Dhe me të vërtetë, ajo 'e priste atje, te vendi i caktuar. Në dritëtëhinen e mbrëmjes verore ai e pa se si qëndronte në këmbë, duke u mbështetur pak te trungu i lëmuar i plepit. Dhe shpejtoi hapin që të arrinte sa më parë. Ajo e ndjeu që po i afrohej me nxitim dhe bëri një hap përpara që të pakësonte largësinë që e ndante nga ai, ndërsa zemra i rrihte më fort se çdo herë tjetër... .

* * *

Me nja dy tri orë natë ai e shoqëroi Dranën gjer afër gurores.

— Andre, tani duhet të ndahemi, — i tha ajo, duke i shtrënguar krahun.

— Edhe pak, edhe pak, moj Dranë, — pëshpëriti ai në vesh. — Dhe kur thamë që do të takohemi prapë?

— Të shtunën në të errun...

Pas katër ditësh! Sa keq! Do të na duken këto katër ditë si katër muaj.

— Do të shihemi edhe atje në punë, André.

— Pse, takime janë ato?

— Sa me u çmallë.

Kështu shëtitën të përqafuar edhe ndonjë orë në afërsi të gurores. Nuk u bënte zemra të ndaheshin.

— Tash doli hëna dhe do të na shofin, Andre — i tha ajo dhe bëri që të tërhiqtë krahun e saj nga dora e tij e fortë.

— Edhe nga hëna ke frikë ti, moj Dranë?

— S'asht punë frige këtu. Sa të vijë ajo ditë kur do të dalim kështu prej krahu edhe nën dritën e dieillit... dhe u largua prej tij.

Andrea e përçollti një herë me sy, gjersa ajo u fut në barrakë; pastaj mori rrugën e kthimit. Ai ecte si i dehur nga lumtëria. Nata i dukej e bukur e ëmbël, e mahnitshme. «Dashuria zbuluron çdo gjë, — tha me vete. — Dashuria i jep një kuptim të thellë jetës së njeriut. Dhe këtë të vërtetë të madhe e kuptova më mirë sonte...»

Në vend që të shkonte rrugës për t'u kthyer në dhomë, mori një rrugicë rrëzë kodrës, që të nxirrte te burimi i ujit. Së andejmi pallatet e qytetit të ri nuk ishin larg.

Nga vajzat që kishte njojur në jetë, mbresa më të thella i kishte lënë Lili. Jo vetëm se marrëdhënjet e tij me atë kishin vazhduar për një kohë të gjatë, por edhe për shumë arësyë të tjera. Lili ishte një vajzë e bukur dhe e kulturuar. Megjithëse kishin kaluar

afro dy vjet nga takimi i tij i fundit me Lilin, ajo i dilte gjithnjë përpëra e pastër si bora, e veshur dhe e pispillosur punë e madhe, duke ecur me hijeshi mbi pllakat e trotuareve të Tiranës. Por dashuria e saj kishte qenë e sipërfaqshme. Ajo vinte komoditetet e jetës së qytetit mbi dashurinë.

Përballë saj i del tanj Drana, Drana zeshkane me vetulla të trasha e sy të zez. Drana malësore që me duart e saj të lyera me vaj e benzinë i bën atij shenjë nga kabina e vinçit që të shkojë atje. Dhe ai niset menjëherë pa ngurrim drejt saj. Atje është i sigurt se do të gjejë dashuri të vërtetë...

Shpejt kapérceu kodrën dhe mbërriti te burimi. Atje zbriti një si shkallë të formuar nga këmbët e njerëzve dhe piu ujë. Pastaj lagu fytyrën dhe u ngjit përsëri. Atij i pëlqente shumë ky burim me atë korien e vogël të vidhave gjigande si një kurorë e blertë, që merrnin nga burimi fuqi dhe i falmi atij hijeshi. Rreth e rrrotull ngriheshin disa shkëmbinj në formë gjysmërrrethi. Sipas legjendës së këtyre anëve, këta shkëmbinj ishin fronat e shtojzovalleve që zbrisnin çdo natë nga mali për t'u larë te burimi.

Ngjyrat humbasin natën gjallërinë dhe forcën e tyre, ndërsa tingujt dhe aromat marrin një forcë të veçantë. Bari i thatë nga dielli përvëlonjës i ditës të dehte me aromën e tij tanj që e njomte nga pak vesa dhe freskia e natës. Shushurima e ujit që zbriste përposh përroit, si një melodi pa mbarim, merrte një kup-tim të veçantë për Andrenë. «Këta janë tingujt dhe aromat e dashurisë» — tha me vete dhe solli ndërmend Dranën gjatë takimit në një çast që ai s'do t'a harronte kurrë. «A më dashuron, ti Dranë?» — e kish pyetur ai atje te plepi. Ajo kish ngritur një herë sytë e saj të zez, e kish vështruar si e menduar, por nuk i qe përgjegjur: «Pse nuk flet, moj Dranë? Pse e ndrydh zemrën? Akoma ngurron?» E kishte nxitur ai që të fliste. «Andrea!» — qe përgjegjur ajo me një zë që sikur i dilte nga thellësia e shpirtit. «Asht fjalë e madhe ajo që më kërkon ti.» «Por kur do t'ma thuash

Dranë këtë fjalë të madhe?» «Do të vijë koha, Andrea, pëdhe do të ta them nji herë e mirë.» Dhe ai e kish putur me dashuri, duke i pëshpëritur: «Dranë, tanë të dua më shumë!»

«Në përgjegjen e saj kishte edhe çiltëri edhe vendosmëri. Po sikur të kisha ngulur këmbë më shumë? Si do që të bëja, ajo nuk do të fliste më shumë sonte. Sa më mirë e njoh aq më tepër bindem pér këtë. Sa rrugë të vështirë ka bërë ajo pér të arritur këtu që është sot. Dhe me vrullin që ka marrë, ajo ka pér të ecur shumë përpara. Ndoshta kjo është që më tërhoqi më tepër drejt saj...»

Në dritaret e pallateve të qytetit të ri u shua edhe drita e fundit.

Ungrit nga shkëmbi dhe u nis pér në dhomë. Pashdashur ju kujtuan fjalët e usta Jorgjit: «Do të bëhesh edhe ti yni një ditë» — i kishte thënë ustai. — «Kur edhe kishte thënë këtë fjalë?» — u mundua ta sillte ndër mend Andrea. «A! E gjeta» — tha. Ai kallëzonte pér një ndeshje sportive midis skuadrës së Rëshenit e asaj të kantierit të Ulzës. «Në kantierin e Ulzës, — thoshte ustai, — nuk kishim vetëm tifoza sporti, por edhe nga ata që luanin futboll. Ata rregullonin ndonjë lëndinë dhe e kthenin menjëherë në fushë sporti. Pas disa ditësh shkonin atje eskavatorët dhe ua prishnin «stadiumin». Atëherë ata shkonin më tutje, në ndonjë lëndinë tjetër. More vesh? Mirëpo një herë deshën të mateshin me skuadrën e Rëshenit. Ata të qytetit vajtën në Ulëz me rroba e këpucë tamam pér futbollin, kurse këta tanët dolën në fushë me brekushe e me çizme. Kur e panë pisk, i hoqën çizmet e nisën të luanin zbathur. Por nga lodra nuk hoqën dorë. Ashtu të zbathur e me këmbë të gjakosura luajtën gjer në fund. Po loja e di si përfundoi? Dymbëdhjetë me zero. More vesh?» «Po kush fitoi, o usta?» — e pyeta unë. «Kush fitoi thotë ky! Ata të qytetit. Tanët lojtën të zbathur, ore! More vesh?» «Po ti aty ke qenë atëherë, usta?» «Jo, unë isha në Kurbnesh». «Po pse thua «tanët» atëherë?» «A! S'e di ti, or djali! Kështu e

kemi ne kur flasim për kantieret. Të gjithë njerëzit e kantiereve, tanët janë. More vesh? Kur të bëhesh edhe ti yni...» Kështu tha ustai atëhere. Andrea ju ngjit shkallëve me nxitim. Kur mbërriti në katin e katërt, vështroi një herë nga ana e gurores. «Drana me siguri fle tani» — tha dhe nxori çelësin nga xhepi për të hapur derën e dhomës...

5

Një ditë të nxehjtë gushti Sefedini me inxhinier Andrenë kaluan nga oxhaku që në mëngjez. Fatmiri qe varur me kovë dhe punonte për dizarmimin e një pjese të përfunduar. Lart, në grykë të oxhakut dallohej Gjeta, që punonte në elektro — argano. Sefedini i thirri me zë të lartë Fatmirit:

— Kur e mbaron këtë punë, o Fatmir?

— Mirë faleminderit, si u gdhive ti? — ju përgjegj Fatmiri.

— Ore, nuk dëgjon ky që flet kështu? — ju drejtua Sefedini kryeinixhinator.

— Me siguri që nuk dëgjon; nuk i thonë shaka; tani punojnë në një lartësi prej më se gjashtëdhjetë metrash.

— Po si i bëhet halli kësaj pune, inxhinier?

Inxhinier Andrea ngeli për një hop si i menduar.

— Duhet të lidhim me telefon grykën e oxhakut me bazën, — tha pas pak.

— E di që nuk e ke keq?

— Si s'na ka vajtur mendja më parë, bre burrë...

— Sikur kemi ndërtuar edhe dje kësi oxhaqesh, — tha Sefedini dhe biseda u mbyll me kaq.

Telefoni u vendos shumë shpejt në grykën e oxhakut, teli i tij zgjatej ngadalë, por me siguri gjithnjë më lart. Punëtorët, kur kalonin pranë oxhakut dhe dëgjonin zilen e telefonit, thoshin si me shaka: «Ky është telefoni i parë tek ne që na lidh me qiellin...»

Vendosja e telefonit u dha dorë atyre që punonin

lart të merreshin vesh shumë lehtë me shokët e tyre në bazë, por nuk i zgjidhi aspak vështirësitë e ndërtimit që përditë bëheshin më të mëdha.

Sefedini shqetësohej shumë për ngadalësimin që vihej re në ngritjen e oxhakut, sidomos pasi kaluan «kuotën gjashtëdhjetë e pesë». Kjo nuk ishte diçka e paparashikuar, por tani që e vërenin përditë më qartë, s'ishte e mundur të mos i shqetësonë të gjithë. Në një mbledhje të këshillit teknik, Sefedini, duke bërë analizën e punës, tha:

«Ne jemi si një ushtri që në frontin e sulmit nuk përparojmë të gjithë në një vijë...» Dhe përmendi sektorët e prapambetur të ndërtimit. Midis tyre ishte edhe oxaku. Fatmiri me njerëzit e tjerë të brigadës, që shkriheshin natë e ditë në punë, pa marrë para-sysh asnjë vështirësi, i dëgjuan me hidhërim këto fjalë të Sefedinit. Çmund të bënин më shumë?..

Vjeshta i gjeti njerëzit e brigadës për ndërtimin e oxhakut në valën më të madhe të punës. Shirat e parë të dimrit nuk kishin filluar ende, por disa shenja të ndryshimit të motit i ndjenin më shpejt e më qartë ata që punonin në grykë të oxhakut. Atje lart ndihej më mirë edhe era që frynte gjithnjë e më shpesh pas-diteve, edhe lagështia e mbrëmjes, edhe të ftohtit e mëngjezit. Këto shenja të para i lajmëronin ndërtuesit e oxhakut se po afrohej stina e keqe, kur do ta kishin shumë të vështirë. Dhe me të vërtetë pa filluar mirë, dimri u bëri një paralajmërim të befasishëm...

Ishte një mëngjez i butë vjeshte. Një natë më parë kishte vetëtirë shpesh andej nga perëndimi dhe ishte ndjerë njëzagushi mbytëse. Kur u nisen ndërtuesit për në punë, u panë aty-këtu në quell disa re të shpërndara, që lëviznin me shpejtësi. Aty nga dreka një re bardhoshe doli nga maja e malit dhe mbuloi menjëherë qielin. Pak nga pak reja nisi të merrte ngjyra më të errëta, sikur një dorë vigane ta spërkatë me pluhur qomyri. Një erë e fortë që frynte nga jugu, ngriti re të tëra pluhuri poshtë në fushë dhe aty pranë në oborrin e uzinës.

Fatmiri, duke punuar i varur në kovë, vështronte ngandonjëherë edhe retë që gjithnjë po uleshin më poshtë, edhe retë e pluhurit që ngriheshin gjithnjë më lart, sikur donin të bashkoheshin me ato të qiellit. Herë-herë toka poshtë nuk dallohej fare dhe ai humbiste nga sytë e shokëve që kalonin poshtë e lart. Po dërrasat e dizarmuara që binin herë pas here përdhe, tregonin se ai vazhdonte punën e tij, sikur të mos ndodhët asgjë...

— Drin, drin, drin! — ra zilja e telefonit lart në grykë të oxhakut.

Gjeta, i struktur prapa bazamentit të makarasë e mori telefonin në dorë dhe foli me zë të lartë, sikur të deshte të mbulonte zhurmën e erës.

— Alo! Alo! Ti je, Llesh?

Një si gjëmim i thellë i shurdhoi veshët. Kur ky gjëmim u pakësua pak, dëgjoi një zë që dukej sikur vinte nga një botë tjetër:

— Alo, Gjetë! Jam unë Andrea, Andrea!

— Nuk po të dëgjoj mirë. Deshe gja shoku inxhiner?

— Lajmëro Fatmirin të ndërpresë punën dhe të ngjitet lart. Po vjen shtrëngata...

Zëri nuk u dëgjua më. Gjeta e la telefonin dhe i thirri Fatmirit me të madhe. Po ku të linte era të dëgjoheshin fjalët? Atëhere Gjeta tërroqi pak litarin dhe kova u shkund. Fatmiri vështroi lart. «Mos më tërhiq, — i bëri me shenjë Gjetës. — Kam edhe ca dërrasa, akoma. Sa t'i hedh ato poshtë, të bëj shenjë që të më tërheqësh».

Në atë çast filloj shiu me pikë të rralla në fillim, që nisën të bëhen në gjithnjë më të dendura. Vetëtima verbuese çanin orë e çast qielin e vrenjtur dhe bu-bullimat dëgjoheshin gjithnjë më afër. Pemët në fushë përkuleshin nga era gjer në dhe. Një orizore, që shtrihet matanë kanalit të bonifikimit, dukej si një det i dallgëzuar. Natyra rrëqetëhej e tëra nga atrimi i dimrit... Fatmiri hodhi poshtë edhe dërrasën e fundit dhe ngriti një herë kokën lart. Një flakë e çuditshme i verboi

sytë dhe një gjëmim i tmerrshëm e bëri që të tulatej brenda në kovë. Çdo gjë sikur ju errësua. Dhe në atë errësirë të plotë ju duk sikur oxhaku u rrëzua përdhe, ashtu si rrëzohet një dru i lartë nga një goditje e fortë e sëpatës. Kova u kolovit disa herë si një lodër e vogël në një dorë të fuqishme. Por kjo vazhdoi vetëm disa sekonda. Ndërsa kova luhatej ende, ai hapi një herë sytë dhe pa se oxhaku qëndronte në këmbë, litari mbahej mirë dhe ai s'kishte pësuar gjë.

«Çfarë ka ndodhur? — pyeti veten apo hapi sytë. — Sigurisht ndonjë rrufe». Ngriti përsëri kokën lart, por mezi dalloj grykën e oxhakut. Retë e zeza kishin zbritur aq poshtë, saqë duke sheshin sikur mbështeteshin në oxhak. Shiu binte me gjyma. Fatmiri që lagur i terti. Ç'të bënte? Ku ishin shokët? Thirri një herë me të madhe:

— Gjetë! O Gjetë!

Asnjë përgjegje. Thirri përsëri. Dhe përsëri heshtje. Hodhi një vështrim poshtë dhe nëpërmjet mjegullës mundi të dallonte tre katër njerëz që vraponin në mes të shiut drejt oxhakut.

«Kushedi ç'ka ndodhur! atje!» — tha me vete dhe mendja i vajti te shokët. Ai për vete gjendej i varur në kovë, në mëshirën e këtij tufani të tmerrshëm. «Po shokët ku janë?» — tha i shqetësuar në kulm.

Befas litari lëvizi. Kova u ngriti ndonjë gjysmë metër lart dhe qëndroi. Fatmiri ngriti kokën lart, me zemër të ngrohur nga një shpresë e re. Lart te gryka e oxhakut dalloj një dorë të fortë që u zgjat për të kapur më mirë litarin. «Kjo nuk është dora e Gjetës, — tha me vete Fatmiri. — Mos ka ardhur gjë Lleshi?».

Litari lëvizi. Po jo ashtu si mblidhej herët e tjera. Ai e mori me mend se makaraja nuk punonte më. Litari vazhdonte të mblidhej pak nga pak e copa-copa dhe kova ngrivej lart ngadalë e me vështirësi. Sa më lart ngrivej kova, aq më shumë ndjente Fatmiri në fytyrë e në trupin e lagur furinë e erës e të furtunës. Pa mbërritur mirë kova te gryka e oxhakut, një dorë u zgjat nga lart, e kapi Fatmirin nga krahu i majtë, e

shkundi disa herë me forcë dhe një zë i njojur i thirri:

— Fatmir! E, Fatmir! Gjallë je?

Disa duar u zgjatën e kapën kovën me shkathtësi dhe e tërroqën përbrenda. Lleshi, kur e pa se shoku i shtrenjtë qe i gjallë, hapi një herë krahët dhe e përqafoi me përmallim, ndërsa disa punëtorë të tjerë e shikonin Fatmirin me fytyrë të qeshur. Megjithëse stuhia tërbohej gjithnjë më shumë, Lleshi e Fatmiri ngelën për një hop të përqafuar, duke mos përfillur as shiu e rrëmbyer dhe as erën e marrë. Ata i jepnin njërit-tjetrit fuqi e ngrohtësi...

— Si janë shokët? — ishte pyetja e parë e Fatmirit.

— Mirë janë, Fatmir...

— Nuk u godit njeri?

Të gjithë heshtën. Lleshi mbeti ca si i menduar, sikur nuk dinte çfarë t'i thoshte.

— Ku është Gjeta, bre Llesh? Pse s'përgjigjesh? Folë! Folë të them!

— Zbresim më mirë poshtë, — ju përgjegj Lleshi sikur të mos kishte dëgjuar fjalët e shokut dhe pa e zgjatur më shumë, mori tëposhtë shkallëve.

Kur mbërriten poshtë në bazën e oxhakut, që i njigate një bodrumi të rrumbullakët, të mbushur me arka e materiale ndërtimi, Fatmiri dalloi në gjysmëerrësirë një grumbull shokësh, që diç biseton midis tyre. Kur u afrua më mirë, dalloi Gjetën të shtrirë mbi një arkë të madhe. Inxhinier Andrea i kishte hapur këmishten dhe e fërkonte në kraharor.

— Gjallë është? — pyeti me dëshpërim. Fatmiri.

— Gjeta shpëtoi për mrekulli. Po ne e kishim mendjen tek ty, or vëlla! — Ju përgjegj Andrea me zë të dredhur nga mallëngjimi.

Në atë çast Gjeta hapi sytë përgjysmë dhe vështroi si me ndrojtje rrëth e rrötull, por pas pak i mbylli përsëri, se nuk e duronte dot drithën. Fatmiri, u përkul mengadalë e puthi Gjetën në ballë dhe, duke i përkëdhelur leshrat e zez, pëshpëriti sikur të fliste me vete:

— Ti je trim me fletë, or djalë...

Gjeta hapi edhe një herë sytë dhe sikur buzëqeshi pak.

— Tani e ka marrë veten mirë, — i tha në vesh Lleshi. — Kur hipa unë lart që të tē tērhiqja ty, dukej sikur kishte humbur edhe të pamët edhe të dëgjuarit.

— Afër mendsh, o Llesh. Nuk i thonë shaka rrufesë. Edhe unë që ndodhesha disa metra më poshtë nga gryka, thashë se u verbova. Poo! Era përplasej me furi lart në grykë të oxhakut e përdridhej teposhtë, duke ulëritur si një bishë e plagosur.

Fatmiri ndjeu të rrëqethura në trup. Rrobat i qenë ngjitur në trup. Ai shtrydhi një herë cepin e kominoshit dhe menjëherë një curril uji u derdh në tokë.

— Tani ju të dy duhet të ndërroheni menjëherë, — tha inxhinier Andrea, duke vështruar nga ana e Fatmirit dhe e Lleshit.

— Mirë do të ishte, po ku të shkojmë, pa, nuk dëgjon se ç'bëhet jashtë?

— Të lajmërojmë të na vijë një maqinë e të shkonit menjëherë në shtëpi.

Një punëtor doli nga qemeri i oxhakut dhe vrapi është mes tē shiut. Pas pak u dëgjua zhurma e një kamioni që po afrohej...

— S'ka ndër mend të pushojë fare sot, — tha Fatmiri, duke vështruar jashtë shiun që binte me rrëmbim.

— Kështu bën në vjeshtë. Këto janë dufet e para të dimrit, themi ne andej nga fshatrat tona në Bregdet, — u përgjegj Andrea.

— Ore le të bëjë të vetën. Tërr s'na bën veshi.

— Dreqi ta marrë! Edhe qelli na lufton. Si duket s'i pëlqeka që të ngjitemi lart, — shtoi Lleshi me të qeshur.

— Moti do të bëjë të tijën e ne do të bëjmë tonën, — ju përgjegj Fatmiri! — Sikur edhe bota të përmbyset, ne do ta mbarojmë oxhakun pa derman.

Kamioni çau nëpërmjet gjoleve të ujit e të baltës e bëri mbrapsht drejt qemerit të oxhakut.

— Tani ikni, ju shokë — i porositi Andrea. — Ndërrohuni një herë dhe ngrohuni pranë zjarrit. Pa do

t'ja gjejmë ilaçin edhe kësaj pune. Njeriu është më i fortë se rrufeja! .

Fatmiri ktheu kokën dhe i hodhi një vështrim të shpejtë por shumë kuptimplotë. Kurrë ndonjëherë tjetër nuk kishte folur Andrea me aq bindje e vendosmëri si këtë radhë. .

VI. DO TË VIJË AJO DITË

«Të duket pa vend fjala ime, byrazer? E me gjithatë s'e tund as topi. Kantieri është si një ve... A nuk dalin prej vezës zogj pule, a pate, a thëllëze, sipas llojit të vezës? Edhe nga çdo kantier lind, të themi, një hidrocentral, a një fabrikë, a një qytet i ri. Dhe klloçka që e ngroh vezën, që të dalë zogu, e di kush është? Dora e punëtorit. Kështu...»

1

Inxhinier Andrea qe ngritur nga gjumi herët, si zakonisht, e po bëhej gati që të nisej për në punë. Në çastin që po lahej, ju duk sikur dëgjoi një të trokitur të lehtë te dera. «Të ketë trokitur njeri me të vërtetë apo më bënë veshët?» — tha dhe mbylli rubinetin që të dëgjonte më mirë. Vështroi një herë fytyrën në pasqyrë. «Bobo! Si më janë buhavitur sytë» — tha dhe në të njëtin çast gogësiti, gjë që tregonte se nuk ishte ngopur me gjumë. Një e trokitur më e fortë te dera ja ndërpreeu këto mendime.

«Kush do të jetë, vallë, në këtë orë? — tha duke vajtur për të hapur derën. — Mos i ka ndodhur gjë-kafshë Dranës?»

Po sa u habit kur hapi derën dhe pa përpëra tij Fatmirin!

— Ti Fatmir je? — e pyeti dhe mendja i vajti për të keq, për ndonjë aksident në punë a për ndonjë avari.

— S'do mend që nuk më prisje në këtë orë, — i tha qetë-qetë Fatmiri.

— Të të them të vërtetën, jo, po ç'ka ndodhur Fatmir?

— Asgjë nuk ka ndodhur, Andrea, mos u bëj me-rak. Unë kisha një punë të vogël me ty dhe thashë të vija të të mirrja që të niseshim së bashku për në punë.

Më tepër se fjalët e qetësoi toni i shtruar, më të cilin bisedonte Fatmiri. Po përsëri dyshimi nuk i ishte larguar. Që nga aksidenti i Kolës ai ndjente një shqetësim të fshehtë, që ende nuk i qe zhdukur plotësisht.

— Domethënë s'na ka ndodhur ndonjë gjë? — e pyeti për së dyti Fatmirin, ndërsa hynin që të dy në dhomë.

— Jo, bre! Ta thashë një herë.. .

— Ulu pra aty në karrige, sa të bëhem gati.

— Mos të zgjova gjëkafshë nga gjumi, Andrea?

— Ç'ne? Unë po bëhesha gati që të dilja për në punë. Nuk kemi thënë se njerëzit e ndërtimit ngrihen herët në mëngjez! . . tha Andrea dhe vuri buzën në gaz.

— Ç'janë këto çarçafe këtu, Andrea? — e pyeti Fatmiri, duke treguar disa letra të mëdha të hapura mbi tavolinë.

— A! Na ka ardhur planimetria e qytetit të ri, Fatmir.

— Vërtet? Kur?

— Dje.

— E aprovuar?

— Jo, ende, prandaj na e dërguan, që ta studjojmë dhe të bëjmë vërejtje.

— Ka gjëra të mira, Andrea?

— Gjëra të bukura, Fatmir, Sigurisht, ato janë ende në letër. Po si të ta them, i ka të gjitha tiparet e një qyteti socialist.

— Kur i duan vërejtjet tona?

— Pas tre muajve.

— Dhe ti ja nise menjëherë punës?

— E di kur kam fjetur mbrëmë, Fatmir? Pas orës dy...

— Pas mesnate, ore?

— Sigurisht.

Fatmiri e vështronte si me habi, pa ditur ç't'i përgjigjej, ndërsa Andrea thoshte me vete: «Ta dije ti Fatmir se ç'do të thotë për një inxhinier, studimi i planimetrisë së një qyteti të ri! Kjo është poezia më e bukur».

— Po cilin ke pasur mbrëmë në dhomë? — pyeti pas pak Fatmiri.

— Kam pasur Burhanin, Sahitin dhe Baftjarin.

— Se unë erdha edhe mbrëmë këtu tek ti, po dëgjova se kishit një bisedë të gjallë dhe nuk trokita...

— Në ç'orë erdhe? — pyeti Andrea, ndërsa me vete thoshte: «Ky që erdhi edhe mbrëmë diçka do të ketë, por nuk e thotë menjëherë» — dhe ndjeu përsëri shqetësim.

— Do të ishte andej nga ora nëntë e gjysmë...

— Po ç'të ka ndodhur, o Fatmir? Pa folë tani. Ti ke diçka. Pse ma mban fshehur? — e pyeti në befasi Andrea, duke mbathur këpucët.

— Vishu ti një herë, pa ta kallëzoj rrugës...

— Jo, jo, dua të ma thuash këtu. Nuk kam durim.

Fatmiri ngeli për një kohë si i pavendosur. Ishte e qartë se kishte diçka për t'i thënë, po përsëri ngurronte që ta kallëzonte. Dhe kjo e shqetësonte më shumë Andrenë.

— E di si është puna, Andrea? — ja nisi si me ndrojtje Fatmiri. — Ojhaku lëviz.

— Si ore lëviz oxhaku? — pyeti përnjëherësh Andrea.

— Ja, që lëviz. Po ç'të të them unë? Jo ndonjë lëvizje e madhe, bre vëlla, jo ndonjë luhatje që të duket me sy, por që e ndjen mirë, sidomos kur je lart në grykë, — tha Fatmiri dhe qëndroi.

— Pa vazhdo, Fatmir, — e nxiti Andrea në një mënyrë që tregonte se ai më tepër ishte qetësuar, se sa

i shqetësuar nga fjalët që kishte dëgjuar. Këtë e vuri re Fatmiri dhe vijoi më lirshëm:

— Unë e kisha ndjerë prej kohe. Mund të thuash qysh atëhere kur kaluam mbi kuotën pesëdhjetë. Kur hipja në majë, më dukej sikur qëndroja mbi një fron që një dorë e padukshme e ndukte lehtë. Po nuk thashë gjë, se m'u duk një gjë e pabesueshme dhe kujtoja se po lajthit. Poo! Këtë lëvizje të lehtë e kishte ndjerë edhe Lleshi edhe të tjerë. Por edhe ata e mbanin të fshehtë, pasi kujtonin se kështu u dukej. Po dje, pasi mbaruam dizarmimin e pjesës së tharë, u mblodh gjithë brigada në grykë. Kështu bëjmë pas çdo dizarmimi. Mblidhemi të gjithë në grykë e vështrojmë sa i është rritur shtati oxhakut tonë. Poo! Në atë çast frynte një erë e fortë. Dhe oxhaku nisi të luhatej më shumë se herët e tjera, ashtu si luan pak një degë druri nga fillidi i mbrëmjes. «Ore, shokë, oxhaku lëviz!» — thirri Gjeta. Të gjithë vëshitruam njëri-tjetrin. Dhe e nxorëm të fshehtën nga zemra: «Unë, — na tha Lleshi,— e kam ndjerë prej kohe këtë gjë. Por më vinte turp që ta thoja. Sa herë hipja këtu lart në grykë, më dukej sikur isha ulur mbi një ndenjëse dhe në këmbët e saj fërkohej një mace, që e ndukte lehtë». Kështu folën dhe të tjerë. E na hyri një frikë të gjithëve, Andrea, se mos nuk e kemi në terezi punën e na del oxhaku çyryk... Poo! Disa propozuan që të niseshim të gjithë të vinin tek ty. Po unë u thashë: «Mos u ngutni, or djema! Mos u alarmoni. Lermëni të shkoj të bisedoj një herë vetë me Andrenë». Ndaj erdha edhe mbrëmë...

— Kjo është e tëra? — pyeti si i lehtësuar Andrea.

— E paktë është kjo? Ti më the se nuk ke fjetur mbrëmë për çeshtjen e planimetrisë së qytetit, po edhe ne nuk kemi bërë ndonjë gjumë të qetë. Jo vetëm unë, po gjithë brigada. Tani që po vija tek ti, më priste Lleshi te shkallët e shtëpisë. «Hë vajte? Ç'të tha?» — më pyeti me padurim.

Andrea qeshi pak, po nuk tha gjë. Fatmiri e vë-shtronte në sy. Mënyra se si i priti inxhinieri fjalët e tij, e bëri që ta ndjente veten më të qetë, më të

sigurtë. Para disa muajve, kur hidheshin themelet e oxhakut, gjakftohtësia e Fatmirit i jepte zemër Andresë dhe i shpërndante dyshimet që e hanin përbrenda. Tani që u dilnin vështirësi teknike ndodhte e kundërtat...

— Nuk është gjë, kjo Fatmir, — filloi mengadalë inxhinieri. — Çdo ndërtësë e lartë ka një luhatje të vogël. Çdo gjë vertikale ka një farë elasticiteti. Më kupton? Pastaj betoni i ka këto veti...

Andrea i shpjegoi shokut shkurt e qartë arësyet përse luhatëj pak oxhaku dhe përfundoi:

— Nuk më kujtohet me saktësi sa centimetra duhet të lëvizë oxhaku ynë, tani që kemi kaluar kuotën 75. Të pyesim pastaj Sahitin, ai me siguri e mban mend ose do ta ketë shënuar në blokun e shënimeve, që e mban me vete. Sidoqoftë hiç mos u shqetëso. Luhatja e oxhakut nuk tregon se kemi lajthitur në përllogaritjet tonë, përkundrazi, tregon se punën e kemi në rregull dhe oxhaku mbahet e do të mbahet i fortë...

Fatmiri, kur dëgjoi këto fjalë, gati sa s'u ngrit përtë përqafuar Andrenë. Por u kufizua vetëm që t'i shtrëngonte fort dorën, duke i thënë:

— Oh, ç'na nxore nga një hall i madh, Andrea! Ç'na hoqe një peshë të rëndë në kraharor!

— Gabimin e kam unë, Fatmir, që nuk ju kam shpjeguar prej kohe, se kjo gjë do të ndodhë...

— S'prish punë kjo, Andre. Mjafton që u qetësuam, or vëlla.

— Hadje, shkojmë tani, — tha më në fund Andrea, duke vënë kasketën në kokë.

Zbritën me nxitim shkallët dhe dolën në rrugën e madhe. Pas pak u futën në lumin e njerëzve që drejtoshin për një uzinë...

2

Sa më lart ngrihej oxhaku, aq më e bukur dukej panorama që shtrihej përqark. Sa më shumë naltësohej

oxhaku, aq më tepér zgjerohej horizonti i vështrimit pér Andrenë: shumë gjëra që më parë i kishte të errëta në shpirtin e tij, bëheshin tani përditë më të qarta e më të thjeshta. I dukej sikur kishte një frysëmarrje më të gjerë...

Ndoshata kjo ishte arësyja që atij i pëlgente të hip-te çdo mëngjez në grykë të oxhakut. «Kjo është gjim-nastika më e mirë e mëngjezit, — thoshte si me shaka, — se u ngjitesh shkallëve me vështirësi e pastaj mbush kraharorin me ajër të pastër...»

E vërteta është që të hipje majë oxhakut tani, që kishte kaluar kuotën 75, nuk qe një punë e lehtë. Ai e bënte këtë ngjitje pér tetë minuta. Fatmiri me Lleshin e bënин pér pesë a gjashtë. Më i shpjetë nga të gjithë ishte Gjeta, që duke i kapërcyer tre e tre shkallarët e ngushtë mbërrinte në grykë, duke dihatur fort, pér tri minuta e ca...

Fatmiri shkonte përpara, Andrea pas. Pranë qemërit të lartë të oxhakut prisnin anëtarët e brigadës. Fjalët e kryeinshinierit, se luhatja e oxhakut nuk përbënte asnjë rrezik, kishin fluturuar dhe kishin mbërritur këtu më parë se ai. Andrea i përshëndeti punëtorët dhe ata i kthyen përshëndetjen. Në vështrimet e tyre ndihej një farë respekti, pér këtë njeri, që, ndonëse më i ri në moshë, ishte më i ditur se ata... Andrea e pikasi këtë mendim, ktheu një herë kokën dhe u buzëqeshi me përzemërsi, sikur donte t'u thoshte: «Kurrë ndonjëherë tjetër nuk e kam ndjerë veten aq shumë pranë jush si sot...»

Fatmiri po u ngjitej shkallëve i pari, pas tij shkonte ai. Aty nga mezi qëndroi një herë dhe mori frysëm thellë. Fatmiri u kthyte dhe e pyeti:

— U lodhe Andrea?

— Ecë, ecë! Të dalim në dritë.

Ngriti një herë kokën lart dhe nga gryka e ngushtë e oxhakut pa një unazë të vogël qelli, në një lartësi të pafund. Sa i bukur dukej qelli duke e vështruar nga kjo gjysmëerrësirë që mbretëronte në brendinë e oxhakut!

Fatmiri po i afrohej grykës. «Ka ecur ai, — tha me vete inxhinieri. — Duhet të shpejtoj hapin.» Dhe filloj përsëri ngjitjen. Ju kujtua ai oxhaku i vogël që kishte sajuar Fatmiri e Kola në hangarin e madh. Në vend të atij oxhaku të vogël, të bërë në miniaturë prej balte, ngrihej tani ky gjigand i lartë, i ndërtuar me hekurbeton prej duarve të njerëzve që kishte takuar që pari aty poshtë. I erdhën ndër mend dyshimet dhe luhatjet e tij kur do të merrej vendimi për ndërtimin e oxhakut. «Luhatjet e mia kanë qenë shumë më të mëdha se luhatjet e oxhakut tani — tha me vete duke buzëjeshur. — Luhatjet e mia ishin shumë të rrezikshme. Ato tregonin se unë nuk kisha besim të plotë në duart e këtyre njerëzve. Ndërsa tani ky oxhak i lartë ngre shtat lart e më thotë: «Po të duash të mos gabosh kurrë në jetë, ki besim në duart e këtyre njerëzve, që nga hiçi bëjnë mrekulli...» Pa dale... Unë isha ai që s'kisha besim tek ata? Unë, sigurisht. Po jo ky që jam sot, ai që kisha qenë atëhere...»

Fatmiri kishte mbërritur në grykë. Pas disa sekondash arriti dhe ai.

— Vështro Andrea, sa bukur! — i tha Fatmiri, duke zgjatur dorën nga ana e qytetit të ri.

Andrea vështroi panoramën e mahnitshme, që shtrihet përreth. Ishte një mëngjez i bukur vjeshte. Dielli sapo kishte dalë nga maja e malit, që kishte marrë një shkëlqim të purpurt. Qielli ishte i kthjellët me një kaltërsi të tejdukshme, që vetëm «behari i vogël» mund të pikturopjë. Fusha ishte ngjyer nga një dorë mjeshtri me një larmi të habitshme ngjyrash. Atje ku mbaronte fusha, fillonte deti. — Oh! Deti! — murmuriti padashur Andrea dhe ju kujtua koha e fëmijnisë në fshatin e bukur të lindjes, kur hipte majë shkëmbit të lartë për të soditur detin, që shtrihej para tij herë i qetë dhe i patrazuar, herë i dallgëzuar dhe i egërsuar... .

Në këmbët e oxhakut shtrihej uzina me repartet e shumta ende të papërfunduara, ku lëviznin mizëri njerëzish. «Në këtë orë fillon puna e turnit të parë, — tha me vete inxhinieri. — Ka hakë Sefedini që thotë se

uzina duket si një qytet i tërë në ndërtim. Ai hipte majë kodrës pér ta soditur plotësisht. Tani mund ta soditësh më mirë nga gryka e oxhakut...»

Matanë kodrës shihet qyteti i ri, me dy a tre rresh-
ta pallatesh. Atje ku mbaronin pallatet e përfunduara,
fillonin ndërtesa karabina. Pak më tutje nxinin hendeqe
të thella, të hapura rishtas në djerrinë. Padashur Andrea
vuri buzën në gaz. Ju kujuan fjalët e usta Jorgjitet:
«Këto hendeqe janë brazdat e ndërtimit. Bujku hap
brazda e hedh farën që të rriten bimët. Ndërtuesi hap
themele e mbjell fabrika e pallate, që i vadit përditë
me djersën e tij, që të rriten sa më parë...»

Andrea solli ndër mend planimetrinë e qytetit të
ri dhe tani nuk shihte vetëm pjesën e përfunduar të
qytetit, por e parafytyronte ashtu si do të ishte pas
disa vjetësh. «Ky qytet — thoshte me vete — po rritet
me shpejtësi të paparë. Këto ditë do të festojë përvje-
torin e tij të dytë dhe shiko sa është zhvilluar. Atje ku
projektuesi kishte shënuar me bojë speciale disa forma
gjeometrike, ai sheh fabrika, pallate, dyqane, parqe e
rrugë të gjera. Qyteti i ri është i rrethuar nga oxhaqe.
«Ky oxhak këtu është si dallëndyshja e parë, që para-
lajmëron ardhjen e pranverës industriale». Atje ku ende
ka baltë ai parafytron rrugë të asfaltuara. «Ja edhe
unaza e qytetit të ri, — tha, — sic e ka quajtur pro-
jektuesi. Ajo kalon rrëzë Kodrës së Divave, merr një
drejtim të lakuar — si unazë e vërtetë — dhe arrin
pranë burimit». Atje ai dallon shkollën e qytetit të ri.
Pak më poshtë, aty ku tani kullosin ende dhentë, i del
përpara syve pallati i kulturës. Në shkallët e tij të
mermerta hynë e dalin njerëz. Nëpër rrugët e qytetit
të ri ka lëvizje të madhe. Njerëzit ecin me shpejtësi.
Është ora e ndërrimit të turneve. Disa shkojnë në punë,
të tjerë kthehen pér në shtëpi... Dielli rrëshqet me-
ngadalë drejt perëndimit. Rrugët marrin një gjallëri
akoma më të madhe. Banorët e qytetit të ri dalin shë-
titje nëpër rrugët e asfaltuara, që i kanë të gjitha ka-
rakteristikat e rrugëve të qyteteve më të mira të ve-
ndit tonë. Vetëm një gjë u mungon: emri. Ato ende

nuk kanë një emër. Andreas i kujtohet se kur asfaltohej rruga e parë e qytetit të ri, punëtorët bisedonin midis tyre e thoshin: «Kësaj rruge do t'i japim emrin e Kolës». «Pse jo?» — tha me vete Andrea sikur bisedonte me një tjetër.

Në mes të njerëzve që shëtitnin në rrugën e gjerë ai sheh dhe veten e tij. Dhe jo vetëm, Ai mban prej krahu Dranën, «vajzën e kantierit», që tashmë është bërë qytetare e qytetit të ri.

— I bukur është qyteti ynë, hë Dranë? — i thoshte ai duke i shtrënguar dorën.

Ajo kthen kokën dhe e vështron në sy. Sa shumë flasin sytë e saj! Ata e vështrojnë Andrenë sikur duan t'i thonë: «Do ta bëjmë akoma më të bukur!».

F U N D